

Economicus

NR 3/2009

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONIMIK

Kryeredaktor

PROF. ASOC. DR. ADRIAN CIVICI

Universiteti European i Tiranës (UET)

Këshilli botues

PROF. ASOC. DR. LULJETA MINXHOZI

PROF. ASOC. DR. FATOS IBRAHIMI

DR. KRESHNIK BELLO

DR. GJERGJI FILIPI

DR. SELAMI XHEPA

DR. SHKËLZEN MARKU

MSC. ILIR HOTI

Redaktor

GLADIOLA BENDAJ

Jeni të mirëpritur të dërgoni shkrime, recensa librash, përmbledhje punimesh shkencore, monografi, studime në redaksinë e revistës ECONOMICUS, në adresën: economicus@universitetieuropean.com

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË

Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al

Permbajta ---

Koncepti dhe rebusi i politikave të zhvillimit

A. CIVICI

Rritje apo Zhvillnim ekonomik

L. MINXHOZI

Zhvillimi ekonomik në retrospektivë dhe në perspektivë

S. XHEPA

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe sfidat mjedisore

J. LATIFI

DOSSIER

Sfida drejt ruajtjes së rritjes

GJ. FILIPI

Paradigma e zhvillimit njerëzor dhe tranzicioni post-komunist në Shqipëri

E. NGJELA

Kapitali njerëzor dhe zhvillimi – rasti shqiptar

B. PICARI

*Politikat e zhvillimit të zonave rurale dhe të defavorizuara
– nevoja për konceptime bashkëkohore*

SH. MARKU – T. TRESKA

A është barazia ekstreme një objektiv për t'u mburrur

F. GURI, A. CIVICI, A. M. JOUVE

*Liria Ekonomike si faktor përcaktues i flukseve hyrëse të IHD
– Rasti i Shqipërisë*

THOMA & LUGA

ANALIZA DHE KËRKIME

Pronësia Kombëtare, faktor kyç për efektivitetin e ndihmës së huaj
E. GJEBREA

*Project finance në vendet në zhvillim –
– Vlerësimi i ndërtimit të TEC-it të Vlorës*
E. KRIPA

Pronësia intelektuale, një koncept i hershëm dhe modern
K. BELLO

*The End of Oil and Petropolitics
in the 21st Century*
F. TARIFA, R. GURAKUQI, I. NIKAJ, J. LUDY

Ekonomia e dijes – SHBA dhe Evropa me shpejtësi të ndryshme
E. SULKO

*Comparative analysis of communication strategies for accession to the
EU – lessons for Kosovo*
TOMIC – MALANAR – SADIKU

EKONOMISTË TË SHQUAR

Paul Krugman dhe Henry Paulson
A. CIVICI

Koncepti dhe rebusi i politikave të zhvillimit

____ Prof.ass.Dr. Adrian Civici _____

ABSTRAKT. *Sa të zhvilluar apo të pazhvilluar jemi? Kemi apo nuk kemi politika koherente zhvillimi? Jemi apo nuk jemi duke u zhvilluar? A po na ndihmon sa duhet rritja ekonomike në rrugën drejt zhvillimit? Dhe, në fund të fundit, jemi apo nuk jemi të qartë për vetë konceptin dhe dimensionet e zhvillimit?...për raportet ndërmjet rritjes dhe zhvillimit? Duke ndjekur me vëmendje e në vazhdimësi vizionin e spektrit politik shqiptar për këto pyetje, por edhe atë të institucioneve kryesore, akademikëve, shoqërisë civile, etj., konstatohet që pikëpyetjet dhe mungesa e koherencës janë akoma shumë të mëdha. Natyrisht që kjo situatë paqartësie dhe ky lloj debati nuk është tipik vetëm për Shqipërinë, por për të gjitha vendet e botës dhe në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim që në kushtet e efekteve të globalizimit, krizës aktuale ekonomiko-financiare që duket se po prek shumë vende të botës si dhe ekspozimit ndaj ekonomive e shoqërive të zhvilluara perëndimore po reflektojnë thellësisht për strategjitë dhe politikat e tyre drejt zhvillimit ekonomik e social. Në thelb të debateve qëndron « koncepti i zhvillimit », mënyra se si janë absorbuar nga shtete e popuj të ndryshëm teoritë themelore mbi zhvillimin apo eksperiencat e vendeve të pasura perëndimore. Çështja e konturimit të « modelit të zhvillimit » mbetet akoma pikëpyetje e madhe për shumë vende apo institucione ndërkombëtare dhe është e natyrshme që edhe në Shqipëri debatet dhe sugjerimet të reflektojnë konfuzion e mangësi në përgjigje të kësaj çështjeje kardinale.*

Evolucioni i konceptit të zhvillimit.

Çështja e zhvillimit dhe e bazës teorike të tij « ekonomisë së zhvillimit » u shfaq si një degë e re e shkencës ekonomisë pas viteve 50-të të shek. XX-të. Punimet e para u fokusuan në dy drejtime: disa prej tyre e konsideronin mos-zhvillimin thjesht si një vonesë kohore në procesin e zhvillimit; ndërkohë që një grup tjetër të quajtur « strukturaliste », e shikonin mos-zhvillimin si një fenomen historik të lidhur me çrregullimet dhe disproporcionet e strukturave prodhuese. Zgjidhjet e propozuara ishin kryesisht të natyrës intervencioniste, projekteve të përqendruara shtetërore, strategji të zëvendësimit të importeve me prodhim vendas pavarësisht nga kostot e tij, etj. Por gjatë viteve 1960–70, debatet e arsyeve të mos-zhvillimit dhe

modelit të tij u zhvendosen drejt idesë se « mos-zhvillimi është pasojë e dominimit të vendeve të mëdha e të zhvilluara kapitaliste mbi vendet e varfra » e për pasojë zhvillimi i tyre ishte i pamundur pa « konsensusin » dhe përkrahjen e tyre.

Në fund të kësaj periudhe lulëzuan teoritë e « ndërvarjes » së ekonomive, të relacioneve « qendër-periferi », të « këmbimeve jo të barabarta », etj. Por ngadalësimi i zhvillimit ekonomik botëror pas viteve 70–80-të i shoqëruar me të ashtuquajturën « krizë e borxheve » i dha fund iluzioneve të krijuara nga politikat intervencioniste dhe përgatiti terrenin drejt politikave tipike liberale. Në zbatim u vu « konsensusi i Washingtonit » që përmbledhet me sentencën: kredi zhvillimi nga Banka Botërore apo institucione të tjera mund të marrësh vetëm në rastet kur zbaton kriteret e rigorozitetit financiar të FMN. Thelbi i këtyre politikave ishin kushtet e paketës së « axhustimit strukturor » me objektiv themelor integrimin e vendeve në zhvillim në tregun botëror. Në këtë kontekst i filloi dhe Shqipëria reformat e para në fillim të periudhës së tranzicionit gjatë viteve 1992-1995.

Por realiteti i fund-shek.XX-të evidentoi probleme thelbësore në raport me objektivat e zhvillimit. Rreth 3 miliard njerëz jetojnë me 2 USD/ditë ; mbi 950 milion prej tyre në uri kronike ; 7 njerëzit më të pasur të botës zotërojnë shuma më të mëdha financiare se PBB e 49 vendeve më pak të zhvilluara së bashku; me ritmin aktual të zhvillimit, do të duhen 130 vjet për të eliminuar varfërinë në botë, etj. Përballë kësaj gjendje në fund të shek. XX-të pati reagime në funksion të debateve me fokus zhvillimin :

(a) vetë institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore e FMN-ja partizane të politikave liberale futën në praktikën e tyre konceptin e « mirëqeverisjes » dhe objektivin kryesor të « luftës kundër varfërisë » duke i kondicionuar kreditë e ndihmat me rezultatet në këto drejtime;

(b) OKB lancoi objektivat globale të zhvillimit të quajtura «Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit » dhe si instrument kryesor privilegjuan teorinë dhe praktikën e « zhvillimit të qëndrueshëm ». Në themel të kësaj platforme globale qëndron reduktimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik, social e mjedisor i çdo vendi;

(c) në kundërshtim me këto tendenca, në disa vende është shfaqur një korrent tjetër i cilësuar si « refuzues » i tendencës globale me argumentin se modelet e zhvillimit që propozohen janë specifike vetëm për perëndimin dhe kanë qëllim rritjen e dominimit ekonomik, politik e kulturor të tyre ndaj pjesës tjetër të botës. Përkrahësit e tij kërkojnë anulimin e marrëveshjeve me BB., FMN e OBT, largimin e qeverive nga bashkëpunimi me këto organizata, hartimin e politikave dhe modeleve origjinale të zhvillimit, etj.

« Rritje ekonomike » apo zhvillim ?

Ekonomistët kanë arritur në konkluzionin se « rritja ekonomike është vetëm një nga elementet e zhvillimit....duke përfaqësuar dimensionin ekonomik të tij ». Por zhvillimi, përtej konceptit të rritjes ekonomike që reflekton një natyrë sasiore e të matshme, shkon akoma më tej në koncepte e përmbajtje të natyrës cilësore, shpesh të pamatshme në mënyrë direkte. Ai implikon një rritje të mirëqenies

sociale, një përmirësim të mentalitetit social, ndryshime në strukturën e cilësisë së fuqisë punëtore e kapaciteteve intelektuale, organizimin e shoqërisë dhe funksionimin e institucioneve, pra nënkupton një ndryshim evolutiv të gjithë shoqërisë në përgjithësi. Zhvillim do të thotë urbanizim, industrializim, shkollim, profesionalizëm, akumulim njohurish e pasurish në mënyrë që nevojat humane të plotësohen sa më mirë. Zhvillimi njerëzor është diçka shumë më e madhe se GDP apo të ardhurat për frymë. Zhvillimi është një proces i zgjerimit të mundësive të zgjedhjes për njerëzit dhe jo thjesht një rritje e të ardhurave kombëtare. Qëllimi i progresit njerëzor është zhvendosja e fokusit nga synimet për zhvillimin ekonomik drejt politikave që e vendosin njeriun në qendër të zhvillimit .

Pra, koncepti i zhvillimit është shumë më i gjerë se sa ai i rritjes ekonomike, duke e vendosur theksin te plotësimi i nevojave fundamentale të njeriut, te reduktimi i diferencave në nivelin e jetesës për grupe të ndryshme sociale apo territore të caktuara, te reduktimi i varfërisë, te garantimi i nivelit optimal të shërbimeve, etj. Zhvillimi nuk mund të garantohet pa « rritjen ekonomike », por ekonomistët janë të shqetësuar se në shumë vende të botës, përfshirë këtu dhe Shqipërinë, shpesh duket se po manifestohet « një rritje ekonomike e pa shoqëruar me zhvillim ».

Koncepti i zhvillimit njerëzor shpreh një preokupim të vjetër: vendosjen e njeriut në qendër te procesit të zhvillimit. Kjo merr një rëndësi akoma më të madhe sot, kur në një kontekst ndërkombëtar ku mbizotëron fryma « neo-liberale », sidomos në vendet në zhvillim, përqendrimi në respektimin e ekuilibrave makroekonomike dhe respektimi i detyruar i paketave të « axhustimit struktural » e ka nxjerrë në plan të dytë prioritetin e zhvillimit human. Por zhvillimi ka dhe një dimension të rëndësishëm politik i cili fokusohet në rolin e shtetit në kuadrin e gjithë kontekstit të zhvillimit. Ky rol ka përbërë vazhdimisht objektin e debateve të gjera. Shkolla « neo-klasike » apo « liberale » ka mbrojtur për shumë kohë idenë dhe praktikën « e reduktimit drastik të rolit të shtetit në favor të zgjerimit të rolit të tregut », por si pasoje e përvojave të shumta, në disa raste edhe negative siç është për shembull dhe kriza e sotme financiare, neo-klasikët kanë filluar ta njohin tashmë « dimensionin politik të zhvillimit », sidomos nëpërmjet koncepteve e praktikave të « mire-qeverisjes ».

Modeli i zhvillimit : një zgjedhje e vështirë

Në debatet aktuale politike apo profesionale në Shqipëri flitet fare pak për situatën specifike « post-tranzicion » dhe modelin që na ofron procesi i integritimit evropian. Ne tashmë kemi kaluar nga një fazë e politikave të « axhustimit struktural » të filluar në 1992, të cilat synonin reduktimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit dhe krijimin e tregut të lire, në një fazë të re politikash ekonomike që synojnë veçanërisht transformimet strukturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dhe e gjitha kjo në një kontekst intensiv të adaptimit me normat dhe standardet europiane. Të hysh në Europë do të thotë të ndërtohet e konsolidosh një sistem ekonomiko-social kapitalist. Por a e kemi shtruar ndonjëherë pyetjen : cili është

modeli më i përshtatshëm i kapitalizmit për Shqipërinë. «Modeli evropian » mund të reagojë kushdo! Aspak, kapitalizmi ka disa parime e rregulla bazë që përbëjnë thelbin e tij, por nga ana tjetër çdo vend e profilizon kapitalizmin sipas specifikave e zgjedhjes së tij. Franca ka zgjedhur modelin e « kapitalizmit shtetëror », Gjermania, Austria, Zvicra dhe vendet nordike « kapitalizmin social-demokrat », Anglia « kapitalizmin liberal anglo-sakson », etj. Prandaj dhe ne nuk duhet ta reduktojmë çdo debat, analizë apo propozim vetëm te elemente të veçanta të sistemit si p.sh. te tregu, liria e individit, avantazhet krahasuese, politikat sociale apo roli i shtetit, por ta trajtojnë në tërësinë e tij modelin.

Kjo bëhet e rëndësishme për faktin se ne kemi ndërtuar « ekonominë e tregut », por sapo kemi filluar të ndërtojmë kapitalizmin dhe të profilizojmë « modelin » e tij. Dhe ky model, nuk fillon e mbaron vetëm te tregu dhe liria individuale, por ai ka nevojë të gjykohet e kristalizohet duke marrë në konsideratë ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve specifike, forcimin e demokracisë dhe legjitimitetit të gjithë aktoreve të zhvillimit, dinamikat politike si dhe faktorët psikologjikë e kujtesën historike të çdo vendi. Përpara se ti referohemi vetëm dhe ekskluzivisht një elementi të modelit apo një shkolle si p.sh. asaj «ultraliberale» apo asaj “intervencioniste”, të preferojmë më shumë kënd-vështrimin tërësor, analizën krahasuese historike dhe gjeografike, si dhe eksperiencën e problematikën e vendeve të tjera të Europës Qendrore e Lindore që tashmë janë integruar në BE. Gjykimet dhe propozimet për sistemet ekonomike dhe zhvillimin duhen parë si në kontekstin ku ato kanë lindur e aplikuar ashtu dhe në kornizën e tyre teoriko-shkencore, pra shkollës apo rrymës që i përkasin. Dhe kjo sepse, sot në botë ekzistojnë shumë shkolla apo rryma të mendimit ekonomik e platforma të zhvillimit të cilat janë të konkretizuara në politika të caktuara ekonomike e sociale në vende apo nga popuj të ndryshëm.

Paqartësitë strategjike dhe konjukturalizmi vazhdon

Po ta analizosh me kujdes ecurinë e rritjes ekonomike në Shqipërinë këto 17 vitet e fundit, konstatohen tre fenomene kryesore : (1) rritëm i lartë dhe tregues pozitivë për periudhën 1992-1994 dhe 1998-2002, fenomen që shpjegohet nga baza e ulët e krahasimit por dhe nga ndikimi i një stabiliteti politik relativ; (2) rënie drastike në periudha krizash sic ishin p.sh., vitet 1991-1992, 1997-1998 dhe 2002; (3) rritje relativisht e stabilizuar por gjithsesi normale gjatë periudhave 1994-1996, 2002-2005, 2006-2008. Ky lloj fenomeni ka bërë që tashmë në kur analizohet problemi i tranzicionit të vendeve të Europës qendrore e lindore “nga ekonomia e centralizuar drejt tregut të lirë”, përveç dy rrugëve të njohura si “Chock Terapy” dhe “gradualizmi” të futet dhe një rrugë e tretë e cilësuar si “stop and go” ku si shembull tipik përmendet Shqipëria.

Strategjitë e paqëndrueshme dhe politikat e paqarta të zhvillimit janë faktori i dytë më i rëndësishëm. Në 17 vjet, Shqipëria i ka ndryshuar mbi 12 herë prioritetet strategjike të zhvillimit duke e bërë konjukturalitetin “rregull” dhe qëndrueshmërinë

“përrjashtim”. Sipas konjunkturave ndërkombëtare, vullnetit individual të drejtuesve apo subjektivitetit politik e elektoral në prioritetet e saj kanë figuruar e janë zhdukur 1-2 vjet më pas, bujqësia, turizmi bregdetar, sektori privat, turizmi rural dhe ai malor, zhvillimi rural, nafta dhe energjia, pyjet e zonat malore, agro-industria, varfëria, arsimi, shëndetësia, infrastruktura, anti-korrupsioni, klima e biznesit, Shqipëria në moshën e internetit, Shqipëria 1 euro, Shqipëria eksportuese energjie, etj. Aktualisht në Shqipëri konstatohet lehtë mungesa e një strategjie të mirëfilltë zhvillimi e bazuar në një hulumtim të thellë në burimet e rritjes dhe avantazhet krahasuese e kompetitive të vendit e shoqëruar me mungesën totale të një konsensusi politik kombëtar për prioritetet e qëndrueshme të zhvillimit të vendit.

Por përtej fasadës së “debateve me FMN-në”, reagimeve nga ana e opozitës në raport me zgjedhjet dhe prioritetet e investimeve të fiksuara nga qeveritë në pushtet, imponimit institucional apo si pasojë e maxhorancave fluide në Parlament të orientimeve të zhvillimit të vendit, shoqëria, politika, institucionet dhe biznesi shqiptar duket se po bëhen shumë më të përgjegjshëm për këtë fazë të re. “Tutela dhe kontrolli i FMN-së” që deri tashti ka qenë një garanci e padiskutueshme e cilësisë së ekonomisë dhe financave shqiptare përfundoi. Në vitin 2009 e përtej, vendi do jetë shumë më i pavarur në përcaktimin dhe aplikimin e politikave ekonomike dhe financiare duke qenë çdo vit përballë një provimi të madh maturie dhe inteligjence qeverisëse në fushën financiare, ekonomike e sociale. Në horizont është atashimi dhe përshtatja me “kriteret e Manstrisht-it” ose standardet ekonomiko-financiare europiane. Të gjithë janë të bindur se është momenti që të bëhemi të përgjegjshëm për këtë fazë të re, se gjuha dhe problematika që po përballemi nuk pranon politika voluntariste apo zgjidhje elektorale ashtu siç nuk pranon as kundërshtime thjesht politike. Buxheti po bëhet totalisht pjesë dhe funksion e strategjive tona të zhvillimit, po kthehet në një instrument thelbësor në funksion të zhvillimit ekonomik e social, po largohet nga objektivi i ngushtë dhe i vetëm i garantimit të ekuilibrit dhe bilancit financiar të vendit.

Nga ana tjetër, stabiliteti politik afat-gjatë është elementi më i rëndësishëm që josh investimet e huaja në një vend, ndërkohë që eksperiencia dhe praktikat tona në këtë fushë gjatë 17 viteve të fundit janë shumë dekurajuese. Tension i lartë politik pothuajse në çdo periudhë të vitit, deklarata dhe përpjekje për zgjedhje të reja vetëm një ditë pas daljes së rezultateve të zgjedhjeve “të vjetra”, raporte konfliktuale gjithmonë të acaruar ndërmjet pozitës dhe opozitës, mbizotërimi i injorimit dhe mohimit për gjithçka që bën “tjetri”, deklaratat patetike “se kur të vij unë në pushtet do ti ndryshoj të gjitha ligjet dhe anuloj marrëveshjet e tua”, etj., janë treguesi më i keq për stabilitetin politik të një vendi e për pasojë janë indikatorët “më armiqtësorë” ndaj investimeve të huaja.

Tashmë shumë analistë ekspertë në fushën e investimeve të huaja, duke analizuar situatën e atraksionit të investimeve në vendet e Evropës qendrore dhe lindore, nënvizojnë pa ekuivoke se investimet e huaja janë investime që kërkojnë marrëdhënie afat-gjata dhe interes të qëndrueshëm me ekonominë pritëse. Stabiliteti dhe parashikueshmëria janë dy kushte sine qua non të çdo projekti investimesh të huaja. Kjo është arsyeja pse vende si Republika Çeke, Sllovenia, Hungaria, Sllovakia, Kroacia, Lituania, etj., janë vendet atraktive për thithjen e investimeve të huaja. Faktor tjetër thelbësor atraktiv

është dhe niveli i kualifikimit të fuqisë punëtore disponibël në vendet që kërkojnë të tërheqin investime të huaja. Me gjithë entuziazmin e disa institucioneve tona që mendojmë e shprehen vazhdimisht se Shqipëria mund t’ju garantojë fuqi punëtore të kualifikuar investitorëve të huaj, realiteti shqiptar i tregut të punës nuk është kaq rozë. Arsimi mesatar i popullsisë në moshë pune nuk është më i lartë se 9.5 vjet shkollim, në një kohë kur në vendet që ne kërkojmë ti ngjajmë është më shumë se 12-13 vjet; njohuritë e tyre për teknologjitë e reja, kompjuterin, makineritë moderne, etj., janë minimale për të mos thënë inegzistente (mbi 80% e tyre është me origjine rurale dhe nuk është mësuar as me disiplinën formale të ndërmarrjeve industriale, tregtare apo të shërbimeve, le më të ketë njohuri për teknologjitë moderne industriale); etj. Ndërkohë, edhe vende më të zhvilluara se Shqipëria, Estonia, Polonia, Hungaria, Turqia, Kroacia, Sllovenia, Sllovakia, etj., për t’ju përgjigjur sa më mirë kërkesave të investimeve të huaja, kanë mbi 10 vjet që në prioritetet dhe objektivat e tyre kanë vënë si përparësi “formimin e një fuqie punëtore të kualifikuar”,

Koha e qëndrimeve partizane pro apo kundra rekomandimeve të FMN-së, justifikimet e tipit “ka vendosur FMN-ja, nuk kemi se çfarë të bëjmë”, apo praktika e zgjidhjeve në emergjencë po merr fund. Analiza e kujdesshme e realitetit shqiptar, përpunimi i një vizioni zhvillimi të qëndrueshëm afat-gjatë e konsensual mbi interesat e mandateve politike e qeveritare, referimi në eksperiencat pozitive ndërkombëtare, studimi më në detaje të “kritereve të BE” dhe *acquis comunitaire* në këtë fushë dhe mbi të gjitha, lançimi i një debati publik sa më të gjerë për këto probleme janë rruga e pashmangshme nga duhet kaluar. Dualizmi i pashmangshëm e konfliktual ndërmjet domosdoshmërisë së politikave të rritjes ekonomike dhe rregullave të “rigorozitetit financiar”, dilemat për dhënien prioritet të “politikave konjunkturale të zhvillimit apo respektimi rigoroz i recetave të politikave strukturore?”, ekuilibri i vështirë ndërmjet “politikave ekonomike dhe asaj monetare”, debatet dhe reagimet e biznesit vendas ndaj efekteve të paketave fiskale, MTL-ve apo OBT-së, ndaj buxhetit apo reformave fiskale në përgjithësi, etj., që shfaqen shumë shpesh në politikën, aksionin qeveritar, biznesin, bankat apo mjedisin mediatik e intelektual shqiptar, dëshmojnë se Shqipëria po hyn në një fazë interesante por dhe delikate, fazën e përzgjedhjes në mënyrë më direkte e të pavarur të politikave të saj të zhvillimit.

Tashmë në Shqipëri po kristalizohet ideja se politikat ekonomike nuk duhen barazuar vetëm me ndryshimet strukturore, por ato duhet të përmbajnë dhe një dozë të konsiderueshme vendimesh e objektivash të politikave publike të zhvillimit ekonomiko-social lokal e territorial. Orientimi i kapitaleve dhe fiksimi i objektivave të zhvillimit të formuluar si vendime e politika publike, si politika buxhetore në mbështetje të këtyre politikave publike po dëshmohet gjithnjë e më tepër si rruga e qeverisjes moderne e efektive. Rregullat strikte buxhetore nuk duhet të shihen si pengese absolute për investimet publike. Me fjalë të tjera, administrimi afat-shkurtër nuk duhet “të fusë në borxhe” zhvillimin afat-gjatë. Kur një vend investon në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, apo kapital human, ai kontribuon në rritjen dhe zhvillimin ekonomik e social afat-gjatë të tij. Përvoja e shumë vendeve të tjera të ngjashme me Shqipërinë po kristalizon një filozofi e praktike të re qeverisëse: politikat ekonomike të rritjes dhe zhvillimit si

dhe politikat strukturore dhe ato të rigorozitetit monetar duhen parë si plotësuese dhe jo si zëvendësuese apo antagoniste të njëra tjetrës. Klasa politike dhe vendim-marrëse në Shqipëri po e kupton gjithnjë e më tepër se politika ekonomike po merr kështu një përgjegjësi të re, atë “të furnizimit të shoqërisë me një garanci kolektive veprimi”. Shteti duhet të ketë gjithë fuqinë e nevojshme financiare e ekonomike që të rregullojë devijimet apo çrregullimet që prodhon tregu, aq më tepër tregu i çoroditur dhe pa shumë rregulla si ai shqiptar. Në gjuhën ekonomike kjo po synohet të përkthehet si “një kombinim perfekt i instrumenteve të zhvillimit me objektivat e tij”.

Roli i Qeverive për adoptimin e politikave “zhvilluese”

Sipas një studimi të OECD, promovimi i një zhvillimi dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, parë në kushtet e një konteksti ndërkombëtar specifik të këtij fillim shekulli që po bëhet gjithnjë e më i kushtëzuar nga përmirësimet teknologjike dhe shpejtësinë e efikasitetit e përdorimit të tyre në ekonomi, roli i Qeverive duhet të fokusohet në pesë drejtime bazë.

1. Të ruajnë stabilitetin makroekonomik duke favorizuar hapjen e vazhdueshme ekonomike dhe integrimin në ekonominë rajonale e atë globale, duke përmirësuar funksionimin e tregjeve, stabilitetin dhe efikasitetin e institucioneve, dhe së fundi “duke u preokupuar vazhdimisht për të eliminuar pasojat negative që mund të provokohen nga ndryshimet”. Në nivelin makroekonomik, vendet e botës që kanë siguruar një rritje ekonomike të shpejtë janë ato vende që kanë aplikuar politika për mbajtjen në nivel të ulët dhe kontrollin e plotë të inflacionit, që kanë reduktuar vazhdimisht borxhin publik, që kanë pasur stabilitet në politikat fiskale e buxhetore, etj. Kuadri makroekonomik stabil konsiderohet si kushti bazë që i ndihmon bizneset ekzistuese të planifikojnë realisht aktivitetet e tyre dhe njëkohësisht ndihmon bizneset e reja që të ecin normalisht dhe të kalojnë vështirësitë e viteve të para. Shpenzimet publike të orientuara me përparësi në infrastrukture dhe në formimin e “kapitalit social” favorizojnë ndjeshëm zhvillimin. Sipas OECD, vendet më performante kanë aplikuar me sukses reforma strukturore që kanë forcuar efektin e politikave të rregullimit të kërkesës, dhe kanë përdorur me shumë efektivitet burimet e tyre financiare.

2. Të lehtësojnë përhapjen e teknologjive të informacionit duke ndërmarrë politika prioritare në fushën e administrimit elektronik. Eksperiencia e shumë vendeve dëshmon se rritja dhe përmirësimi i pajisjeve të TI ndihmon në rritjen e produktivitetit të ekonomisë vetëm nëse kjo shoqërohet me përmirësimin e kompetencave të përdoruesve të tyre.

3. Të favorizojë “thithjen” dhe përdorimin sa më të gjerë të teknologjive të reja në të gjitha hallkat prodhuese, përpunuese dhe shërbime duke i dhënë prioritet financimit publik në fushën e kërkim-zhvillimit dhe krijuar kushte lehtësuese për qarkullimin e njohurive të reja ndërmjet universiteteve, qendrave kërkimore dhe sektorëve prodhues. Sipas OECD-së, eksperiencia e shumë vendeve, qofshin këto të vogla apo në zhvillim dëshmon se sa më shumë prioritet ti jepet financimit publik dhe atij privat në fushën

e kërkim zhvillimit në kuadrin nacional, aq më tepër rriten mundësitë që të përfitohet dhe nga rezultatet e kërkim-zhvillimit në kuadrin ndërkombëtar”.

4. Të investojë sa më shumë në krijimin dhe konsolidimin e “kapitalit social” duke forcuar sistemin arsimor dhe dijet profesionale, duke e bërë më atraktiv e cilësor profesionin e mësuesit apo pedagogut, duke përmirësuar lidhjet ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, duke i adaptuar vazhdimisht institucionet arsimore-shkencore me prirjet dominuese të zhvillimit ekonomik e social. Shumë të rëndësishme konsiderohen dhe strategjitë e cilësuar si “formim profesional në mes të karrierës”, strategji që synojnë të kualifikojnë atë kategori të punësuarish që kanë hyrë në tregun e punës pa kualifikimin e nevojshëm fillestar si dhe kategorinë që rezulton e “pa kualifikuar” si rezultat i ndryshimeve strukturore në ekonomi apo si rezultat i futjes së teknologjive të reja në sektorë të ndryshëm të prodhimit e shërbimeve.

5. Të stimulojë në maksimum krijimin e ndërmarrjeve dhe bizneseve të reja duke lehtësuar procedurat administrative dhe vendosur marrëdhënie besimi, transparence e bashkëpunimi me biznesin, por njëkohësisht edhe duke “stimuluar e disiplinuar institucionalisht procesin e falimentimit të atyre bizneseve që nuk janë efektive apo nuk përputhen me logjikën dhe kërkesat e tregut”. Eksperiencia e vendeve me të zhvilluara dëshmon se atje ku vërehet një numër i madh biznesesh të reja që krijohen dhe biznese ekzistuese që falimentojnë, atje dëshmohet dhe një alokim me cilësor i resurseve dhe për pasojë një rritje ekonomike e shëndetshme.

Rritje apo Zhvillim ekonomik

Trajtimi i një modeli neoklasik të rritjes

ekonomike në rastin e Shqipërisë

Prof. Asoc. Dr. Luljeta Minxhozi

ABSTRAKT. *Tranzicioni ka krijuar një model te veçantë të rritjes në Shqipëri. Pas një rënie të dukshme te ritmit te rritjes së GDP-së gjatë viteve të para të tranzicionit, zgjerimi i sektorit privat përmirësoi dukshëm sjelljen ekonomike të GDP-së. Qeveritë e këtyre viteve kane fokusuar dukshëm përpjekjet e tyre në ndërtimin e strategjive që synonin të siguronin një ritëm të qëndrueshëm të rritjes ekonomike. Për këtë një analizë e burimeve te rritjes do të shërbente si bazë për të kuptuar më mirë cilët janë faktorët që do të siguronin qëndrueshmërinë e këtij procesi. Qëllimi i këtij artikulli është që të mund të identifikojë burimet e rritjes në një këndvështrim neoklasik duke ndarë burimet klasike të rritjes se sasia e punës dhe akumulimi i kapitalit nga faktorët e tjerë. Një nga gjetjet e artikullit është se në Shqipëri motori i rritjes ka qenë ritmi i lartë i performancës ekonomike të TFP-së. Kështu që rritja në dekadat e fundit ka ardhur kryesisht nga rritja e efciences në rialokimin e burimeve gjatë periudhës së tranzicionit. Ecuria e deritanishme e këtij procesi buron nga fakti se Shqipëria ka arritur të liberalizojë çmimet e tregje te privatizojë sektorët kyç dhe te krijojë një mjedis makroekonomik të qëndrueshëm. E ardhmja e rritjes ekonomike në Shqipëri është e lidhur me rritjen e efciencës së institucioneve te tregut dhe me krijimin e institucioneve te reja që të garantojnë lirinë në treg dhe barazinë e aktorëve ekonomikë.*

Qëllimi kryesor i çdo aktiviteti ekonomik në një sistem shoqëror është të sigurojë mirëqenie për qytetarët e vet. Për këtë arsye, debati teorik mbi procesin e rritjes ekonomike dhe të modeleve ekonomike mbi të cilat ky proces bazohet është shumë dimensional. Fillimisht duhet të formulohet metodologjia e përcaktimit të fazave të zhvillimit ekonomik dhe më pas të ndërtohen modele ekonomike te lidhjes midis variablave kryesore që të përcaktojnë raportet optimale midis burimeve të rritjes në një ekonomi dhe shkallës së zhvillimit institucional të saj.

Në literaturën ekonomike ka mjaft terma që karakterizojnë pikërisht kalimin e një ekonomie të caktuar në faza të ndryshme të zhvillimi ekonomik. Shpesh gjate analizave ekonomike shprehemi se një vend po kalon nga stadi “para industrial” në atë

“industrial”, apo nga “ekonomia e prapambetur “ në “ekonominë e përparuar”. Çfarë shprehin këto kategorizime dhe si mund t’i dallojmë këto etapa?

Do të ishte shumë e thjeshtë që ndarjen e këtyre etapave të zhvillimit ekonomik të mund ta përshkruanim me një ose disa tregues, siç mund të ishte një përshkrim i thjeshtë i të ardhurave kombëtare për frymë ose i dinamikës së ndryshimit të GDP-së kombëtare në një periudhë të caktuar. Por, në të vërtetë, përcaktimi i kufijve ndarës midis etapave të rritjes ekonomike dhe identifikimi i variablave ekonomike që karakterizojnë këto etapa, kërkon një analizë ekonomike më të thelluar.

Ekonomisti amerikan Walt Rostv¹ ka shpjeguar se, nga pikëpamja teorike, stadi kryesorë nëpër të cilat kalon procesi i rritjes ekonomike janë pesë, por, ai ka identifikuar si më të rëndësishmet tre prej tyre: stadi i ekonomisë tradicionale, stadi i emergjencës dhe krijimit të kushteve për *shkëputjen ekonomike* dhe stadi i *shkëputjes ekonomike*.

Koncepti i *shkëputjes ekonomike* është një element qendror në skemën e Rostov. Teorikisht, ky koncept interpretohet si “një tranzicion vendimtar në një shoqëri”, - si një periudhë kur “përmasat e produktivitetit në një veprimtari ekonomike arrijnë një nivel kritik, i cili prodhon ndryshime strukturore, ekonomike dhe shoqërore të dallueshme, më shumë në cilësi se sa në sasi”. Shpesh kjo fazë emërtohet me termin “Take Off” që është termi teknik që karakterizon shkëputjen e avionit nga toka. Ky krahasim bëhet për te mbajtur parasysh se, në këtë fazë ekonomia duhet t’i ketë të gjithë “motorët” të ndezur për të siguruar shkëputjen nga stadi i mos zhvillimit dhe për të filluar stadin e ri të zhvillimit ekonomik, ku ritmi i rritjes së GDP-së është i lartë dhe i qëndrueshëm.

Karakterizimi i njëres prej etapave të rritjes ekonomike, si një fazë e *shkëputjes ekonomike*, bëhet duke siguruar ekzistencën e tre kushteve të mëposhtme:

- Rritjen e të ardhurave kombëtare me një ritëm vjetor më të lartë se 10%.
- Nxitjen e një ose më shumë degëve të rëndësishme të industrisë përpunuese dhe sigurimin e një ritmi të lartë të rritjes së tyre.
- Krijimin e një kuadri politik social dhe institucional që të sigurojë një mjedis nxitës për aftësitë zgjeruese të ekonomisë në tregun e brendshëm dhe në atë të jashtëm.

Të pranosh se çdo ekonomi ndjek të njëjtin kurs zhvillimi, më të njëjtën pikë nisje, me të njëjtat objektiva perspektivë apo me të njëtin ritëm rritje, do të thotë të pranosh një zhvillim shumë skematik të ekonomisë. Ideja që mund të përftohet nga koncepti i Rostovit për etapën e zhvillimit ekonomik është se, secila prej tyre duhet të konceptohet si një set problemesh që vendet përballojnë në procesin e tyre të rritjes ekonomike e të zhvillimit, dhe që duhet të zgjidhen brenda përcaktimit të strukturës institucionale të vendit

1 W.W Rostov “the stages of Economic Growth” *Economic Historic Review* (Gusht 1959)

Modeli Solow i rritjes ekonomike dhe përcaktimi i TFP ne rastin shqiptar

Për të bërë një analizë të burimeve të rritjes në Shqipëri, në fillim duhet të bëjmë një parashtrim teorik të një prej modeleve bazë të rritjes ekonomike, modelit neoklasik të rritjes, që quhet ndryshe edhe modeli Solow².

Në një artikull novator për teorinë ekonomike në *“Review of Economics and Statistics”* (1957), Robert Solow, për herë të parë zhvilloi teorikisht konceptin e funksionit agregat të prodhimit. Ky funksion prodhimi përmban si variabla kryesore përveç kapitalit fizik dhe atij human, edhe një seri faktorësh të tjerë jo domosdoshmërisht ekonomikë. Këta faktorë përzgjidhen nga ndikimi që ata kanë në rritjen produktivitet marzhinal të outputit total.

Kontributi më i rëndësishëm i këtij modeli është pikërisht formulimi i rolit ekonomik të këtyre faktorëve, me ndikim të dukshëm në rritjen ekonomike. Në fillim u mendua që këtë rol mund ta kishte vetëm përparimi teknologjik, por kontributet e mëvonshme teorike provuan se kishim të bënim me shumë faktorë që u quajtën faktorë “mbetje” të cilët shkaktonin efekte mbi produktivitetin e ekonomisë.

Nga analiza empirike e modelit u identifikuan faktorët e mëposhtëm si më influentët në procesin e rritjes ekonomike.

- Përmirësimi i cilësisë së punës nëpërmjet arsimimit, eksperiencës në punë dhe trajnimit të vazhdueshëm.
- Rialokimi i burimeve, nga përdoruesit me produktivitet të ulët në ata me produktivitet të lartë. Kjo rishpërndarje realizohet ose me anë të forcave normale të tregut, ose me anë të ndërhyrjeve në treg për të eliminuar barrierat institucionale.
- Zgjerimi i ekonomive të shkallës.
- Përmirësimi i metodave të kombinimit të faktorëve prodhues, si në përdorimin e makinerive të përparuara, ashtu edhe në përmirësimin dhe përshtatjen e metodave të prodhimit në nivele firme.

Si rezultat i këtij evolucioni të teorisë mikroekonomike mbi variablat e funksionit të prodhimit dhe mënyrën e kombinimit të tyre, ndryshoi krejtësisht këndvështrimi i teorisë së rritjes ekonomike dhe burimeve të saj. Për herë të parë burimet e rritjes u trajtuan si një kombinim i ri i forcave të tregut dhe të atyre jashtë tregut meqë modeli u konsiderua si një zhvillim i modelit të mëparshëm u quajt modelit neoklasik i rritjes

Ekuacioni bazë në modelin neoklasik të rritjes sipas Solow-t është:

$$\Delta Y = \sum w_i \Delta L_i + \sum r_j \Delta K_j + R$$

Ku “Y” është GDP nominal, “L” është sasia e inputit pune dhe “w” është kosto për njësi e tij, ndërsa “K” është stoku i kapitalit dhe “r” është çmimi për njësi i tij. “R” është shënuar ndikimi i grupit të faktorëve që u quajten “mbetje”.

Trajtimi i rritjes ekonomike në një perspektivë mikroekonomike, krijon mundësinë e matjes së kontributit të secilit komponent të funksionit të prodhimit në rritjen ekonomike. Matja e rritjes ekonomike me anë të ekuacionit bazë të modelit të Solow-t krijon mundësinë që të matet efekti i akumulimit të kapitalit dhe përmirësimit cilësor të faktorit punë.

Risia teorike i këtij modeli është evidentimi i rolit të komponentit “R”, i cili më vonë u përcaktua si TFP³.

Treguesi i TFP-së mbledh vlerat e produktiveteve për secilin nga inputet që kontribuojnë në rritjen ekonomike. Ritmi i rritjes së inputeve dhe ritmi i rritjes së TFP-së kontribuojnë njëkohësisht në rritjen e prodhimit. Shpesh faktori TFP përcaktohet si një “kuti”, ku përfshihen të gjithë faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike, përveç akumulimit të kapitalit dhe punës.

Në shumë studime, lista e faktorëve që përfshihet në TFP është e ndryshme. Në përgjithësi, konsiderohen si elementë të TFP-së, ato kategori ekonomike, të cilat krijojnë devijime midis vlerës së produktit marzhinal të krijuar nga faktorët e prodhimit, dhe të ardhurave marzhinale që këta faktorë krijojnë gjatë përdorimit të tyre. Në këtë listë përfshihen sistemi i taksave, strukturat e tregut, marrëdhëniet e pronësisë, por edhe ndotja e mjedisit shkalla e zhvillimit të institucioneve të zgjidhjes së konflikteve..

Në zhvillimet e fundit të modelit neoklasik të rritjes është pranuar se një nga elementet e rëndësishëm të TFP-së është edhe sjellja e institucioneve, të cilat gjatë veprimtarisë së tyre krijojnë kosto në transaksionet ekonomike që duhet të mbahen parasysh. Kur institucionet mungojnë, ose janë të dobëta, reformat ekonomike janë shumë të kushtueshme, dhe shpesh mundësitë e rritjes ekonomike pengohen seriozisht.

Për të kryer një analizë realiste të burimeve të rritjes në një ekonomi, duhet pa tjetër të “hapet” “kutia” e TFP-së, në mënyrë që të mund të zbulohen më mirë variablat që ndikojnë në këtë proces.

Faktorët e rritjes në Shqipëri

Nëse do të bëjmë një paraqitje të përgjithshme të modelit të rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë fazës së tranzicionit, do të vërejmë se, në fazat e para të tranzicionit 1990 – 1992 u vërejt një rënie e dukshme e prodhimi kombëtar, që në terma kumulative arriti në një rënie prej 50%. Rënia e prodhimit ishte një tipar që shoqëroi të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore, megjithëse jo të gjitha në të njëjtën masë.

3 TFP (Total Factor productivity) është treguesi bazë që mat eficiencën e përdorimit të inputeve bazë të përdorura në një funksion prodhimi


Në fazën e mëpasshme (duke filluar nga viti 1993) ekonomia shqiptare u karakterizua nga një ritëm i lartë rritje ekonomike, e cila, sipas të dhënave zyrtare, në periudhën 1993-1995 arriti në terma kumulativë një rritje prej 31.8 %. Shqipëria arriti të zbatojë një program të stabilizimit makroekonomik, të liberalizojë çmimet, dhe të privatizojë tokën bujqësore.

Në 1997, rënia e skemave piramidale dhe anarkia politike e sociale që karakterizoi këtë fazë, u shoqërua me një rënie të outputit real prej 7 %. Fatmirësisht, kjo fazë kaosi social dhe rënie ekonomike nuk zgjati. Shpejt Shqipëria arriti të siguronte përsëri një ritëm pozitiv rritjeje në vitin 1998⁴

Problemi më i madh që ka hasur modeli i rritjes në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit është pamundësia që sistemi ekonomik të mund të siguronte një rritje të qëndrueshme. Të gjitha përpjekjet për të siguruar një ritëm të lartë rritjeje të GDP-së kane rezultuar në një ritëm jo më të lartë se 6%, që do të thotë se ekonomia shqiptare nuk ka pasur mundësi të shkëputet nga faza e moszhvillimit ekonomik.

Në tredjetër problematik i i sjelljes së GDP-se në Shqipëri është edhe vulnerabiliteti i i larte ndaj ecures së këtij treguesi ndaj goditjeve strukturore dhe politike. Kështu që procesi i rritjes ekonomike në Shqipëri nuk mundi të karakterizohej as nga një qëndrueshmëri dhe as nga një ritëm i larte rritjeje.

Grafiku 1 - Dinamika reale e Produktit Kombëtar Bruto



Një nga shkaqet themelore të paqëndrueshmërisë së rritjes ekonomike është pamundësia e ekonomisë për të siguruar burime të qëndrueshme të rritjes: si në stokun e kapitalit, ashtu edhe në faktorin punë.

Këtë përfundim e mbështesin edhe të dhënat mbi një rritje shumë modeste të burimeve kryesore të rritjes, si rritja e kontributit të stokut të kapitalit dhe e kontributit të punës. Kontributi e kapitalit është rritur nga një shifër e papërfillshme prej 0.10 %,


4 Të dhënat janë marrë nga *World Development Indicator* 2003

në periudhën 1993-1996, në 0.78 % gjatë viteve 1998-2001 dhe 1.62 % gjatë viteve 2002-2003. Po kështu, mjaft i kufizuar ka qenë edhe kontributi i faktorit punë në sigurimin e rritjes në Shqipëri. Nga një ritëm negativ prej -0.51 % në vitet 1993-1996, kontributi i këtij faktori filloi të aktivizohej në masën 0.56 % në 1998-2001, dhe për t'u rritur më tej në 1.07 % në 2002-2003.

Edhe po të analizojmë kontributin e sektorëve të veçantë që mbështesin rritjen ekonomike, mund të vëmë re se, ekonomia shqiptare nuk ka mundur të sigurojë një ritëm të lartë të rritjes ekonomike në sektorët bazë prodhues, që të mund të gjeneronte “një shkëputje” të ekonomisë nga faza e paqëndrueshmërisë ekonomike.

Edhe në periudhën 2006-2007, për të cilën ritmi i rritjes së produktit kombëtar duket pozitiv, në një analizë sektoriale (Grafiku 2) të komponentëve të GDP-së, duket se kontribuesit kryesorë janë industritë e shërbimeve dhe të tregtisë me shumicë. Sektori i ndërtimeve, që ishte konsideruar për disa vjet si një nga sektorët bazë prodhues, ka filluar të ketë shenja të dukshme të tkurrjes së aktivitetit të tij.

Grafiku 2 – Përbërja e PBB sipas sektorëve ekonomikë



Duket se rezultatet e mësipërme konfirmojnë edhe përfundimet e disa studimeve për burimet e rritjes në Shqipëri⁵, se komponenti më i rëndësishëm i rritjes ekonomike në vendin tonë është ritmi i lartë i rritjes së TFP-së. Ritmet e larta që kanë karakterizuar rritjen ekonomike në Shqipëri në 18 vitet e tranzicionit, kanë qenë rezultat i reformave të rëndësishme strukturore të liberalizimit të tregut dhe të rritjes së lirisë ekonomike, të cilat kanë siguruar një eficiencë më të lartë në rialokimin e burimeve dhe kanë sjellë ndryshime pozitive strukturore.

5 Faruk Khan “Albania: Growth during Transition and Growth prospects” 2004

Rasti i Shqipërisë konfirmon përpunimet e modelit neoklasik të rritjes ekonomike, sipas të cilave, formimi i kapitalit njerëzor dhe përmirësimi i sjelljes së institucioneve, duhet të konsiderohen si burimet vendimtare në sigurimin e qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike nëpërmjet ritmit të lartë të rritjes së TFP-së. Që procesi i tranzicionit të bëhet më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm, duhet të forcohen institucionet dhe të rritet kontributi i tyre në TFP.

Vendosja e kapitalit njerëzor si element të TFP-së, mund të fuqizojë rolin e inputit punë si burim i rritjes ekonomike, sepse kapitali njerëzor i krijuar si rezultat i arsimit, fuqizon faktorin punë dhe rrit eficiencën e këtij faktori duke lehtësuar hyrjen e teknologjive të reja.

Në rastin e Shqipërisë, roli i kapitalit njerëzor, akoma nuk mund të konsiderohet si element i TFP-së, sepse ky faktor me sjelljen e tij akoma nuk ka mundur të krijojë një diferencë pozitive midis vlerës së produktit marzhinal të krijuar nga puna dhe të ardhurave marzhinale.

Treguesit që karakterizojnë performancën e arsimit në Shqipëri, si faktori kryesor që krijon kapitalin human, janë akoma shumë të ulët. Numri i nxënësve shqiptarë të regjistruar në shkollat e mesme është vetëm 59 % e totalit të popullsisë në moshën e shkollës, ndërsa regjistrimet në Universitet shqiptarë akoma përbëjnë vetëm 25 % të nxënësve që mbarojnë shkollat e mesme⁶. Këto janë shifra me gjithë përmirësimet që kanë pësuar këto vite janë shumë më të ulëta edhe po të krahasohemi me vendet fqinje të rajonit tonë.

Kontributi i kufizuar i kapitalit human në Shqipëri duket edhe nga pjesa e shpenzimeve publike që destinohet për krijimin e tij. Nga viti 1991 në vitin 1999, shpenzimet për arsimin ndaj totalit të produktit kombëtar ranë nga 4,2 % në 2,9 %.⁷ Megjithatë në 10 vitet në vazhdim pjesa e shpenzimeve për arsimin nga fondet publike ka qëndruar rreth shifrës 3,2 %, këto shpenzime janë të shpërndara keq, dhe nuk arrijnë të krijojnë një sistem nxitës për të rritur cilësisht formimin arsimor të faktorit punë.

Duke përjashtuar edhe krijimin e kapitalit human si një faktor gjenerues të rritjes ekonomike të qëndrueshme në Shqipëri, mbetet të pranojmë se burimi i vetëm i sigurimit të një ritmi pozitiv të rritjes ekonomike ka qenë përmirësimi i TFP-së nëpërmjet riallokimi i burimeve nga reformat e thella ekonomike. Reformat strukturore dhe roli i institucioneve të krijuara kanë përbërë motorin kryesor të përmirësimit të eficiencës ekonomike në Shqipëri

Roli i Institucioneve Rregulluese dhe roli i tyre në rritjen ekonomike

Termi “Institucione” është mjaft i gjerë, dhe sigurisht që duhet të përcaktohet për të kuptuar rolin konkret të tyre në procesin e garantimit të një rritje ekonomike të qëndrueshme. Ashtu siç e ka përcaktuar North (2006), institucionet janë “rregulla loje” të cilat mund të jenë formale ose informale, por përcaktojnë kostot e prodhimit dhe nivelin e eficiencës me të cilën operon ekonomia e tregut.

6 Burimi INSTAT

7 Burimi Ministria e Financave

Kuptohet që institucioni më i rëndësishëm është qeveria, e cila në rastin shqiptar, për shkak të nivelit akoma të lartë të centralizimit të vendimmarrjes, gëzon një pozitë të privilegjuar në nxitjen, hartimin dhe zbatimin e reformave, dhe krijimit të institucioneve të reja.

Përcaktimi i institucioneve dhe ndikimit të tyre në aktivitetin ekonomik, lidhet shumë ngushtë edhe me klasifikimi e tyre. Rodrik (1999) ka përcaktuar pesë grupe kryesore institucionesh, të cilat kanë një rol të madh në qeverisjen dhe menaxhimin e jetës ekonomike e shoqërore në një vend. Në këtë klasifikim institucionet ndahen në:

Institucione të së drejtës së pronësisë; institucione rregulluese; institucione të stabilizimit makroekonomik; institucione të sigurimeve shoqërore; institucione të zgjidhjes së konflikteve.

Duke u nisur numri shume i madh i institucioneve dhe nga spektri shume i gjerë i ndikimit të tyre në jetën ekonomike, analiza në këtë artikull do të përqendrohet vetëm në rolin e institucioneve rregulluese dhe efektit të tyre në përmirësimin e sjelljes së TFP-së.

Institucionet rregulluese luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zbutjen e mjaft problemeve gjatë fazës së kalimit të një ekonomie nga faza tradicionale drejt zhvillimit ekonomik. Këto institucione u krijojnë kushte individëve dhe biznesit që të sigurojnë një informacion më të besueshëm në treg dhe të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme në të.

Lehtësimi i informacionit nëpërmjet institucioneve rregulluese bën që transaksionet ekonomike të jenë më pak të kushtueshme dhe më eficiente, sepse aktorët ekonomikë marrin njohuritë e domosdoshme për të marrë vendimet e duhura ekonomike.

Rasti më i zakonshëm i dështimit të tregut është transferimi i informacionit në mënyrë asimetrike midis aktorëve në treg. Në kushtet kur një treg ofron një informacion të paplotë dhe të pabarabartë për të gjithë pjesëmarrësit në të, atëherë të gjithë do të krijojnë marrëdhënie të mosbesimit ndaj njëri tjetrit, dhe kjo krijon kosto shtesë për realizimin e transaksioneve ekonomike.

Në rastin e Shqipërisë, institucioni rregullues që do të favorizonte fuqimisht procesin e rritjes ekonomike dhe të krijimit të burimeve të qëndrueshme të rritjes së stokut të kapitalit, do të ishte Bursa e Tiranës (TSE). Ky institucion dhe performanca e tij ndikon drejtpërdrejtë në tregun e kapitaleve.

Mungesa e një informacioni të sigurt dhe transparent krijon pasiguri, nga njëra anë në të gjithë individët, të cilët do të donin të rrisnin stokun e tyre të kapitalit me anë të shitjes së aksioneve, dhe nga ana tjetër në të gjithë individët që do të dëshironin informacion për investimet e tyre. Kështu, të gjithë ata që kanë kapacitete kapitalesh dhe ide të qarta për t'i investuar ato, frenohen në iniciativat e tyre ekonomike, për shkak të pasigurisë që vjen nga mungesa e informacionit.

Ky mosfunksionim i tregut ndikon negativisht në TFP dhe ndalon alokimin eficient të burimeve të kapitalit. E vetmja mënyrë për ta mënjeluar këtë dështim të tregut, është krijimi i një burse, e cila është një institucion rregullues që i jep mundësi shumë individëve dhe firmave të tregtojnë elemente të kapitalit në mënyrë të sigurt, në bazë të një informacioni të besueshëm që ofrohet pikërisht nga ky institucion.

Për të siguruar një zhvillim të tregjeve të kapitaleve edhe në Shqipëri, janë bërë përpjekje për të rregulluar këtë treg me anë të krijimit të institucionit rregullues përkatës,

që është bursa. Bursa e Tiranës TST, është krijuar në vitin 1996 si departament i Bankës së Shqipërisë. Në 1 korrik 2003, Bursa e Tiranës mori nga Komisioni i Letrave me Vlerë licencën si treg letrash me vlerë dhe funksionon si një institucion i pavarur.

Misioni i këtij institucioni është që të organizojë dhe zhvillojë tregjet e siguriteve në Shqipëri. Krijimi i kushteve të favorshme për sigurimin e informacioneve transparente për shitësit, investitorët dhe ndërmjetësit financiarë në Shqipëri, do të lejonte kapitalet të alokoheshin në mënyrë më eficiente dhe TFP të ndikohej pozitivisht.

Bursa e Tiranës është i pari dhe i vetmi treg i organizuar letrash me vlerë në historinë e financave shqiptare, në të cilin tregtohen letra me vlerë të pronësisë (aksione) dhe letra me vlerë të borxhit (bono thesari, obligacione shtetërore, bashkiake), alternativa te reja investimi.

Sfida më e madhe që ka përpara ky institucion, është që t'ju krijojë individëve dhe bizneseve mundësi sa më të gjera për të investuar në tregjet e kapitaleve dhe për të diversifikuar portofolet e tyre. Bursa e Tiranës duhet që, krahas transparencës në shpërndarjen e informacionit, të arrijë të sigurojë një nivel të pranueshëm të garantimit të sigurisë së të dhënave të firmave dhe të kontribuojë në krijimin e një klime besimi në biznesin shqiptar.

Konkluzione

Nga analiza e mësipërme e burimeve të rritjes në Shqipëri, del se kontribuuesi më i madh i rritjes ekonomike në vitet e tranzicionit, ka qenë përmirësimi i TFP-së, i cili ka sjellë rialokimin e burimeve në aktivitetet më prodhuese, si dhe transformime të rëndësishme strukturore.

Nga disa studime të Bankës Botërore mbi rritjen në Shqipëri, është provuar se, në vitet e fundit, rritja e TFP-së ka filluar të bjerë, kështu që, për të ardhmen duhet të gjenden burime të reja, që mund të jenë rritja e normës së akumulimit të kapitalit fizik dhe human, por edhe përmirësimi i mëtejshëm i sjelljes së institucioneve

Që ekonomia shqiptare të sigurohet se do të karakterizohet nga një rritje ekonomike e qëndrueshme, në periudhat e ardhshme, duhet që përpjekjet të orientohen në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, të sigurohen një *stabilitet makroekonomik*.

Eksperienca ka treguar se instabiliteti makroekonomik sjell rënie të investimeve dhe ul trajektorën e rritjes ekonomike. Në të kundërt, sigurimi i stabilitetit makroekonomik krijon një mjedis të sigurt për investimet në kapital njerëzor e fizik dhe rritje ekonomike. Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin të gjithë stabilizatorët fiskalë apo monetarë që mund të sigurojnë ekonomisë një qëndrueshmëri në sistemin e çmimeve dhe të nxisin investimet.

Së dyti, të *përmirësohet klima e biznesit dhe të rritet konkurrueshmëria e njëzive ekonomike vendase*

Me gjithë përpjekjet e bëra nga qeveria, ky drejtim i përmirësimit të institucioneve, qeverisjes dhe infrastrukturës së biznesit, është një fushë ku duhet të orientohen

përpjekje të mëdha. Një klimë favorizuese për bizneset prodhuese, jo vetëm do të stimulojë investimet vendase, por do të nxisë eksportet me anë integrimit tregtar në tregjet rajonale e më gjerë dhe do të përmirësojë alokimin e burimeve. Përmirësimi i klimës së biznesit në të dy drejtimet është thelbësor për një treg të vogël si tregu shqiptar. Shumë nga bizneset tona do të arrijnë eficiencën vetëm kur të mund të realizohen në një treg të gjere që mund të jetë rajonal apo ndërkombëtar.

Së treti, të rritë *mobilizimin e projekteve për investime publike themelore me orientim te fortë biznesi*

Qeveria duhet të krijojë një ekuilibër, në mënyrë që investimet, nga njëra anë, me investimet publike, të nxisë përmirësimin e arsimit dhe infrastrukturës, dhe nga ana tjetër, të krijojë hapësira për investimet eficiente private. Në këtë drejtim, duhen përmirësuar metodat e qeverisjes në mënyrë që të shmanget informaliteti dhe përdorimi jo eficient i fondeve.

Bibliografia

Bank of Albania www.bankofalbania.gov.al

Douglass C. North *"Institutions, Institutional change and Economic performance"* Cambridge University Press, 2006

Dani Rodrik *"Institutions for High Quality Growth"* Harvard University, 1999

Faruk Khan *"Albania: Sustaining Growth beyond Transition"* World Bank Working Paper, Country Economic Memorandum for Albania, 2004

Mark De Broeck, Vincent Koen *"The great contraction in Russia, the Baltics and other Countries of the former Soviet Union"* IMF Working Paper 1998

Robert Barro *"Determinants of Growth"* MIT Press, 1997

Schnytzer Adi *"Stalinist Economy in Practice: case of Albania"* Oxford University Press 1982

Zhvillimi ekonomik në retrospektivë dhe në perspektivë

Dr. Selami Xhepa

ABSTRAKT. *Studiuesit e ekonomisë që përpiqen të shpjegojnë “gjëegjëzën” e pashpjegueshme të zhvillimit ekonomik të shoqërisë njerëzore, janë ballafaquar me pyetje dhe ngërthyer në dilema të pazgjidhshme. Pse disa vende janë të zhvilluara dhe disa jo? Cilët janë faktorët fundamental të rritjes dhe a janë ato njëlloj për të gjitha vendet dhe të gjitha kohërat? Cilat janë limitet e rritjes ekonomike dhe a ka të tilla? Pyetje të kësaj natyre të disiplinës së ekonomisë të zhvillimit, kanë tërhequr vëmendjen e kërkuesve përgjatë shekujve, me shpresën për të kuptuar proceset që zhvillohen brenda kësaj “kutie të zezë” dhe për të orientuar politikë-bërjen me synimin që të përshpejtohet zhvillimi ekonomik i vendit dhe të rritet standardi i jetesës së qytetarëve.*

Në këtë kontekst, megjithatë, duhet bërë një parantezë, duke sjellë në kujtesë një cilësim të Shumpeterit (1952) se “ekonomiksi nuk është një listë recetash politike, por një tërësi instrumentesh analitik”¹. Pra, ekonomiksi na jep metodologjinë në studimin dhe kuptimin e një fenomeni, por ai as mund të fajësohet dhe as të pretendojë meritat e dështimeve apo sukseseve të zhvillimit ekonomik të shoqërisë. Zhvillimi nuk është thjesht ekonomiks; ai shtrihet tek historia, politika, sociologjia, antropologjia – duke qenë kështu në fushë ndërdisiplinore. Për këto arsye, hedhja e vështirimit pas në histori është shumë ndihmuese, pasi nga jehonat e një bote të vjetër, mund të nxirren mësim të vryera, që do të parandalonin rënien e shoqërisë sonë në një errësirë të dytë mesjetare.² Për ekonomiksin, të

1 Josef Schumpeter, 1952, “History of Economic Analysis”.

2 Historia nuk na ofron precedentë të një progresi të pandërprerë. Çdo vit që kombet e zhvilluara shmanjin një kohë të turbullt të re, ne vendosim një rekord të ri të njerëzimit. Lexoni fjalët e Xhorxh DUBY ndërsa ai përshkruan Europën në shekullin e njëmbëdhjetë. Është e frikshme të mendosh se këto dekada të tmerrshme erdhën pas dhe jo përpara përparimit të madh të Greqisë së vjetër, Romës, Babilonisë dhe Egjiptit: bota e Perëndimit në vitin 1000. Një botë e egër, e ngërthyer nga uria. Popullsia e saj e vogël dhe e dobët është në fakt shumë e madhe. Njerëzit luftojnë duarbosh, si skllevër të një natyre të pamëshirshme dhe një toke jo produktive sepse punohet dobët. Asnjë fshatar që mbjell një shinik drithë nuk parashikon të korrë tre – edhe nëse nuk është një vit i vështirë; kjo do të thotë bukë për të ngrënë deri në kohën e Pashkës. Pastaj duhet të mbahet me barishtet, rrënjët dhe gjërat e ujit, që mund të nxirren nga pylli apo brigjet e lumenjve..... Disa herë kur bie shi i dendur dhe pengon plugimin e tokës gjatë vjeshtës, kur furtunat godisin dhe prishnin prodhimet, mungesa e zakonshme e ushqimit bëhet një uri, një valë vdekjeprurëse e lëngimit. Kronikat e kohës shpesh përshkruajnë lëngata të tilla, jo pa një lloji kënaqësie. “Njerëzit ndiqnin njëri-tjetrin në mënyrë që të hanin diçka nga trupi i tjetrit, tamam si ujqër”. Cituar nga Todd G. Buchholz, 2007, “*Idet e Reja Nga Ekonomist të Vdekur*”. Argjentina e filloi shekullin e njëzetë me një

cilit i mungon eksperimenti si metodë, historia është laborator nga ku ne mund të mësojmë për sukseset, por më me rëndësi nga gabimet, në rrugën e zhvillimit ekonomik.

Përgjatë historisë së ekonomiksit, paradigmat teorike të tij janë luhatur midis “laissez-faire smithian”, ndërhyrjeve kejnsoniane, teorisë marksiste të shoqërizimit, për t’u rikthyer, në fundin e shekullit të kaluar, tek paradigmat e magjive çudibërëse të forcave të tregut.³ Por, sot, siç e cilëson Greenspan, ne kemi hyrë në epokën e turbulencës⁴, prandaj dhe ne jemi kejnsonianist dhe fridmanist njëherësh, ose thjesht eklektik. Për të kuptuar më mirë realitetet e sotme, le të bëjmë pra një vështrim të shpejtë në teoritë ekonomike të zhvillimit, të cilën po e sjell në formën e një përmbledhjeje të studimeve të hershme të kryera nga autorët më në zë, dhe të përmbledhura njëkohësisht në një botim të Meier and Stiglitz (2001).⁵

Një historik i shkurtër i teorisë të zhvillimit ekonomik të botës së pasluftës⁶

Një ndër fushat më të studiuara në teoritë e zhvillimit është ajo midis tij dhe pabarazisë shoqërore. Rritja ekonomike është e lidhur ngushtësisht me rritjen e standardit të jetesës së shoqërisë, por a përfitojnë të gjithë nga rritja ekonomike, apo vetëm një pjesë e saj, apo një grup i caktuar shoqëror. Simon Kuznets është ndër baballarët e studimit të rritjes ekonomike moderne. Një nga pretendimet e tij se, gjatë procesit të zhvillimit ekonomik, shpërndarja e të ardhurave ndjek formën e një kurbe “U” me kokë poshtë, pra duke qenë fillimisht më të pabarabarta dhe pastaj më të barabarta (Kuznets, 1955), mbetet një ndër pikat më të nxehta të debatit edhe në ditët e sotme. Ekonomistë të tjerë kanë nxjerrë konkluzione krejt të kundërta (shih, Deininger and Squire, 1998). Në botën e globalizuar të para vitit 1914, emigracioni masiv krijoi një rritje të pabarazisë së të ardhurave në vendet pritëse, por një ngushtim të pabarazisë në vendet origjinuese, përfshi Italinë dhe Suedinë (Williamson, 1997). Eksperiencia amerikane, për dy shekuj deri në mesin e viteve ’70, provon kurbën rritëse të Kuznets, por këtë nuk e provon eksperiencia britanike pas vitit 1688. Në thelb, përgjithësimi i Kuznets ndeshet me evidenca që janë shumë mikse. Sidoqoftë, studimi i marrëdhënieve midis zhvillimit dhe pabarazisë, ka orientuar kërkimet në një sërë variablash me një fuqi të padiskutueshme në këtë *trade off*, të tillë si, zhvillimet demografike, zhvillimi i kapitalit njerëzor, ndryshimet në teknologji dhe efektin Engel.⁷

PBB për frymë (në terma real) më të madhe se të Gjermanisë dhe e mbylli shekullin me një shifër sa gjysmën e këtij treguesi të Gjermanisë. Shembuj të tillë të prapësimeve të niveleve të zhvillimit ekonomik të një vendi janë dokumentuar nga historiani i shquar i ekonomisë, Angus Maddison (1995: *Monitoring the World Economy, 1820-1992*: Paris, OECD).

3 Megjithatë duhet theksuar se lufta e kapitalizmit akoma nuk është fituar. Amerika Latine është shembulli që ilustron më së miri këtë konkluzion.

4 Alan Greenspan, 2007, “The Age of Turbulence: Adventures in a New World”, Penguin Books.

5 Gerald M. Meier and Joseph Stiglitz, 2001, “Frontiers of Development Economics: The Future in Perspective”, A co-publication of the World Bank and Oxford University Press.

6 Kjo pjesë bazohet kryesisht në një punim të Nicholas Crafts, *Historical Perspectives on Development*, 2001, and comments of Avner Greif and David Landes.

7 Ligji Engel (statistician gjerman) thekson se elasticiteti i kërkesës për ushqime në raport me të ardhurat është më i vogël se 1.

Një kontribut i mirënjohur në fushën e teorive të rritjes është teoria e etapave të rritjes ekonomike e Rostow (1956).⁸ Ideja e tij ishte ajo e një progresi linear të zhvillimit nëpër faza që kalon: nga shoqëria tradicionale – përgatitja e kushteve për të bërë kërcimin e madh – kërcimi – vënia në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm. Që të bëhej kërcimi, duhej që të dyfishoheshin ritmet e investimeve prodhuese, të zhvillohej një ose më shumë sektor udhëheqës, me lidhje *backward* dhe *forward*, dhe një strukturë e përshtatshme institucionale që mund të nxiste zhvillimin ekonomik në dy apo tre dekada. Etapa e përgatitjes së kushteve për zhvillim nënkuptonte: investime në kapitalin njerëzor, zhvillimin e një infrastrukture ligjore dhe institucionale që lehtëson investimet dhe inovacionin, si dhe një sektor bujqësor dinamik që çliron faktorët e prodhimit, në mënyrë të veçantë fuqinë punëtore jobujqësore.

Paaftësia e kësaj teorie për të shpjeguar modelet e zhvillimit të ekonomive të veçanta, si për shembull të Francës dhe të Britanisë, i dha rrugë zhvillimit të një teorie alternative mjaft të fuqishme, të zhvilluar nga një tjetër ekonomist i madh i historisë së zhvillimit ekonomik, Gerschenkron (1962). Në librin e tij më të rëndësishëm *Economic Backwardness in the Historical Perspective*, ai parashtroi teorinë e zëvendësuesve të parakushteve të zhvillimit: inovacioni institucional mund të shmangë krijimin e marrëdhënieve mbi bazën e tregut, shteti mund të jetë një zëvendësues i tregjeve private të kapitalit, fitimet monopol mund të gjenerojnë kursimet për të financuar investimet, sistemi bankar mund të sigurojë sipërmarrjen dhe tregtia e jashtme mund të zëvendësojë sektorin e brendshëm bujqësor për të mbështetur zhvillimin e industrisë së brendshme. Kërkimet e bëra nga autorë të ndryshëm (Crafts, Trebilcock, etj.) nuk gjejnë evidenca të qëndrueshme për konkluzionet e Gerschenkron. Teza që ka një pranueshmëri më të gjerë, dhe që akoma është një fushë e kërkimeve të mëtejshme, është ajo midis zhvillimit ekonomik dhe nivelit të zhvillimit të tregjeve financiare.

Megjithëse tezat e Rostow dhe Gerschenkron nuk kanë gjetur konfirmim të pranueshëm nga kërkimet e mëvonshme, fuqia e tyre intelektuale vazhdon akoma të ushqejë kërkimet ekonomike edhe në ditët e sotme. Për shembull, idetë e ndërhyrjes shtetërore për të shmangur rënien e ekonomisë në një ekuilibër të keq, janë formalizuar në modele që aplikojnë të ardhurat rritëse të shkallës dhe mostregtueshmërinë së disa inputeve të prodhimit (Rodrik, 1996). Po kështu, mbeten akoma një objekt kërkimi dhe debati intelektual, roli i shtetit në zhvillimin ekonomik dhe çështjet e tjera që janë parashtruar nga këta autorë në lidhje me prerekuizitat për zhvillim.

Një tjetër mësim i rëndësishëm që del nga shqyrtimi i faktorëve të rritjes ekonomike është roli i inovacionit dhe progresit teknologjik, që veçanërisht në vitet e para të tij, është modest. Ky konkluzion gjendet tek studimet e para pioniere të kësaj çështjeje të Fogel and Fishlow, në lidhje me rolin e hekurudhës në zhvillimin e ekonomisë amerikane, dhe ka gjetur mbështetje edhe në studimet e tanishme mbi rolin e kompjuterëve (Sichel, 1997). Me gjithë sofistikimin e modeleve ekonometrike në studimin e rritjes dhe faktorëve të zhvillimit, dobësia themelore e tyre vazhdon të jetë prezente dhe që është paaftësia e tyre për të shpjeguar ndryshimet endogjene

8 Rostow W.W, 1956, "The Take-Off into Self-Sustained Growth", *Economic Journal* 66.

teknologjike dhe institucionale. Në këndvështrimin historik të zhvillimit, janë divergjencat e këtyre dy faktorëve që qëndrojnë në thelb të divergjencave të zhvillimit ekonomik midis vendeve.

Modelet e regresionit në teoritë e rritjes

Literatura e modeleve të regresionit mund të ndahet në dy etapa. Në fillimet e veta, variablat në të djathtë të ekuacioneve të regresionit ishin tregues që karakterizonin akumulimin e kapitalit dhe nivelin fillestar të të ardhurave si faktorët shpjegues të rritjes ekonomike. Modelet e këtij tipi e shihnin tranzicionin e vendeve të Europës Lindore në një kontekst neoklasik të rritjes. Punime të kësaj fushe me një aplikim edhe për ekonominë shqiptare mund të gjenden tek Fisher et al (1998)⁹. Në diskutimin e Abramovitz mbi rritjen ekonomike dhe arritjen e niveleve të vendeve më të përparuara, theksohen dy momente kyçe. Së pari, procesi i arritjes së vendeve të përparuara përfshin ngushtimin e hendekut teknologjik. Së dyti, ai kërkon “aftësi sociale”, domethënë aftësinë për të asimiluar dijen teknologjike të vendeve të përparuara. Këto çështje, kërkojnë jo vetëm nivele adekuate të kapitalit njerëzor, por edhe institucione të përshtatshme, një shkallë hapjeje ndaj ekonomisë globale dhe një sistem politik që nuk bllokoi reformat apo bllokoi iniciativat krijuese. Sipas Abramovitz, kombinimi i hendekut teknologjik dhe aftësive shoqërore, përcaktojnë dhe potencialin e një vendi në rritjen e produktivitetit, ndërsa kuadri makroekonomik dhe lehtësimi i përhapjes ndërkombëtare të teknologjisë, influencojnë realizimin e këtij potenciali.

Gjenerata e dytë e modeleve të regresionit, vendos në ekuacion, si faktorë shpjegues që matin cilësinë institucionale, të tillë si shteti ligjor dhe respektimi kontratave, të

9 Stanley Fisher, Ratna Sahay, Carlos A. Vegh “*From Transition to Market: Evidence of Growth and Prospects*”, *IMF Working Paper WP/98/52*; 1998. Për faktorët e rritjes ekonomike afatgjatë në ekonominë në tranzicion, disa studime janë bërë duke identifikuar si përcaktues të rritjes: ritmin e rritjes së popullsisë; nivelin e arsimimit primar dhe sekondar; formimin e kapitalit (gross capital formation); eksportet dhe konsumin e qeverisë; dhe të ardhurat për frymë të popullsisë. Rritja ekonomike shihet si funksion:

$$g(t) = f(Y1960, PRIM, SEC, INV(t), GOV(t), POP(t)).$$

- + + + ? - Drejtimi i lidhjes se variableve.

Ku: Y1960 = të ardhurat për frymë në vitin 1960;

G(t) = rritja ekonomike

PRIM = niveli i primary school enrollment;

SEC = niveli i secondary school enrollment;

GOV = konsumi i qeverisë

POP = përqindja e rritjes së popullsisë;

INV = pesha specifike e investimeve ndaj PBB.

Dy ekuacionet e rritjes afatgjatë të fituara janë:

Rezultatet e Barro (1991) tregojnë:

$$G(t) = 0,0302* - 0,0075*Y1960 + 0,025*PRIM + 0,0305*SEC - 0,119*GOV$$

Ndërsa sipas Levine & Renelt:

$$G(t) = -0,83 - 0,35*Y1960 - 0,38 POP + 3,17*SEC + 17,5* INV$$

drejtat pronësore, cilësinë e burokracisë dhe korrupsionin, etj, faktorë që kanë treguar se kanë një ndikim të madh në rritjen ekonomike (EBRD, 1997, Easterly and Levine, 1997, Rodrik, 1999).¹⁰ Këto punime janë një jehonë e punimeve në North, një tjetër personalitet i mirënjohur në historinë e ekonomisë botërore. Në zemër të teorisë së North mbi rritjen ekonomike qëndrojnë të drejtat pronësore, të qarta dhe të mbrojtura me ligj dhe që reduktojnë kostot e transaksioneve, gjë që inkurajon investimet prodhuese dhe inovacionin. Siç thekson Coase (1937), kur realizimi i të drejtave të pronësisë është i kushtueshëm, tregu mundet ose jo të jetë sistemi më i mirë i alokimit të burimeve ekonomike.¹¹

Karla Hoff dhe Josef Stiglitz (2001)¹² marrin në analizë çështjen e forcave që shpjegojnë divergjencën në nivelet e të ardhurave midis vendeve të ndryshme. Sipas tyre, vendet e industrializuara ndryshojnë nga vendet në zhvillim nga shumë më tepër se sa nivelet e kapitaleve, përfshirë dhe kapitalin njerëzor. Domethënë, më shumë kapital nuk mund të shpjegojë divergjencat midis vendeve. Po kështu, eliminimi i ndërhyrjeve shtetërore në ekonomi mund të jetë diçka e dëshirueshme, por rezulton të mos jetë as një kusht i nevojshëm dhe as i mjaftueshëm për një rritje ekonomike të qëndrueshme. Ata e shohin procesin e zhvillimit ekonomik jo si një proces të akumulimit të kapitalit, por si një proces të ndryshimit organizativ.

Rritja dhe zhvillimi i ekonomisë shqiptare përgjatë tranzicionit

S hqipëria hyri në rrugën e zhvillimit modern të saj vetëm me shembjen e sistemit të ekonomisë së centralizuar në fillim të viteve '90. Ajo hyri në procesin e tranzicionit ekonomik si një vend me një ekonomi të dobët dhe të prapambetur, me një trashëgimi të varfër në bazën e saj ekonomike, me një stok kapitali tërësisht të vjetruar dhe të amortizuar, pra, një vend me një ekonomi tërësisht të paralizuar dhe të falimentuar. Dekada e fundit të viteve '80 shënoi një ngadalësim shqetësues në ritmet e rritjes ekonomike. Ritmi mesatar i rritjes së prodhimit të brendshëm në periudhën 1985-'90 ra në mesatarisht 0.25% në vit, krahasuar me një ritëm mesatar vjetor rritjeje prej rreth 7.5 % në periudhën 1970-'80. Në vitin 1990, ekonomia ra me 10 %, për të vazhduar edhe më këtë proces rënije të thellë. Deri në fund të vitit 1992, prodhimi i ekonomisë ishte më pak se 70 % e vëllimit të prodhimit të vitit 1990. Për të mbajtur në këmbë një ekonomi të falimentuar, shpenzimet buxhetore u rritën ndjeshëm, duke e çuar gjendjen e deficitit buxhetor në 58.6 % të PBB-së, ndërsa inflacioni kishte shënuar një nivel mesatar vjetor prej 226 %. Prodhimi i përgjithshëm për frymë ishte 211 dollarë, duke e renditur Shqipërinë si vendin më të varfër në të


10 EBRD, 1997, Transition Report, London; Easterly and Levine, 1997, "Africa's Growth Tragedy: Policies And Ethnic Division", Quarterly Journal of Economics 112, (November); Rodrik, 1999, "Where All The Growth Go? External Shocks, Social Conflict And Growth Collapse", Journal of Economic Growth 4 (December).

11 Coase, Ronald H, 1937, "The Nature of the Firm", Economica 4, 1960.

12 Karla Hoff and Josef Stiglitz, 2001, "Modern economic theory and development", in Frontiers of Development Economics: The future in perspective.

gjitha ekonomitë në tranzicion. Duke filluar nga mesi i vitit 1992, Shqipëria filloi të zbatojë një program të ashpër të stabilizimit makroekonomik, për të vënë nën kontroll shpenzimet qeveritare dhe inflacionin, dhe nisi zbatimin e reformave strukturore, në zemër të të cilit ishin programi i privatizimit dhe hapjes së sektorëve të ekonomisë për sipërmarrjen private vendase dhe të huaj, liberalizimi i tregtisë dhe shkëmbimeve me jashtë dhe derregullimi i tregjeve në tërësi.

Siç vërehet dhe nga grafiku i mëposhtëm, rrjedha ekonomike ndryshoi kahun e saj negativ dhe, duke përjashtuar vitin 1997, ekonomia e vendit ka përjetuar një rritje, duhet thënë impresionuese, në të gjithë epokën post komuniste. Në fund të vitit 2000, ekonomia tashmë e kishte arritur nivelin e saj të paratranzicionit, ndërkohë që vendeve të tjera të Europës Juglindore iu deshën akoma mesatarisht dhe një pesëvjeçar që të rikuperonte rënien e shënuar para fillimit të tranzicionit.



(Burimi i të dhënave: Deri në vitin 1999 janë marrë nga data base e Bankës Botërore dhe pas kësaj periudhe nga raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë, 2007)

Një analizë e hollësishme dhe rigoroze (dhe në dijeninë time e vetmja) nga pikëpamja metodologjike mbi burimet e rritjes në Shqipëri është kryer nga një grup i ekspertëve të Bankës Botërore¹³, një studim i mbikëqyrur nga dy prej ekonomistëve më të spikatur të kohës sonë, Robert Solow (MIT) dhe Robert Barro (Universiteti Harvardit). Studimi aplikon metodën e kontabilitetit të rritjes (*growth accounting*) dhe faktorizon ndikimin individual të faktorëve të prodhimit (punës dhe kapitalit) dhe produktivitetit total të faktorëve (ose përfitimet nga përmirësimi i shpërndarjes së burimeve ekonomike). Rezultatet e këtij studimi janë paraqitur në këtë tabelë, (tabela 1) nga ku spikasin disa konkluzione të rëndësishme të raportit.

13 Shqipëria: Ruajtja e Rritjes së Qëndrueshme edhe përtej Tranzicionit, *Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë*, Raport Nr. 29257-AL, Dhjetor 2004

Tabela 1: Llogaritjet e burimeve të rritjes ekonomike (skenari 1: pa marrë në konsideratë heqjen e stokut të kapitalit të trashëguar nga sistemi mëparshëm).

Mesatarja vjetore e			Kontributi nga		
	rritjes reale te PBB, %	Rritja e kapitalit	Rritja e fuqisë punëtore	Rritja e TFP	Rritja faktoriale
1982-89	2.17	2.2	1.93	-1.97	4.13
1990-92	-15.26	0.47	0.78	-16.5	1.25
1993-03	6.27	-0.05	0.18	6.1	0.13
1993-96	9.25	-0.54	-0.51	10.3	-1.05
1998-01	7.35	0.05	0.56	6.75	0.61
2002-03	5.35	0.78	1.07	3.5	1.85

Është e dukshme që në epokën e paratranzicionit ishte niveli i kapitalit dhe punës që ndikonte pozitivisht në normën e rritjes, por që alokimi i burimeve dhe eficientia e përdorimit të tyre ishin me impakt negativ. Një tezë e mendimit ekonomik thekson se, për rritjen ekonomike nuk është aq i rëndësishëm niveli i kapitalit se sa eficientia me të cilin përdoret ky kapital ose faktor prodhimi.¹⁴ Për rrjedhojë, është e kuptueshme që, me liberalizimin e çmimeve dhe të shkëmbimeve në fillimet e tranzicionit, burimi kryesor që ushqeje rritjen ekonomike ishin faktorët e eficientës së përdorimit të faktorëve (TFP). Nga ana tjetër, efekti i veprimt të tij, që është e kuptueshme që do të ishte në rënie, nuk ka qenë e mundur të kundër-balancohet nga rritja e përdorimit të faktorëve të rinj të prodhimit, punës dhe kapitalit. Ky është një shpjegim logjik i rënies së normës së rritjes ekonomike përgjatë viteve. Po kështu, duke parë këto prirje në faktorët e rritjes, rritja ekonomike në të ardhmen pritet të ngadalësohet më tej¹⁵,

- 14 Në studimet e historianëve të ekonomisë dhe ekonomistëve të zhvillimit, reziduali ishte dhe shpjeguesi kryesor i rritjes ekonomike të ekonomive të vendeve të botës. Ky rezidual identifikohet me një kompozitë të efekteve të forcave të ndryshme, si: (i) përmirësimi në cilësinë e punës nëpërmjet edukimit, eksperiencës dhe trajnimit në punë; (ii) rialokimit të burimeve nga aktivitetet me produktivitet të ulët në aktivitetet me produktivitet të lartë qoftë për shkak të forcave të tregut apo eliminimit të deformimeve të ekonomisë; (iii) shfrytëzimit të ekonomisë së shkallës; (iv) përmirësimit të mënyrave të kombinimit të burimeve për të prodhuara mallra dhe shërbime, jo vetëm në nivel ekonomie, por dhe në nivel fabrike apo ferme. Gerald Mayer, 2001, **The Old Generation of Development Economists and the New**, in *Frontiers of Development Economics: The future in perspective*.

- 15 Autorët e studimit të CEM, parashikojnë ekuacionin e mëposhtëm neoklasik të rritjes:

$$y_{ritje_i} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln\left(\frac{I}{Y}\right) + \alpha_2 \ln(sec_i) + \alpha_3 \ln(n_i + g + \delta) + \alpha_4 \ln(y_{0,i}) + \varepsilon_i$$

ku y_{ritje} është niveli i rritjes së GDP reale për frymë gjatë periudhës 1980-2000, y_0 është GDP reale fillestare për frymë në 1980, (I/Y) dhe n janë nivelet mesatare të rritjes së investimeve dhe popullsisë për periudhën 1980-2000, sec është niveli mesatar i regjistrimit në arsimin e mesëm për periudhën 1980-96, dhe $g+\delta$ (niveli i përparimit teknologjik dhe amortizimit) është supozuar të jetë një nivel i njëjtë prej 0.05 për të gjitha vendet. Niveli mesatar i regjistrimit në arsimin e mesëm është konsideruar ai i periudhës 1980-96 vetëm për arsye se siç është vënë në dukje edhe më parë, të dhënat e *Treguesve të Zhvillimit Ndërkombëtar* për nivelet e regjistrimit në arsimin e mesëm mbas vitit 1996 nuk janë të krahasueshme me ato të periudhës përpara vitit 1996. Duke aplikuar të dhënat e vendit tonë në këtë ekuacion regresioni, rritja afatgjatë e prodhimit për frymë në Shqipëri rezultojnë të zbrësë deri në 2.16%.

nëse nuk zbatohen politika të nxitjes së kursimeve dhe të investimeve në ekonomi. Ky konkluzion është me implikime mjaft të rëndësishme për politikë-bërjen dhe përvijon në këtë mënyrë dhe prioritetet themelore të vendit në fokusimin e politikave qeveritare në masat që nxisin investimet private, të brendshme dhe të huaja, dhe që nxisin inovacionin dhe sipërmarrjen në vend.

Rritja ekonomike në perspektivë

Mësimet që ekonomistët kanë nxjerrë nga historia e zhvillimit të ekonomisë botërore ndër vite, megjithëse jo gjithnjë kanë qenë të qarta, duket se konvergjojnë në atë se, ndër faktorët kritik të suksesit mbeten sipërmarrja dhe një mjedis që inkurajon aktivitetet sipërmarrëse, që i ofron asaj sigurinë dhe nxitjet e nevojshme dhe minimizon barrierat dhe vështirësitë ndaj saj. Në librin e botuar së fundmi nga Baumol et al,¹⁶ (2007), analizohen pikërisht faktorët dhe politikat për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme të ekonomisë në kushtet e organizimit kapitalist të sistemit të prodhimit dhe pronësisë. Një ndër konkluzionet qendrore të këtij libri është se, jo çdo lloji kapitalizmi mund të sigurojë rritje ekonomike dhe prosperitet shoqëror. Në katër format e organizimit kapitalist që ata dallojnë¹⁷, burimi më i besueshëm dhe i qëndrueshëm i inovacionit radikal, pikërisht atij faktori themelor të rritjes ekonomike, mund të gjendet vetëm tek firmat e reja, të cilat nuk kanë interesa të veshura tek gjendja ekzistuese e tregut, dhe që ndeshen vetëm në orientimin e zhvillimit ekonomik sipas modelit të një kapitalizmi sipërmarrës, një kapitalizmi që ushqen krijimin e firmave të reja dhe inovatore.

Në këtë këndvështrim, krijimi i një ambienti që lehtëson hyrjen e firmave të reja në treg, është një ndër drejtimet më të rëndësishme të reformave që kanë ndërmarrë të gjithë ekonomitë botërore, të tillë si Bashkimi Europian në nismën e vet për rritjen e Konkurrueshmërisë së ekonomisë europiane deri në vitin 2010, por në veçanti ekonomitë në tranzicion në të gjithë botën. Akset e politikave dhe reformave janë ankoruar përreth drejtimeve që janë parashtruar në botimin e Bankës Botërore, *Doing Business*, një botim i përvitshëm dhe që mat progresin e vendeve dhe të reformave të ndërmarra. Botimi më i fundit i këtij raporti¹⁸, evidenton një progres të rëndësishëm të bërë nga ekonomitë e rajonit tonë, ku vendi ynë spikat ndjeshëm në raport me konkurrentët e vet më eminent, në fusha të tilla si: lehtësia e hyrjes në biznes (thjeshtimi i procedurave, i kohës dhe kostove për të krijuar një biznes të ri),

16 William J. Baumol, Robert E. Litan, Carl J. Schramm, 2007, "Good Capitalism, Bad Capitalism and the Economics of Growth and Prosperity", Yale University Press and New Haven & London.

17 **Kapitalizmi shtetëror**, ku shteti zgjedh industritë fituese dhe i mbështet ata me politika të posaçme; **kapitalizmi oligarkik**, karakteristike kjo për shumë vende të Amerikës Latine, Afrikës, Lindjes së Mesme dhe Rusisë, ku ekonomia orientohen nga interesat e një grupi të vogël njerëzish përfitues; **kapitalizmi i firmave të mëdha**, tipike kjo për vendet e Europës Perëndimore, Japoninë dhe Korenë dhe segmente të veçanta të ekonomisë amerikane; dhe **kapitalizmi sipërmarrës**, tipike për ekonominë e sotme amerikane.

18 World Bank, 2008, *Doing Business in South East Europe in 2008*. (www.worldbank.org)

suksesi ky që i dedikohet kryesisht krijimit të agjencisë “one stop shop” për regjistrimin e bizneseve. Numri i bizneseve të reja të krijuar ka proliferuar me shpejtësi, duke shërbyer si dëshmi e krijimit të një mjedisi më të lehtësuar për të hyrë dhe për të bërë biznes. Mbeten prioritete të reformës rregullatore të klimës së biznesit thjeshtimi procedurave të licencimit, dhe në veçanti procesi i realizimit të ndërtimit, marrjes lejes së ndërtimit, çështjet e regjistrimit të pasurive, zbatimit të kontratave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, që janë faktorë të rëndësishëm të një klime biznesi të shëndoshë dhe kompetitive.

Përmbledhje

Zhvillimi është i dëshirueshëm, por jo i pashmangshëm, thotë Stiglitz. Është i dëshirueshëm, pasi me të lidhet përmirësimi i standardit të jetesës dhe mirëqenia jonë, por mund të mos jetë i pashmangshëm pasi prapësimet në standardin e jetës materiale të shoqërisë njerëzore, siç u theksua më lart, nuk janë të paprecedentë. Politikat e drejta duhet të mundësojnë krijimin e një ambienti të shëndoshë që të shmangen aksidente të tilla të padëshirueshme për historinë e një kombi apo të civilizimit botëror në tërësi.

Bota përjetoi një rritje në standardin e jetesës së saj veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit, të paprecedentë në historinë e shoqërisë njerëzore. Thelbi i këtij progresi është bazuar tek rritja e produktivitetit, e ushqyer nga progresi teknologjik dhe inovacioni, veçanërisht në fushën e teknologjive të komunikimit, gjë që nga ana e vet, ka fuqizuar më tej prirjet e thellimit të proceseve globalizuese, veçanërisht në sektorin financiar. Kjo ka krijuar më shumë pasiguri dhe paqëndrueshmëri në tregjet e sotme globale, i ka bërë krizat ekonomike më të shpeshta, me efekte të shtrira dhe jo lehtësisht të izolueshme, vetëm tek ekonomitë, fundamentet e të cilave mund të justifikojnë realisht gjendjen e një krize ekonomike. Për pasojë, ashpërsia me të cilat godasin sot krizat ekonomike dhe financiare, ka frymëzuar më shumë kritikizëm ndaj proceseve globalizuese dhe vetë fenomenit të globalizmit. Reagimi i vendeve të botës ndaj krizës ushqimore të këtij viti me ngritje të mureve proteksioniste, pezullimi i negociatave të Raundit Doha (i supozuar të ishte një raund pro zhvillimit të vendeve të varfra), i përngjet të njëjtit precedent të krizës së madhe të viteve 1929-33, që Fridman dhe Shvartz pëlqenin ta cilësonin si “kontraktimi i madh”. Natyrisht që bashkëpunimi dhe koordinimi ndërkombëtar i politikave sot, është më lehtësisht i mundshëm, dhe njohja jonë historike është e mjaftueshme për të kuptuar mirë pasojat e zgjedhjeve të gabuara dhe për të vepruar në kohën e duhur për t’i parandaluar ato.

Zhvillimi i qendrueshëm dhe sfidat mjedisore

Dr. Juliana Latifi

ABSTRAKT. *“Ardhja e mijëvjeçarit të ri na ofron të gjithëve ne, një mundësi për reflektim mbi arritjet dhe dështimet e njerëzimit gjatë mijëvjeçarëve të shkuar dhe sfidave me të cilat do të përballemi në një epokë të re edhe më të ndërruarur në historinë e njerëzimit. Ndërkohë shumë nga shqetësimet tona aktuale mund të duken të parëndësishme në një perspektivë të tillë afatgjatë, por synimi për një zhvillim të qëndrueshëm, të barabartë dhe të shëndoshë nga ana mjedisore, merr një rëndësi edhe më të madhe, pasi ka të bëjë pikërisht me mbijetesën e jetës në Tokë”. Përpara njerëzimit sot, shfaqen probleme shumë shqetësuese për mjedisin. Hollimi i shtresës së ozonit; shfrytëzimi pa kriter i ujërave nëntokësore; rënia e prodhimit të tokës; shkatërrimi i pyjeve tropikale dhe pyjeve të thata; humbja e pakthyeshme e specieve; ndikimet e rritjes së pakontrolluar të popullsisë, etj; ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mbi mjedisin, duke bërë që ekuilibri mjedisor në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm të jetë i brishtë dhe shpesh herë i paqëndrueshëm.*

Koncepti i “zhvillimit të qëndrueshëm”

Shqetësimi i vendeve për të integruar mjedisin dhe zhvillimin ka çuar në krijimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë ky koncept përmendet në një sërë traktatesh dhe marrëveshjesh mjedisore, Raporti i Brutlandit nga Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit, krijuar nga Kombet e Bashkuara i vitit 1983, shikohet si dokumenti themelor që përcaktoi **zhvillimin e qëndrueshëm si objekt të politikës globale** dhe çoi në krijimin e një sërë rregullash të quajtura “E drejta ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm”. Raporti morri emrin e Kryetarit të Komisionit Gro Harlem Bruntland. Ai mbetet edhe sot aktual e përkufizoi zhvillimin e qëndrueshëm si **“zhvillimi që plotëson nevojat e tanishme pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre”**².

1 *Kofi Annan*, Fjalimi i përshëndetjes në Konventën e Aarhusit (Danimarkë, 25 qershor, 1998)

2 Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin. E ardhmja jonë e përbashkët, fq 43, 1987.

Ky përkufizim përmbante dy koncepte, atë të *nevojave* - veçanërisht të nevojave themelore të brezit të tanishëm dhe konceptin e *kufizimeve* të imponuara nga gjendja e teknologjisë dhe organizimit shoqëror, të aftësisë së burimeve mjedisore për të plotësuar nevojat e së tashmes dhe së ardhmes.

Arritja e Zhvillimit të qëndrueshëm nuk është detyre e lehtë. Katër dekadat e fundit kanë qenë dëshmitarë të një ndërgjegjësimi në rritje të efekteve shkatërruese të njerëzimit ndaj mjedisit, por natyra dhe shkalla e shqetësimit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe.

Megjithëse çështjet mjedisore filluan të merrnin përmasa politike që në vitet 1950, interesi ishte kryesisht i fokusuar në çështjet mjedisore vendore, pra nuk kishim një dimension ndërkombëtar. Vendet shqetësoheshin për ajrin e ndotur, ujin e ndotur dhe mbetjet toksike. Nga fundi i viteve '60 u bë e qartë që ndotjet nuk respektonin kufijtë kombëtarë, dhe se shumë çështje mjedisore ishin me rëndësi ndërkombëtare. Transportimi i largët i ndotjeve të ajrit, të tipit të shiut acid të impianteve që prodhonin energji në Britani dëmtonte pemët në Norvegji, dhe mbetjet e derdhura në lumin Rin në Gjermani dilnin në brigjet e Holandës. Këto probleme megjithatë, vazhduan të mbeteshin gjerësisht shqetësime rajonale deri në Konferencën e OKB për Mjedisin Njerëzor, të mbajtur në Stokholm në 1972.

E iniciuar nga shqetësime ndërkombëtare, por kryesisht perëndimore, konferenca njohu natyrën globale të problemeve mjedisore dhe vuri themelet për zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë stad, si shkak themelor i problemeve të ndotjes shihej rritja e pakontrolluar e popullsisë dhe zhvillimi ekonomik.

Konkluzioni logjik për disa ishte që, si zhvillimi ekonomik, ashtu edhe rritja e popullsisë, duhej të kufizoheshin, ose edhe të ndalohej, në mënyrë që të ndalohej katastrofa mjedisore. Natyrshëm, koncepti i kontrollit të popullsisë ndeshej me probleme etike në shumë pjesë të botës. Po kështu, ideja që zhvillimi ekonomik duhej të ngadalësohej për të siguruar mbrojtjen mjedisore, ishte pak i besueshëm, kryesisht në vendet në zhvillim.

Në vitin 1983 u formua Komisionit Botëror për Mjedisin. Ky Komision doli me një Raport përfundimtar, i titulluar **"E ardhmja jonë e përbashkët"**.

Raporti Bruntland, bënte një shtjellim për një integrim pozitiv të dimensioneve mjedisore, sociale dhe ekonomike të mjedisit. Sipas këtij Raporti *"ishte më mirë, një kompromis për një çështje të ravigjësuar dobët, se sa mos rënia dakord mbi një çështje shumë të qartë"*. Me dhënien dhe pranimin e një përcaktimi kaq të gjerë të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, pritej që Konferenca e Kombeve të Bashkuara e 1992 për Zhvillimin dhe Mjedisin e quajtur ndryshe -**Samiti i Tokës i Rios** do të arrinte në një nivel veprimi për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë 38 çështje, që përfshinin nga atmosfera deri tek turizmi i qëndrueshëm.

Samiti i Tokës³, pranoi faktin se, që të përballoheshin të gjitha këto problematika, duheshin burime të jashtëzakonshme, dhe në mënyrë thjesht rastësore, rënia e Murit të Berlinit premtonte të sillte një “Fitim Paqeje” nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve për problemet ushtarake. Fundi i Luftës së Ftohtë gjithashtu premtonte një konsiderim të ri të çështjeve të sigurisë, dhe çoi në **konceptin e sigurisë mjedisore**, ku u riformulua ideja se: **“degradimi mjedisor mund të çojë në kolapse sociale dhe ekonomike, emigracion masiv dhe si përfundim, në konflikte të dhunshme”**.

Kjo i dha një shtysë akoma më të madhe nevojës për veprim në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm. Pavarësisht nga studimet substanciale të dhjetëvjeçarit të shkuar, akoma ka paqartësi shkencore për sa i përket parashikimit të së ardhmes globale mjedisore.

Toka nuk është, dhe asnjëherë nuk ka qenë një sistem i pandryshueshëm. Ndryshueshmëria natyrore është dhe ka qenë një pjesë e ndërlikuar e të gjitha sistemeve mjedisore dhe vetëm shkurtimi i kohëzgjatjes së vëzhgimit të drejtpërdrejtë të aktivitetit njerëzor jep një ndjesi stabiliteti. Përballë kësaj ndryshueshmërie të tokës, pyetjet që shtrohen janë :

- ❖ A është ritmi i ndryshimit, që i atribuohet direkt faktorit njeri, kaq i ngadaltë sa do të ketë kohë të mjaftueshme për të reaguar ?
- ❖ Qeveritë e botës, a janë shumë të kujdesshme për të investuar para në një çështje akoma të paqartë ?

Nisur nga kompleksiteti i problemit, mungesa e dëshirës politike përpara paqartësive shkencore, apo thjesht vështirësitë e problemeve, bënë që angazhimet e marra në Rio para 12 vjetësh të jenë të pamjaftueshme për të përballuar këtë detyrë.

Por nga ana tjetër ka pyetje të tilla si:

- ❖ A është komuniteti ndërkombëtar në gjendje për zhvillim të qëndrueshëm ?
- ❖ A do të arrihet balanca ndërmjet mjedisit, ekonomisë dhe popullsisë ?
- ❖ A do të arrihet të shmangen efektet e kolapsit ekonomik, luftës, urisë, sëmundjeve?
- ngelen akoma të kohës, pa një përgjigje dhe pa një vizion të saktë edhe mbas ***Samitit të Johannesburgut të Gushtit 2002⁴***.

3 Axhenca 21, Deklarata e Rios mbi Mjedisin dhe zhvillimin, si dhe Deklarata e parimeve mbi menazhimin e qëndrueshëm dhe pyjet, është adaptuar nga më shumë se 178 anëtarë të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi mjedisin dhe zhvillimin (UNCED) mbajtur në Rio de Janerio, Brazil, 3 - 14 qershor 1992.

4 Johannesburg Summit 2002 – the World Summit on Sustainable Development – brought together tens of thousands of participants, including heads of State and Government, national delegates and leaders from non-governmental organizations (NGOs), businesses and other major groups to focus the world's attention and direct action toward meeting difficult challenges, including improving people's lives and conserving our natural resources in a world that is growing in population, with ever-increasing demands for food, water, shelter, sanitation, energy, health services and economic security.

Koncepti i “zhvillimit të qëndrueshëm” ngelet i papërcaktuar dhe i vështirë të përdoret si një mjet i nevojshëm për të adresuar problemet e mëdha me të cilat duhet të ndeshemi. Ky koncept, shihet i lidhur me përcaktimin që i jepet konceptit “zhvillim ekonomik”, ku ky i fundit, duhet të ecë me atë hap dhe në atë mënyrë, që të bëhet e mundur të ruhet mjedisi dhe burimet natyrale të harxhueshme, dhe nga ana tjetër, në formën e tij më ekstreme, popullsia njerëzore duhet të stabilizohet dhe burimet e ripërtëritshme duhet të përdoren.

Bazuar në këtë përcaktim, problemi që duhet të trajtojë “zhvillimi i qëndrueshëm” është ai i rritjes së popullsisë dhe rritjes ekonomike, që na shtyjnë ne jashtë kufijve të qëndrueshëm të përtëritjes së burimeve dhe përpunimit të mbetjeve.

Në nivelin më esencial, një popullsi me ritme rritëse kërkon më tepër ushqim, ujë, dhe energji. Ndërkohë, pyjet po zhduken për t'i lënë vend prodhimit të ushqimeve, ujërat nëntokësorë shfrytëzohen për të marrë ujin për përdorim të popullsisë dhe për ujitje, karburantet fosile digjen me një ritëm më të madh dhe në rritje, për të përballuara kërkesat në avancim për energji.

Djegia e karburanteve fosil pakëson rezervat e parikuperueshme dhe shton dyoksidin e karbonit CO² në atmosferë - një problem ky, që përkeqësohet nga ulja e aftësisë përpunuese thithëse globale të këtyre gazrave për shkak të uljes së sipërfaqes së pyjeve.

Këto mekanizma çojnë në rritjen potenciale të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Ndryshimet klimatike, nga ana e tyre kanë potencialin për ndikim të drejtpërdrejtë dhe negativ në prodhimin e sasive të kërkuara të ushqimit dhe ujit në pjesë të ndryshme të botës, nëpërmjet shkretirëzimit, ngritjes së nivelit të detit, gërryerjeve dhe përmbytjeve. Ndotës të tjerë ndikojnë drejtpërdrejt në atmosferë, oqeanë dhe rezerva ujore, duke ulur direkt mundësinë e prodhimit të produkteve ushqimore në det dhe tokë.

Rezultati i të gjitha këtyre ndikimeve negative është shfrytëzimi më i egër i burimeve, duke krijuar kështu një rreth ciklik.

Po t'i shtojmë këtij skenari edhe aspiratat e vendeve në zhvillim për të arritur të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik si ato të zhvilluara, arrijmë në një problem me pasoja potenciale shumë serioze.

Ky model, sigurisht, është shumë i thjeshtëzuar dhe nuk arrin të trajtojë një sërë problemesh të zhvillimit të qëndrueshëm, nga bio-diversiteti deri tek problemet shëndetësore, shumë prej të cilave kanë rëndësi lokale dhe rajonale.

Thjeshtëzimi i një problemi shumë kompleks ka rreziqet e veta, por këto shembuj shërbejnë për të nxjerrë në pah faktorët kryesorë me rëndësi globale: rritja e popullsisë, rritja ekonomike, ushqimi dhe uji, energjia.

Rritja numerike e popullsisë

Ritja numerike e popullsisë gjithmonë ka qenë e vështirë të parashikohet, dhe aq më pak të kontrollohet. Ritmi i rritjes së popullsisë ka rënë nga 2.1 % që ishte në vitet '60 në 1.3% në vitet 2000⁵. Por, megjithëse duket sikur ka një farë rënie të ritmit, sipas studimeve të Divizionit të Popullsinë së Kombeve të Bashkuara, popullsia e sotme prej 6.3 miliardë do të arrijë në 7.9 deri në 10.9 në mesin e shekullit të 21-të.

Akoma më e vështirë bëhet mundësia për të parashikuar aftësinë mbajtëse të njerëzimit për të gjithë planetin. Aftësia mbajtëse e planetit varet nga zhvillimi ekonomik dhe niveli i konsumit të burimeve, dhe këtu duhet bërë i qartë ekuacioni: **“planeti mund të mbajë 20 miliardë njerëz duke jetuar sipas stilit të fshatarëve të Evropës Qendrore, apo shumë më pak duke jetuar sipas stilit të Amerikanëve të Veriut”**. Sipas studiuesve, kjo shifër lëviz nga 4 deri në 16 miliardë. Bazuar në këto shifra, mund të themi se kemi arritur në një pikë, ku shumë shpejt mund të takohemi me kufijtë mbajtës të planetit.

Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik, është veçanërisht i rëndësishëm, duke pasur parasysh aspiratat ekonomike të botës në zhvillim. Influenca e këtyre aspiratave është një ndikim direkt i njerëzimit mbi mjedisin.

Në këtë këndvështrim, **zhvillim ekonomik, do të thotë më shumë konsum dhe më shumë mbetje**, duke kontribuar pozitivisht në “zhvillimin e qëndrueshëm” dhe duke siguruar edhe burime për uljen e varfërisë dhe zgjidhje teknologjike për problemet mjedisore.

Nga ana tjetër, ulja e varfërisë është e rëndësishme për dy arsye.

1. Njerëzit e varfër nuk kanë mundësi që ta konsiderojnë mjedisin si problem prioritar, kështu një fermer i Amazonës, vështirë se do ta konsideronte pyllin apo shiun prioritet përpara fëmijëve të paushqyer.
2. Për lidhjen midis varfërisë dhe edukimit të pamjaftueshëm, dhe rritjes së pakontrolluar të popullsisë: për shembull, në Ekuador, gratë pa arsim kanë pjellshmëri 6.4 lindje, ndërsa po në të njëjtin vend, gratë e arsimuara e kanë 2.3 lindje⁶.

5 Divizioni i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara- “Populations challenges and development goals”, 2005

6 Divizionit të Popullsisë së Kombeve të Bashkuara - “Populations challenges and development goals”, 2005

Ushqimi dhe uji

Prodhimi i ushqimeve ka kaluar ritmin e rritjes së popullsisë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Kjo është arritur nëpërmjet zgjerimit masiv të sipërfaqes së tokës bujqësore, dhe rritjes së produktivitetit nëpërmjet sistemeve të ujitjes dhe bujqësisë intensive. Por, rritja e sasisë së prodhimit të ushqimit ka sjellë si pasojë degradimin e tokës-arë, shpyllëzim, zhdukje të vegjetacionit natyral, kripëzim dhe alkalizim të tokave, të cilat vijnë si pasojë e sistemeve, jo e rezultateve të ujitjes. Vlerësimet tregojnë se, gjatë viteve 1980, rreth 10 milionë hektarë tokë nën ujë braktiseshin në vit, dhe se afërsisht 10-30 % e emisioneve të CO² shkaktoheshin nga ndryshimi i drejtimit të përdorimit të tokës.

Kërkesat në rritje për ujitje kanë sjellë kërkesa të mëdha për burime ujore dhe përbëjnë 2/3 e ujit të përdorur nga njeriu. Ndërsa lumenjtë dhe liqenet, po arrijnë në limitet e tyre, nga marrja e ujit, ngritja e digave dhe ndotja. E njëjta gjë po ndodh edhe me rezervat e ujërave nëntokësore, të cilat po harxhohen më shpejt se sa zëvendësohen. Duhet thënë që edhe këto rezerva janë të ndikueshme nga bujqësia dhe ndotjet industriale.

Ndotja gjithashtu po ndikon në oqeanet e planetit, të cilët po dëshmojnë se kapaciteti prodhues për ushqime i tokës, është jo vetëm i kufizuar, por edhe mund të reduktohet nga veprimet e pa qëndrueshme. Shkatërrimet e pengesave koralore dhe shtimi i algave shkatërruese, të cilat ndihmohen në zhvillimin e tyre nga mbetjet e fermave të ndryshme, janë bërë një gjë e zakonshme në shumë zona bregdetare, dhe kanë sjellë si pasojë shkatërrimin e peshkimit lokal dhe humbjen e një burimi të rëndësishëm proteinash për vendet në zhvillim. Rezervat e peshkut, që dikur ishin me shumicë, janë në ulje tanimë nga peshkimi i tepruar.

Energjia

Përdorimi i energjisë, si asaj industriale, bujqësore, apo për përdorim shtëpiak ose transport, është një çështje kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse mbështetja në karburantet fosile të harxhueshme, rezulton në zhdukjen e burime të pazëvendësueshme, si edhe prodhimin e gazrave që ndikojnë në **efektin serë**.

Për sa i përket harxhimit të pazëvendësueshëm, duket sikur me gjithë zbulimet e mëdha që kanë bërë teknologjitë e reja, nuk do të mund të ndërpritet përdorimi i tyre nga ekonomitë që kërkojnë gjithmonë të prodhojnë më shumë. Përdorimi i këtyre burimeve fosile të energjisë do të vazhdojë të lëshojë në atmosferë sasi gjithmonë e më të mëdha të CO², i cili prish ekuilibrin kompleks të ciklit global të karbonit dhe kontribuon në ndryshimet klimatike nëpërmjet efekteve tashmë të njohura si efektet serë, dhe ngrohje globale.

Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) ka parashikuar një rritje globale të temperaturës së sipërfaqes së tokës nga 1.4 deri në 5.4 gradë celsius, me një tendencë që vendet e lartësive të veriut do të ngrohen më shpejt se sa mesatarja

vjetore. Parashikimet janë për rritje të nivelit të ujërave dhe përmytjet bregdetare, ndryshime ekstreme të temperaturave dhe përhapje më të mëdha të epidemive.

Modeli i Panelit Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike tregon gjithashtu për një ngadalësim të qarkullimit të rrymave oqeanike, duke sjellë si pasojë uljen e transmetimit të nxehtësisë në gjerësitë veriore, për shembull, Golf Strimi.

Roli i pyjeve si filtra të CO² është kuptuar drejt, por është më pak i njohur fakti që oqeanet prodhojnë nga 1/3 deri në 2/4 e rezervës së oksigjenit, oqeanet ndihmojnë në rregullimin e raporteve të CO² nëpërmjet një mekanizmi të quajtur pompa biologjike. CO² hyn në shtresat e sipërme të oqeanit, ku përdoret nga fito planktonet dhe bimë të tjera detare në procesin e fotosintezës, duke ngadalësuar kështu grumbullimin e gazeve që shkaktojnë efektin serë në atmosferë. Ndotja dëmton organizmat ujore, dhe ndërsa ndotësit kanë tendencë të grumbullohen në ujërat sipërfaqësore, ato kanë mundësi që të kenë efekte negative në disproporcionimin e fotosintezës marine, duke u bërë kështu një kërcënim për efektet rregullatore dhe në klimën globale. Fotosinteza marine është gjithashtu themeli i një zinxhiri ushqimor që na jep miliona ton ushqim deti në vit.

Pasoja të pritshme

Si rezultat i grumbullimit të të dhënave të jashtëzakonshme gjatë viteve të fundit, tashmë dihet shumë më tepër për problemet shqetësuese dhe ndikimin e tyre në mjedisin global, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, pasojat e mundshme, në rast se nuk do të trajtohen në kohën e duhur janë shumë të diskutueshme.

Apokalipsi - Në rast se njerëzimi nuk do të jetë shumë i mençur ose shumë me fat, atëherë tabloja që mund të na ofrojnë vitet e ardhshme është shumë e zymtë.

Sipas parashikimeve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), në 30 vjetët e ardhshëm kjo tablo mund të paraqitet e tillë:

- ❖ Mundet që, një rritje eventuale e nivelit të detit prej disa centimetrash, do të kërkonte evakuimin e shumë zonave bregdetare dhe të shumë ishujve të Paqësorit Jugor, dhe shumë pjesë të tokës prodhuese të Holandës do të zhdukeshin.
- ❖ Burimet e naftës dhe gazit, që janë shumë problematike aktualisht në tregun e sotëm ndërkombëtar, do të shkonin drejt pakësimit deri në zhdukjen e tyre.
- ❖ Rezervat e ujit, paraqiten tepër problematike. Jemi dëshmitarë të konflikteve që ndodhin për rezervat e ujit, i cili në disa raste, në rajone të veçanta, e kalon edhe çmimin e naftës për fuçi.
- ❖ Hapësira të mëdha të tokave shumë prodhuese të SHBA dhe të Kanadasë kanë vite me radhë që vuajnë nga thatësira dhe po provojnë rënien e cilësisë së tokës bujqësore.
- ❖ Në rajone të tjera, atje ku gruri prodhohet me shumicë, shpesh mungon infrastruktura e nevojshme për ta bërë këtë produkt të mundshëm në tregjet ndërkombëtare, për shembull në Rusi dhe ish Republikat Sovjetike.

❖ E njëjta gjë ndodh edhe me problematikën e sipërfaqes oqeanike.

Nga ana tjetër, parashikimi i pasojave që mund të ketë mjedisi në të ardhmen, ka bërë që shumë analistë të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare të rishikojnë konceptet e tyre për sa i përket sigurisë ndërkombëtare dhe të shtojnë aty edhe konceptin e sigurisë mjedisore.

Mos trajtimi i qartë dhe i saktë i lidhjes midis degradimit mjedisor dhe sigurisë mund të shkaktojë edhe pasoja të tjera, ku ndër me thelbësoret janë:

1. Ndërsa themelet mjedisore të një vendi shkatërrohen, ekonomia e këtij vendi do të bjerë në mënyrë të vazhdueshme, kohezioni social do të përmbysset, dhe struktura politike do të destabilizohet.
2. Shkatërrimi mjedisor mund të sjellë ulje të mundësive ekonomike, duke shkaktuar zhvendosje ekonomike brenda vendeve dhe ndërmjet vendeve, duke sjellë kështu tensione politike brenda vendeve, si edhe jashtë vendeve.
3. Degradimi mjedisor i shkakuar nga veprimet e iniciuara jashtë kufijve të vendit mund të përkeqësojë marrëdhëniet dypalëshe, deri në shkatërrimin e sigurisë rajonale.
4. Stresi mjedisor mund të shkaktojë që grupe të caktuara kombëtare ose ndërkombëtare të kërkojnë rishikime të situatave duke rritur kështu mundësinë për jostabilitet politik, pakënaqësi civile dhe ndoshta edhe terrorizëm.

Këto lidhje janë të mbështetura nga fakte historike. Al Gore në librin e tij “Toka në balance” debaton se *“Një ndryshim klimatik, i njohur si përkeqësimi subatlantik në vitet 500–400 para Krishtit, solli ndryshimet në erërat dhe shpërndarjen e lagështirës, si edhe në uljen e temperaturave, gjëra këto që sollën fundin e epokës së bronzit dhe ndikuan në invazionin Gjerman drejt Evropës Jug Lindore”*.

Paqartësia - Zhvillimi i qëndrueshëm, në themel të çështjes së mjedisit kërkon veprim të menjëhershëm. Por duhet theksuar që të tregohet edhe pak kujdes, për vetë faktin se kjo çështje është e mbuluar me paqartësi shkencore dhe mund të gjenden argumente për të gjitha mënyrat e trajtimit. Po ta shikojmë nga një këndvështrim prej qindra dhe mijëra vjetësh, mund edhe të arrijmë në konkluzionin që, **të shqetësohemi për ngrohjen globale ose efektin serë, mbase është diçka e gabuar, dhe mbase kjo është mënyra më e mirë për të mos shkakuar edhe njëherë epokën glaciale.** Megjithatë, mund të thuhet me siguri se, sot ka një opinion të përgjithshëm për sa i përket “zhvillimit të qëndrueshëm” si një çështje afatgjatë. Normalisht, ka një segment kohe shumë të gjatë ndërmjet ndryshimeve në sjelljen e njeriut dhe ndikimit të tyre global, dhe koha e përfshirë na jep argumentet e durimit dhe të investimit, më shumë për kërkime, se sa për veprime të nxituara të drejtpërdrejta.

Masat e marra për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm

Pyetja që shtrohet është: A mundet njerëzimi të bëjë zhvillim të qëndrueshëm? - dhe përgjigja që jepet nga të gjithë është: Po, por me rezerva! Nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin - Samiti i Tokës-1992; e deri në ditët e sotme, një raport i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm⁷ thekson: “...*progresi drejt qëllimeve të arritura ka qenë më i ngadaltë se sa ishte parashikuar, dhe në disa raste kushtet janë më të këqija*”

Por, nga ana tjetër, është gabim të thuash që nuk ka pasur progres që nga Rio. Koha e kaluar që nga Rio deri sot tregon për një hendek që thellohet midis retorikës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe implementimit. Opsionet për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm qëndrojnë ndërmjet dy ekstremeve:

- ❖ nga njëra anë ndalimi i harxhimit pa kriter të burimeve dhe ndotjeve, dhe
- ❖ nga ana tjetër përmirësimi i kapaciteteve njerëzore për t’u marrë me problemet dhe ndryshimet mjedisore.

Brenda këtyre limiteve, komuniteti ndërkombëtar nuk e ka shumë të lehtë të manovrojë.

Një sërë dokumentesh ndërkombëtarë janë miratuar, por edhe vazhdojnë të miratohen.

Kështu, **Protokolli i Montrealit**,⁸ që synon eliminimin e lëndëve kimike që dëmtojnë shtresën e ozonit, ka ulur ndjeshëm përdorimin e substancave që dëmtojnë ozonin; llogaritet në 87 % ndërmjet 1987 – 2003, dhe është vazhduar me po këto ritme.

Gjithashtu, duhet theksuar që ndërgjegjësimi për këtë problem ka qenë i jashtëzakonshëm, po të theksojmë se në më shumë se 150 shtete ekzistojnë tashmë institucione të nivelit kombëtar që trajtojnë këto probleme, megjithëse në disa vende këto institucione kanë qenë më tepër politike se sa të specializuara.

Kur përmendëm që progresi i dëshiruar dhe i parashikuar nuk ka qenë në ritmet e pritura, këtë e themi duke iu referuar fushave kryesore ku synon zhvillimi i qëndrueshëm.

7 Raporti i Kombeve të Bashkuar për Mjedisin, 2006.

8 The **Montreal Protocol on Substances That Deplete the Ozone Layer** is an international treaty designed to protect the ozone layer by phasing out the production of a number of substances believed to be responsible for ozone depletion. The treaty was opened for signature on September 16, 1987 and entered into force on January 1, 1989 followed by a first meeting in Helsinki, May 1989. Since then, it has undergone seven revisions, in 1990 (London), 1991 (Nairobi), 1992 (Copenhagen), 1993 (Bangkok), 1995 (Vienna), 1997 (Montreal), and 1999 (Beijing). It is believed that if the international agreement is adhered to, the ozone layer is expected to recover by 2050. Due to its widespread adoption and implementation it has been hailed as an example of exceptional international co-operation with Kofi Annan quoted as saying it is “Perhaps the single most successful international agreement to date.”

1. Popullsia e botës vazhdon të rritet me një ritëm prej 77 milionë në vit, dhe megjithëse në vendet e zhvilluara rritja është shumë e ngadaltë dhe në disa raste e papërfillshme, vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim vazhdojnë të kenë ritme shumë të larta rritje, gjë që mendohet që do ta shtojë presionin mbi burimet natyrore dhe mjedisin
2. Fundi i shekullit të kaluar dëshmoi një rritje të konsiderueshme të ekonomisë, por numri i njerëzve me të ardhura të pamjaftueshme është ulur fare pak, dhe akoma rreth 113 milionë fëmijë në moshë shkollore vazhdojnë të mos ndjekin shkollën, 60 % e të cilëve janë femra.
3. Për sa i përket ushqimit, duhet theksuar se ka një shkurtim të ndjeshëm të flotave të peshkimit në një përpjekje për të mbrojtur rezervat e peshkut në të gjithë planetin. Toka ka vazhduar të tregojë probleme të theksuara, dhe duhet thënë që edhe gjatë viteve të fundit ka vazhduar përkeqësimi. Pyjet dhe kullotat kanë vazhduar të pakësohen, dhe sipërfaqet ligatinore të zvogëlohen ose degradohen, duke sjellë si rezultat erozion të tokës dhe shkretirëzimin e saj. Gjatë viteve '90 llogaritet që humbjet e sipërfaqes së pyllëzuar të ishin 0.2 % në vit dhe këto shifra vazhdojnë të jenë aktuale; degradimi i tokës tani prek pothuajse 2/3 e tokës së punueshme të botës. Një shembull i qartë është rasti i Kinës Veriore, ku për shkak të shkretirëzimit preken rreth 1350 milje katrorë në vit, për të cilën të gjitha mendimet shkencore pranojnë se ndodh për shkak të shpyllëzimit, fermave dhe industrializimit në të cilin Kina hyri vrullshëm në dy dekadat e fundit.
4. Për sa i përket ujit, nevoja për sisteme ujitëse dhe kërkesat e mëdha e në rritje nga industria dhe përdoruesit privatë, kanë rritur nevojën për ujë në shumë rajone të botës. Në dy dekadat pasardhëse, mendohet se konsumi i ujit do të rritet me 40 %.
5. Fusha ku problematika ka qenë më e madhe ka qenë ajo e përdorimit të karburanteve fosile. Kjo është edhe fusha ku fjalët, detyrimet dhe zotimet janë shumë larg asaj që ndodh në të vërtetë. Studimet tregojnë se ngrohja globale i dedikohet kryesisht aktivitetit njerëzor gjatë 50 viteve të fundit. Këto fakte përforcohen në mënyrë dramatike nga të dhëna të tilla si, hollimi i shtresave akullnajore të Antarktidës dhe vëzhgimet për zvogëlimin e akullnajës "Hillary" në Malin Everest. Konsumi i karburanteve fosile është rritur me 10 %, pjesa më e madhe e të cilit përdoret për transport. *Protokolli i Kyotos* synon për uljen e CO², gjë që në të vërtetë ka ndodhur vetëm në Rusi, dhe kjo si arsye e ndalimit të industrisë për shkak të problemeve të ndodhura atje. Studimet e fundit tregojnë se ka një lidhje midis çlirimit të dyoksidit të sulfurit të stacioneve të prodhimit të energjisë në Amerikën e Veriut dhe Evropë, dhe thatësirës gjithnjë në rritje në zonën Sub Sahariane në Afrikë. Fenomene këto, që pritet të shtohen nga industrializimi galopant i Indisë dhe Kinës.

Zhvillimi i qëndrueshëm vazhdon të ngelet një sfidë për institucionet në të gjitha nivelet. Ndërsa duket që ka një mirëkuptim të përgjithshëm për sa i përket vizionit

afatgjatë, prapë vihen re probleme të mëdha kur flitet për implementim. Problemet që vihen re janë të shumta dhe të drejtpërdrejta, dhe shpesh me interes të ngushtë e të drejtpërdrejtë, të cilat ndikojnë në interesat globale. Nga ana tjetër, në interesat e ngushta rajonale dhe nacionale është shumë e dukshme kur flitet për ndarjen midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Vendet në zhvillim debatojnë duke mbrojtur tezën që zhvillimi i qëndrueshëm nuk duhet të shihet si një justifikim për të ndaluar zhvillimin e tyre ekonomik, duke shtuar se vendet e zhvilluara e arritën zhvillimin e tyre duke shfrytëzuar në mënyrë të pakontrolluar rezervat natyrore. Në rast se SHBA e ka të vështirë të miratojë një taksë të arsyeshme që të disiplinojë përdorimin e karburantit, si mund të pritët nga vendet në zhvillim të kontrollojnë rritjen e popullsisë? Në nivelin institucional, vetë problematika e gjerë e zhvillimit të qëndrueshëm, ku përfshihen çështje shumë të rëndësishme, nga bio-diversiteti, te bio-teknologjia dhe demografia, jep një platformë shumë perfekt për grupime të ndryshme me interesa specifike. Këto grupe, organizata joqeveritare, etj, luajnë një rol kryesor në evidentimin e problemeve jetësore dhe në ngritjen e problemeve publike, por në disa raste ato janë gjithashtu në gjendje të shtrembërojnë prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në shumë raste analizat e tyre kanë qenë të gabuara dhe u janë larguar fakteve shkencore, gjë që jo vetëm u ka ulur atyre kredibilitetin, por ka bërë në disa raste të shtohen paqartësitë për zhvillimin e qëndrueshëm.

Në disa raste qëndrimet e tyre kanë qenë jo të qarta, dhe duhet thënë që shumë nga këto grupe, që kërkojnë për shembull uljen e urisë në botë janë kundra GMO, të cilat, është pranuar që rrisin produktivitetin, ose në disa raste të tjera, kur kundërshtojnë përdorimin e karburanteve fosile, janë gjithashtu kundër përdorimit të energjisë bërthamore.

Sfidat kryesore për të arrirë “zhvillimin e qëndrueshëm”

Sfidat që dalin sot përballë komunitetit ndërkombëtar për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm janë të shumta, por më të rëndësishmet janë të fokusuara në disa drejtime:

Edukimi - Gjatë viteve të fundit zhvillimi i qëndrueshëm është futur gjerësisht në terminologji, por akoma ngelet shumë larg të kuptuarit e këtij procesi. Në mënyrë që të bëhet më i kuptueshëm dhe më i thjeshtë, njerëzit kanë nevojë të edukohen që të ndërgjegjësohen se zhvillimi i qëndrueshëm është diçka që përfshin çështje larg shtëpive të tyre dhe larg interesave të ngushta të përditshme. Ky togfjalësh duhet të kthehet nga një term shkencor në një **koncept të kuptimtë dhe të kuptueshëm**, jo vetëm nga specialistët, por nga çdo individ, ku secili të arrijë të kuptojë se zhvillimi i qëndrueshëm është arritja e një cilësie më të lartë të jetës për vete dhe për brezat që do të vijnë.

Vetëm kur ky koncept të kuptohet në të gjithë kompleksitetin e tij, atëherë do të mund të thoshim se jemi në rrugë të mbarë.

E gjithë vlera ekonomike aktuale e ekosistemit të planetit dhe rezervave natyrore në vit llogaritet të jetë 33 trilion USD, ndërsa produkti global i planetit llogaritet të jetë 18 trilion USD në vit⁹. Megjithëse këto shifra duhen trajtuar me shumë kujdes dhe rezerva, ato prapë janë në gjendje të japin një mesazh shumë të fuqishëm dhe të rëndësishëm, si publikut të gjerë ashtu edhe politik-bërësve, dhe të shërbejnë si një mjet për të drejtuar veprimet rregulluese. Edukimi i popullsisë së planetit është i një rëndësie parësore, sidomos kur flitet për probleme të kontrollit të popullsisë. Ndërkaq, ka vlera të veçanta kur flasim për uljen e varfërisë, e cila gjithashtu është faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm. Aq më tepër që edukimi është faktor kryesor, kur flitet për teknologjitë e reja të cilat do të ndërtohen për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.

Teknologjia - Sot, ka një sërë zhvillimesh teknologjike dhe novacionesh që na japin shtysën për një qëndrim optimist për zhvillimin e qëndrueshëm. Teknologjia në përgjithësi po përmirëson ndjeshëm eficiencën e përdorimit të burimeve dhe teknologjitë e reja që prodhojnë energji në mënyra miqësore për mjedisin. Prodhimi dhe pastrimi i ujit, bio-teknologjia dhe riciklimi, të gjitha këto ofrojnë potenciale të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm. Kështu që, inkurajimi dhe mbështetja e iniciativave të reja teknologjike është esenciale, megjithatë nuk duhen harruar dy faktorë që janë ngushtësisht të lidhur:

1. risku i menaxhimit të teknologjive, dhe
2. transferimi i teknologjisë.

Të gjitha teknologjitë kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, të cilat në stadin aktual ku ndodhemi nuk mund të injorohen. Në stadin aktual të nevojave për prodhim dhe përdorim energjie, është praktikisht e pamundur që njerëzimi të zëvendësojë përdorimin e burimeve fosile, me resurse të reja të prodhimit të energjisë dhe metoda që janë miqësore për mjedisin, megjithëse aktualisht njihet dhe pranohet ndikimi shumë pozitiv që këto burime të reja kanë në mjedis. Të gjitha këto industri të prodhimit të energjisë, do të jetë e pamundur që në të ardhmen e afërt të zëvendësojnë djegien e karburanteve fosile dhe të pakësojnë çlirimin e CO² në atmosferë në shifrat 60-80%, shifër kjo e dhënë nga shkencëtarët për të stabilizuar efektin serë në atmosferë.

Lidershipi - Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm do të kërkojë një lidërsip politik shumë të fortë, partneritete të fuqishme dhe të qëndrueshme, si qeverisje ndërkombëtare për shumë probleme. Zhvillimi i qëndrueshëm ka hyrë vonë në planet e veprimeve të Kombeve të Bashkuara dhe në sferën e marrëdhënieve institucionale, e si pasojë ka ngelur një marrëdhënie që lë shumë për të dëshiruar dhe janë bërë pak përpjekje për një integritet të plotë. Një administrim ndërkombëtar do të kërkohej që të bëjë vendosjen e prioritetëve, monitorojë, dhe administrojë mekanizmat financiarë dhe burimet ndërmjet investorëve të ndryshëm. Sfidat më të mëdha, për fat të keq

9 Robert Costanza- The value of the Worlds Ecosystem Services and Natural Capital, Vol. 387, 1997

vijnë nga vendet më të zhvilluara, ku SHBA, me 4 % të popullsisë së botës, është përgjegjëse për 20 % të gazrave që kontribuojnë në efektin serë. Një përgjigje për këtë çështje na jep një thënie e Mahatma Gandhit: “Ne duhet të jemi vetë ndryshimi që duam të shikojmë të ndodhë në botë¹⁰”.

Literatura:

- Aarhus Convection “*On access to information, public participation in decision-making and access to justice in environmental matters*”- Denmark, June 1998
- Report of the World Commission on Environment and Development- “*Our Common Future*”, United National Documents, 1987
- Rio Declaration “*On Environment and Development*”- June 1992
- Johannesburg Summit – the World Summit on Sustainable Development-2002
- The Montreal Protocol “*On Substances That Deplete the Ozone Layer*”
- National trends in population, resources, environment and development 2003-Country profiles-Publication of UN-Population Division.
- Population, challenges and development- Publication of UN-Population Division, 2005
- Population, environment and development 2001 (Wall Chart)- Publication of UN-Population Division
- World Population Monitoring- 2001- Population, environment and development- Publication of UN-Population Division
- World Population Monitoring – 2002- Reproductive rights and reproductive health Publication of UN-Population Division
- World Population Monitoring – 2003 – Population, education and development Publication of UN-Population Division
- World population to 2300- Publication of UN-Population Division, 2004
- Intergovernmental Panel on Climate Change (IPCC)- United National Environment Program Expert Meeting on Integration of Adaptation and Mitigation and Sustainable Development, France, 16-18 February 2005
- Integrating Sustainable Development and Climate Change in the IPCC Fourth Assessment Report , Colombo, Sri Lanka, 5-7 March 2003
- Al Gore- Earth in balance-Ecology and human Spirit, 1992
- Robert Costanza- The value of the Worlds Ecosystem Services and Natural Capital, Vol. 387, 1997
- Book-Epigrams from Gandhi...

Sfida drejt ruajtjes së rritjes

Gjergj Filipi

ABSTRAKT. *Shqipëria është dalluar për ritme mbresëlënëse të rritjes ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Pavarësisht kësaj, vendi vazhdon të mbetet më i varfri në rajon. Rritja gjatë tranzicionit është stimuluar dukshëm nga incentivat e reja që u shfaqën pas rënies së ekonomisë së centralizuar dhe fillimit të rrugëtimit drejt ekonomisë së tregut. Këto incentive u shndërruan në rialokimin më eficient të burimeve, duke rritur vrullshëm Produktivitetin e Tërësisë së Faktorëve që kontribuoi gjatë viteve 1993–2003, me pothuajse 98 % në hapin real të rritjes ekonomike. Ndërkohë që puna dhe kapitali, që mund të konsiderohen si “lëndët e para” të prodhimit kombëtar, kanë dhënë një kontribut fare modest. Dërgesat e emigrantëve në formën e remitancave, si dhe kreditimi në rritje i kohëve të fundit, kanë ushqyer kërkesën e brendshme, në funksion të rritjes ekonomike. Në kontekstin e tkurrjes së ekonomisë globale, rreziqet ndaj rritjes së ekonomisë shqiptare rriten, sidomos duke pasur parasysh faktin se kolonat aktuale të rritjes ekonomike, do të shkojnë natyrshëm drejt konsumimit, dhe nuk pritet të sigurojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të rritjes. Prandaj mbetet në duart e politikëbërësve orientimi i politikave drejt fuqizimit të faktorëve të tjerë të prodhimit, si krahu i punës dhe kapitali. Dhe për të mbërritur këtu duhet të investohet sot për arsimin e kraut të punës të së nesërme, për rritjen dhe integrimin tregtar të vendit, si dhe për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet.*

1– Një panoramë e rritjes ekonomike

Në vitet e fundit, ekonomia shqiptare ka shfaqur një rritje vjetore mesatare të prodhimit kombëtar bruto prej rreth 6 %. Që prej fillimit të periudhës së tranzicionit drejt një sistemi ekonomik bazuar mbi tregun e lirë, rritja kumulative e ekonomisë shqiptare ka qenë mbresëlënëse, duke e pozicionuar vendin ndër ekonomitë Europiane – Lindore me ritme më të larta mesatare për të gjithë periudhën e tranzicionit.¹ Ndonëse ende larg standardeve të ekonomive fqinje, për shkak të nivelit bazë tejet të ulët, treguesi i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) real për frymë ilustron një ndryshim të dukshëm, duke pësuar më shumë se katërfishim gjatë këtyre viteve, dhe duke shënuar nivelin e 2882 USD për frymë në vitin 2006 në krahasim me vlerën e 680

1 EBRD, *Transition Report 2007 updated*, fq. 64

USD që ishte në vitin 1990.² Pavarësisht kësaj, vendi mbetet një ndër më të varfrit në Europë. Për shkak se ekonomia shqiptare e ka nisur tranzicionin nga një nivel prodhimi kombëtar ekstremisht i ulët, produktiviteti i saj duhet të rritet me ritme më të larta, në mënyrë që të kapë (*catch up*) standardet e ekonomive fqinje, të avancuara dukshëm për nga përmasat absolute të ekonomive të tyre.

Renditja sipas PBB për frymë, pas axhustimit me nivelin respektiv të çmimeve.
(EU27=100)

Luksemburgu	276	Gjermania	113	Sllovakia	69
Norvegjia	184	Franca	111	Hungaria	63
Irlanda	146	Spanja	107	Lituania	60
Zvicra	137	Italia	101	Letonia	58
Holanda	131	Greqia	98	Kroacia	55
Austria	128	Qiproja	93	Polonia	54
Suedia	126	Sllovenia	89	Turqia	42
Danimarka	123	Republika Çeke	82	Rumania	41
Belgjika	118	Malta	77	Bullgaria	38
Finlanda	116	Portugalia	75	Republika Serbe	35
Mbretëria e Bashkuar	116	Estonia	72	Maqedonia	29
				Shqipëria	22

Burimi: Eurostat³

Në një vështrim të shkurtër të ecurisë së rritjes ekonomike gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, vlen të përmendet që Shqipëria, në ndryshim nga vendet e tjera të Bllokut të Lindjes, nuk kishte ndërmarrë asnjë reformë ekonomike transformuese përpara vitit 1991. Gjatë 1991-1992 ekonomia shënoi një rënie drastike të prodhimit, të shoqëruar me nivele të larta të papunësisë dhe inflacionit. PBB-ja reale u tkurr ndjeshëm mes viteve 1990 dhe 1992, deri në nivelin e 39 pikëve përqindjeje. Situata ekonomike e disfavorshme çoi në një eksod masiv të forcës së punës jashtë vendit, gjë që përveç se solli uljen e presioneve mbi tregun vendas të punës, shërbeu që në momentet e para si një burim thelbësor të ardhurash për pjesëtarët e familjeve të emigrantëve të mbetur në vend.

Për të kuptuar përmasat e këtij fenomeni, mjafton të përmendim që, deri në vitin 2001, numri i të emigruarve përbënte gjithsej më shumë se dy të tretat e të punësuarve totalë në Shqipëri për të njëjtin vit. Pas përfundimit të Regjistrimit të parë post-komunist të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2001, INSTAT arriti të llogarisë se numri i emigrantëve që kishin lënë vendin gjatë dekadës së fundit ishte rreth 650 mijë⁴. Ndërkohë që numri i të punësuarve gjithsej në Shqipëri gjatë po të njëjtin vit ishte 920 mijë persona.


2 INSTAT, Indikatorët kryesorë makroekonomikë (1996 - 2006, me çmime korrente)

3 Të dhënat marrë nga http://www.ssb.no/ppp_en/main.html. Konsultuar për herë të fundit në 1 Nëntor 2008.

4 INSTAT (2004) *Migracioni në Shqipëri, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001*, fq. 36.

Që prej 1993, ekonomia shqiptare filloi të rigjenerohej intensivisht, duke shënuar në atë vit një rritje impulsive prej 10% të prodhimit kombëtar. Kjo situatë erdhi kryesisht si rrjedhojë e kombinimit të stabilizimit makroekonomik, liberalizimit të çmimeve, gjallërimit të tregtisë së jashtme, si dhe privatizimit të tokës bujqësore, meqenëse sektori bujqësor kontribuonte ndjeshëm në prodhimin kombëtar të asaj periudhe, me mbi 30%.

Vlerësim në PPP i PBB-së për 2007-n, krahasuar me PBB-në e 1989. (1989=100)*




* Vlerat e përdorura për përlogaritjen e indekseve janë vlerësime të BERZH-it të konvertuara sipas PPP në bazë të kursit të këmbimit në vitin 1989

Burimi i të dhënave: BERZH, Transition Report 2007

Ekspierenca e rritjes ekonomike të Shqipërisë që prej tranzicionit mund të ndahet në dy periudha. Viti 1997 shënoi një ndërprerje të papritur të rritjes për shkak të kolapsit të përgjithshëm, shkaktuar nga kriza e firmave piramidale. Fatmirësisht, ekonomia shqiptare e rimori veten në mënyrë të menjëhershme, kryesisht si rezultat i politikave të kujdesshme të stabilizimit ekonomik, duke arritur rezultate pozitive të niveleve të rritjes që prej vitit pasues 1998. Në vitin 1999 prodhimi i përgjithshëm kombëtar kapërceu në terma realë për herë të parë nivelin e vitit 1990.

Nëse i referohemi vetëm periudhës pas 1998, rritja reale vjetore e PBB-së ka shënuar mesatarisht 7%, duke u dalluar për nivelet e saj ndër më të lartat në Europën Lindore. Për të njëjtën periudhë, vetëm ekonomia e Letonisë dhe Estonisë kanë shënuar një rritje reale mesatare më të lartë se Shqipëria, por me një diferencë prej më pak se një pikë përqindjeje. Ndërsa në krahasim me ekonomitë e fqinjëve më të afërm, mesatarja e normës së rritjes reale për Shqipërinë shënoi nivelin më të lartë.


Rritja reale e PBB-së për Shqipërinë dhe mesatarja për vendet e Europës Juglindore, 1998-2008.



Burimi: BERZH, Transition Report 2007

Këto ritme rritjeje janë shoqëruar nga një nivel relativisht i qëndrueshëm i inflacionit, duke u luhatur brenda bandës së 2% deri 4%, që është tashmë prej disa vitesh edhe objektivi i vendosur prej Bankës së Shqipërisë. Rritja ekonomike, relativisht e lartë dhe e qëndrueshme, ka çuar në vitin 2006 në shënimin e një niveli të të Ardhurave Kombëtare Bruto (GNI) prej 3 mijë USD për frymë, duke e ngjitur Shqipërinë në grupin e vendeve mesatare për nga të ardhurat.

PBB për frymë dhe Inflacioni vjetor



Burimi i të dhënave: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Gjithsesi, në një përpjekje për të vlerësuar qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në vijimësi, natyrshëm duhet të marrim në shqyrtim faktorët nxitës që qëndrojnë pas këtyre ritmeve spikatës të rritjes së ekonomisë shqiptare. Faktorët që kanë qenë në themel të kësaj performance të zhvillimit ekonomik mund të kategorizohen në tre

grupime apo nivele të ndryshme: paketa e politikave makroekonomike dhe financiare, faktorët e produktivitetit dhe zgjerimi i konsumit.

Sa i përket **nivelet të politikave**, stabiliteti makroekonomik ka siguruar një mjedis ekonomik të favorshëm përgjatë të gjithë periudhës tranzitore. Një përqasje fiskale e kujdesshme ka ndihmuar në konsolidimin e financave publike, duke reduktuar deficitin buxhetor nga 6,74% të PBB-së që ishte në vitin 1998, në 2,86% në 2005-ën, si edhe duke zvogëluar borxhin e përgjithshëm publik nga 75% e PBB-së që ishte në vitin 1998, në 55,5% në vitin 2006. Politikat monetare të kujdesshme kanë kontribuar në stabilitetin e çmimeve dhe pritshmëritë për një inflacion mjaft të qëndrueshëm, gjë që ka stimuluar besimin ndaj monedhës vendase, duke ruajtur gjithashtu një kurs të qëndrueshëm këmbimi, si dhe duke mundësuar krijimin e rezervave valutore të kënaqshme gjatë kësaj periudhe.


Një aspekt i rëndësishëm në themel të këtyre ritmeve të rritjes ekonomike, lidhet me kontributin e faktorëve të ndryshëm në rritjen produktivitetit të ekonomisë kombëtare, ku ndër to spikat **Produktiviteti i Tërësisë së Faktorëve**, apo siç njihet në literaturën ndërkombëtare, *Total Factor Productivity* (TFP). Gjatë viteve të para të tranzicionit, sikurse pritej, prodhimi kombëtar pësoi një rënie të menjëhershme si rrjedhojë e shokut që rezultoi nga kalimi prej një sistemi ekonomik të kontrolluar dhe të planifikuar në nivel qendror, drejt atij të orientuar nga tregu. Kjo situatë, e shoqëruar edhe me mangësi të theksuara të stokut të kapitalit, i dha shkas riallokimit të burimeve drejt aktiviteteve prodhuese që nuk kërkonin nivele të larta të investimeve, duke bërë të mundur rritjen e Produktivitetit të Tërësisë së Faktorëve. Këto tendenca ridimensionimi ndikuan ndjeshëm në orientimin e prodhimit vendas edhe në vitet në vazhdim, ku me kalimin e kohës spikati riallokimi i burimeve nga sektorët me produktivitet të ulët, siç është p.sh. bujqësia, drejt sektorëve me produktivitet më të lartë, siç janë shërbimet dhe ndërtimi.

Për rrjedhojë, duket se rritja e niveleve të prodhimit në ekonominë shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit është nxitur pikë së pari nga nivelet e larta të rritjes së TFP-së, dhe kjo kryesisht si rezultat i përmirësimit të alokimit të burimeve. Përlllogaritjet e FMN-së dhe Bankës Botërore mbi rritjen e produktivitetit kombëtar tregojnë që gjatë periudhës 1993-2003, TFP-ja ka kontribuar me pothuajse 98 % në rritjen reale vjetore të PBB-së. Po për të njëjtën periudhë, ritmi i rritjes së TFP-së ka shënuar vlerën e 6,14 %, ndërsa ritmi mesatar vjetor i rritjes së përgjithshme të PBB-së arriti nivelin 6,27 %.⁵

Një tjetër faktor i rëndësishëm i performancës ekonomike të Shqipërisë është **ekspansioni i shpejtë i konsumit**. Ka dy elemente bazë që nxisin këtë ekspansion, që janë rritja e kredisë bankare gjatë viteve të fundit, dhe veçanërisht, remitancat e dërguara nga emigrantët shqiptarë. Sa i përket kredisë bankare, realiteti shqiptar nuk ofron ndonjë tendencë spikatëse në krahasim me ecurinë e përgjithshme të këtij treguesi në ekonominë në tranzicion të rajonit.

5 World Bank Country Economic Memorandum, *Albania - Sustaining Growth Beyond the Transition*, Poverty Reduction and Economic Management Unit, ECA Region, Raporti Nr. 29257-AL, (2005), fq.22 [Tabela 7: Albania Growth Accounting Results]

*Niveli i kreditimit bankar, ndryshimi ndaj vitit paraardhës
(në %)*



Burimi: BERZH

Ndërsa nivelet e remitancave ofrojnë një veçori krejt unike. Sipas vlerësimeve zyrtare, remitancat janë burimi më i madh i prurjeve valutore në vend. Sasia e tyre kapërcen madje edhe kombinimin e vlerave të eksporteve dhe të investimeve të huaja direkte (FDI) të marra së bashku. Në vitin 2005 niveli i remitancave të dërguara në vend kapi vlerën e 14 % të PBB-së, ose rreth 65 % të vlerës së deficitit tregtar.⁶ Banka e Shqipërisë vlerëson se sasia e remitancave të dërguara nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendit kapërceu vlerën e 1,3 miliardë USD në terma absolutë vetëm gjatë vitit 2007.

Në milion USD	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Remitancat	452	368	531	615	632	778	1,028	1,161
Remitancat ndaj PBB (%)	16%	11%	14%	15%	14%	13%	14%	14%
Remitancat ndaj Deficitit Tregtar (%)	75%	56%	65%	60%	55%	58%	65%	64%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Me pak fjalë, mund të arrihet në përfundimin se, nivelet e larta të rritjes së ekonomisë shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit kanë qenë të nxitura nga rritja e prodhimit kombëtar si pasojë e rialokimit më eficient të burimeve, si dhe të mbështetura nga një kërkesë e brendshme e vullshme, e stimuluar vazhdueshëm nga prurjet e remitancave, por së fundmi edhe nga rritja e nivelit të kreditimit. Të gjitha këto, janë zhvilluar brenda një mjedisi ekonomik të favorshëm dhe të qëndrueshëm në kontekstin e politikave monetare dhe financiare. Pavarësisht ritmeve mbresëlënëse të rritjes ekonomike të Shqipërisë gjatë viteve të fundit, shqetësime serioze ngrihen në lidhje

⁶ Banka e Shqipërisë, *Remitancat: Eksperienca Shqiptare*. Marrë nga www.imf.org/external/np/sta/bop/2006/luxgrp/pdf/albani.pdf, përditësuar më 1 Nëntor 2008.

me qëndrueshmërinë e këtyre tendencave për periudhën që pason. Rritja e TFP-së nga riallokimi i post-tranzicionit prirët të shkojë gradualisht drejt shuarjes. Për më tepër, tkurrja e kohëve të fundit në ekonomitë partnere të Bashkimit European mund të sjellë kërcënime serioze, që së bashku me risqet që shoqërojnë natyrshëm faktorët e rritjes ekonomike në Shqipëri, ngrenë alarmin për një qasje vigjilente ndaj qëndrueshmërisë së këtyre ritmeve, ose së paku, të kësaj tendence të rritjes ekonomike.

2- Faktorët e produktivitetit në thelb të rritjes ekonomike

Rritja e TFP-së shpjegon pothuajse të gjithë rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke përbërë mesatarisht mbi 80 % të rritjes së përgjithshme të prodhimit të brendshëm gjatë gjithë periudhës së tranzicionit ekonomik.⁷ Ndërkohë që, sa i takon mobilizimit të faktorëve të produktivitetit, akumulimi i kapitalit ka kontribuar dukshëm më shumë se sa krahu i punës, sikurse vërehet edhe në tabelën e mëposhtme. Në mënyrë të ngjashme me ekonomitë e tjera në tranzicion, krahu i punës nuk ka luajtur rol domethënës në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Kjo kryesisht si pasojë e lëvizshmërisë së lartë të krahut të punës drejt ekonomive më të avancuara, por gjithashtu edhe si pasojë e fshehjes informale të produktivitetit real të këtij faktori.

Faktorët e Rritjes në Ekonomitë e Tranzicionit, 1993– 2007

		Rritja reale kumulative	Kontributi në rritjen ekonomike		
			TFP	Kapital	Punë
Shqipëria		96.1	80.5	20.9	-5.1
17 ekonomitë e tranzicionit		49.8	49.0	4.8	-4.3
Nga të cilat:	Vendet Balltike	73.5	73.2	11.7	-11.1
	Vendet e CEE	51.3	45.6	8.7	-2.9
	Ekonomitë Tranzitore PRGF	37.9	43.0	-5.9	0.9

Burimi: FMN

Modeli neoklasik i rritjes, ose siç njihet ndryshe modeli Solow-Swan i rritjes, nënvijëzon rolin e rëndësishëm mbi rritjen ekonomike të katër elementeve përcaktues: investimeve, shkallës së arsimit, integritit tregtar si dhe të cilësisë së institucioneve. Sipas këtij modeli, nivelet e investimeve dhe të shkallës së arsimit janë përcaktuesit kryesorë të ekuilibrit dinamik (*steady-state*) të produktivitetit për punëtor. Për një produktivitet për punëtor të caktuar, një nivel më i lartë i këtij ekuilibri do të gjeneronte rritje ekonomike më të madhe. Një tjetër përcaktues i nivelit të ekuilibrit dinamik është edhe niveli i teknologjisë, që varet në vetvete nga shkalla e integritit tregtar dhe nga cilësia e institucioneve. Duke pasur parasysh që zhvillimet specifike për secilin prej këtyre katër elementëve përcaktues do të luajnë


7 FMN, Country Report Albania No. 08/267 Gusht 2008, fq. 12.

një rol thelbësor në të ardhmen ekonomike të Shqipërisë, le të shikojmë secilin prej tyre më në detaje.

Kontributi i **akumulimit të kapitalit** mbi rritjen ekonomike ka qenë në nivele të ulëta gjatë gjysmës së parë të periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Ndërkohë që, ky tregues ka shënuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Sipas përlllogaritjeve të Bankës Botërore, kontributi i akumulimit të kapitalit ndaj rritjes filloi të rritet pas vitit 2006.⁸ Nga grafiku i mëposhtëm duket qartë që ajo që e dallon Shqipërinë nga ekonomitë e tjera në tranzicion është kontributi i lartë dhe në rritje i akumulimit të kapitalit.

Duke qenë se vendi vinte nga një bazë shumë e ulët ose jo-eficente investimesh para viteve '90-të, të gjitha përpjekjet investuese të këtyre viteve për t'i dhënë formë ekonomisë Shqiptare kanë kushtëzuar treguesin e akumulimit të kapitalit të bëjë dallimin nga ekonomitë e tjera në tranzicion. Gjithsesi, kjo tendencë nuk mund të vazhdojë e pacenuar dhe me të njëjtat ritme edhe në vitet në vijim, nëse nuk ndërhyhet sa më shpejt për zgjidhjen e çështjes së pronave si dhe në përmirësimin e infrastrukturës bazë të shërbimeve publike.

Kontributi i Akumulimit të Kapitalit në Rritjen Ekonomike



Burimi: FMN

Gjithashtu, rritja e TFP-së, që erdhi kryesisht nga riallokimi i post-tranzicionit, pritet të zbutet gradualisht. Për Shqipërinë bëhet gjithnjë e më e rëndësishme gjetja e përmirësimeve të TFP-së nga burime alternative, dhe një nga potencialet më të mirë në këtë kontekst është rritja e nivelit të **sistemit arsimor**. Ende pas 17 vjetësh, struktura dhe cilësia e sistemit arsimor shqiptar lënë shumë për të dëshiruar. Politikat arsimore nuk janë zhvilluar përkrah mjedisit dinamik ekonomik, duke çuar jo vetëm

⁸ Banka Botërore, Country Ec Mem, fq. 22 [Tabela 7: Albania Growth Accounting Results]

në mungesën e krahut të kualifikuar të punës, por në një rritje të dukshme të nivelit të braktisjes së shkollës. Në krahasim me fqinjët e saj, Shqipëria është konsideruar si një nga vendet që ka vuajtur më rëndë nga mungesa e politikave të përpërshtatshme të arsimit gjatë periudhës së tranzicionit.

Arsimi i grupmoshës 18-24 vjeç

	%-ja e grupmoshës 18-24 vjeç që nuk kanë mbaruar shkollën e mesme dhe nuk ndjekin ndonjë proces tjetër edukativ apo trajnues.
Objektivat e Lisbonës për 2010	10
BE-(15 vende) mesatarja	17.3
Shqipëria	61.9
Maqedonia	36.2
Serbia	11.4
Kroacia	5.4

Burimi: Komisioni European (2006)

Ndonëse evidenca i takon dy viteve më parë, fakti që afro 62 % e të rinjve shqiptarë (18-24 vjeç) nuk kanë përfunduar shkollën e mesme dhe nuk janë regjistruar në ndonjë program alternativ edukimi apo trajnimi, është një tregues i qartë që politikë-bërësit kanë dështuar për të përdorur kanalet e duhura dhe për të shfrytëzuar mjetet e nevojshme në përshtatjen e sistemin arsimor për t'ju përgjigjur sfidave bashkëkohore.

Sidoqoftë, këto shifra nënvijëzojnë faktin se Shqipëria ka në dorë aktualisht një burim të pashfrytëzuar, krahun punës së të rinjve, që sipas të dhënave demografike është i përmasave të mëdha, dhe nëse shfrytëzohet në mënyrë optimale, mund të prodhojë efekte pozitive në favor të rritjes së kapitalit njerëzor dhe të ruajtjes së qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike të vendit.

Një tjetër element përcaktues i TFP-së është shkalla e *integritit tregtar*, që lejon një ekonomi të specializohet në prodhimin e atyre produkteve, për të cilat produktiviteti relativ është më i lartë, si dhe lehtëson transferimin e teknologjisë dhe ideve nga ekonomitë më të avancuara. Rritja reale në totalin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve është ngadalësuar, nga mesatarisht 18,1 % që ishte në fillim të viteve 2000, në 8,6 % në vitin 2007, duke e pozicionuar Shqipërinë poshtë mesatares së vendeve të Europës dhe Azisë Qendrore. Ndërsa mbetet ende në nivele mjaft të ulëta, norma e integritit tregtar të Shqipërisë ra në nivelin e 68,8 % të PBB-së gjatë vitit 2007. Shërbimet, përfshi edhe turizmin, përbënë gjatë vitit 2007 rreth 65 % të totalit të eksporteve. Një situatë e tillë është dukshëm e ndryshme nga vendet e tjera, ku mallrat dominojnë strukturën e eksporteve me më shumë se 75 % të totalit të tyre.

Këto fakte tregojnë se edhe ky aspekt shënon një fushë ku mbetet ende shumë për të bërë lidhur me të kuptuarit e avantazheve krahasuese të ekonomisë shqiptare dhe hartimin e politikave të përshtatshme stimuluese me qëllim përmirësimin e integritit tregtar të vendit. Instrumente të tilla do të ndihmojnë gjithashtu në ngushtimin e

deficitit tregtar, që në kombinim me rënien potenciale të remitançave mund të paraqiste risqe ekstreme, jo vetëm ndaj ritmeve të rritjes së prodhimit të ekonomisë shqiptare, por edhe ndaj stabilitetit të përgjithshëm të saj.

Një potencial pozitiv në këtë këndvështrim e ofron afërsia e Shqipërisë me tregun masiv të BE-së. Vendet europiane janë destinacioni i 85 deri 90 % të eksporteve aktuale shqiptare. Falë skemës së Preferencave të Pakushtëzuara Tregtare, nënshkruar në vitin 2006, që ofron hyrje të lirë pa detyrime doganore dhe kuota për praktikisht të gjithë eksportet shqiptare drejt tregjeve të BE-së, Shqipëria favorizohet për të aksesuar tregun evropian. Në vazhdim të listës së përparësive në kuadrin e integritit tregtar, Shqipëria është që prej vitit 2000 anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë, ka ratifikuar Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë me Europën Qendrore (CEFTA) në vitin 2007, si dhe marrëveshjen e tregtisë së lirë me Turqinë, që hyri në fuqi në Maj të vitit 2008.

Rrjedhimisht, ndjekja rigoroze e një integriti më të thellë tregtar do të ishte mjaft e favorshme për ekonominë shqiptare. Duhet identifikuar sektorët dhe politikat e përshtatshme mbështetëse për thellimin e integritit tregtar, si me vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe me disa vende anëtare të BE-së. Duke pasur parasysh ekzistencën dhe kompleksitetin e barrierave jotarifore në Tregun e Brendshëm Europian, mbase përqaşja më e arsyeshme e politikave tregtare afatshkurtra dhe afatmesme duhet të synojë vendet e rajonit karshi atyre të BE-së.

Elementi i katërt përcaktues i TFP-së përmbledhet tek **aftësia e institucioneve**. Institucione të qëndrueshme dhe të përgjegjshme mund të ulin koston e transaksioneve dhe të stimulojnë sektorin privat për t'u përqendruar në produktet dhe sektorët për të cilat ekonomia është më produktive në mënyrë të natyrshme. Për fat të keq, është provuar se zhvillimi i këtyre institucioneve ka qenë një sfidë komplekse për Shqipërinë gjatë periudhës së tranzicionit. Ngritja e një sistemi demokratik funksional është ende një proces që, me gjithë asistencën e institucioneve dhe aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë, parashtron sfida komplekse. Mjafton të përmendim faktin që Shqipëria, ende pas 17 vjetësh ndërrimi të sistemit politik, nuk ka mundur të organizojë asnjë palë zgjedhje të lira dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare. Sidoqoftë, afërsia me BE-në dhe fokusi i komunitetit ndërkombëtar në stabilitetin e rajonit përbën një shtysë madhore drejt përmirësimit të mjedisit të brendshëm institucional.

3- Sfidat që paraqiten

Ndonëse ekonomia shqiptare ka shfaqur ritme pozitive të rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, në perspektivë shfaqen një seri risqesh potenciale që kërcënojnë këtë ecuri. Kriza aktuale globale nuk i favorizon ekonominë në tranzicion, gjë që do të thotë se edhe ekonomia shqiptare është e ekspozuar ndaj këtyre presioneve. Duke pasur parasysh varësinë financiare nga dërgesat e emigrantëve rezidentë në ekonomi, që janë goditur tashmë ose pritet të goditen nga një ngadalësim apo tkurrje ekonomike, shtohet edhe më tej niveli i kujdesit që duhet treguar për sigurimin e një ambienti të favorshëm ekonomik në përputhje me këtë panoramë të thepësuar.

Shkalla e ulët e eksporteve, investimet e huaja dhe private në nivele modeste, si dhe ngërçet infrastrukturore, janë disa nga sfidat e trashëguara që kërkojnë ndërhyrje me politika të shëndosha. Gangrena e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike vazhdon të dekurajojë jo vetëm subjektet prodhuese vendase e ato pak të huaja prezente, por vetëm mendimi i ringjalljes së saj na ofendon të gjithëve për një ngjarje krejt të paimagjinueshme në kontekstin e epokës ku jetojmë.

Remitancat parashtrojnë gjithashtu një risk të theksuar jo vetëm ndaj ritmeve të rritjes, por ndaj stabilitetit të përgjithshëm të sistemit ekonomik të vendit. Prurjet e konsiderueshme nga transfertat korente dhe bilanci pozitiv i shërbimeve gjatë viteve të fundit, kanë ndihmuar në zbutjen e rritjes së deficitit tregtar. Ndërsa dëgjojmë për rritje të eksporteve, importet vazhdojnë të rriten me ritëm më të shpejtë, ndërsa deficitit tregtar thellohet edhe më tej. Në të gjithë rastet dhe skenarët e mundshëm të orientimit të ardhshëm ekonomik, remitancat nuk mund të përbëjnë një bazë solide për zhvillimet ekonomike afatgjata. Bazuar në avantazhet konkurruese të vendit duhet të vihen në zbatim politika dhe instrumente mbështetëse në funksion të rritjes intensive të eksporteve.

Sigurimi i financimeve nga jashtë për investimet e domosdoshme në vend, është një tjetër sfidë e mprehtë. Avancimi i Shqipërisë, nga vend me të ardhura të ulëta, në mesatare brenda kuadrit të Shoqatës për Zhvillimin Ndërkombëtar (IDA) të Bankës Botërore, nënkupton kreditimin me terma më pak preferencialë, ose thënë ndryshe, me borxhe më të shtrenjta. Gjithashtu, duke qenë se edhe tregjet globale të kapitalit po kalojnë një krizë të përmasave të jashtëzakonshme, financimi i projekteve madhore vendase me kapital të ngritur jashtë u shndërrua shumë shpejtë në një element risku.

Në këto kushte, mbetet mjaft thelbësor vazhdimi i ecurisë pozitive të konsolidimit financiar, duke bërë përmirësimet e domosdoshme në menaxhimin fiskal dhe të borxhit. Përmirësime të tilla bëhen akoma më të mprehta duke qenë se roli mbikëqyrës i FMN-së pritet të venitet pas përfundimit të Programit në janar të vitit të ardhshëm. Përpos situatës së disfavorshme globale, duke qenë se institucionet vendase kanë ende shumë për të bërë në kontekstin e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të tyre politikë-bërëse, por edhe në kontekstin e koordinimit ndërinstitucional të politikave, nuk do të ishte shumë pavend gjetja e një “kujdestari” të ri të stabilitetit makroekonomik. Institucionet e Bashkimit Evropian i përshtaten mjaft mirë një profili të tillë, por Shqipëria është ende shumë larg në rrugën e integritimit evropian. Për sa i përket Brukselit, Shqipëria mban statusin e vendit kandidat potencial dhe ende nuk është shprehur formalisht për anëtarësim në BE.

Bibliografi

Banka e Shqipërisë (2005), *Raporti Vjetor*.

Banka e Shqipërisë (2007), *Raporti i Stabilitetit Financiar*.

Banka e Shqipërisë (2008), *Deklarata e Bankës së Shqipërisë mbi Politikën Monetare për gjysmën e parë të vitit 2008*.

- Banka e Shqipërisë, *Remitancat: Eksperienca shqiptare*. Marrë nga www.imf.org/external/np/sta/bop/2006/luxgrp/pdf/albani.pdf, përditësuar më 1 Nëntor 2008.
- Carletto, G., B. Davis and M. Stampini (2005). *Familiar Faces, Familiar Places: the Role of Family Networks and Previous Experiences for Albanian Migrants. ESA Working Paper No. 05-03*.
- Centre for Administrative Innovation in the Euro-Mediterranean Region, *Policies for business in the Mediterranean Countries: Albania*.
- EBRD (2007), *Transition report update*.
- Economist Intelligence Unit, *Country Report: September 2008*.
- IMF (2008), *Country Report Albania*, Report No. 08/267-AL.
- INSTAT, Indikatorët e Tregut të punës 1996-2006.
- INSTAT, Indikatorët Kryesorë Makroekonomikë 1996 - 2006, me çmime korrente.
- Muent H., Pissarides F., Sanfey P. "Taxes, competition and finance for Albanian enterprises: evidence from a field study". EBRD Working Paper No. 54, 2000.
- OECD (2005), *The informal economy in Albania: Analysis and Policy Recommendations*.
- World Bank (2005) Country Economic Memorandum, *Albania - Sustaining Growth Beyond the Transition*, PREM Unit, ECA Region, Report No. 29257-AL.
- World Bank (2006), *Albania: Labor Market Evaluation*, Report No. 34597-AL.
- World Bank (2006), *Investment Horizons: Western Balkans*.
- World Bank (2007), *Albania, Urban Growth, Migration and Poverty Reduction*.
- World Bank Country Economic Memorandum (2005), *Albania - Sustaining Growth Beyond the Transition*, PREM Unit, ECA Region, Report No. 29257-AL.
- INSTAT (2004) *Migracioni në Shqipëri, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave*

Paradigma e zhvillimit njerëzor dhe tranzicioni post-komunist në Shqipëri

Eno Ngjela

ABSTRAKT. Zhvillimi njerëzor nuk është një shpikje e re. Ai i dedikohet mendimtarëve të hershëm ekonomikë e politikë. Aristoteli shprehej që “mirëgenia është evidente që nuk është e mira që kërkojmë, por është thjesht e dobishme dhe për hir të diçkaje tjetër.” Emanuel Kant e vazhdoi traditën e trajtimit të njerëzve si qëllimi i vërtetë i të gjithë aktiviteteve, kur theksoi trajtimin e njeriut në formën e tij dhe asnjëherë vetëm si mjet. Kur Adam Smith, mbrojtësi i iniciativës së lirë private, shfaqti shqetësimin e tij që zhvillimi ekonomik duhet të lejojë një person të përzihet lirshëm me të tjerë “pa pasur turp për t’u shfaqur në publik”, ai po shprehte një koncept të varfërisë, që shkonte përtej matjes së të ardhurave për një koncept që integronte të varfrit në shumicën e komunitetit. Një linjë e njëjtë reflektohej në shkrimet e themeluesve të tjerë të mendimit ekonomik, përfshirë Robert Malthus, Karl Marx dhe John Stuart Mill¹. Ky punim synon të shpalosë teorinë alternative të zhvillimit njerëzor, përkundërt teorisë tradicionale të zhvillimit ekonomik, duke e aplikuar atë në situatën e tranzicionit post-komunist në Shqipëri. Qëllimi kryesor i zhvillimit është të zgjerojë zgjedhjet e njerëzve. Në parim, këto zgjedhje mund të jenë pafund dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Njerëzit shpesh vlerësojnë arritjet që nuk shfaqen ndonjëherë, apo jo menjëherë, në treguesit e të ardhurave të zhvillimit: më shumë akses në njohuri, ushqim më i mirë dhe shërbime shëndetësore, zona banimi më të sigurta, siguri ndaj krimeve dhe dhunës fizike, kohë të lirë të këndshme, liri politike dhe kulturore dhe një sens pjesëmarrjeje në aktivitetet e komunitetit. Me pak fjalë, objektivi i zhvillimit është të krijojë një mjedis që mundëson njerëzit të gëzojnë jetë të gjatë, të shëndetshme dhe krijuese².

Të ardhurat dhe zgjedhjet njerëzore

Diferenca përcaktuese ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe shkollave të zhvillimit njerëzor është që, e para fokusohet në mënyrë ekskluzive mbi zgjerimin e një zgjedhjeje të vetme – të ardhurave – ndërsa e dyta mbështet zgjerimin e zgjedhjeve njerëzore – qoftë ekonomike, sociale, kulturore apo politike. Mund të diskutohet nëse rritja e të ardhurave mund të shtojë edhe zgjedhjet,

1 Mahbub ul Haq, *Reflections on Human Development*, Oxford University Press, New York, 1995, p.13

2 Ibid. p. 14

por kjo nuk është domosdoshmërisht e vërtetë, për disa arsye. Së pari, të ardhurat mund të shpërndahen në mënyrë të pabarabartë në një shoqëri. Njerëzit që nuk do të kenë akses në të ardhura, apo që kanë akses të kufizuar, do t'i konsiderojnë zgjedhjet e tyre mjaft të kufizuara. Është vënë re shpesh që në shumë shoqëri, zhvillimi ekonomik nuk jep efekte reale.

Por ekziston edhe një arsye më e rëndësishme, se pse rritja e të ardhurave mund të dështojë në shtimin e mundësive njerëzore. Ka të bëjë edhe me prioritete kombëtare të zgjedhura nga një shoqëri apo nga drejtuesit – një model elitar zhvillimi apo një egalitar, autoritarizëm politik apo demokraci politike, një ekonomi e komanduar apo një zhvillim me pjesëmarrje.

Eksperienca botërore tregon se zgjedhje të tilla bëjnë një diferencë të madhe. Megjithatë, shpesh harrohet se përdorimi i të ardhurave nga një shoqëri është po aq i rëndësishëm sa gjenerimi i vetë të ardhurave. Nuk ekziston një lidhje automatike ndërmjet të ardhurave dhe jetëve njerëzore. Megjithatë ka ekzistuar gjatë një prezumim sipërfaqësor që një lidhje e tillë automatike ekziston.

Akumulimi i pasurisë mund të mos jetë domosdoshmërisht faktor vendimtar për përmbushjen e disa zgjedhjeve për njerëzimin. Në fakt, individët dhe shoqëritë bëjnë shumë zgjedhje që nuk kërkojnë pasuri. Një shoqëri nuk duhet të jetë e pasur për të pasur demokraci. Një familje nuk duhet të jetë e pasur për të respektuar të drejtat e secilit anëtar të familjes. Një komb nuk duhet të jetë i kamur për të trajtuar burrin dhe gruan në mënyrë të barabartë. Zakonet me vlerë sociale dhe kulturore mund të jenë – dhe janë – ruajtur në të gjitha nivelet e të ardhurave.

Kështu që shumë zgjedhje njerëzore shtrihen përtej mirëqenies ekonomike. Njohuritë, shëndeti, një mjedis i pastër, liri politike dhe kënaqësitë e thjeshta të jetës nuk janë në mënyrë ekskluzive, apo në përgjithësi, të varura nga të ardhurat. Pasuria kombëtare mund ta shtrijë zgjedhjen e njerëzve në këto aspekte, por pasuria në vetvete nuk është decizive.

Kështu, paradigma e zhvillimit njerëzor ngre një pikëpyetje mbi lidhjen e supozuar automatike midis rritjes së të ardhurave me zgjerimin e zgjedhjeve njerëzore. Një lidhje e tillë varet nga cilësia dhe shpërndarja e rritjes ekonomike, e jo vetëm nga sasia e kësaj rritjeje. Një lidhje midis rritjes dhe jetës njerëzore krijohet në mënyrë të ndërgjegjshme nëpërmjet politikave të qëllimshme publike – si për shembull shpenzimet publike për shërbimet sociale dhe politika fiskale për ri-shpërndarjen e të ardhurave dhe asetëve.

Por këtu ka vend për shumë kujdes. Pikëpyetja ndaj lidhjes automatike ndërmjet rritjes së të ardhurave dhe lulëzimit të jetës njerëzore nuk e hedh poshtë rritjen në vetvete. Rritja ekonomike është thelbësore në shoqëritë e varfra për reduktimin dhe eliminimin e varfërisë. Por, thelbi i argumentit është që cilësia e kësaj rritjeje është po aq e rëndësishme sa edhe sasia. Politika publike të ndërgjegjshme nevojiten për ta përçuar këtë rritje ekonomike tek jetët e njerëzve.

Por si mund të bëhet kjo. Kjo mund të kërkojë një ristrukturim të madh të rendit ekonomik e politik, dhe nga kjo pikëpamje paradigma e zhvillimit njerëzor është disi revolucionare nga ky kuptim. Pasi ngre pyetje mbi strukturat ekzistuese të funksionimit të shtetit. Lidhje më të mëdha midis rritjes ekonomike dhe zgjedhjeve njerëzore

mund të kërkojnë për shembull një reformë të sistemit të menaxhimit të tokës, sisteme progresive taksash, sisteme të reja të kreditimit të bankave drejt të varfërve, një zgjerim i madh i shërbimeve bazë sociale, në mënyrë që këto të arrijnë popullsinë e privuar, heqjen e barrierave për aksesin e njerëzve në sferat ekonomike dhe politike dhe sigurimi i barazisë së aksesit tek mundësitë, si edhe krijimi i rrjeteve të sigurisë për ata të cilët mund të preken nga funksionimi i tregut apo politika të caktuara publike. Këto paketa politike janë thelbësore dhe ndryshojnë nga një vend në tjetër. Megjithatë disa karakteristika janë të përbashkëta për të gjithë vendet.

Njerëzit duhet të vendosen në qendër të zhvillimit, pasi zhvillimi analizohet dhe kuptohet me njerëzit. Çdo aktivitet analizohet për të parë se sa shumë njerëzit marrin pjesë në të, apo përfitojnë prej saj. Guri themeltar i suksesit të politikave të zhvillimit bëhet kështu përmirësimi i jetëve të njerëzve, e jo thjesht zgjerimi i proceseve të prodhimit.

Zhvillimi njerëzor mendohet të ketë dy anë. Njëra është formimi i kapaciteteve njerëzore – si përmirësimi shëndetit, dijeve dhe aftësive. Ana tjetër lidhet me përdorimin që njerëzit i bëjnë këtyre kapaciteteve për punësim, aktivitete produktive, çështje politike dhe argëtim. Një shoqëri ka nevojë të ndërtojë kapacitetet njerëzore, si edhe të sigurojë akses të barabartë për mundësitë njerëzore. Nëse peshorja e zhvillimit njerëzor nuk i balancon në mënyrë të drejtë këto dy anë, kjo do të rezultonte në një frustrim të konsiderueshëm njerëzor.³

Një dallim i kujdesshëm duhet bërë midis qëllimit dhe mjeteve. Njerëzit shihen si qëllimi. Por nga ana tjetër dhe mjetet nuk duhen harruar. Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto është një mjet i rëndësishëm i zgjerimit të opsioneve njerëzore, por karakteri dhe shpërndarja e rritjes ekonomike maten me metrin e pasurimit të jetës së njerëzve. Proceset e prodhimit nuk mund të trajtohen në një vakum abstrakt. Ato kanë nevojë të shihen në një kontekst njerëzor. Njerëzit nuk shihen thjesht si instrumente për prodhimin e komoditeteve – nëpërmjet rritjes së kapitalit njerëzor. Duhet kujtuar gjithnjë se qeniet njerëzore janë qëllimi i fundmë i zhvillimit, e nuk janë thjesht kontribuues drejt makinerisë së madhe konvencionale materialiste.

Një koncept përfshirës dhe ndryshe

Paradigma e zhvillimit njerëzor përqafon të gjithë shoqërinë e jo vetëm ekonominë. Faktorëve politikë, kulturorë dhe socialë u jepet po aq vëmendje sa dhe atyre ekonomikë. Në fakt, studimi i lidhjes midis mjedisit ekonomik dhe atij jo-ekonomik është një nga aspektet më interesante të kësaj analize.

Paradigma e zhvillimit njerëzor mbulon të gjithë aspektet e zhvillimit – qoftë zhvillimin ekonomik apo tregtinë e jashtme, deficitet buxhetore apo politikat fiskale, kursimet apo investimet apo teknologjia, shërbime bazë apo skema mbrojtjeje sociale për të varfrit. Asnjë aspekt i modelit të zhvillimit nuk del jashtë qëllimit të

3 Për më shumë info shih Amartya Sen: Development as Freedom, OUP, 1999

tij, por avantazhi është zgjerimi i mundësive të njerëzve dhe përmirësimi i jetës së tyre. Të gjitha aspektet e jetës – ekonomike, politike dhe kulturore – shihen nga ky këndvështrim. Rritja ekonomike, si e tillë, bëhet vetëm një element i paradigmes së zhvillimit njerëzor.

Përveç marrëveshjes së gjerë mbi shumë nga këto tipare, ekzistojnë disa debate mbi konceptin e zhvillimit njerëzor – shpesh rezultat i disa keqkuptimeve mbi vetë konceptin. Ka mendime të gabuara që cilësojnë zhvillimin njerëzor si kundër zhvillimit dhe që nxit vetëm zhvillimin social.

Paradigma e zhvillimit njerëzor është e mendimit që rritja nuk është fundi i zhvillimit ekonomik – por që mungesa e rritjes shpesh është e tillë. Rritja ekonomike është esenciale për zhvillimin njerëzor, por për të eksploruar tërësisht mundësitë për përmirësimin e mirëqenies që rritja ekonomike ofron, ka nevojë të menaxhohet mirë. Disa vende kanë qenë shumë të suksesshëm në menaxhimin e rritjes së tyre ekonomike për të përmirësuar kushtet e njerëzve, të tjerë nuk kanë mundur ta realizojnë këtë. Pra, nuk ka një lidhje automatike ndërmjet rritjes ekonomike dhe progresit njerëzor. Dhe një nga çështjet më të rëndësishme politike lidhet me procesin nëpërmjet të cilit përkthehet, apo dështon të përkthehet rritja në zhvillimin njerëzor nën kushte të ndryshme zhvillimi.

Ka katër mënyra për të ndërtuar urat e duhura ndërmjet rritjes ekonomike dhe zhvillimit njerëzor. E para, vendos theksin mbi investimet në arsim, shëndetësi dhe zhvillimin e aftësive që mundësojnë njerëzit të marrin pjesë në procesin e rritjes si dhe të ndajë përfitimet, kryesisht nëpërmjet punësimit. Ky është një model rritjeje adoptuar nga Kina, Hong Kong, Japonia, Malajzia, Republika e Koresë, Singapori, Tailanda dhe shumë vende të tjera të industrializuara së fundmi. Së dyti, shpërndarja më e barabartë e të ardhurave dhe asetëve është kritike për krijimin e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet rritjes ekonomike dhe zhvillimit njerëzor. Kudo që shpërndarja e të ardhurave dhe asetëve është shumë e pabarabartë (si në Brazil, Nigeri dhe Pakistan), nivelet e larta të rritjes kanë dështuar të përkthehen në jetët e njerëzve. Lidhja ndërmjet shpërndarjes së asetëve dhe mënyrës së rritjes mund të jetë:

- ❑ E drejtuar nga rritja, me kushte të favorshme që në fillim për shpërndarjen e asetëve dhe edukimit të masës, përfshirë pjesëmarrjen e njerëzve në aktivitetet ekonomike (Kina, Republika e Koresë).
- ❑ Kushte fillestare të pafavorshme por rritje e madhe me sjellje politike publike korrektuese, përfshirë pjesëmarrjen e njerëzve (Kili, Malajzia)
- ❑ Rritje e ulët me aktivitete politike publike për të ofruar shërbime publike bazë, por normalisht e paqëndrueshme në afat gjatë (Xhamajkë, Sri Lanka)

Së treti, disa vende kanë mundur të bëjnë përmirësim të ndjeshëm në zhvillimin njerëzor edhe në mungesë të një rritjeje të mirë apo shpërndarjeje të mirë. Ata kanë arritur këtë rezultat nëpërmjet shpenzimeve sociale të strukturuar mirë nga qeveria. Kuba, Xhamajka, Sri Lanka dhe Zimbabve, ndërmjet të tjerave, kanë arritur rezultate jo shumë të mira nëpërmjet sigurimeve bujare të shërbimeve publike nga ana e shtetit.

Kështu bënë vendet në Evropën Lindore dhe në vendet e Bashkësisë së Vendeve të ish Bashkimit Sovjetik. Por eksperiencia të tilla nuk janë të qëndrueshme në përgjithësi, deri sa baza ekonomike të shtrihet aq sa të mbështesë bazën sociale.

Së katërti, fuqizimi i njerëzve – veçanërisht i grave – është një rrugë e sigurt e lidhjes së rritjes me zhvillimin njerëzor. Në fakt, fuqizimi duhet të shoqërojnë të gjitha aspektet e jetës. Nëse njerëzit ushtrojnë zgjedhjet e tyre në sferat politike, sociale dhe ekonomike, atëherë ekziston një bazë e mirë për sigurimin e një rritjeje të fortë, demokratike, pjesëmarrëse dhe afatgjatë.

Një keqinterpretim tjetër – i lidhur ngushtë me kritikën për gjoja theksin kundër rritjes ekonomike të modeleve të zhvillimit – është që strategjitë e zhvillimit njerëzor kanë vetëm përmbajtje sociale jo analiza ekonomike⁴. Kjo përshtypje është rritur duke argumentuar që strategjitë e zhvillimit lidhen vetëm me shpenzimet e zhvillimit social – sidomos arsim dhe shëndetësi. Disa analistë kanë shkuar dhe më tej dhe e kanë konfuzuar zhvillimin njerëzor me zhvillimin e burimeve njerëzore – me fjalë të tjera shpenzime zhvillimi me qëllim fuqizimin e kapaciteteve njerëzore. Të tjerë kanë insistuar që strategjitë e zhvillimit njerëzor kanë të bëjnë vetëm me aspektet sociale të mirëqenies njerëzore – ose akoma më ngushtë, vetëm me nevojat bazë njerëzore – dhe që ato kanë shumë pak për të thënë për rritjen ekonomike, prodhimin dhe konsumin, kursimet dhe investimet, tregtinë dhe teknologjinë, apo ndonjë aspekt tjetër të kuadrit makroekonomik.

Këta analistë, e vështrojnë padrejtësisht konceptin gjithëpërfshirës të paradigmes së zhvillimit, që përqafon si qëllimet dhe mjetet, si produktivitetin dhe barazinë, si zhvillimin ekonomik dhe social, si të mirat materiale dhe mirëqenien njerëzore. Në rastin më të mirë, këto kritika bazohen mbi moskuptimin e paradigmes së zhvillimit njerëzor.

Pika e vërtetë e nisjes e strategjiave njerëzore të zhvillimit është të preket çdo çështje në modelet tradicionale të rritjes nga avantazhi i njerëzve. A marrin pjesë ata në rritjen ekonomike, si dhe a përfitojnë prej saj? A kanë ata akses të plotë në mundësitë e tregtisë së zgjeruar? A janë zgjedhjet e tyre të zgjeruara apo janë ngushtuara nga teknologjitë e reja? A është ekspansioni ekonomik duke çuar drejt rritjes së vendeve të punës apo drejt rritjes së papunësisë? A janë buxhetet të balancuara pa prishur balancën në jetët e brezave të rinj? A janë tregjet “e lira” të hapura për të gjithë njerëzit? Jemi duke rritur mundësitë vetëm për brezat aktualë apo edhe për brezat e ardhshëm?

Asnjë nga çështjet ekonomike nuk është injoruar, por ata të gjithë janë të lidhur me objektivin kryesor të zhvillimit: njerëzit. Njerëzit analizohen shpesh jo si përfituesit e rritjes së zhvillimit ekonomik, por si agjentë të vërtetë të çdo ndryshimi në shoqëri – qoftë ekonomik, politik, social apo kulturor. Për të përcaktuar supremacinë e njerëzve në procesin e zhvillimit është mos diskriminimi rritjes ekonomike por rizbulimi i qëllimit të vërtetë të saj.

4 Për më tepër mbi këtë argument shih: Commission on Growth and Development (2008) ‘The Growth Report: Strategies for Sustained Growth and Inclusive Development’ - Introduction. www.growthcommission.org

Është e drejtë të themi se paradigma e zhvillimit njerëzor është model i zhvillimit gjithëpërfshirës që ekziston sot. Ky model përfshin çdo çështje zhvillimi, përfshirë rritjen ekonomike, investimin social, njerëzit, sigurimi i nevojave bazë dhe skema sociale sigurie, liritë politike dhe kulturore dhe të gjithë aspektet e jetës së njerëzve. Nuk është as teknokratik i ngushtë as shumë filozofik. Është një reflektim i vetë jetës.

Zhvillimi njerëzor kundrejt zhvillimit ekonomik – rasti i Shqipërisë

Aplikimi praktik i debatit konceptual midis zhvillimit njerëzor dhe atij ekonomik shfaqet në mënyrë shumë interesante në vendet ish-komuniste si Shqipëria. Tranzicioni post-komunist në Shqipëri si në të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe ato të ish-Bashkimit Sovjetik karakterizohet nga një model orientimi drejt zhvillimit ekonomik mbi bazën e parimit orientues të fillim viteve 90. Siç u tha më lart baza e këtij parimi konsistonte në marrjen si të mirëqenë të faktit që politikat shtetërore të orientuara drejt zhvillimit ekonomik do kenë ndikimin e tyre pozitiv afatgjatë në trajtimin e sfidave sociale të pas-komunizmit. Në atë kohë ky parim i përqafuar nga shumë analistë dhe ekonomistë të organizatave ndërkombëtare i apelonte kushteve të disfavorshme ekonomike në të cilat ndodheshin këto vende fill pas ndryshimeve strukturore. I ashtuquajtur “Washington consensus” i promovuar nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar për vendet në krizë në fund të viteve 80’ arriti të gjeneronte një paketë reformash që me gjithë kritikën, këndvështrimet e ndryshme apo rivlerësimet e mëvonshme, e arritën qëllimin e tyre – sigurimin e rritjes ekonomike. Reformat e orientuara drejt rritjes ekonomike pas ndryshimeve strukturore e arritën objektivin e tyre dhe në Shqipëri.

Rritja ekonomike u bë motivi kryesor i politikave shtetërore me shpresën që rimëkëmbja e ekonomisë do të sillte si pasojë mbushjen e arkave të shtetit që më pas do të lejonte adresimin e problemeve sociale të lidhura ngushtë me aspektet e zhvillimit njerëzor.

Shpesh Shqipëria përmendet si një rast i suksesshëm i zhvillimit ekonomik ku rritja ekonomike e qëndrueshme rreth shifrës 6% në vit (shih Figura 1) gjatë viteve të mijëvjeçarit të ri arriti ta nxjerrë Shqipërinë nga vendet me të ardhura të ulëta. Kjo është një arritje vërtet për t’u shënuar duke marrë parasysh nivelin e dëshpëruar ekonomik që përfjetoj Shqipëria gjatë viteve të fundit të komunizmit.

Megjithatë është interesant fakti që në një këndvështrim krahasues dhe për më tepër nga këndvështrimi i zhvillimit njerëzor tabloja Shqiptare ofron një dinamikë disi të ndryshme. Në ndihmë në këtë analizë na vijnë një mori treguesish të krahasueshëm duke filluar që nga treguesit e zhvillimit njerëzor të aplikuar që prej vitit 1990 si edhe ato të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit të përcaktuar në Samitin e Mijëvjeçarit të vitit 2000⁵.


5 <http://www.mdgmonitor.org/>

Figura 1: Rritja reale e PBB (%)



Treguesit e zhvillimit njerëzor, duke njohur rolin e zhvillimit ekonomik marrin parasysh gjithashtu dhe komponentë të tjerë të zhvillimit si arsimi dhe shëndetësia të shprehur në indikatorë specifikë që më pas agregohen në Treguesin e Zhvillimit Njerëzor⁶. Për më tepër, këto tregues kualifikohen akoma më tepër nga pikëpamja gjinore duke na dhënë dhe një tablo specifike të çështjeve gjinore në vend. Duke përdorur një metodologji të njehsuar si edhe duke përdorur të dhëna të dala nga i njëjti vit, Raporti i Zhvillimit Njerëzor i përpiluar nga zyra qendrore e UNDP shpalos renditjen botërore të zhvillimit njerëzor e cila që prej vitit 1990 është kthyer në një barometër të zhvillimit. Sipas të dhënave të publikuara së fundmi (mbi bazën e të dhënave të vitit 2006), Shqipëria raportohet të ketë hyrë në grupin me zhvillim të lartë njerëzor pasi e ka kapërcyer pragun prej 0.800 (me një vlerë prej 0.801). Sidoqoftë duke i dhënë nota krahasuese kësaj vlere shihet se Shqipëria së bashku me Maqedoninë janë inferiore ndaj performancës njerëzore të vendeve të tjera të rajonit siç duket qartë në Figurën 2.

Figura 2: Zhvillimi Njerëzor në rajon



6 Për më shumë informacion për treguesit e zhvillimit njerëzor shih: <http://hdr.undp.org/en/statistics/indices/hdi/>

Në të njëjtën frymë, po të hedhim një vështrim krahasues mbi rritjen e të ardhurave në rajonin tonë vihet re që ndonëse rritja ekonomike e Shqipërisë është impresive krahasuar me nivelet globale dhe më e lartë se Maqedonia apo Bosnja, ajo përsëri është më e ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Po ta zgjerojmë krahasimin me vendet tjera të ish bllokut komunist e që tashmë janë anëtarë të Bashkimit Evropian do shohim se rritja e Shqipërisë është disi e ulët në raport me rritjen e vendeve Baltike apo Sllovakinë siç shihet në Tabelën 1.

Tabela 1: Rritja reale e PBB (%)

	2003	2004	2005	2006	2007
Albania	5.7	5.9	5.5	5	6
BiH	3.5	6.1	5	6.2	5.5
Bulgaria	5	6.6	6.2	6.1	6.3
Croatia	5.3	4.3	4.3	4.8	5.7
Romania	5.2	8.4	4.1	7.7	6
Macedonia (TFYR)	2.8	4.1	3.8	3.1	4.6
Serbia	2.5	8.4	6.2	5.7	7
Czech Republic	3.6	4.6	6.5	6.4	5.7
Slovakia	4.8	5.2	6.6	8.8	8.5
Estonia	7.1	8.1	10.5	11.4	7.9
Latvia	7.2	8.7	10.6	11.9	10
Lithuania	10.3	7.3	7.6	7.5	7.8

Vërtet, po ta përkthejmë këtë rritje ekonomike në vlera monetare do të shikojmë se vlera e Prodhimit të Brendshëm Bruto për frymë në Shqipëri për vitin 2006 është përsëri më e ulët se vendet e tjera të rajonit. Duke marrë parasysh që ritmet e zhvillimit për vitet e ardhshme priten të jenë rreth të njëjtave nivele (duke shpresuar që kriza globale mund të mos ketë ndonjë efekt serioz mbi ekonominë shqiptare), me një sy optimist mund të vërehet se Shqipëria mund të kapë shumë shpejt nivelet e Maqedonisë dhe Bosnjës. Pavarësisht kësaj, siç shihet dhe nga Figura 3, niveli i Shqipërisë është afërsisht 2 herë më i vogël se anëtarët më të reja të BE – Bullgaria dhe Rumania.

Duke e çuar më tej argumentin në debatin mbi zhvillimit, ka disa aspekte që rritja ekonomike nuk ka arritur ende t'i fuqizojë siç pritej e që i japin një shtysë superiore argumentit pro zhvillimit njerëzor. Disa tregues shumë të thjeshtë por mjaft domethënës shpalosin një tablo zhvillimore disi të tkurrur të Shqipërisë me gjithë hapat galopantë që janë bërë që prej vitit 1990. Për shembull, numri i linjave telefonike ndonëse është rritur nga disa herë prej vitit 1990 (duke shënuar rritjen më të madhe në rajon), ai përsëri mbetet mjaft i ulët krahasuar me vendet e rajonit siç shihet dhe në Figurën 4.

Figura 3: PBB për fryme





Figura 4: Linjat telefonike: 1990 - 2005



Me të njëjtën logjikë treguesit e zhvillimit modern teknologjik si përdorimi i telefonisë celulare apo i internetit pasqyrojnë një tablo të ngjashme për vitin 2005. Ndonëse është për t'u vënë në dukje fakti që këto 3 vjetët e fundit këta tregues ka gjasa të jenë përmirësuar ndjeshëm, nga pikëpamja krahasuese ata shpalosin një realitet ndonëse dinamik e progresiv, akoma të ndrydhur dhe jo në potencialin e vet maksimal.

Figura 5: Telefonia celulare





Figura 6: Përdoruesit e internetit



Pyetja mund të lindë natyrshëm – përse kjo performancë jo fort e kënaqshme e Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Duke mos dashur të justifikoj stadin e zhvillimit të vendit duke e vënë atë në perspektivën e regjimit komunist apo në goditjen që mori modeli Shqiptar i zhvillimit në vitin 1997 si edhe pasigurinë rajonale që shoqëroi luftën në Kosovë, argumenti shkencor që vjen në ndihmë është ai i zhvillimit njerëzor.

Përballja me situatat imediate dhe problemet akute që pllakosën vendin gjatë fillimit të viteve 90' si edhe një orientim politikash drejt rritjes ekonomike lanë shumë pak vend për artikulumin e alternativave të tjera. Por duke hedhur një sy të shpejtë mbi sfidat e zhvillimit të Shqipërisë pas-komuniste mund të vihet re kollaj se pak rëndësi gjatë këtyre viteve i është vënë efikasiteti së politikave publike. Adresimi i problemeve serioze në dhënien e shërbimeve bazë si ujë, energji, mjedisi i paqëndrueshëm si edhe reformat në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë është kryer në kushtet e një menaxhimi ad-hok jo-vizionar dhe në mungesë të një qasjeje drejt zgjidhjes afatgjatë e të qëndrueshme të problemeve. Është për të ardhur keq, që Shqipëria pavarësisht se trashëgoi nga sistemi komunist një sistem arsimor të strukturuar mirë dhe një sistem shëndetësor kombëtar falas për të gjithë, sot pas 18 vjetësh tranzicion ende rezulton me tregues të pakënaqshëm në këto dy sektorë. Ndërkohë që debatet mbi sistemet shëndetësore zënë një pjesë të madhe të mendimit mbi politikat publike në shumë vende të zhvilluar si Britania e Madhe apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëria kishte një mundësi shumë të mirë për të përmirësuar sistemin e trashëguar nga regjimi i kaluar e për të ndërtuar një model shumë afër atij skandinav. Siç shihet dhe nga Figurat 7 dhe 8 treguesit e shpenzimeve shëndetësore publike dhe private janë inferiorë në krahasim me vendet e rajonit (përveç rastit të Bosnjës ku shpenzimet private janë më të larta se ato të Shqipërisë).

Figura 7: Shpenzimet publike shëndetësore për frymë (PPP USD)






Figura 8: Shpenzimet private shëndetësore si % e PBB (2004)



E njëjta situatë vihet re dhe në sektorin e arsimit ku gjatë viteve 2002 – 2005 shpenzimet publike u sollën rreth shifrës 2.9 % të PBB ndërkohë që në Kroaci e Bullgari ato e kalojnë nivelin e 4 %.

Figura 9: Shpenzimet publike për arsim 2002 – 2005 (% e PBB)



Konkluzione

Qëllimi i këtij punimi ishte të hedhë dritë mbi paradigmen e zhvillimit njerëzor, artikulin e tij si edhe ndryshimet rrënjësore me qasje të tjera të modeleve të zhvillimit duke shpresuar të kontribuojë në nxitjen e debateve rreth politikave dhe orientimit të zhvillimit.

Zhvillimi njerëzor cilëson si procesin e zgjerimit të mundësive të njerëzve dhe përmirësimit të mirëqenies së tyre. Dimensionet më kritike të zhvillimit njerëzor janë: një jetë e gjatë dhe e shëndetshme, dije dhe një standard i pranueshëm jetese. Çështje të tjera përfshijnë dhe liritë sociale dhe politike. Koncepti i zhvillimit njerëzor dallon dy anë të tij. Njëri është formimi i aftësive njerëzore si përmirësimi i shëndetit dhe dijeve. Ndërsa tjetri është shijimi i këtyre aftësive të fituara, si për punë ashtu dhe për kënaqësi.

Më pas pjesa e dytë e këtij punimi u fokusua mbi një analizë të shkurtër të zhvillimeve post-komuniste në Shqipëri të vështuara prej lenteve të zhvillimit njerëzor. Nëpërmjet një sërë të dhënash, treguesish dhe nëpërmjet një analize krahasuese u nënvizua fakti që modeli shqiptar i zhvillimit ka qenë i orientuar drejt rritjes ekonomike duke lënë disi pas dore efektet anësore të këtij modeli. Thelbi i argumentit kryesor konsistonte në sugjerimin që zbatimi në praktikë i paradigmes gjithëpërfshirëse dhe së zhvillimit njerëzor dhe vënia e njerëzve në shënjestër të të gjitha politikave të zhvillimit do t'i kishte dhënë një karakter cilësisht më dinamik dhe kompetitiv tranzicionit post-komunist në Shqipëri.

Bibliografia

- Mahbub ul Haq, *Reflections on Human Development*, Oxford University Press, New York, 1995
- Sen, Amartya (2000) *'A decade of human development'*, *Journal of Human Development*, 1 (1), p. 17-23.
- Sen, Amartya (1999), *'Development as Freedom'*, Oxford: Oxford University Press
- Boozer, M., Ranis, G., Stewart, F., Suri, T. (2003) *'Paths to Success: The Relationship Between Human Development and Economic Growth'*, New Haven, Conn.: Economic Growth Center, Yale University.
- Prabhu K. Seeta, 2007, *'Operationalising Human Development: A Programmatic Approach'*, HD Insights, Human Development Report Office, UNDP http://hdr.undp.org/en/media/HDInsights_Oct2007.pdf
- Subir Roy, 2008, Putting people before GNP, <http://www.business-standard.com/india/storypage.php?autono=338814&chkFlg=>
- Commission on Growth and Development (2008) *'The Growth Report: Strategies for Sustained Growth and Inclusive Development'*, www.growthcommission.org
- Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor Shqipëri, 2005,
- Raporti Global i Zhvillimit Njerëzor, 2007/2008, <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr2007-2008/>
- Figurat, grafikët dhe tabelat me të dhënat nga <http://hdr.undp.org/en/statistics/>

Kapitali njerëzor dhe zhvillimi

– rasti shqiptar

Blerta Picari

***ABSTRAKT:** Ky artikull synon të analizojë ndryshimet dhe ndikimin e kapitalit njerëzor në zhvillimin ekonomik, politik dhe social të vendit gjatë periudhës së tranzicionit. Ai analizon aspekte të ndryshme të kapitalit njerëzor, duke u përqendruar në faktorët ndikues parësorë dhe dytësorë. Këtu përfaqësohet sistemi arsimor dhe politikat qeveritare të lidhura me të duke përfshirë dhe buxhetin, trajnimet në vendin e punës dhe përshtatja me kërkesat e tregut, sikurse dhe faktorët dytësorë, si migrimi i jashtëm dhe i brendshëm, politikat e përkrahjes sociale, sistemi shëndetësor, etj. Në këtë artikull, argumentohet se, duke u bazuar në gjendjen e sotme, niveli dhe cilësia e kapitalit njerëzor në Shqipëri nuk mund të shërbejë si bazë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe si rrjedhojë, politik dhe social në të ardhmen. Cilësia aktuale e arsimit, regjistrimi në shkollat fillore dhe të mesme, sikurse dhe ndikimi i elementëve të tjerë, nuk përbëjnë baza të shëndosha për të përmirësuar gjendjen aktuale të kapitalit njerëzor të domosdoshëm për t'i dhënë fund tranzicionit të vazhdueshëm në të cilin gjendet vendi.*

Pikë së pari, është e rëndësishme të qartësohet se cila është qasja mbi zhvillimin në të cilën është bazuar ky artikull. Mbizotërojnë dy mënyra kryesore që dominojnë këtë proces. Qasja e parë është përqendrimi tek rritja ekonomike (në terma afatshkurtër) duke ristrukturuar burimet ekzistuese dhe duke shfrytëzuar ato sektorë të ekonomisë të cilët janë më fitimprurës, por duke lënë mënjanë mjedisin, sistemin arsimor dhe shëndetësor, politikat sociale, etj., me idenë se në një moment të dytë, pasi ekonomia të ketë arritur këtë rritje, këto të ardhura do të shërbejnë për të përmirësuar politikat sociale. Qasja e dytë përqipet të zhvillojë në terma afatgjatë dhe në mënyrë të balancuar pjesën më të madhe të sektorëve të ekonomisë, sikurse dhe spektrin social dhe politik për të arritur një proces demokratik dhe uniform. Argumentet në këtë artikull i referohen qasjes së dytë, pra një procesi zhvillimi dhe jo thjesht rritjeje ekonomike. Ne jemi ende larg fundit të procesit të tranzicionit, dhe si rrjedhojë, ekzistojnë mundësi dhe hapësira të konsiderueshme për të hartuar politika në funksion të këtij modeli.

Studiues të shumtë, pavarësisht nga rryma të cilës i përkasin, e vlerësojnë kapitalin njerëzor¹ si një nga burimet më të vlefshëm të një vendi. Në të nuk përfshihen vetëm shifra të popullatës, por dhe cilësia e këtij kapitali dhe ndikimi që ka ai në zhvillimin ekonomik, politik dhe social të një vendi. Bazuar në të dhënat e fundit, kapitali njerëzor i vendeve të zhvilluara vlerësohet me 80% të pasurisë së përgjithshme të tyre, ndërsa në vendet në zhvillim, kjo përqindje është më e ulët, 59% (Rogers, Jalal, & Boyd, 2006: 309). Pavarësisht diferencës së theksuar, përqindja e lartë e vlerës së këtij kapitali kundrejt totalit të përgjithshëm tregon se ky i fundit është një nga çështjet thelbësore për t'u marrë në konsideratë për hartimin e politikave të zhvillimit në Shqipëri.

Investimi tek kapitali njerëzor nuk përbën vetëm një investim privat, por dhe një investim social. Pavarësisht burimeve të ndryshme natyrore të një kombi (që në Shqipëri janë të shumta), ato nuk mund të shfrytëzohen dhe të përdoren për të përmirësuar cilësinë e jetesës, nëse kapitali njerëzor vazhdon të mbetet në nivele të ulëta. Si rrjedhojë, nuk mund të ketë një zhvillim të mirëfilltë të shtrirë në mënyrë uniforme në të gjithë vendin, por një rritje ekonomike afatshkurtër dhe sporadike.

Ky artikull synon të adresojë problemet kryesore që janë hasur me kapitalin njerëzor në Shqipëri, duke u përqendruar më tepër tek sistemi arsimor, faktori parësor ndikues në të. Duke supozuar se lexuesi është në dijeni të situatës historike para dhe pas viteve 90, në segmentet e ndryshme të arsimit në vendin tonë, një gjë e tillë nuk është analizuar në asnjë pjesë të artikullit. Ai nuk synon të rekomandojë mënyra më të mira të zhvillimit të arsimit dhe kapitalit njerëzor, por thjesht të vërë në pah mënyrën se si politikat e ndërmarra gjatë tranzicionit në Shqipëri kanë ndikuar në kapitalin njerëzor, sikurse dhe rëndësinë që i është dhënë këtij të fundit. Teza kryesore mbështetet në argumentin se, kapitali njerëzor gjatë tranzicionit në Shqipëri nuk ka pësuar përmirësime të ndjeshme, dhe në terma afatgjatë nuk mund të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të vendit, por në një rritje afatshkurtër ekonomike, dhe si rrjedhim, në një zhvillim të cekët politik dhe kulturor.

Metodologjia kryesore e përdorur ka qenë ajo e vështirimit në literaturë e teorieve të ndryshme mbi zhvillimin dhe të dokumenteve analitike mbi arsimin, migrimin, dhe sistemin shëndetësor në vendin tonë nga organizata dhe institucione të ndryshme. Faktorët parësorë dhe dytësorë që ndikojnë në kapitalin njerëzor janë të shumtë dhe secili është trajtuar më poshtë me aq thellësi sa mund të lejojë ky artikull. Rëndësia më e madhe i është dhënë sistemit të arsimit, pasi në terma afatgjatë, ai është elementi më i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së kapitalit njerëzor.

Arsimi

Shqihtarët i japin një rëndësi të madhe arsimit dhe rendimentit të lartë në të. Shfrytëzimi i burimeve për të përmirësuar sistemin arsimor është i domosdoshëm në mënyrë që të përmirësohet dhe zhvillohet kapitali njerëzor. Në vendet në zhvillim e sipër, siç është Shqipëria, fëmijët shpeshherë vërehen si një “mjet” zëvendësues kundrejt mungesës së institucioneve, pasi mendohet se fëmijët

do të kujdesen për prindërit e tyre gjatë viteve të fundit të jetës. Pra fëmijët shihen (ekonomikisht) si një investim/formë sigurimi, pasi në periudhën e moshës së vjetër mungojnë institucionet shtetërore të cilat duhet të kujdesen për njerëzit.²

Por ashtu sikurse fëmijët vërehen si një “investim”, shpenzime të konsiderueshme lidhen me rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Disa prej kostove janë të drejtpërdrejta (ushqimi dhe veshja, arsimimi) dhe disa të tjera janë të tërthorta, ku mund të përmendim sasinë e punës që duhet të kryejnë prindërit për të rritur fëmijën. Këtu përfshihet dhe puna pothuajse gjithmonë e papaguar e punëve të shtëpisë dhe kujdesit të grave. Përgjatë viteve të tranzicionit është konstatuar një ulje në cilësinë e sistemit arsimor dhe për faktin se mungojnë standardet uniforme të vlerësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit.

Probleme të mëdha janë evidentuar, ndër të cilat mund të përmendim transformimin e institucioneve por mungesën e konsolidimit të tyre, ndryshimin e teksteve shkollore, cilësinë e mësimdhënies, mundësitë për kërkim dhe zhvillim, diferencat në arsim në zonat urbane dhe rurale, infrastrukturën e varfër të institucioneve arsimore dhe amortizimin e vazhdueshëm të tyre, përqindjen e ulët të buxhetit të arsimit në krahasim me vendet e rajonit, sistemi i riprodhimit të dijeve dhe jo i të menduarit kritik, rënia e konkurrueshmërisë në treg e arsimit publik për shkak të përfshirjes së sektorit privat, mungesën e shkollave profesionale, përshtatjen e studentëve me tregun e punës, etj. Pritshmëria e arsimimit në Shqipëri ka pësuar një rënie të konsiderueshme, në vitin 89 ishte 11.6 vjet, ndërsa në 98 ishte 9.5 (shih tabelën 1 në shtojcë), duke reduktuar kështu pritshmëritë në arsim me 6 vjet më pak në krahasim me vendet e tjera Europiane, pritshmëria e arsimit për të cilat ishte 15.4 vjet (Khan, 2004). Sipas Studimit të Standardit të Jetesës të INSTAT (LSMS) të vitit 2005, vitet e shkollimit ishin rritur me 0.3 vite duke i rritur pritshmëritë për arsim në 9.9 vjet.

Arsimi i mesëm ka pësuar rënie drastike nga viti 1990 (78%) të fëmijëve në 30% në 1995. Dhe pse Banka Botërore sugjeron se në vitin 2001 regjistrimi në shkollat e mesme u rrit deri në 49%, LSMS tregon se përqindja e regjistrimit gjatë vitit 2002 ishte rreth 28.1%. I njëjti studim në vitin 2005 tregon se kjo shifër varion shumë bazuar tek të ardhurat e familjes, duke llogaritur vetëm 50% regjistrime për familjet e varfra, ndërsa regjistrimi i tyre në arsimin e lartë është nën 10%. Pra si përmbledhje mund të thuhet se Shqipëria ka nivelin arsimor më të ulët se çdo vend në rajon.³

Vlerësimi i cilësisë së arsimit në Shqipëri vihet re në testimin e bërë kundrejt standardeve të dëshiruara. Shqipërisë i mungojnë standardet e mësimi dhe deri tani nuk ka zhvilluar sisteme të vlerësimit të performancës studentore në lidhje me vendet e tjera. Në mungesë të masave të drejtpërdrejta vlerësuese të arritjeve studentore, duhet të përdoren kurrikulumet shkollore, librat dhe mësuesit. Diferencat në arsim variojnë duke përfshirë këtu ato gjinore, fetare, preferenciale (zgjedhja se kush fëmijë do të arsimohet dhe pse), dhe ndërfamiljare (e cila varet nga të ardhurat, arsimimi i prindërve, infrastruktura shkollore, zonat rurale/urbane, etj.) (Picard & Wolff, 2004). Këto vlerësime japin një pasqyrë të rënduar, sidomos për zonat rurale. Burimet parësore (inputet) që influencojnë cilësinë e arsimit (outputet) nuk maten dot as me minimumet e standardeve të përdorura në vendet me ekonomi të zhvilluar.

Pas përfundimit të shkollës së detyrueshme (tani 9-vjeçare) vihet re se në Shqipëri bie numri i regjistrimit në zonat rurale sidomos për vajzat. Varfëria është e përqendruar në zonat rurale dhe shumë familje nuk mund të investojnë në arsimimin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu oferta e shkollave të disponueshme dhe cilësia e shërbimeve arsimore janë në kushte të këqija, gjë që ndikon në frekuentimin e tyre prej fëmijëve. Migrimi i brendshëm nga zonat rurale në qytet ka ndikuar gjithashtu dhe në cilësinë e shkollave të zonave urbane, ku rritja e numrit të studentëve në klasë ka ulur cilësinë e mësimdhënies. Vlen gjithashtu të përmendet dhe “braktisja e fshehtë”, fenomen i përhapur sidomos në zonat rurale, ku mësuesit i kalojnë nxënësit pavarësisht rendimentit të tyre dhe këta të fundit nuk tentojnë të mësojnë. Problemet normalisht evidentohen në shkollat e mesme dhe të larta, ku duket qartë që studentët nuk i kanë njohuritë e nevojshme për të vazhduar arsimin e lartë.

Hartimi i teksteve shkollore, organizimi dhe trajnimi i stafit gjithashtu, nuk janë të menaxhuara në mënyrë efikase dhe nuk iu përgjigjen nevojave të domosdoshme. Qeverisja e sistemit të arsimit në Shqipëri është mjaft e centralizuar dhe e ndjeshme ndaj ndryshimeve politike. Menaxhimi i saj përbën një pengesë të madhe drejt përmirësimit të shërbimeve arsimore. Shteti dominon këtë shërbim dhe konkurrenca nga institutet private nuk ka ndikuar ndjeshëm në mënyrë pozitive në rritjen e cilësisë së arsimit publik. Me sa duket privatizimi (dhe në sektorin shëndetësor) nuk çon domosdoshmërisht drejt përmirësimit të cilësisë së një sektori shërbimesh shtetëror.⁴

Buxheti i pakët për arsimin është një nga faktorët që ka ndikuar negativisht në cilësinë e arsimit. Infrastruktura e dobët e shkollave, episodet e vandalizmit, mungesa e mirëmbajtjes, kanë rezultuar në dëme të mëdha. Buxheti për arsimin ka rënë në mënyrë të ndjeshme nga 4.2% të GDP-së në vitin 1990, në 2.7% në vitin 2001, 2.95% në 2006, 3.33% në 2007 dhe është planifikuar të arrijë në 3.46% në 2008 (Ministria e Financave, 2008). Buxheti i MASH pretendohet të shtohet me nga 1 miliard lekë për vitet 2009, 2010, dhe 2011 për të investuar në mirëmbajtjen e klasave, pajisjeve dhe shpenzimeve të tjera (Ibid). Pavarësisht kësaj shtese të shumëpritur, kjo përqindje investimi në arsim vazhdon të mbetet e ulët në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe të Europës Lindore, të cilat kanë ndjekur gjithashtu politikat e tyre të zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Problemet e arsimit reflektojnë menjëherë kapacitetet e kapitalit njerëzor dhe rritjen ekonomike të një vendi. Nga analiza e raportit të Bankës Botërore e vitit 2004 është marrë një ekuacion neoklasik për treguar se regjistrimi në shkollat e mesme në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur një rritje të vazhdueshme ekonomike prej 5-6% të produktit të brendshëm bruto në periudhën afatgjatë. Rezultatet e këtij ekuacioni⁵ që gjenden në shtojcë, tregojnë se është tepër e rëndësishme që Shqipëria të arrijë një përqindje më të lartë të regjistrimit në nivelin në shkollat e mesme, pasi është e nevojshme për zhvillimin ekonomik të vendit duke qenë se kapitali njerëzor ndikon në të në mënyrë të drejtpërdrejtë. Siç mund të shihet në ekuacionin e përdorur nga Khan për të përlogaritur rritjen ekonomike të Shqipërisë në terma afatgjatë, mund të shihet (në tabelën 1 në shtojcë) se rezultati do të ishte një ulje e ndjeshme e rritjes ekonomike në të ardhmen, nëse niveli dhe cilësia e arsimit do të mbeteshin në këtë

gjendje. Shqipëria krahasohet përafërsisht me republikat e Tashkistanit, Kyrgistanit, dhe Azerbajxhanit në këto përllogaritje, dhe jo me vendet e Europës Qendrore, të cilat iu bashkëngjiten Bashkimit Europian në vitin 2004 dhe drejt të cilit synojmë.

Një ulje e tillë ekonomike vërehet vetëm në varësi të cilësisë së arsimit bazë dhe atij të mesëm. Nëse do të analizoheshin dhe problemet ekzistuese në arsimin e lartë (mungesa e punës kërkimore dhe zhvillimi profesional, mangësitë në brezin e kërkuesve të rinj 25-40 vjeç, mungesa e botimeve shkencore, mungesa për trajnime për pedagogët e rinj dhe mundësive për avancim në karrierë, infrastruktura e fakulteteve dhe ambienteve laboratorike, etj.) do të mund përllogaritej se si cilësia e arsimit të lartë ndikon jo vetëm në maksimizimi e të ardhurave në tregun e punës për individët, por në mënyrë të drejtpërdrejtë, në aftësitë e mësuesve dhe cilësinë e mësimdhënies në shkollat fillore dhe të mesme.

Përfitimi i investimit të bërë në arsim (privat – individual apo shoqëror) duhet parë jo vetëm në terma monetarë. Përfitimet individuale kanë të bëjnë me përfitimet ekonomike në sajë të gjetjes së një pune të mirë në fushën e preferencës dhe përfitimeve të tjera duke pasur një cilësi më të lartë jetese dhe duke maksimizuar burimet e individit. Nga ana tjetër, përfitimet shoqërore kanë të bëjnë me përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë, të cilat shfaqen nëpërmjet zhvillimit social dhe kulturor të vendit, angazhimit në politikë dhe përgjegjësisë që mbajnë individët në shoqëri.

Tregu i punës dhe trajnimet

Domosdoshmëria e lidhjes së sistemit të arsimit dhe tregut të punës është studiuar në thellësi në vendet e zhvilluara, ku një pjesë e mirë e universiteteve stabilizojnë marrëdhënie të ngushta me kompani dhe organizata, për të hartuar programe të cilat do të shërbejnë si baza të shëndosha për individët në momentin e hyrjes së tyre në tregun e punës. Ndërsa në Shqipëri, nuk ekziston ndonjë studim i mirëfilltë i kërkesave të tregut të punës dhe programeve arsimore të shkollave të mesme profesionale dhe të universiteteve. Si rrjedhojë, të dy këto sektorë funksionojnë të izoluar, duke shkëmbyer shumë pak ide dhe praktika, dhe programet akademike reflektojnë shumë pak nevojat e tregut, sidomos nga nevojat e sektorit privat. Shumë organizata synojnë të marrin në punë individët që janë të kualifikuar nëpërmjet trajnimeve apo arsimit dhe nuk e kanë të nevojshme trajnimin bazë, siç mund të jetë p.sh.: komunikimi efikas, aftësitë për të punuar vetëm dhe në grup, aftësitë për zgjidhje problemesh, gjuhësore, kompjuterike, etj. Por, nëse këto aftësi nuk merren përgjatë viteve të shkollimit apo në shkolla profesionale (të cilat mungojnë), atëherë studentët që mbarojnë shkollën e mesme apo të lartë e kanë tejet të vështirë të përshtaten me tregun e punës. Kjo çon drejt punësimit të tyre në pozicione ku ekzistojnë pak mundësi për zhvillim, ose drejt krijimit të sektorëve të tregut që funksionojnë të cunguar për shkak të aftësive të pakta të njerëzve të punësuar në ta.

Mungesa e institucioneve mbështetëse për ekonominë e hapur dhe mungesa e metodave për zhvillimin e kapaciteteve të kapitalit njerëzor ka sjellë një dëmtim

afatgjatë në vendin tonë. Duke pasur parasysh faktin që Shqipëria gjatë tranzicionit ka pësuar ndryshime rrënjësore të sistemit ekonomik, papunësia e lartë ka qenë treguesi kryesor i mungesës së efikasitetit të këtij ristrukturimi ekonomik dhe të aftësive minimale të shumicës së individëve për të mbijetuar në këtë treg.⁶

Në tregun e brendshëm të punës, faktorët kryesorë për t'u marrë në konsideratë janë: së pari, madhësia mesatare e firmave, së dyti, influenca e sindikatave, forca/influenca e sistemeve që mbështesin vjetërsinë në punë, dhe së treti, tradita për dhënien e trajnimeve. Në vendin tonë, administrata shtetërore është reduktuar me kalimin e viteve, pra të punësuarit në sektorin privat përbëjnë pjesën më të madhe të forcës punëtore në vend. Duke mbajtur parasysh që organizatat ndërkombëtare dhe kompanitë e mëdha punësojnë një përqindje tepër të vogël të kësaj force punëtore, pjesa më e madhe e individëve janë të punësuar në biznese të vogla private, që përbëjnë pjesën më të madhe të ekonomisë informale. Si rrjedhojë, trajnimet për zhvillimin e aftësive të stafit mungojnë pothuajse plotësisht dhe për më tepër forca punëtore e kualifikuar është zakonisht e nënpaguar. Për më tepër, mungon një sistem i mirëfilltë i menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorin privat ku nuk ka shkallë të zhvillimit të karrierës por negocime individuale dhe të vazhdueshme ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kjo mënyrë informale e organizimit të tregut, shërben si një mënyrë mbijetese, por jo si një zgjidhje afatgjatë që ndikon pozitivisht në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të kapitalit njerëzor.

Por dhe në organizatat e mëdha të cilat kanë fondet dhe stafin e disponueshëm për të dhënë trajnime formale në filiale të ndryshme për vende pune të specializuara vërehen probleme të zhvillimit të stafit. Bizneset e mëdha me shumë punëtorë ndikohen drejtpërdrejt nga sindikatat dhe rregullat e tyre. Në Shqipëri sindikatat kanë pak influencë si rrjedhojë e madhësive të firmave dhe mundësive për negocim (niveli i lartë i papunësisë bën që punëtorët të jenë të zëvendësueshëm lehtësisht). Pra investimi i bërë në arsimin e një individi të caktuar mund të hidhet poshtë shumë lehtë pasi mungojnë mekanizmat mbrojtës në tregun e punës (zbatimi i kodit të punës dhe negocimi nëpërmjet sindikatave).

Ndërsa kur flasim për administratën publike, vëmë re se Shqipëria gjatë 50-60 viteve të fundit është karakterizuar nga ajo që quhet politikë e klaneve.⁷ Gjatë procesit të zhvillimit dhe në kuadrin e reformave të shumta të partive të ndryshme, është ndërruar dhe personeli i një pjese të konsiderueshme të stafit të administratës publike duke pasur si bazë nepotizmin (dhe forma të ndryshme korrupsioni) dhe jo përzgjedhjen në bazë të meritave. Teksa janë shpenzuar shuma të konsiderueshme parash nga qeveritë dhe donatorë të huaj për trajnime të ndryshme, rezultatet nuk kanë reflektuar dhe nuk justifikojnë këto përpjekje për përmirësimin e kapitalit njerëzor. Pasojat në terma afatgjatë reflektojnë tek popullata pasi mungesa e institucioneve efikase përbën humbje në investimet e bëra tek kapitali njerëzor. Në periudhën afatgjatë masat e përshtatshme të sasisë së krahut të punës të disponueshme duhet të reflektojnë cilësinë e punës së kryer dhe orët e shpenzuara në punë. Këto janë shumë të rëndësishme dhe varen nga vendimet që merren në nivelin mikro (individi, familja) si dhe në nivelin makro (sektori, industria).

Infrastruktura, si ajo e arsimit publik në zonat urbane, shërbimet shëndetësore, por dhe aksesit ndaj ambientit natyror (tokat e punueshme, pyjet, zonat e peshkimit) ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies të popullatës dhe përbën një investim në rritjen e kapaciteteve të kapitalit njerëzor. Infrastruktura është një nga elementët kryesorë si kur flasim për rritjen e shpejtë ekonomike dhe për zhvillimin afatgjatë dhe ky artikull është bazuar në supozimin e mirëfilltë se pa një infrastrukturë të zhvilluar, nuk mund të flitet për politika zhvillimi. Problemet dhe ndikimi i infrastrukturës janë aq të shumtë dhe kompleksë, sa janë dhe thelbësorë. Por trajtimi i plotë i tyre do të përbente një studim më vete.

Politikat e përfshirjes sociale, sistemi shëndetësor, migrimi i brendshëm dhe i jashtëm

Pjesëmarrja në sferën publike përbën shtyllën kryesore të ndërtimit të një sistemi demokratik, që perceptohet si forma më e mirë e mundshme e organizimit social. Por pjesëmarrja e individëve në sferën publike shihet si një tregues i fuqizimit të individëve në sferën private. Ky i fundit është i lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e jetesës, sistemit arsimor dhe të drejtave që gëzojnë individët lidhur me punësimin, aksesin ndaj sistemit ligjor, të drejtat e pronësisë, etj. Mungesa e përfshirjes sociale mund të jetë aktive ose pasive në varësi të elementëve të përmendur më sipër⁸ (Amartya Sen në Rogers, Jalal, dhe Boyd, 2006: 246-7). Pra siç mund të shihet, organizimi shoqëror në sferën sociale dhe politike është i lidhur drejtpërdrejt me të gjithë elementët që përbëjnë kapitalin njerëzor. Cilësia e tij ndikon në formën dhe mënyrat se si organizohen individët dhe në ndërtimin e demokracisë dhe një sistemi egalitar.

Në Shqipëri janë hartuar disa strategji dhe plane veprimi⁹ për të eliminuar diskriminimin social të grupeve të caktuara të shoqërisë me qëllimin e përfshirjes së tyre në jetën ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Nëse do të kishin një buxhet të bashkangjitur dhe mekanizma zbatues, këto strategji dhe plane veprimi do të kishin qenë shumë funksionale në eliminimin e disa prej problemeve kryesore që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare pasi synimi i tyre është të përmirësojnë cilësinë e jetesës dhe të kapitalit njerëzor në vend. Por, pas shumë vitesh punë, strategjitë janë mbledhur në një të vetme (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim) e cila u finalizua më në fund një vit më parë dhe që ende pritet të vihen në zbatim elementët përbërës të saj (mbi 30 strategji përbërëse, disa prej të cilave ndërsektoriale).

Një nga problemet më emergjente që lidhen drejtpërdrejt me kapitalin njerëzor është dhe sistemi shëndetësor. Në ndryshim nga vendet e tjera të rajonit dhe ato Europiane, Shqipëria ka një popullatë mjaft të re dhe shkalla e lindjeve mbetet akoma pozitive, pavarësisht nga uljet që ka pësuar gjatë periudhës së tranzicionit (Femra dhe Meshkuj, 2006). Gjatë kësaj periudhe nuk është ndërmarrë ndonjë politikë e veçantë për të ndikuar në ritmin e nivelit të lindjeve apo numrin e fëmijëve brenda familjeve shqiptare, me fjalë të tjera masa konkrete për planifikimin familjar (duke hequr

mënjë ligjin për të drejtat riprodhuese por mungesën e mekanizmave zbatues të tij). Disa nga faktorët kryesorë në vendet në zhvillim e sipër dhe ata pak të zhvilluar është mungesa e higjienës dhe shërbimeve shëndetësore cilësore të cilët çojnë në rritjen e vdekjes foshnjore sikurse dhe asaj amësore.

Sistemi shëndetësor përbën një nga institucionet bazë të investimit në kapitalin njerëzor dhe si rrjedhojë mungesa në investimin e tij apo keqmenaxhimi i fondeve përbën një mangësi të politikave të zhvillimit gjatë periudhës së tranzicionit. Në vendet në zhvillim gjithashtu shërbimet shëndetësore janë të disponueshme për njerëzit që kontribuojnë në skemat publike të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këtu hyn shërbimi shëndetësor i plotë, sigurimi për jetën, mbrojtja ndaj humbjes së menjëhershme të punës, dëmtim shëndetësor dhe kufizim për punësim, etj.

Meqë në Shqipëri një pjesë e mirë e shërbimeve shëndetësore janë të administruara nga shteti, sistemi i kontributit në skemën e sigurimeve shëndetësore është i vlefshëm vetëm në rastin kur individ i është i punësuar me kontratë të rregullt dhe sigurimet derdhen në mënyrë elektronike nga bankat në llogarinë përkatëse. Në këto raste, pavarësisht se individ derdh sistematikisht kontributin e tij/saj në sistem, përfitimet e lidhura me shërbimet shëndetësore janë tepër modeste përkundrejt shumës së derdhur. Përveç kësaj nuk merren në konsideratë, shumat e parave që paguhën për kryerjen e analizave, shtrimin në spital dhe ryshfetet e shumta në pjesën më të madhe rasteve, për të përfituar një shërbim që në vendet e tjera të botës ku shërbimet shëndetësore janë shtetërore është shumë herë më cilësore dhe të aksesueshëm (Harding, 2005). Megjithatë pjesa më e madhe e shërbimeve janë shtetërore, në Shqipëri gjatë këtyre viteve janë hapur spitale dhe klinika private, të cilat ofrojnë shërbime relativisht më cilësore sesa spitalet dhe klinikat shtetërore, por kundrejt një shume më të madhe në lekë pa pasur asnjë skemë për derdhjen e kontributeve dhe sigurimesh shëndetësore të përhapur në nivel kombëtar. Mungesa e një sistemi shëndetësor cilësor dhe të aksesueshëm lehtësisht, ndikon negativisht tek mirëqenia e individit sikurse dhe në kontributin e tij ekonomik (punësimin), politik (pjesëmarrja) dhe social (përfshirja në komunitet).

Një nga përbërësit e tjerë të rëndësishëm është dhe migrimi.¹⁰ Që në fillim të viteve 90, Shqipëria ka përjetuar valë drastike migrimi, qofshin këto brenda apo jashtë vendit. Ikja e trurit (klasa intelektuale), trafikimi i qenieve njerëzore, krimi i organizuar dhe lëvizjet ilegale të njerëzve për arsye të ndryshme ekonomike në vendet fqinje kane qenë disa nga karakteristikat e këtyre valëve migrimi. Gjithashtu përveç migrimit për punë, ka mjaft studentë shqiptarë të cilët studiojnë jashtë kufijve të vendit sidomos në Itali dhe Greqi.¹¹ Largimi nga vendi i klasës intelektuale përbën një humbje jo vetëm të vendit dhe të investimit të bërë në arsim dhe trajnime të këtyre njerëzve, por dhe në arritjen e potencialit maksimal të tyre. Përafërsisht, rreth 25% të popullatës ka migruar jashtë vendit duke përfshirë këtu mbi 35% të forcës/krahut të punës (Barjaba, 2004). Pra humbja është personale/private sikurse dhe shoqërore.

Një nga problemet kryesore që ka sjellë migrimi i jashtëm në sferën e kapitalit njerëzor ka qenë ikja e “trurit” apo klasës intelektuale. Në periudhën 90-03, rreth 45% e të gjithë profesorëve të universiteteve shqiptare dhe kërkuesve shkencorë janë larguar

nga Shqipëria, si dhe 65% e të shkolluarve jashtë vendit (Ibid). Megjithatë për shkak të popullatës së re mbizotëruese në vend dhe të mundësive të pakta të tregut të punës, mund të themi se kthimi i studentëve në vend do të shkaktonte probleme të mëdha duke rritur numrin e të papunëve. Politikat e ndërmarra për të rikthyer numrin e të diplomuarve jashtë “Programi për Thithjen e Trurit”, ka synuar të punësojë këta të fundit në universitetet apo administratën shqiptare duke tentuar të rrisë cilësinë e këtyre sektorëve. Megjithatë programi është shumë herë më i besueshëm në letër se sa në realitet ku studentët e diplomuar jashtë hasin pengesa të mëdha dhe burokratike për njohjen e diplomave, përballen me mënyrat e dyshimta të punësimit dhe me rrogat tepër të ulëta të sektorit publik.

Pavarësisht se valët e migrimit të jashtëm janë reduktuar, individët (sidomos shtresa e varfër) tentojnë në mënyrë të vazhdueshme të largohen nga vendi. Kjo situatë vazhdon dhe do të vazhdojë nëse asnjë politikë sociale nuk merr përsipër për të parandaluar këtë fenomen i cili shkakton pasoja negative jo vetëm për vendin në tërësi por dhe për emigrantët jashtë vendit shumica e të cilëve nuk punojnë në fushat e ekspertizës duke çuar dëm kështu investimin e bërë në kapitalin njerëzor (rreth 74% në Greqi, 67% Itali, 58% Austri, 70% USA, të emigrantëve nuk punojnë në fushat e tyre të ekspertizës). Migrimi ka qenë një nga mënyrat e mbijetesës jo vetëm për shqiptarët të cilët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë jashtë vendit por dhe për ata brenda kufijve.¹²

Migrimi i brendshëm ka ndikuar gjithashtu në cilësinë e kapitalit njerëzor. Ndryshimet në stilin e jetesës, braktisja e zonave rurale dhe mbipopullimi i qyteteve ka çuar drejt uljes së nivelit të punësimit dhe të ardhurave ekonomike, rritjen e nivelit të stresit për shkak të mbipopullimit të zonave të banuara në qytete, mungesën e shkollimit të fëmijëve, uljen e cilësisë së mësimdhënies për shkak të mbipopullimit të shkollave, etj.

Si përfundim, kapitali njerëzor mbetet një nga fushat kryesore të investimit gjatë procesit të zhvillimit. Cilësia e këtij të fundit mundëson që të gjitha burimet e tjera të disponueshme brenda një vendi të përdoren në mënyrën më efikase të mundshme. Në Shqipëri ky burim, gjatë periudhës së tranzicionit ka pësuar ndryshime të mëdha, të cilat nuk mund të etiketohen domosdoshmërisht si pozitive. Rënia e cilësisë së sistemit arsimor, mungesa e përshtatjes në tregun e punës, migrimi i jashtëm dhe i brendshëm, mungesa e një sistemi cilësor shëndetësor, etj., kanë ndikuar në uljen e cilësisë të kapitalit njerëzor. Një gjë e tillë nuk mund të shërbejë si një bazë e shëndoshë për një zhvillim të mirëfilltë ekonomik, politik dhe shoqëror në terma afatgjatë. Edhe pse përfitimet ekonomike, politike dhe sociale nuk janë të përllogaritur paraprakisht në terma monetarë, ato janë të varur në përqindjen e investimit në kapitalin njerëzor që mund t'i ofrohet individit nëpërmjet shërbimeve publike apo mundësive të ofruara në sektorin privat. Shumëllojshmëria e investimit në kapitalin njerëzor shihet qartë si një burim fleksibël dhe i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik si të tërë. Për më tepër, cilësia e jetesës dhe maksimizimi i aftësive dhe përfitimeve ekonomike të individit ndikon në mënyrën e organizimit të shoqërisë dhe pjesëmarrjen e individëve në jetën publike, karakteristike të një procesi zhvillimi demokratik, të balancuar dhe të qëndrueshëm.

SHËNIME:

Ky term gjendet në literaturë dhe si 'kapitali social.'

Në disa nga vendet e zhvilluara pensionet dhe sigurimet shëndetësore gjatë moshës së vjetër paguhen nga vetë njerëzit të cilët kanë kontribuar në fondet e sigurimit social (pensioneve) duke shtuar dhe kursimet personale. Në Shqipëri vlen për t'u theksuar fakti se rrogat e ulëta në sektorin formal nuk janë motivues/nxitës të mirë për t'u punësuar dhe paguar kontributet. Si rrjedhojë, është e vështirë për shtetin të mbulojë sistemin e pensioneve dhe sigurimit shëndetësor duke u varur nga kontributet e pakta të paguara nga njerëzit. Për më tepër, sistemi bankar stimulues ndaj kursimeve personale është akoma në hapat e tij të para.

Ekzistojnë probleme me krahasueshmërinë e të dhënave shqiptare dhe atyre të huaja pasi raporti i Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara e rendit Shqipërinë si një nga vendet me përqindjen më të lartë të alfabetizimit (98.7%) dhe indeks të zhvillimit të kapitalit njerëzor (0.801) (Human Development Report, 2007: 245).

Argumenti që mbështet teorinë se privatizimi (hyrja në treg i kompanive private që ofrojnë shërbime të cilat ofrohen dhe nga sektori shtetëror) përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga sektori shtetëror, nënkupton se me ndërhyrjen e sektorit privat në treg, një pjesë e mirë e individëve i referohen këtij të fundit pasi cilësia do të jetë më e lartë. Si rrjedhojë, sektori shtetëror zotëron po të njëjtat fonde në dispozicion, por një numër më të vogël njësisish shërbimi që duhet të menaxhohë duke supozuar kësioj, një efikasitet më të lartë.

$$y_{growth_i} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln\left(\frac{I}{Y}\right)_i + \alpha_2 \ln(sec_i) + \alpha_3 \ln(n_i + g + \delta) + \alpha_4 \ln(y_{0,i}) + \varepsilon_i$$

y = rritja e vërtetë e GDP për kapita ndërmjet 1980-2000, y_0 = GDP fillestare në vitin 1980, I/Y dhe n janë mesatarja e investimeve dhe përqindja e rritjes së popullatës për të njëjtën periudhë, sec është mesatarja e shkallës së frekuentimit të nivelit sekondar shkollor për 1980 - 96 dhe $g + \delta$ janë shkallët e zhvillimit teknologjik dhe amortizimi është marrë i njëjtë për të gjitha vendet (0.05)

Tregu i punës në shumë vende në zhvillim e sipër tregon karakteristika të dyfishta ndërmjet sektorit kapitalist (ku punëtorët punojnë për të marrë rrogat dhe për të maksimizuar fitimin) dhe sektorit jo-kapitalist (puna e dorës, tregtia e vogël) që shpesh merr format e sektorit informal apo është një shkrirje midis modelit të centralizuar dhe ekonomisë së tregut (Europa Lindore). Një nga karakteristikat kryesore në këto vende është ndryshimi drastik që vihet re ndërmjet zonave rurale dhe urbane, këto të fundit më shumë të zhvilluara dhe ku vihet re migrimi nga zonat rurale. Pra vihet re një përqendrim i zhvillimit ekonomik në disa qytete ndërsa pjesa tjetër e vendit regreson. Kur vihet re një rritje të industrisë së një vendi, sektori bujqësor ku gjendet një segment i mirë i krahut të punës, migron nëpër qytete dhe mbulon kërkesën për punë që mund të jetë e disponueshme. Vihet re (sikurse në vendin tonë) një mbipopullim i qyteteve me njerëz të disponueshëm për punë por shumë pak kërkesë për forcën punëtore. Një gjë e tillë çon në krijimin e një ekonomie të dytë, informale, firma dhe biznese të cilat nuk paguajnë taksa dhe u vidhen rregullave ligjore. Migrimi i kapitalit njerëzor të sektorit bujqësor ndikon jo vetëm në dëmtimin e këtij sektori, por dhe në atë të vetë kapitalit (krahut të

punës) i cili nuk e gjen dot veten në sektorët e tjerë, teknologjia e të cilëve zakonisht është më e zhvilluar. Si rrjedhojë, individët nuk e arrijnë maksimumin e tyre gjatë jetës.

Kjo politikë varet nga preferencat e partisë apo liderit partiak dhe cilën zonë gjeografike apo cilin grup të interesit favorizon ai. Gjatë kohës së sistemit komunist, u favorizua më shumë zona jugore e Shqipërisë, gjë që bëri që kjo zonë gjeografike të ishte më e zhvilluar nga ana ekonomike dhe sociale. Zonat veriore të Shqipërisë vuajtën më shumë pasi u ndërtuan pak rrugë, shkolla, më pak mundësi punësimi dhe si rrjedhojë më pak zhvillim. Izolimi u ndie më shumë këtu. Gjatë periudhës 1992-97 iu dha më shumë përparësi “hapjes” së zonave veriore ndaj mundësive të reja të periudhës së tranzicionit. Nepotizmi, si praktikë ka ekzistuar dhe është përforcuar në periudhën e komunizmit në Shqipëri, periudhë në të cilën kapitali njerëzor pësoi humbje të rënda pasi ishte një sistem që nuk mbështeste konkurrencën dhe zhvillimin e njerëzve. Përkundrazi, të gjithë e kishin të garantuar një vend pune dhe shpesh mbeteshin në të për tërë jetën. Ngurtësimi i aftësive të individëve bëri që gjatë periudhës së tranzicionit shumë njerëz të mbeteshin të papunë dhe për arsyen se nuk kishin kualifikimet apo fleksibilitetin e duhur t’i përshtateshin një ekonomike jo të decentralizuar.

Mungesa aktive e përfshirjes sociale duke iu referuar Amartya Sen, është diçka që lidhet me ligjin ose shpalljet publike të cilat nuk lejojnë një grup njerëzish për arsye të ndryshme të marrin pjesë në procesin e politikë bërjes. Mungesa pasive e përfshirjes sociale përkufizohet si rrjedhojë e proceseve sociale (jo ligjore) siç mund të jetë varfëria dhe izolimi.

Këtu mund të përmendim strategjinë për përmirësimin e jetesës së komunitetit Rom, strategjinë e përfshirjes sociale, strategjinë për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje, strategjinë e shërbimeve sociale, strategjinë e arsimit, shëndetësisë, punësimit, e kështu me radhë.

Faktorët kryesorë mbeten papunësia, varfëria, mungesa e mundësive për një jetë më cilësore, dhe mungesa e përkrahjes sociale. Duke u bazuar në raportin e bërë nga Bankës Botërore në vitin 2002, rreth 25% e popullatës shqiptare jetonte me më pak se 1 dollar në ditë (nën kufirin e varfërisë) ndërsa në vitin 2005, kjo përqindje u reduktua duke prekur 18.5% (2007: 5). Në 2003, Ligji për migrimin e forcës punëtore tentoi të rregullonte valët e migrimit jashtë vendit duke thjeshtësuar punësimin sezonal. Gjithashtu marrëveshje u nënshkruan me vende të Europës Perëndimore si Gjermania për trajnimin dhe kualifikimin e të rinjve shqiptarë, program i cili u braktis pasi një pjesë e mirë e pjesëmarrësve në këto trajnime nuk u kthyen më në Shqipëri. Politika të reja janë ndërmarrë gjithashtu në kuadrin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për lëvizjen e lirë të njerëzve. Megjithatë, politikat Europiane mbi emigrantët shqiptarë deri më sot, kanë qenë ato të ndalimit, kontrollit dhe reduktimit të valëve të migrimit legal, gjë që ka shtytur hapjen e kanaleve ilegale të migrimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore (Për më shumë informacion mbi valët e migrimit në Shqipëri shih: Kosta, Barjaba. “*Albania: Looking Beyond Borders*” <http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?ID=239>).

Ibid.

Sipas Bankës së Shqipërisë, kursimet e sjella në Shqipëri përbëjnë rreth 12-15% të produktit të brendshëm bruto të vendit.

Bibliografia

- Banka e Shqipërisë. 2007. *Buletini i Bilancit të Pagesave*. Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit.
- Banka Botërore. 2004. *Shqipëria: Ruajtja e Rritjes së Qëndrueshme dhe përtej Tranzicionit*. Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë, Njësia e Uljes së Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik – Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore.
- Berryman, S. E. 2000. *Albania's Education Sectors: Problems and Promises*. Human Development Sector Unit of Europe and Central Asia Region, World Bank.
- Gërxxhani, K. Schram, A. 2000. *Albanian Political-Economics: Consequences of a Klan Culture*. Journal for Institutional Innovation, Development and Transition, volume 4.
- Harding, L. 2005. *G2: The politics of childbirth: Europe's poor relation? How they do it abroad: Germany*, The Guardian.
- INSTAT. 2004. *Dimensionet jo-monetare të varfërisë në Shqipëri*, Tiranë.
- INSTAT. 2002 & 2005. *Një profil i varfërisë dhe standardeve të jetesës në Shqipëri*, Tiranë.
- INSTAT. 2004. *Parashikimet për popullsinë e Shqipërisë 2001-2021*. Tiranë, Ilar.
- INSTAT. 2004. *Vjetari i treguesve socialë*, Tiranë, Morava.
- INSTAT. 2006. *Femra dhe Meshkuj*, Tiranë, Ilar.
- INSTAT. 2006. *Tregu i Punës*, Tiranë, Ilar.
- INSTAT. 2006. *Vjetari i treguesve socialë*, Tiranë, Ilar.
- Kerr C., Staudohar P.D. 1994. *Labour Economics and Industrial Relations*. Harvard University Press.
- Khan, F. 2004. *Albania: Growth during Transition and Growth Prospects*. World Bank's Country's Economic Memorandum for Albania.
- Linden, T. Arnhold, N. Vasiliev, K. 2008. *Nga copëzimi në bashkëpunim; arsimi i lartë, kërkimi dhe zhvillimi në Europën Jug-lindore*. World Bank Working Paper Series, nr. 13.
- Lourdes, B. 2003. *Gender, Development, and Globalization*. New York & London: Routledge.
- Ministria e Financave. 2008. *Udhëzimi Plotësues për Përgatitjen e Buxhetit*. Nr. 11/1, dt. 10.07.2008.
- Palomba, G. Vodopivec, M. 2000. *Financing, Efficiency, and Equity in Albanian Education*, World Bank.
- Picard, N. and Francois. C. W. 2004. *Measuring Educational Inequalities: Evidence from Albania*. Universite de Nantes, France.
- Piracha, M. De Coulon, A. 2002. *Self-Selection and the Performance of Return Migrants: The Case of Albania*. UK Economic and Social Research Council, JEL F22, J61.
- Ray D. 1998. *Development Economics*, Princeton N.J.: Princeton University Press.
- Rogers, P. Jalal, K. Boyd, J. 2006. *An Introduction to Sustainable Development*. Canada: The Continuing Education Division, Harvard University and Glen Educational Foundation.
- Sadiraj, K. 1999. *Albania: Transition to a Market Economy*. University of Amsterdam, Thesis Publisher, Netherlands.
- United Nations Development Program and INSTAT. 2003. *Human Development Indicators*. Oxford University Press.
- United Nations Development Program. 2007. *Human Development Reports 2007/2008*. New York: Palgrave Macmillian.
- World Bank. 2006. *Albania's Social Insurance Review*. Human Development Sector Unit. Report nr. 37594-AL.
- World Bank. 2008. *World Bank Development Indicators*.
- World Bank. 2007. *Albania, Urban Growth, Migration, and Poverty Reduction*. Poverty Reduction and Economic Management Unit. Paper nr. 40071-AL.

Kosta, B. 2004. *Albania: Looking Beyond Borders*. <http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?ID=239> [parë për herë të fundit më 2 tetor 2008].

Ministria e Arsimit. 2008. *Financimi*. [<http://www.mash.gov.al/financimi/ekonomia.html>] parë për herë të fundit më 10 tetor 2008.

Shtojcë

Tabela 1- Pritshmëria arsimore sipas vendit

Shqipëria	9.5
Mesatarja e WEI	13.0
OECD	16.9
Republika Çeke	16.0
Hungaria	16.4
Polonia	16.7
Republika Sllovake	14.9
Federata Ruse	14.6

Burimi: Shqipëria: LSMS-ja e vitit 2002; vendet e WEI-t: OECD, 2002b, Aneksi A4, tabela 20, f.192; vendet e OECD-së: OECD, 2003a, Tabela C1.1, f.257. Shënim: Vitet e pritshme të arsimimit llogariten duke përfshirur fëmijët nën pesë vjeç. Nuk është e qartë nëse në përllogaritjet për vitet e pritshme të arsimimit, OECD-ja përfshiu frekuentimin e fëmijëve pesë vjeçarë dhe më të mëdhenj vetëm nëse ata ishin në shkollë fillore apo në çfarëdolloj shkolle (parashkollore apo tetëvjeçare).

Tabela 2 – Rritja ekonomike e përllogaritur bazuar në nivelin aktual të arsimit dytësor në Shqipëri dhe vende të tjera.

	Real GDP per capita (PPP-based \$) 2000	Gross Domestic Investment (% of GDP)	Population Growth Rate	Secondary School Enrollment Rate	Predicted Long Run per capita Growth Rate	Standard Error of Predicted Growth Rate
Albania	3,350	18.3	0.85	45.1	2.16	0.33
Armenia	2,791	18.5	0.16	42.7	3.30	0.51
Azerbaijan	2,793	22.7	0.83	35.6	2.88	0.29
Bulgaria	5,785	18.9	-1.00	76.2	4.90	0.74
Belarus	8,408	23.8	-0.35	70.9	4.01	0.41
Czech Republic	13,673	29.2	-0.24	81.1	4.04	0.40
Estonia	9,588	26.7	-0.43	78.0	4.43	0.43
Croatia	8,524	23.1	0.02	80.1	3.43	0.32
Hungary	10,444	29.0	0.32	101.8	3.65	0.28
Kazakhstan	7,394	20.5	-1.09	55.4	4.81	0.69
Kyrgyz Republic	3,014	18.1	0.94	40.8	2.07	0.33
Lithuania	7,242	21.6	-0.52	63.2	4.08	0.49
Latvia	7,648	27.3	-0.78	73.8	5.29	0.55
Moldova	2,082	22.3	-0.26	38.0	4.74	0.62
Macedonia, FYR	5,135	19.3	0.62	67.3	2.45	0.32
Poland	9,229	24.7	-0.03	95.8	3.76	0.32
Romania	4,287	19.2	-0.15	71.9	3.81	0.54
Russia	8,013	17.8	-0.51	70.0	3.43	0.52
Slovak Republic	11,417	28.8	0.08	84.0	3.73	0.33
Slovenia	15,756	28.1	0.11	96.6	3.37	0.32
Tajikistan	1,321	14.5	0.83	29.0	2.15	0.63
Ukraine	4,624	19.4	-0.80	59.3	4.68	0.69
Average	6,933	22.3	-0.06	66.2	3.69	0.46

Note. Investment, population growth, and secondary school enrollment rates are averages for 1999-2001.

Burimi në Anglisht: Khan, F. 2004. *Albania: Growth during Transition and Growth Prospects*. World Bank's Country's Economic Memorandum for Albania.

Politikat e zhvillimit të zonave rurale dhe të defavorizuara – nevoja për konceptime bashkëkohore

Doktorant Shkelzen Marku

Dr Tomi Treska


ABSTRAKT. Shqipëria ka një popullsi prej 3.13 milion banorësh, nga të cilët, rreth 54% jetojnë në zonat rurale. Zhvillimi i ekonomisë Shqiptare ka pasur një ecuri relativisht të mirë gjatë këtyre viteve të fundit, me një rritje prej 5–7% në vit. Ndër faktorët kryesorë që kanë çuar në arritjen dhe mbajtjen e këtij niveli relativisht të lartë rritjeje, janë reformat në privatizim, liberalizimi i tregtisë, një disiplinë e lartë fiskale, një forcë pune relativisht e arsimuar dhe e aftë për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tregu, si dhe zhvillimi i shpejtë i një sektori financiar të qëndrueshëm. Zonat rurale zënë mbi 2/3 e territorit të vendit, ndërsa zonat e defavorizuara (edhe pse nuk ka akoma një përcaktim zyrtar të këtyre zonave), vlerësohet se zënë rreth 65% të sipërfaqes së vendit. Në këto zona jetojnë rreth 1/3 e popullsisë dhe gjendet rreth 50% e sipërfaqes bujqësore (krahasuar me rreth 56% të totalit të tokës bujqësore në vendet e BE). Bazuar në rezultatet e politikave të deritanishme, del e domosdoshme futja e përqasjeve të reja zhvillimore për këto zona, të cilat të mund të ofrojnë zgjidhje më efektive, me efekte më të shpejta balancuese dhe integruese. Sfidat me të cilat përballen këto zona kërkojnë metoda më “holistike” e të integruara për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar socio-ekonomik, të bazuara dhe në eksperiencën e përqasjeve të adoptuara nga shume prej vendeve të BE-së, mbështetur në konceptin bashkëkohor të zhvillimit territorial.

Problematika të zhvillimit socio-ekonomik në zonat rurale dhe ato të defavorizuara

Edhe pse niveli i varfërisë në vend gjatë viteve 2002–2005 ka pësuar rënie dhe niveli i diferencimit mes zonave të ndryshme të vendit është reduktuar, Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfra të Europës jug-lindore. Niveli i varfërisë mbetet mjaft i lartë në zonat e defavorizuara rurale dhe veçanërisht në ato malore. Në vitin 2005 niveli i varfërisë në zonat rurale malore ishte rreth 14% më i


lartë se në zonat e tjera të vendit (pavarësisht rënies së ndjeshme nga 67% më i lartë që ishte vitin 2002) (INSTAT, 2006). Gjithashtu, niveli i papunësisë dhe i koeficientit **Gini** (pabarazisë) rezulton të jetë më i lartë në zonat rurale malore, sidomos ato veriore dhe veri-lindore.

Figura 1. Ecuria e nivelit të varfërisë gjatë periudhës 2002-2005



Burimi: INSTAT dhe Banka Botërore. 2006

Figura 2. Niveli i papunësisë sipas zonave




Burimi: Ministria e Punës, 2007

Si rezultat i kombinimit të kushteve agro-ekologjike, nivelit të izolimit, sipërfaqeve të kufizuara të tokës, pjerrësisë dhe cilësisë së tokës, kufizimeve infrastrukturore, mungesës së kapitaleve dhe shërbimeve, etj., këto zona kanë një nivel shumë më të ulët produktiviteti të faktorëve të prodhimit krahasuar me zonat e tjera. Kjo sidomos, në sektorin bujqësor, edhe pse është sektori më i rëndësishëm. Përveç madhësisë së kufizuar të fermave dhe fragmentimit të pronësisë, ndër faktorët më të rëndësishëm që pengojnë rritjen e produktivitetit të bujqësisë përmenden: niveli i ulët i teknologjive të prodhimit (përfshirë ujitjen, mekanizimin, etj); praktikatat e pas-vjeljes; aksesit në treg; mungesa e kreditimit dhe e shërbimeve financiare rurale; cilësia e dobët dhe çmimet e larta të inputeve; mungesa e shërbimeve mbështetëse dhe të lidhjeve të përshtatshme

me shërbimet e specializuara këshillimore; infrastruktura e dobët dhe vështirësitë e transportit; niveli i ulët i kooperimit, etj.

Figura 3. Indeksi i varfërisë sipas komunave



Burimi. CIESIN. 2007

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Megjithatë, shumica e tyre janë të lokalizuara në zonat urbane dhe në zonat me më shumë potenciale ekonomike, ndërsa numri i tyre në zonat rurale (dhe sidomos në zonat malore dhe në ato të defavorizuara) mbetet akoma shumë i vogël.

Zhvillimi i infrastrukturës rurale (përfshirë rrugë, ujë, ujësjellës dhe kanalizime) përbën një prioritet të rëndësishëm të politikave zhvillimore të viteve të fundit. Megjithatë, niveli i cilësisë dhe aksesit në infrastrukturë, në përgjithësi mbetet akoma në nivele të dëshirueshme, sidomos në zonat e thella malore dhe në zonat e defavorizuara, ku rreth 60% e rrugëve janë akoma në gjendje shumë të dobët. Furnizimi me energji elektrike përbën gjithashtu një problem për mjaft familje dhe sidomos për bizneset në zonat rurale, të cilat konsumojnë mesatarisht vetëm gjysmën e nivelit të konsumit mesatar për banor në nivel vendi.

Edukimi dhe shërbimet shëndetësore përbëjnë gjithashtu një vështirësi të konsiderueshme me të cilën përballen familjet rurale. Me gjithë reformat dhe politikat publike në favor të këtyre sektorëve, në zonat e thella rurale dhe në ato malore, cilësia e arsimit dhe shërbimeve shëndetësore nuk po shikon akoma përmirësime të

ndjeshme. Përveç nevojës për rritjen e investimeve, një problem shumë i rëndësishëm dhe që kërkon zgjidhje (të paktën në afat-mesëm) është garantimi i stafëve pedagogjike dhe personelit të kualifikuar mjekësor në zonat e thella rurale dhe ato malore.

Sektori financiar në Shqipëri, gjatë këtyre viteve të fundit, është zhvilluar me ritme të shpejta. Megjithatë, niveli i shërbimeve financiare dhe kryesisht i kreditimit për biznesin (sidomos atë agro-ushqimor) në zonat rurale mbetet akoma shumë i ulët. Duke qenë se niveli i fitimit të bizneseve rurale është dukshëm më i ulët se në zonat urbane, futja e teknologjive të përparuara dhe rritja e nivelit të aseteve prodhuese kërkon financime nga jashtë bizneseve rurale. Edhe pse në këto zona ka një kërkesë të konsiderueshme për kreditim, mungesa e kolateralit dhe institucioneve garantuese të kredive vështirëson aksesin e familjeve dhe bizneseve rurale në këto shërbime.

Sidoqoftë, këto zona nuk janë të pashpresa dhe pavarësisht vështirësive dhe nivelit aktual të zhvillimit, ato kanë resurse dhe potenciale specifike, të cilat, nëse futen në efikasitet dhe shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme, mund të përshpejtojnë ritmet e zhvillimit dhe të ndikojnë ndjeshëm në reduktimin më të shpejtë të nivelit të varfërisë dhe pabarazisë. Ndër këto potenciale përmenden produktet agro-ushqimore tradicionale, turizmi, artizanati, pyjet, minierat, burimet ujore, etj.

Vendi i zonave të defavorizuara dhe zonave malore në politikën e zhvillimit në Shqipëri

Duke qenë se janë zona me problematika zhvillimi specifike, ashtu siç ndodh dhe në vendet e tjera perëndimore (dhe kryesisht në vendet e BE), edhe në Shqipëri zhvillimi i këtyre zonave kërkon politikë dhe përqasje specifike. Për të kuptuar më mirë politikën e zbatuar në Shqipëri, në Boks 1, si më poshtë, paraqitet një përshkrim i shkurtër i koncepteve “ruralitet”, “zona rurale”, “zona të defavorizuara” dhe “zona malore”, siç përcaktohen dhe praktikohen ato në vendet e BE.

Gjatë këtyre viteve të tranzicionit, në Shqipëri janë hartuar një numër i madh dokumentesh strategjike. Edhe pse akoma nuk ka një strategji të veçantë të zhvillimit të zonave të defavorizuara dhe atyre malore, shumë aspekte të zhvillimit të këtyre zonave janë përmendur në strategji të ndryshme sektoriale (Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit, e Turizmit, e Transportit, e Shëndetësisë, e Arsimit, etj.) dhe strategji ndër-sektoriale (Strategjia e Zhvillimit Rural, Strategjia e Zhvillimit Rajonal, Strategjia e Mjedisit) të cilat janë të inkuadruara në dokumentet strategjike kombëtare, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe në Programin Buxhetor Afat-mesëm. Shumica e këtyre dokumenteve strategjike, sidomos gjatë viteve të para të tranzicionit, janë fokusuar kryesisht në politikë dhe masa që kanë të bëjnë me reformat e nevojshme strukturore, reduktimin e varfërisë dhe rritjen e sasisë së prodhimit (me fokus sigurimin e ushqimit). Çështjet e mirëfillta të zhvillimit rural dhe të zonave të defavorizuara (në konceptet e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm rural) kanë filluar të përfshihen vetëm pas vitit 2000.

Boksi 1. Përcaktimi i ruralitetit, zonave rurale, të defavorizuara dhe malore

Për përcaktimin e **zonave rurale** përdoren disa përkufizime, ndër të cilat shumica përfshijnë kryesisht: (i) densitetin e popullsisë; (ii) shkallën e largimit apo kthimit të popullsisë; (iii) madhësinë e territorit të banuar; (iv) strukturën ekonomike dhe; (v) konfigurimin e peizazhit. Skema e OECD dallon 2 nivele hierarkike të ndarjeve gjeografike: (i) nivelin e njësisë së komunitetit/administrimit lokal (LAU1/2) dhe nivelin rajonal (NUTS3). Njësitë e komunitetit lokal klasifikohen si rurale apo urbane, bazuar kryesisht në densitetin e popullsisë. Veçanërisht, kur densiteti i popullsisë është më i vogël se 150 banorë për km² njësia klasifikohet si rurale (OECD, 2006). Për rajonet përdoret përqindja e popullsisë urbane/rurale që jeton në njësitë lokale dhe klasifikohen në tre grupe: (i) *kryesisht rurale*, kur mbi 50% e popullsisë së rajonit jeton në njësitë rurale; (ii) *shumë rurale*, kur 15 - 50% e popullsisë së rajonit jeton në njësitë rurale; (iii) *kryesisht urbane*, kur më pak se 15% e popullsisë së rajonit jeton në njësitë rurale (Benaki, V. et al., 2005).

Zona të defavorizuara konsiderohen zonat me kushte fizike dhe socio-ekonomike në një perspektivë dinamike: zonat që sigurojnë një nivel relativisht të ulët të ardhurash si pasojë kushteve të vështira fizike, mungesës së infrastrukturës, shërbimeve mbështetëse dhe ku si pasojë, sektori privat nuk paraqet interes të mjaftueshëm për të investuar në kushtet apo perspektivën aktuale. (Oskam, A., 2004). Kriteret e përgjithshme për klasifikimin e zonave të defavorizuara dhe atyre malore në vendet e BE janë përcaktuar në Direktivën 75/268 dhe Rregulloren e KE No. 1257/1999. Megjithëse, si pasojë e ndryshimeve të mëdha të kushteve agro-ekologjike mes vendeve dhe rajoneve, nivelet treguese të kriterëve të përdorura nga vende të ndryshme anëtare ndryshojnë shumë nga njëri vend tek tjetri, shumica e vendeve të BE i klasifikojnë zonat e defavorizuara në tre grupe si më poshtë:

- **Zona malore dhe kodrinore**, ku lartësia mbi nivelin e detit dhe pjerrësia ndikojnë ndjeshëm në reduktimin e sezonit të prodhimit dhe përdorimit të mekanizimit në bujqësi. Zonat malore karakterizohen nga sipërfaqe të kufizuara toke dhe kosto të larta të punës, si pasojë e kushteve klimaterike, lartësisë, pjerrësisë së tokës, apo kombinimeve të këtyre faktorëve. Këtu futen zakonisht zonat malore që janë mbi 500m mbi nivelin e detit, ose zonat kodrinore-malore mbi 300m mbi nivelin e detit, me toka që kanë pjerrësi mbi 15% për të paktën 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore.
- **Zona të defavorizuara me handikapë të veçantë** (që përfshijnë zakonisht territore të vogla), siç janë zonat me furnizim të kufizuar me ujë, me përmytje periodike, etj. Zakonisht, zonat me handikapë të veçantë janë zona ku mbajtja e aktivitetit bujqësor konsiderohet si e domosdoshme për të siguruar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, si dhe për menaxhimin e territorit dhe peizazhit për vlerat e tij turistike, etj. (Benaki, V. et al., 2005).
- **Zona të defavorizuara të përgjithshme**, të karakterizuara nga toka me cilësi të dobët, produktivitet të ulët të bujqësisë, nivel të ulët të ardhurash, densitet të ulët të popullsisë, apo tendenca të theksuara depopullimi (CAP 2000). Zonat e defavorizuara të përgjithshme janë zona ku, mbajtja e aktivitetit bujqësor konsiderohet e nevojshme për mirëmbajtjen e territoreve rurale si dhe sigurimin e një niveli minimal densiteti të popullsisë në kushtet ku produktiviteti bujqësor është i ulët. Këtu zakonisht futen zonat me produktivitet ekonomik < 50% i nivelit mesatar të vendit, me densitet popullsie <30 banorë./km² dhe që kanë më shumë se 8% të punësimit në sektorin primar (sidomos në bujqësi).

Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën e mëposhtme, paraqiten elementët kryesorë të politikave të hartuara në Shqipëri gjatë periudhës 1999–2007, të krahasuara këto me elementët kryesor të politikave të ndërmarra në vendet e Bashkimit Europian.

Boksi 2. Krahasimi i elementëve të politikave tona me ato të vendeve të BE-së sipas periudhave

Periudha	Strategjitë	Politikat kryesore në Shqipëri	Politikat kryesore në BE
1990 - 1999	-Reformat e privatizimit në bujqësi dhe asetet prodhuese rurale; -Dokumenti i parë orientues i zhvillimit të bujqësisë, -Njohja e pronësisë dhe lejimi i tregut të tokës bujqësore; -Strategjia e Gjelbër;	-Siguri ushqimore, -Parandalim krize, -Reforma strukturore, -Reduktim varfërie, -Rivënie në prodhim, -Furnizim inputesh, -Nxitje prodhimi, -Shfrytëzimi i pyjeve -Njohuri teknike bazë, -Infrastrukturë bazë,	-Ristrukturim sektorësh, -Rritje produktiviteti, -Përmirësime teknike, -Rritje prodhimi, -Eficenca e faktorëve prodhues, -Siguri ushqimore, -Standarde jetese, -Garantim çmimesh, -Mbrojtje mjedisi, -Shëndetë kafshësh, -Mbrojtje e konsumatorit, -Kualifikim profesional, -Kërkim zhvillim
2000 - 2006	-Strategjia kombëtare e zhvillimit të bujqësisë – horizont 2010 (FAO); -Strategjia e rritjes dhe reduktimit të varfërisë; -Strategjitë e tjera sektoriale; -Objektivat e Mijëvjeçarit; -Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomiko-Social;	-Reduktimi i varfërisë, -Infrastruktura rurale, -Infrastruktura bujqësore (ujtja + tregjet), -Rritja e prodhimit, -Futja e teknikave e teknologjive, -Këshillimi bujqësor, -Infrastruktura bujqësore (marketing), -Mbrojtja e pyjeve, -Shërbimet rurale (shëndeti + edukimi bazë); -Krijimi i zonave të mbrojtura, -Nisma të zhvillimit rural, -Nxitja e kreditimit, -Zonat malore,	-Pagesa për zonat e defavorizuara, -Masa mjedisore, -Dalje e shpejtë në pension, -Ripyllëzim i tokës bujqësore, -Standardet e prodhimit, -Fermat në vetë-mbajtje, -Grupet e prodhuesve, -Fermëritë e rinj, -Përpunimi dhe marketingu, -Kualifikim profesional, -Pylltaria, -Siguria ushqimore, -Zhvillimi i integruar rural, -LEADER+,

2007 – 2013	-Strategjia e Bujqësisë, -Strategji të tjera sektoriale; -Strategjia e Zhvillimit Rural, -Strategjia e Zhvillimit Rajonal, -Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,	-Konkurrueshmëri, -Përmirësim i teknologjive, -Këshillimi bujqësor, -Siguri Ushqimore, -Rritje produktiviteti, -Shfrytëzim oportunitetesh, -Integrim rural/rajonat, -Zona malore dhe të defavorizuara, -Infrastrukturë rurale, -Infrastrukturë bujqësore (marketing, përpunim), -Shërbime rurale (shëndet + edukim bazë); -Nxitje kreditimi, -Fillim i subvencioneve,	-Përmirësim i konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë dhe pyjeve, -Përmirësim i mjedisit dhe zonave rurale, -Përmirësim i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitje e diversifikimit, -Ngritja e kapaciteteve lokale për punësim dhe diversifikim. <i>(41 masa në total të grupuara si më sipër)</i>
--------------------	---	---	--

Që prej vitit 2000, përveç disa programeve të vogla lokale, janë ngritur dy institucione të specializuara për mbështetjen e zhvillimit të zonave malore (respektivisht Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore dhe Fondi i Financimit të Zonave Malore). Megjithatë, me gjithë rezultatet shpresëdhënëse të arritura nga këto dy institucione, si dhe programe të tjera lokale, burimet e vëna në dispozicion të zhvillimit të zonave të defavorizuara dhe atyre malore mbeten akoma të kufizuara krahasuar me nevojat e mëdha të këtyre zonave.

Nevoja për përqasje të reja

Bazuar, si në rezultatet konkrete të këtyre politikave në Shqipëri, ashtu dhe në eksperiencat ndërkombëtare, përqasjet e politikave të zhvillimit rural, zonave të defavorizuara dhe atyre malore nuk kanë arritur akoma rezultate të pritshme në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe reduktimit të diferencave të zhvillimit mes rajoneve të ndryshme të vendit.

Në këtë kuadër, del e domosdoshme futja e përqasjeve të reja zhvillimore për këto zona, të cilat të mund të ofrojnë zgjidhje më efektive, balancuese dhe integruese të faktorëve të ndryshëm socio-ekonomikë, përfshirë ato demografikë, punësimin, aftësitë profesionale, sigurinë njerëzore, mirëqenien, si dhe nxitjen e një roli të ri të shtetit. Përmirësimi i përqasjeve të zhvillimit për këto zona bëhet akoma më i domosdoshëm në kuadër të ndryshimeve të ekonomisë botërore, rritjes së efekteve të globalizimit, rritjes së fuqisë transformuese të teknologjive të reja, zhvillimit të ekonomisë së dijes, dhe rolit të ri të kapitalit dhe burimeve njerëzore (njerëzve, dijeve dhe aftësive profesionale të tyre). Tashmë ka një konsensus të përgjithshëm se sfidat e sotme sociale

dhe ekonomike, me të cilat përballet Shqipëria, janë komplekse dhe të ndërlydhura ngushtë mes tyre. Si të tilla, zgjidha e tyre kërkon metoda më “holistike” e të integruara për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar socio-ekonomik të këtyre zonave.

Pavarësisht se përjashtet, metodat dhe mekanizmat e reja të zhvillimit të balancuar dhe të integruar rural (që tentojnë të rezultojnë në një zhvillim të qëndrueshëm) po adaptohen gradualisht dhe po zbatohen në nivele dhe mënyra të ndryshme nga vende të ndryshme, karakteristikat e tyre kryesore përfshijnë:

- Një fokusim më të madh drejt zhvillimit territorial (me objektiv të veçantë njerëzit që jetojnë në të) dhe harmonizim të politikave sektoriale;
- Një orientim drejt oportuniteteve, drejt pikave të forta dhe avantazheve konkurruese të territoreve rurale;
- Një fokusim drejt investimeve strategjike dhe reduktim të subvencionimit të sektorëve jo-produktivë;
- Përdorim të koordinuar të një numri të madh instrumentesh zhvillimor komplementarë, si pjesë të një pakete të përbashkët mjetesh ndërhyrje, masash dhe mbështetjesh;
- Zhvillim të një modeli të ri dhe të mirë-koordinuar qeverisje, që përfshin nivele të ndryshme të qeverisjes, aktorësh dhe partnerësh; dhe,
- Rritje të ndjeshme të rolit të qeverisjes dhe aktorëve lokalë në planifikimin dhe menaxhimin e proceseve të zhvillimit të territoreve të tyre lokale.

Në këtë kuadër, politikat e reja rurale (të konsideruara ndryshe si “paradigma e re rurale”) po bëhen përditë e më pak “të orientuara në mbrojtje”, më pak të fokusuara në kufizimet, dhe të përqendruara përditë e më shumë në rritjen e oportuniteteve, në shfrytëzimin efikas të burimeve lokale, si dhe rritjen e aftësive konkurruese dhe specificiteteve avantazhuese të territoreve (OECD, 2006).

Planifikimi dhe orientimi i procesit të zhvillimit socio-ekonomik të qëndrueshëm të territorit rural dhe roli i aktorëve lokalë

Qasjet e reja të zhvillimit kërkojnë si domosdoshmëri angazhimin e aktorëve vendorë në planifikimin dhe orientimin e proceseve të zhvillimit, në mënyrë që të sigurohet harmonizimi më i mirë i nevojave, interesave dhe faktorëve të zhvillimit. Tashmë pranohet se suksesi në zhvillimin e një territori varet nga aftësia e komunitetit të tij për të vepruar me efikasitet, në kushtet e ndikimit të faktorëve globalë, kombëtarë dhe lokalë, në favor të zhvillimit të territorit respektiv, përmes forcimit të kapaciteteve ekonomike lokale, përmirësimit të klimës së biznesit dhe investimeve, rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit vendas, përmirësimit të shërbimeve dhe kushteve sociale, etj. Pra, përmirësimi i cilësisë së jetesës së komunitetit varet nga aftësia e aktorëve vendorë për të planifikuar dhe vepruar strategjikisht. Kjo nevojë bëhet më

e domosdoshme në kushtet e vendit tonë, ku komunitetet tona rurale, që vijnë nga një sistem i centralizuar, pa përvojën dhe dijet e mjaftueshme, ndodhen të përfshira në një sistem plotësisht të hapur social dhe ekonomik me ritme ndryshimi shumë të mëdha.

Kjo kërkon rritjen e rolit të aktorëve lokalë në analizën e gjendjes, identifikimin e problemeve dhe oportuniteteve, dhe planifikimin në mënyrë strategjike, koherente dhe konkrete të zhvillimit të territorit përkatës. Ky proces planifikimi dhe Plani Strategjik (si produkt i tij) bën harmonizimin e parimeve bazë, prioriteteve, politikave, masave, metodave dhe mjeteve për maksimalizimin e efikasitetit të shfrytëzimit të burimeve dhe potencialeve dhe minimizimin e efekteve të faktorëve negativë mbi zhvillimin. Planifikimi strategjik është një proces fleksibël pjesëmarrjeje, që në një kuptim më teknik, mban parasysh situatën ekzistuese, misionin dhe parimet bazë nëpërmjet: (i) formimit të një vizioni të qenësishëm por realist; (ii) përcaktimit të objektivave dhe të synimeve të përshtatshme, (iii) përcaktimit të mekanizmave dhe mjeteve të zbatimit; dhe (iv) vlerësimit dhe monitorimit të vazhdueshëm përmes indikatorëve të matshëm. E thënë ndryshe, procesi i planifikimit strategjik ndihmon për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të tilla të rëndësishme si: (i) Cila është situata e sotme (identifikimi dhe analiza e gjendjes, problemeve, potencialeve)? (ii) Ku duam të arrijmë (vizioni, qëllimet, objektivat)? (iii) Si mund ta realizojmë këtë (masat, metodat, mjetet, burimet)? (iv) Si të verifikojmë nëse jemi në rrugë të mbarë për arritjen e objektivave të parashikuara apo jo (monitorimi, vlerësimi, reflektimi, përmirësimi)?

Nëpërmjet këtij procesi dhe këtij dokumenti orientohen dhe konsolidohen interesat dhe përpjekjet e përbashkëta të aktorëve dhe komunitetit lokal për një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm, duke siguruar kështu premiset për përmirësime të ndjeshme të kushteve socio-ekonomike të jetesës së komunitetit që jeton aktualisht mbi këtë territor dhe duke krijuar mundësi për mirëmbajtje dhe rritje të burimeve në dispozicion të brezave që do vijnë. (tek Bertelsmann S, 2004.)

Në mënyrë që të realizohet sa më mirë qëllimi i zhvillimit të balancuar dhe përmirësimit të kushteve socio-ekonomike të jetesës së komunitetit në një territor apo njësi vendore, në themel të procesit të planifikimit strategjik të zhvillimit dhe nëpërmjet tij, synohet të arrihen këto objektiva:

- Të krijohet një praktikë reale dhe e prekshme e një procesi strategjik vendim-marrës që përfshin bashkëpunimin e gjithë aktorëve lokalë, politikë, ekonomikë e socialë që veprojnë brenda një territori apo njësie vendore.
- T'i ofrohet komunitetit dhe qeverisjes vendore një dokument orientues dinamik në përcaktimin e drejtimeve kryesore në dobi të rritjes së balancuar dhe të qëndrueshme socio-ekonomike të komunitetit, dokument i cili është gjithmonë në proces përmirësimi, por jo mohimi, prej të zgjedhurve dhe drejtuesve pasardhës.
- Të krijohet një platformë me hapa të programuara për përmirësimin e jetës socio-ekonomike të komunitetit duke eliminuar apo reduktuar risqet.

- Të krijohen ura bashkëpunimi dhe të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet partnerëve publikë, biznesit dhe komunitetit për një zhvillim të koordinuar dhe harmonizuar.
- Të lehtësohet koordinimi dhe realizimi i politikave, masave dhe ndërhyrjeve zhvillimore të ndërmarra në favor të këtij territori/njësie vendore nga aktorë të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm.
- Të ofrohet një kornizë koherente vendim-marrëse për çështjet dhe detyrimet bazë që ofron njësia vendore ndaj komunitetit nën juridiksionin e saj, të tilla si: shërbimet publike, furnizimi me ujë, largimi i mbeturinave dhe kanalizimet e ujërave të zeza, infrastruktura rrugore, klima joshëse për biznesin, etj.
- Të orientohen dhe ndikohen politikat e financimit të qeverisjes qendrore, rajonale, vendore, si dhe të donatorëve, veçanërisht për projekte zhvillimi në interes të më shumë se një njësie vendore.
- Të mundësohet një qeverisje vendore transparente dhe e besueshme nga komuniteti, efektive dhe që i përgjigjet me përkushtim, profesionalizëm dhe standarde, nevojave dhe kërkesave të banorëve dhe vizitorëve të njësisë që administron.

Me qëllim që procesi i planifikimit strategjik të jetë sa më i plotë dhe produkti i tij të jetë sa më efektiv gjatë fazës së zbatimit, është mirë të kihet parasysh disa nga parimet kryesore që duhet të udhëheqin punën për hartimin e planit strategjik (siç jepen në Boksen 3).

Përveç dhjetë parimeve të mësipërme, në mënyrë që të sigurohemi se sa janë arritur treguesit e qëndrueshmërisë në planin strategjik të zhvillimit, para përfundimit të plotë të procesit të hartimit të tij, mund të bëjmë një vlerësim të shpejtë, bazuar në karakteristikat dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm që jepen në Boksen 4.

Boksi 3. Disa parime kryesore udhëheqëse të planit strategjik të zhvillimit lokal

Një proces i planifikimit strategjik, që të jetë sa më i suksesshëm duhet:

1. Të bazohet në kushtet lokale ekonomike e sociale, duke ndërtuar mbi arritjet dhe avantazhet konkurruese dhe potencialet territoriale ekzistuese, duke sqaruar dhe gjetur zgjidhje për pikat e dobëta dhe duke mundësuar mbrojtjen nga rreziqet/kërcënimet.
2. Të bazohet në vizionin që ndajnë grupet komunitare të interesit dhe mbi partneritetin mes këtyre grupeve të interesit si dhe aktorëve e institucioneve përgjegjëse dhe/apo mbështetëse të zhvillimit.
3. Të ketë një qasje të integruar, duke përfshirë gjithë gamën e sektorëve dhe çështjeve që prekin komunitetin (sociale, ekonomike, ambientale, hapësinore, etj.), si dhe harmonizimin e çështjeve dhe prioriteteve mes sektorëve të ndryshëm, me qëllim maksimizimin e sinergjisë.
4. Të fokusohet në nxitjen e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë lokale, thithjen e investimeve, rritjen e përfshirjes së grupeve të ndryshme komunitare në aktivitetet ekonomike, hapjen e saj dhe ndërtimin e lidhjeve mes ekonomisë/bizneseve lokale me ato rajonale (kryesisht të territoreve rurale dhe urbane rrethuese), përmirësimin e shërbimeve dhe reduktimin e burokracisë.
5. Të nxisë, me kujdes, formalizimin e ekonomisë informale, e cila në disa zona mund të përfaqësojë një pjesë të madhe të ekonomisë lokale dhe shpesh është mjaft e lidhur me ekonominë formale, duke siguruar në këtë mënyrë bazat e të ardhurave dhe ekonomisë, sidomos për popullsinë më të varfër.
6. Të përfshijë prioritete, politika dhe veprime të harmonizuara mirë me strategjitë, politikat dhe veprimet prioritare kombëtare dhe rajonale, si dhe interesat e grupeve komunitare që përfaqëson.
7. Të hartohet në konsultim dhe me kontribut të grupeve komunitare të interesit, si dhe të aktorëve të tjerë publik e privat. Kjo kërkon që, para fillimit të punës, të punohet për ngritjen e kapaciteteve të grupeve komunitare pjesëmarrëse për njohjen prej tyre të metodave dhe përjasjeve që do të përdoren gjatë hartimit të planit.
8. Të konsiderohet pasuri publike dhe t'u shpërndahet (si në fazën draft edhe në atë përfundimtare) të gjithë aktoreve të interesuar dhe kontribuesve të ndryshëm, në mënyrë që secili ta njohë dhe ta përvetësojë mirë planin strategjik, të mund të kontribuojë për përmirësim të mëtejshëm të tij, si dhe më pas të mund të veprojë në harmoni me të.
9. Të përfshijë ndërhyrje të ekuilibruara ndërmjet prioriteteve dhe veprimeve zhvillimore sektoriale dhe infrastrukturore me ato të zhvillimit institucional, çështjeve sociale dhe të ngritjes së kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, si përbërës të domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm.
10. Të parashikojë dhe realizojë harmonizimin e interesave të biznesit me ato të grupeve të tjera të interesit dhe banorëve, të identifikojë dhe parandalojë konfliktet e mundshme mes grupeve të ndryshme të interesit.

(Përshtatur nga Gwen Swinburn www.worldbank.org/ledprimer)

Boksi 4. Karakteristikat dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm

- Plotësimi i nevojave të komunitetit (ushqim, banim, ujë, energji, shërbime sociale të ndryshme, etj.);
- Progresi ekonomik;
- Mbrojtje e bio-diversitetit dhe kushteve të mira ekologjike;
- Barazi dhe drejtësi sociale;
- Pjesëmarrje e grupeve të komunitetit në aktivitetet dhe vendimmarrjen që i prek ata;
- Partneritet ndërmjet qeverisjes, komunitetit dhe sektorit privat;
- Përgjegjshmëri dhe llogaridhënie;
- Përqaasje e çështjeve të zhvillimit në mënyrë sistematike;
- Përkujdesje ndaj brezave të ardhshëm;
- Ndërlidhje mes dimensioneve lokale dhe globale;
- Përdorim i aftësive dhe talenteve lokalë;
- Angazhim për ngritjen e kapaciteteve të komunitetit lokal;
- Prania e procedurave të monitorimit dhe vlerësimit.

(UNDP, 2002)

Është e rëndësishme të theksojmë se, vlera dhe efektiviteti i planit strategjik, përcaktohen jo vetëm nga vlerësimi që i bëhet hartimit të tij, por edhe nga përdorimi i tij në veprimtarinë konkrete të autoriteteve dhe aktorëve të tjerë vendorë. Në të kundërt, ky plan, sado i mirë të jetë, mbetet vetëm një dokument në sirtarët e autoriteteve vendorë. Nuk janë të pakta rastet që, edhe pse është hartuar një Plan Strategjik i mirë, pas afatit kohor të përcaktuar, nuk është arritur zhvillimi i premtuar, dhe kjo jo për faj të Planit, por sepse zhvillimi përsëri i është nënshtruar më shumë spontanitetit sesa planit.

Për këtë është e rëndësishme që, qeverisja lokale dhe aktorët e tjerë të interesit, të kenë kapacitetet për të ngritur një sistem për menaxhimin e zbatimit të planit strategjik. Në mënyrë që plani të ketë më shumë sukses, edhe pse shumë nga aktivitetet financohen nga projekte dhe burime të veçanta, është e rëndësishme që plani strategjik të përfshijë një identifikim dhe planifikim sa më të mirë kostove të masave dhe veprimeve si dhe burimet e mundshme financiare.

Konkluzione

Nga kjo analizë e dokumenteve strategjike dhe politikave të deritanishme, si dhe gjendjes së zhvillimit të zonave rurale dhe atyre të defavorizuara rezulton se:

- Strategjitë dhe politikat e pothuajse dhjetëvjeçarit të parë të tranzicionit ishin të orientuara kryesisht drejt reformave strukturore, reduktimit të varfërisë, furnizimit me inpute, rritjes së prodhimit dhe sigurimit të ushqimit;
- Shumë nga strategjitë dhe politikat e hartuara gjatë këtyre viteve të fundit janë përpjekur të përfshijnë elementë (edhe pse të shkëputur nga njëri-tjetri) të zhvillimit rural dhe zonave të defavorizuara. Megjithatë, pavarësisht

përpjekjeve të pjesshme gjatë këtyre viteve (bazuar deri diku në eksperiencat dhe influencat e BE), koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm rural në Shqipëri mbetet akoma një koncept relativisht i ri dhe i pa përfshirë siç duhet në politikat zhvillimore.

- Koncepti i zhvillimit të zonave të defavorizuara dhe zonave malore (si nënkategori e zonave të defavorizuara) është trajtuar pothuajse vetëm përmes MADA dhe MAFF, si dhe programeve të financuara nga donatorët, dhe ka filluar të konsiderohet dhe të përfshihet në politikat zhvillimore kryesisht gjatë 2-3 viteve të fundit. Megjithatë, mbetet akoma shumë për të bërë në këtë fushë;
- Gjithashtu, pavarësisht përmirësimit të këtyre politikave gjatë viteve të fundit, këto strategji dhe politika mbeten akoma shumë sektoriale, të fragmentuara dhe të pa koordinuara siç duhet. Strategjitë dhe politikat e formuluar, përgjithësisht, nuk ndiqen më pas nga programe, masa dhe financime të mjaftueshme. Kjo ka çuar në mosrealizim të impaktit të pritshëm dhe reduktim të efektivitetit të këtyre politikave.
- Edhe pse specificitetet e zonave të defavorizuara dhe atyre malore janë përmendur në dokumente të ndryshme strategjike (si Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal, që parashikon zhvillimin në të ardhmen të një programi të veçantë për zonat e defavorizuara dhe Strategjia e Zhvillimit Rural, që përfshin masa që do të mund të prekin më direkt edhe zonat malore), në SKZHI, zonat e defavorizuara dhe ato malore, nuk trajtohen në mënyrë të qenësishme. Kjo mund të rezultojë, ashtu siç ka ndodhur dhe me shumë politika dhe masa të parashikuara gjatë viteve të mëparshme, me financime të pamjaftueshme të këtyre politikave dhe programeve, në mosrealizim të masave dhe kështu në mosarritje të impaktit dhe objektivave të parashikuara.
- Bazuar në rezultatet e politikave të deritanishme, del e domosdoshme futja e përjasjeve të reja zhvillimore për këto zona, të cilat të mund të ofrojnë zgjidhje më efektive, me efekte më të shpejta balancuese dhe integruese. Sfidat me të cilat përballen këto zona kërkojnë metoda më “holistike” e të integruara për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar socio-ekonomik, të bazuara dhe në eksperiencën e përjasjeve të adoptuara nga shume prej vendeve të BE-së, mbështetur në konceptin bashkëkohor të zhvillimit territorial.
- Përshpejtimi i ritmeve të zhvillimit rural kërkon si domosdoshmëri rritjen e përfshirjes së qeverisjes dhe aktorëve vendorë në planifikimin, orientimin dhe menaxhimin e proceseve të zhvillimit, në mënyrë që të sigurohet harmonizimi më i mirë i nevojave, interesave dhe faktorëve të zhvillimit.
- Rritja e kontributit të aktorëve lokalë në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale, kërkon domosdoshmërisht rritjen e kapaciteteve dhe të nivelit të njohurive të këtyre aktorëve mbi konceptet, përjasjet dhe metodat e trajtimit të çështjeve të zhvillimit që prekin zonat e tyre.
- Përveç përfshirjes së elementëve teknikë të përjasjeve të reja, politikat e zhvillimit rural kërkojnë gjithashtu: (i) një koordinim më të mirë të

instrumenteve të ofruara nga institucione të niveleve të ndryshme të qeverisjes; (ii) një partneritet dhe bashkërendim më të madh mes niveleve të ndryshme vendimmarrëse (qendror, rajonal dhe vendor) dhe komunitetit, si në formulim, ashtu dhe në zbatim të politikave zhvillimore; si dhe (iii) një koordinim më të mirë të fondeve dhe instrumenteve zhvillimore, me qëllim maksimizimin e efikasitetit të burimeve, oportuniteteve dhe kapaciteteve.

Bibliografia

- Banka e Shqipërisë. 2007. *Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë*.
- Benaki, V., Rontos, K., Apostolopoulos, C., Kazazis, E., Christos, M., 2005, *Rural Areas in Greece: Definition, Typology and Data Needs for the Monitoring and Evaluation of Rural Development. Connecting and Sharing Knowledge: A Dialogue on Linkages between Communities*.
- CAP 2000, *Rural Developments, European Commission, Directorate General for Agriculture (DG VI)*.
- CIESIN. 2007. *World Poverty Mapping*.
- Edwards, T. 2005. *Rural Policy in Finland, Norway and England. SPICe Briefing, Scottish Parliament*.
- GoA-MoE, 2007, *Regional Development Cross-cutting Strategy*.
- IFAD, 2005, *Republic of Albania: Programme for Sustainable Development in Rural Mountain Areas*.
- INSTAT dhe Banka Botërore. 2006. *Raporti i vlerësimit të varfërisë në Shqipëri*.
- Leviten-Reid, E. 2007. *Investing in Community Capacity Building. Caledon Institute of Social Policy*.
- Marku, Sh. 2006. CEI-Socio-Economic Forum. *Integration of the Albanian agricultural market into the regional and EU markets*.
- Marku, Sh. 2005. CEI. *Sustainable Rural Development in Albania: the need for new approaches*.
- MBUMK, 2007, *Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 – 2013*.
- MPSHB, 2007, *Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007–2013*.
- Skreli, E., 2007, *Assessment of strengths and weaknesses of mountain policies in the SEE Europe (Balkans)*.
- Skreli, E., Civici, A., Sena, S., Zhllima, E., 2007. MADA. *Constraints and Potentials for Sustainable Socio-Economic Development of Mountainous and Disadvantaged Areas in Albania*.
- Reimer, B. 2004. *The New Rural Economy: What Have We Learned? International Rural Network*.
- OECD. 2006. *The New Rural Paradigm: Policies and Governance*.
- Oskam, A., Komen, P., Wobst, P., Yalaw, A., 2004, *Trade policies and development of less-favoured areas: evidence from the literature Food Policy 29, pp.445–466*.
- UNDP. 2002. *How to make local development work*.
- World Bank, 2007, *Albania – Urban Growth, Emigration and Poverty Reduction: A Poverty Assessment*.
- Bertelsmann Stiftung, 2004. World Bank, *“Local Economic Development”*

A është barazia ekstreme një objektiv për t'u mburrur?

Rasti i reformave agrare në Shqipëri _____

Fatmir Guri¹,

Adrian Civici²,

_____ Anne- Marie Jouve³ _____

ABSTRAKT. *Historikisht, administrimi i tokës në Shqipëri është i lidhur në mënyrë direkte, ashtu si në një pjesë të madhe vendesh, me sistemin politik të periudhës në fjalë. Studimi i organizimit dhe strukturave që kanë administruar tokën, mbetet një temë e privilegjuar kërkimi për ekonomistët urbanë, duke pasur parasysh ndryshimet radikale që kanë shoqëruar këto struktura përgjatë së paku gjatë shekullit të fundit. Në artikull prezantohet një pamje e përgjithshme e ecurisë së strukturave të tokës përgjatë shekullit të fundit. Objektivi kryesor i analizës sonë është krahasimi i karakteristikave të reformave agrare të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1930 –1990 dhe të analizojë efektet e tyre në strukturat e tokës bujqësore të vendit. Artikulli përbëhet nga pesë pjesë. Në pjesën e parë analizohet organizimi i tokës në momentin e shpalljes së pavarësisë dhe ecuria deri në luftën e dytë botërore me reformat e aplikuar nga mbreti Zog I. Pjesa e dytë shpjegon ecurinë e strukturave të tokës pas luftës së dytë botërore me reformën e ndërmarrë në vend në vitin 1946. Pjesa e tretë do të fokusohet në procesin e dekollektivizimit të viti 1991 dhe shpërbërjen e të gjithave formave të pronës kolektive në bujqësi. Në pjesën e parafundit kryhet një analizë e krahasuar e tre reformave agrare të aplikuar në bujqësinë shqiptare gjatë shekullit të fundit, mbështetja ideologjike që i kishte inspiruar, si edhe krahasimi i rezultateve. Së fundi listohen disa rezultate mbi zhvillimin e strukturave agrare në vend. Objektivi kryesor i këtij artikulli është që të tregojë se reformat agrare të njëpasnjëshme që janë aplikuar në Shqipëri gjatë vitit të fundit në vend, që të plotësojnë qëllimin e tyre, pra të përmirësojnë situatën e popullsisë në zonat rurale dhe të sigurojnë pagën sociale, kanë prodhuar efekte të kundërta, rritjen e konflikteve të tokës në nivel fshati, duke rritur këtu pasigurinë ndaj tokës dhe duke ulur efektivitetin e përdorimit të burimit.*

1 Dr. në ekonomi Agrare dhe zhvillim rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës


2 Prof.ass.Dr., Universiteti European i Tiranës

3 Ciheam-Iam.Montpellier

1. Strukturat e tokës në Shqipëri gjatë periudhës 1912–1944

Strukturat agrare shqiptare në agim të pavarësisë ishin të ndikuara nga organizimi i perandorisë osmane. “Në fund të pushtimit osman (1912) sistemi i *çifligut* mbulonte pothuaj gjysmën e Shqipërisë. Fshatarët ishin të detyruar të kontribuonin me punë dhe produkte për pronarët privatë dhe për institucionet fetare” (Cungu99). Në momentin e pavarësisë, struktura e tokës mbizotërohej nga pronat e mëdha latifondiste dhe fermat e vogla.

Fig 1 :Struktura bujqësore shqiptare në momentin e pavarësisë



Source Wheeler et al. 2003

Me shpalljen e pavarësisë, shteti shqiptar konfiskoi menjëherë të gjithë pronat e shtetit turk, pa ndërhyrë në pronën private të individëve apo të instituteve fetare. Strukturat e tokës paraqisnin një pabarazi të thellë. Toka bujqësore shtetërore përbëhej nga 50,000 ha të një cilësie shumë të mirë midis lumenjve Vjosa dhe Shkumbin (Roucek33).

Më 1924-1926, pas shpërnguljes masive të fshatarëve kosovarë, nga forcat ushtarake serbe drejt Shqipërisë, parlamenti shqiptar votoi një ligj i cili kishte si objektiv shpërndarjen e sipërfaqeve të tokës të zotëruara nga shteti, për këtë kategori shtetasish. Ligji i votuar më 1925, synonte që t'i vendoste të ardhurit në zona të caktuara, në ultësirën perëndimore në rrethin e Lushnjës. Shumë shpejt, ky ligj u kthye në një mjet “përfitim i funksionarëve e lartë civilë e ushtarakë, pronarët, të cilët regjistroheshin si *banorë të kthyer në atdhe* pa investuar kapitale në to” (Civici01). Gjatë viteve 1925-1927, shumë prej tyre përzhënë fshatarët dhe i pronësojnë këto toka.


“Tentativa e vërtetë për reformë agrare u ndërmor në periudhën 1930-1932 nga Mbreti Zog I. Ligji, i cili sanksiononte këtë reformë agrare (Ligji i reformës Agrare), u miratua më 17 prill 1930, dhe shpërndante falas për fshatarët pa tokë, sipërfaqe të cilat i ishin shtetëzuar bejlerëve kundrejt pagesës, në zonën e ulët, duke e kufizuar “sipërfaqen e pronës së tyre në 40 ha, për çdo pronar, me nga pesë ha shtesë për çdo fëmijë dhe për bashkëshorten. Fatura financiare e kësaj reforme u përballua nga Banka

Kombëtare Bujqësore (Roucek33). Në këtë periudhë sipërfaqja bujqësore ishte e ndarë në tre aktorët kryesorë, të cilët zotëronin pothuaj të njëjtën sipërfaqe (rreth 1/3), pra shteti, pronarët e mëdhenj latifondistë, dhe së fundi fermerët e vegjël (Roucek33). Kjo reformë nuk ishte e plotë, «sepse pjesa më e madhe e regjistrave kadastralë ishin të falsifikuar. Si përfundim gjatë kësaj reforme u shpërndanë 8109 ha, ose më pak se 2.2 % të sipërfaqes bujqësore kombëtare nga të cilët 3411 ha i përkisnin pronave të mëdha shtetërore dhe pjesa tjetër (4698 ha) pronarëve të mëdhenj privatë» (Civici01).

Periudha 1932-1946 nuk u shoqërua me politika publike, të cilat të ndryshonin në mënyrë të rëndësishme strukturën e tokës në Shqipëri. Por megjithatë, duhet theksuar se theksi u vu në përmirësimin e shfrytëzimit të sipërfaqes bujqësore. Politika qeveritare synonte rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të këtij burimi. Për këtë u synua që të rritej niveli i tokës së punuar si edhe teknikat bujqësore. Në vitin 1922, në Shqipëri mbillej vetëm 10 % e tokës bujqësore së shfrytëzueshme, kryesisht në zonat e ultësirës perëndimore, në zonën e Beratit, mbi Shkodër etj. (Roucek33). Në mesin e viteve '30, në Shqipëri funksionojnë shkolla teknike bujqësore të cilat formojnë teknikë bujqësorë që kishin si synim të punësoheshin në fermat e mëdha, në jug dhe qendër të vendit, përdorej plugu i hekurit dhe në zonën e ulët ishin krijuar disa ferma model për prodhimin bujqësor. Nën dritën e kësaj politike, në gjysmën e dytë të viteve '30, u ndërtuan vepra ujitëse dhe kulluese kryesisht në zonën e ulët e bregdetare të cilat rritën sipërfaqen e vënë nën kulturë në shkallë vendi. Kështu në periudhën 1912-1938, sipërfaqja e tokës bujqësore u rrit me 12000 ha, ose 3% të sipërfaqes së përgjithshme bujqësore kombëtare. Për sa i përket strukturave agrare, kemi një zvogëlim të sipërfaqes së pronave bujqësore nëpërmjet tregut të tokës, i cili ishte i sapokrijuar, dhe ndarjes së çifligjeve të mëdhenj nëpërmjet trashëgimit (Wheeler03). Periudha 1912-1938, shënon edhe "dobësimin e pronësisë latifondiere dhe krijimin e borgjezisë së vogël agrare, e cila zotëron sipërfaqet më të mëdha të tokës në nivel kombëtar" (Civici01).

Kështu në rreth 35 vjet, struktura e pronësisë mbi tokën pëson ndryshime të rëndësishme.

Fig 2: Ndryshimet e strukturës tokës në periudhën 1912-1938



Burimi: Vjetari statistikor i Shqipërisë 1991, Wheeler et al. 2003

Këto ndryshime janë më të lidhura me zhvillimin social të vendit sesa me zhvillimin e tij ekonomik, por gjithashtu me zhvillimin e një klase borgjezie të lidhur me tregtinë që kërkonte të pronësohej me toka si një siguri për pasurinë e tyre. Periudha që pasoi luftën e Dytë Botërore na dëshmoi se këto strategji nuk kishin shumë vlerë. Regjimi që u instalua në vend pas vitit 1944 fshiu shumë shpejt dhe në mënyrë përfundimtare të gjithë format e pronësisë private mbi tokën. Së fundi duhet të theksojmë se, zhvillimet e strukturave të tokës pasuan zhvillimet ekonomike dhe politike të vendit. Ne do ta shohim se vektori politik do të mbetet elementi më i rëndësishëm në administrimin e tokës përgjatë shekullit të XX-të

2. Reformat e pasluftës – hapi i parë drejt kolektivizimit

Arsyet që shtynë të gjithë vendet e Europës Lindore për të kryer reforma agrare menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ishin të njëjta me ato që iniciuan reformën agrare në Rusinë e pas revolucionit të tetorit (Schmitt93). Klasifikon tre si më kryesoret: i) arsyet politike: - popullsia rurale në të gjithë vendet e Europës Lindore ishte maxhoritare ndaj popullsisë urbane dhe shpërndarja e tokës, lidhte këtë pjesë të rëndësishme të popullsisë me pushtetin e ri. Historiku i hidhur i Revolucionit demokratik të vitit 1924⁴, ishte një ngjarje shumë e freskët për të mos u marrë në konsideratë nga qeveria komuniste e sapodalë nga lufta, e cila do të kryente me shpejtësi reformën më të thellë agrare që kishte kryer shteti shqiptar që nga krijimi i tij. ii) arsyet ekonomike: - bujqësia e vendeve të Europës Lindore ishte e njohur për nivelin e ulët të efektivitetit që kishte përpara Luftës së Dytë Botërore, si pasojë e mbizotërimit të pronësisë nga pronarë abstenteistë të cilët kishin pak interes për zhvillimin e bujqësisë dhe aplikimin e teknikave të reja agrare. iii) arsyet sociale: - në zonat rurale jetonte, siç e theksuam, pjesa më e madhe e popullsisë së vendit, ndaj zhvillimi i pronësisë private do të çonte jo vetëm në uljen e presionit social ndaj qeverive përkatëse, por edhe në rritjen e prodhimit bujqësor.

Në të gjithë vendet e Europës Lindore, reformat agrare kanë qenë të rëndësishme menjëherë pas luftës së dytë botërore. Sipas (Tomasevich58), niveli i shpronësimeve të kryera në vende të ndryshme, ishte shumë e ndryshme, ajo lëvizte nga 50% të sipërfaqes së përgjithshme bujqësore, për Poloninë në më pak se 2.1% të saj për Bullgarinë. Ky ndryshim kaq i rëndësishëm kishte të bënte me dy faktorë të rëndësishëm: i) rëndësia që kishte radikaliteti i reformës nga një vend në një tjetër ishte i ndryshëm dhe nga ana tjetër, ii) struktura bazë bujqësore që trashëgonin vendet që para Luftës së Dytë Botërore.

4 Në qershor 1924 forcat demokratike shqiptare përmbysën qeverinë e drejtuar nga Ahmet Zogu, me ndihmën e popullsisë së zonave rurale. Fituesit premtuan një reformë agrare, që do të ulte diferencën midis fermave. Qeveria e formuar e drejtuar nga Fan S. Noli një kundërshtar i njohur i Zogut, vonoi reformat dhe në mënyrë të veçantë atë agrare, duke humbur kështu mbështetjen popullore. Zogu, me mbështetjen ushtarake të mbretit të Jugosllavisë dhe të mbretërve të tjera ballkanike, përmbysi qeverinë e Nolit në dhjetor të po të njëjtit vit.

(Sanders50), bën një analizë të përgjithshme të domosdoshmërisë së reformave agrare në të gjithë Vendet e Europës Lindore në gjysmën e dytë të viteve dyzetë.

- Këto reforma, së pari mundësuan klasën politike të pronarëve të mëdhenj të tokës të cilët ishin politikisht të rrezikshëm për “*rendin e ri*” që po krijohet, jo vetëm për tendencën e tyre për të pasur një tërheqje drejt perëndimit, por edhe për dëshirën e tyre për të ruajtur status quo-n ekzistuese. Politika e ndjekur ishte e njëjtë me atë të shtetëzimit të ndërmarrjeve, industrive minierave etj;
- Reforma agrare duhej që të shpërblente besnikët. Ata të cilët kishin mbështetur regjimin e ri ishin në krye të listave për të përfituar tokë, cilësia e të cilave ishte nga më të mirat;
- Ndihamonte mbështetjen e atyre të cilët ishin ekonomikisht në gjendje të vështirë. Kjo reformë mundësoi që të varfrit të merrnin tokat e të pasurve dhe pushteti i ri mund që t’i thërriste në ndihmë sa herë që të dëshironte për të ruajtur “fitoret e arritura”;
- Ndarja dhe copëtimi edhe i njësive bujqësore, të cilat ishin ekonomikisht efektive në njësi të vogla dhe jo efektive, kërkonte që në një të ardhme të afërt të përballej me problemin e efikasitetit të metodave të prodhimit dhe të zgjerimit të njësive prodhuese.
- Lidhja e shkurtër e fshatarëve me tokën (në disa raste vetëm disa muaj, mundëson një proces kolektivizimi shumë më të shpejtë (në periudhat e mëvonshme u verifikua se procesi i kolektivizimit ishte më i vështirë në zonat malore, në të cilat tradicionalisht kanë ekzistuar ferma të vogla të zotëruara nga fermerët).
- Së fundi, në nivelin e besimit tek popullsia, shpërndarja e tokës krijon një efekt pozitiv dhe një klimë besimi në të gjithë popullsinë e vendit (edhe ato shtresa të cilat nuk kanë përfituar nga kjo politikë), për politikën e ardhshme ekonomike dhe sociale të vendit dhe për sistemin që po ngrihej.

Një tjetër karakteristikë e cila është dalluese për të gjithë reformat e zhvilluara në Europën Lindore, është fakti se këto reforma u përdorën si hapi i parë por më i rëndësishmi për të kaluar socializimin e bujqësisë. Edhe në vendet në të cilat niveli i socializimit të bujqësisë dhe kolektivizimi nuk ishte shumë i lartë (siç ishin Jugosllavia, Polonia dhe pjesërisht Hungaria), reformat agrare ishin elementë të cilët lanë shenja të rëndësishme në format e organizmit të tokës në të ardhmen agrare (Tomasevich58).

Kështu nën moton “toka i takon atij që e punon”, që në mes të vitit 1945 (25 gusht) miratohet ligji i reformës agrare i cili kishte si qëllim «të shpërndante më shumë se 155159 ha tokë bujqësore, 474227 rrënjë ullinj dhe 5923 qe» (Civici03). Objektivi ishte pronësimi i më shumë se 145000 familjeve me tokë të cilët qoftë nuk kishin fare tokë në dispozicion, qoftë kishin sipërfaqe të cilat nuk i kalonin 5 ha.

Reforma e vitit 1945, mund të ndahet në dy faza kryesore:

Gjatë kësaj faze u shtetëzuan pa asnjë dëmshpërblim tokat e pronarëve të mëdhenj, duke u lënë këtyre të fundit sipërfaqe, të cilat nuk duhet t’i kalonin 40 ha nëse pronarët i shfrytëzonin sipërfaqet vetë, dhe 20 ha nëse sipërfaqet nuk shfrytëzoheshin nga

pronarët. Në parim shohim se në këtë fazë, reforma e vitit 1946 nuk ka një ndryshim të madh nga objektivat që i kishte vënë vetes reforma e vitit 1930 - tentohej që të ulej pabarazia midis pronarëve të tokës dhe nga ana tjetër të ulej niveli i abstenteizmit në bujqësinë shqiptare. Megjithatë ekzistonin dy elementë të cilët i jepnin këtyre reformave karakteristika shumë të ndryshme: i) toka e shpërndarë në reformën e vitit 1930, ishte e blerë, kështu reforma ruante karakter demokratik, ii) reforma e vitit 1945, u zhvillua në shkallë të gjerë, në të gjithë vendin, fakt i cili nuk ishte i vërtetë për atë të vitit '30 (edhe për faktin se zhvillimi i reformës nuk kishte asnjë pengesë financiare), por edhe se baza ideologjike mbi të cilën ajo ishte mbështetur ishte shumë e ndryshme;

Më 1946, u miratua një version i dytë reformës, i cili është në vetvete shumë më radikal se sa ai i vitit 1945. Arsyeja kryesore e këtij ligji të ri ishte pengimi i krijimit të një klase kapitaliste agrare, e cila mund të ishte e vështirë për t'u integruar në format e mëvonshme kolektiviste. Nëse faza e parë e reformës ishte mbështetur në shqetësimin e shpërndarjes së mjeteve të prodhimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së më shumë se 77% të popullsisë (Enyedi67), versioni i dytë i reformës, tentonte që të atomizonte pronësinë mbi tokën, të shkëpuste lidhjen midis pronarit dhe tokës, me qëllim kolektivizimin e shpejtë dhe pa rezistencë të saj. Sipas këtij versioni sipërfaqja maksimale e lejuar për tu disponuar nga një familje ishte 5 ha. Kjo masë e dytë fshihi përfundimisht pronën e madhe private të tokës nga peizazhi agrar shqiptar.

Përfituesit e tokës u pajisën me dokumente pronësie "tapi", të cilat njihnin ligjërisht pronësinë e pronarëve të rinj mbi tokën. Nga ana tjetër, pronarët e rinj nuk kishin të drejtën për të tregtuar këto toka gjë që bllokoi tregun e tokës (Aliko01).

Është e rëndësishme të theksohet se midis vendeve të Ballkanit perëndimor Shqipëria ka nivelin më të lartë të sipërfaqes së shtetëzuar në krahasim me vendet të cilat ndajnë veçori të sipërfaqeve bujqësore të afërta (zona të rëndësishme malore), sipërfaqja e shtetëzuar shqiptare është shumë më e rëndësishme. Logjika e reformave në të gjithë vendet është e njëjtë (shtetëzimi i tokave të tepërta nga pronarët e mëdhenj), por limiti maksimal, është i ndryshëm dhe gjithmonë më i madh se ai i vendosur në Shqipëri (Tomasevich58).

Rezultatet e kësaj reforme janë të rëndësishme, u shpronësuan plotësisht apo pjesërisht më shumë se 19355 ferma bujqësore .

3. Reforma e tretë agrare drejt barazisë totale

Në fillim të viteve 1990, ndërtimi i një shoqërie demokratike dhe një ekonomie tregu ishte detyra primare. Në këtë logjikë dekollektivizimi i tokës dhe i mjeteve të tjera të prodhimit bujqësor ishte për institucionet shqiptare pika e nisjes së reformës. Duhet të theksojmë se dekollektivizimi i shpejtë ishte i justifikuar nga varfëria ekstreme dhe situata sociale. (Cungu dhe Swinnen 99) theksojnë se arsyet që shtynë institucionet shqiptare për të përshpejtuar dekollektivizimin (soutiennent que les raisons qui ont poussé les institutions albanaises à accélérer la décollectivisation étaient) :

1. Popullsia rurale përbënte pothuajse 65% të popullsisë totale ;
2. Pjesa e bujqësisë në GDP kombëtare ishte shumë e lartë ;
3. «Shqipëria nuk arrinte që të përmbushte nevojat ushqimore të popullsisë (Pashko93), dekollektivizimi do të ulte detyrimet e qeverisë për popullsinë në zonat rurale.

Të gjithë këta elementë çuan në një reformë imediate në sistemin bujqësor. Kjo i mundësoi shkarkimin nga ana e qeverisë të barrës morale për popullsinë rurale dhe krijoi ambientin ekonomik për të inkuadruar sa më shpejt që të jetë e mundur këtë sektor në jetën ekonomike të vendit. Sistemi kolektivist gëzonte një reputacion shumë negativ në zonat rurale, kooperativat kishin filluar shpërbërjen e tyre që në dhjetor të vitit 1990, ndaj edhe dekollektivizimi kishte një impakt pozitiv në këtë pjesë të popullsisë dhe përmbushte aspiratat e këtyre të fundit. Përpara ligjvënësve u shtruan disa pyetje të rëndësishme përgjigja e të cilave do të transformonte rrënjësisht sistemet e organizimit të tokës. Këto pyetje mund të përmbledhen në më kryesoret:

- Cili do të jetë niveli i dekollektivizimit të tokës, do të favorizohet një transformim i organizatave ekzistuese apo ato do të eliminohen në mënyrë përfundimtare?
- Cilët do të konsiderohen si pronarët e vërtetë të tokës? Ata të cilët i kishin këto toka në pronësi përpara vitit 1946, ata të cilët kanë punuar në kooperativat bujqësore gjatë periudhës së kolektivizimit?, me fjalë të tjera do të kryhet një shpërndarje e cila do të mbështesë familjet fshatare apo që do të mbështesë ish - pronarët, ose ndryshe “duhet të “privatizohet” apo të “ri-privatizohet” toka” (Civici03).
- Cili do të jetë mënyra e shpërndarjes së tokës midis i) akordimit të të drejtave të plota mbi tokën, ii) akordimi i të drejtave të shfrytëzimit dhe pronësisë por jo tregtimit, iii) akordimi i të drejtave të shfrytëzimit dhe ruajtja e tokës në pronësi të shtetit.

Aprovimi i ligjit No 7501 “Mbi Tokën i miratuar më 31.07.1991, nga parlamenti me shumicë socialiste, vendoste likuidimin organizatave kolektivistike dhe shpërndarjen e tokës për të gjithë anëtarët e kooperativave në sipërfaqe dhe cilësi të barabartë.


Elementët kryesorë të kësaj reforme të tretës brenda një shekulli dhe më të rëndësishmes për sa i përket sipërfaqeve që preku dhe formave të prodhimit që krijoi mund t’i grupojmë si më poshtë (Civici01):

- Shkrirjen e kooperativave bujqësore dhe shpërndarjen e drejtë të tokave të këtyre kooperativave për banorët e çdo fshati ;
- Përfituese nga ky ligj do të ishin familjet fshatare të regjistruara si anëtarë të ish kooperativave bujqësore deri më 31 korrik 1990;
- Sipërfaqja e tokave të disponueshme në çdo fshat pas verifikimeve, duhet të ndahet në funksion të anëtarëve të çdo familjeje ;
- Toka i shpërndahet fshatarëve pa pagesë, por këta të fundit nuk gëzojnë të drejta të plota për sa i përket sipërfaqeve të shpërndara, ata nuk mundet që ta shesin, ta japin me qira apo ta lënë peng, nga ana tjetër ata nuk kanë të drejtë që të blejnë toka nga fermerë të tjerë ;

- Shpërndarja e tokave sigurohet nga një komision fshatarësh i cili përbëhet nga fshatarë banorë të fshatit ;
- Institucionet e shpërndarjes së tokës janë të katër niveleve: i) Komisioni i shpërndarjes së tokës në bazë fshati, ii) Komisioni i shpërndarjes së tokës në bazë komune, iii) Komisioni i shpërndarjes së tokës në bazë rrethi dhe Komisioni i përgjithshëm i shpërndarjes së tokës në nivel kombëtar ;
- Ish pronarët e tokës të cilët ishin regjistruar si të tillë deri në vitin 1946, do të dëmshpërblehen.

Në katër vite të shoqëruara me shumë polemika politike dhe konflikte midis fshatarëve, u zbatua ky ligj i cili ndau një sipërfaqe prej më shumë se 700,000 në 466,000 ferma bujqësore familjare të cilat kishin një sipërfaqe prej 6.0 -3 ha.

Fig 6 : Sipërfaqja mesatare e fermave bujqësore në Shqipëri



Source: Civici 2000

4. Karakteristikat e reformave agrare gjatë shekullit të fundit

Gjatë shekullit të fundit, Shqipëria ka pësuar ndryshime të rëndësishme të strukturave bujqësore. Mjafton që të theksojmë se gjatë shtatëdhjetë viteve të fundit në Shqipëri janë kryer tre reforma agrare si pasojë e shqetësimit të shoqërisë për sa i përket strukturave agrare ekzistuese në vend, por gjithashtu edhe një tentativë nga ana e institucioneve politike për të përmirësuar kushtet e jetës në zonën rurale që përbën pjesën më të madhe të popullsisë të vendit. Krahasimi i këtyre reformave na mundëson kuptimin e zhvillimit të politikave të tokës në Shqipëri.

Fig 8 : Karakteristikat e reformave agrare në Shqipëri

Objektivi	Reduktimi i fshatarëve pa tokë	Tokë për të gjithë	Tokë për të gjithë barabaz i (sasi cilësi)
Institucioni që ndërmori reformën	Mbreti	Partia Komuniste	Parlamenti
Sipërfaqja e shpërndarë	8109 ha	155159 ha	704000 ha
Sipërfaqja/sip totale bujqësore (%)	2,12%	39,44%	95,7%
Pronarët e shpronësuar	Pronarët e mëdhej pronat shtetërore	Pronarët e mëdhej e të mesëm	Kooperativat, NB
Mënyra e përfitimit të tokës	Pagesë për pronarët	Shpronësim i detyrueshëm	Dekolektivizim
Mënyra e shpërndarjes	Pa pagesë	Pa pagesë	Pa pagesë
Të drejtat	Të plota	Përdorimi jo tregtimi	Përdorim (1991) Tregtimi (1995)
Strukturat e tokës	Të mëdha, mesme të vogla	Të mesme të vogla	Të vogla
Reagimi ndaj reformës	Pozitiv, pronarët dakord	Pozitiv ish-pronarët kundër	Pozitiv ish pronarët kundër
	1930	1946	1991

Burimi : Përpunimi nga autorët.

Karakteristikat kryesore të reformave agrare në Shqipëri janë:

Reformat agrare të aplikuara kanë si objektiv kryesor uljen e pabarazive të tokës dhe rritjen e numrit të përfituesve ;

- Reforma e vitit 1930 (edhe pse e pjesshme) u aplikua sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe duke u mbështetur në tregun e tokës. Niveli i reformës është përcaktuar nga kufizimet buxhetore (duhet pasur parasysh gjithashtu niveli i korrupsionit që kanë shoqëruar aplikimin e reformës);

- Reformat agrare kanë pasur karakteristikat e politikave të rikompensimit për disa klasa sociale (në të gjitha rastet shpërndarja është kryer falas), që përgjithësisht përbën pjesën më të madhe të popullsisë së vendit. Në të gjithë rastet legjislatori ka kërkuar që të ketë mbështetjen e klasës sociale përkatëse;
- Reformat janë aplikuar në Shqipëri kanë qenë gjithmonë e më të thella. Sipërfaqja e tokës që u prek nga reformat ka qenë gjithmonë e më e gjerë, për të arritur limitet e saj në vitin 1991;
- Rritja e shqetësimit social të legjislatorit ka çuar në një ulje të vazhdueshme të sipërfaqes mesatare të strukturave të tokës (fenomen i nxitur gjithashtu nga rritja demografike);
- Reformat agrare janë shoqëruar me konflikte të rëndësishme dhe me një pasiguri evidente që vjen si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të pronësisë mbi tokën.

Një studim i krahasuar i karakteristikave të reformave agrare të kryera në Shqipëri gjatë shekullit të fundit kanë nxjerrë në pah se ato janë drejtuar nga një objektiv politik më shumë se sa ekonomik. Gjatë dy reformave të fundit është marrë shumë pak në konsideratë strukturat agrare që do të rezultonin nga aplikimi i këtyre reformave në zonat rurale duke ndarë gjithmonë e më shumë sipërfaqet e tokës në vend. Kjo na bën që të mbështesim idenë se reformat agrare të ndërmarra në Shqipëri, objektivi kryesor nuk ishte ai e përmirësimit të strukturave të tokës apo përmirësimit të efikasitetit ekonomik të bujqësisë, por ai i ruajtjes së paqes sociale në vend. Këto reforma janë ndërmarrë padyshim në momente ndryshimesh radikale ekonomike dhe sociale (pas luftës së dytë botërore dhe ndryshimet demokratike të viteve 1990), që kërkonin zgjidhje radikale që ulnin në mënyrë të ndjeshme mundësinë për të zgjedhur. Nga kjo tablo e përgjithshme bën përjashtim reforma e ndërmarrë në vitet 1930 nga Mbreti Zog I-rë e cila kishte si qëllim që të ulte pabarazitë në zonat rurale pa përmbysur totalisht strukturat ekzistuese të tokës.

Edhe pse këto reforma janë ndërmarrë me një qëllim të vetëm atë të sigurimit të paqes sociale në zonat rurale, ato kanë prodhuar efektin e kundërt duke nxjerrë në pah konflikte që janë të gjalla edhe sot që kanë kaluar pothuaj njëzet vjet nga aplikimi i reformës së fundit mbi tokën. Pronarët e tokës në periudha të ndryshme, kërkojnë të drejtat e tyre mbi tokën në mënyrë të veçantë kur këto të fundit zotërojnë një rentë të veçantë shtesë përveç rentës bujqësore (zonat periurbane, të bregut etj.).

Reformat agrare kanë ulur në mënyrë të vazhdueshme nivelin e efektivitetit të përdorimit të tokës bujqësore. Numri i lartë i parcelave të cilat janë të shpërndara në një sipërfaqe të gjerë, ka çuar në rritjen e tokave djerrë. Përdorimi i pakët i mekanikës bujqësore dhe e investimeve të tjera ngrenë pyetje të rëndësishme rreth ribashkimit të parcelave bujqësore në vend, por ajo mbetet një strategji e cila kërkon shumë kohë dhe mbështetje financiare. Roli gjithmonë e më i pakët i ish pronarëve në procesin e ndarjes së tokës, është një karakteristikë e cila dëshmon shqetësimin vendimmarrësve përballë masës së gjerë të popullsisë pa u shqetësuar për ish pronarët dhe të drejtën e përhershme të këtyre të fundit për tu dëmshpërblyer për tokën e tyre. Edhe njëherë reforma e viteve 1930 bën dallim në mënyrën e konceptimit dhe të aplikimit nga

reformat e viteve 1946 dhe 1990. Marrja shumë e pjesshme në konsideratë e ish pronarëve, ka çuar në rritjen e nivelit të aplikimit të kësaj të fundit, duke arritur në vitin 1990 në tërësinë e tokave bujqësore të vendit.

Ndarja e e përgjithshme e tokave në vitin 1946 dhe 1990, ka rritur në mënyrë të ndjeshme pasigurinë e pronës në zonat rurale. Kjo shpjegohet nga së paku tre faktorë: i) numri i rëndësishëm i reformave të ndërmarra për një periudhë të shkurtër kohe (tre reforma agrare nga të cilat dy të përgjithshme në një periudhë shtatëdhjetë vjeçare) fakt i cili ka ulur besimi popullor në institucionet publike që i organizonin këto reforma, ii) mungesa e dëshmipërblimit të ish pronarëve që vazhdojnë të kërkojnë të drejtat e tyre mbi tokën, iii) ekzistenca e së paku tre pronarëve të ndryshëm mbi të njëjtën sipërfaqe (pronarët e para vitit 1946, ata të reformës të 1946 dhe së fundi atyre të pas vitit 1991). Kjo pasiguri e tokës e bashkangjitur me strukturat pak a shumë të barabarta të tokës, dhe në kushtet e mungesës së formave të kreditimit të bujqësisë, frenojnë zhvillimin e kësaj të fundit prej së paku dhjetë vjetësh⁵ dhe zhvillimin e tregut të tokës (duke përjashtuar këtu tokat që do të përdoren pas blerjes për qëllime urbanizimi dhe jo bujqësor).

5. Përfundime

Reformat agrare në Shqipëri japin mundësinë e nxjerrjes së shumë mësimave për vendimmarrësit. Shohim se këto reforma janë kryer në një vend i cili ishte i ndarë nga pabarazitë dhe një nevojë të ngutshme për të shpërndarë tokën në zonën rurale. Motivët ideologjike mbi të cilat ishin bazuar këto reforma ishin shumë të ndryshme. Reforma e parë e ndërmarrë kërkonte që të ulte nivelin e numrit të pronarëve abstenteist në zonat rurale dhe në të njëjtën kohë të ulë numrin e fshatarëve pa tokë, reforma e dytë (1946) kishte si qëllim të shkulte nga rrënjët fermat e mëdha dhe të mesme dhe në të njëjtën kohë të fshinte në mënyrë përfundimtare çdo lidhje që ekzistonte midis pronarëve dhe tokës e të shpërblente popullsinë rurale për mbështetjen gjatë luftës. Së fundi reforma e tretë donte që t'i jepte të gjithëve të njëjtën sipërfaqe në sasi dhe cilësi, pa u shqetësuar rreth efekteve që kjo strategji do të kishte në efektin e gjatë. Nëpërmjet kësaj ne mund të themi se:

Reformat agrare që janë aplikuar në Shqipëri gjatë shekullit të fundit përbëjnë një proces i cili është shtyrë në qëllime shumë të mira por me rezultate shumë pak të kënaqshme. Kjo kërkesë gjithmonë e më e rëndësishme për barazi sociale në zonat rurale ka ulur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin e strukturave agrare dhe ka rritur konfliktet sociale.

Së fundi mund të themi se historiku i reformave agrare në Shqipëri tregon se objektivi i arritjes së barazisë së plotë prodhon probleme të rëndësishme, pikërisht ato që ajo mendon se zgjidh (pasiguri të pronës, konflikte sociale etj.) probleme të cilat janë shumë të vështira për tu zgjidhur.

5 Ligji mbi shitblerjen e tokës bujqësore u aprovua në 1995

Bibliografi

- [Aliko (2001)] H. Aliko. The impact on the development of a land market in Albania caused by the restitution and compensation of an agriculture land. In. *Transition, Institutions and the rural sector*. Center for the study of transition and development, December 2001.
- [Civici(2001)] A. Civici. Evolution des politiques foncières et dynamique des espaces ruraux en Albanie. In *Terres méditerranéennes. Le morcellement, richesse ou danger ?*, pages 127-146. Karthala-Ciheam, 2001
- [Civici(2003)] A. Civici. *Dé-collectivisation et reconstruction de l'agriculture Albanaise 1989-2002. Une transition spécifique ?* PhD Thesis, Ecole nationale Supérieure Agronomique de Montpellier, 2 Place Pierre Viala, 34060 Cedex 1, Montpellier, France, 2003
- [Civici(1997a)] A. Civici. La réforme foncière en Albanie durant la période de transition, comparaison avec les autres pays de l'Europe centrale et orientale. *Cahiers Options Méditerranéennes*, 36 :105-160, 1997a
- [Civici(1997b)] A. Civici. La questionne foncière en Albanie et la restructuration de l'économie agricole. *Options Méditerranéennes Sér. B*, (15) : 157-169, 1997b. Albanie une agriculture en transition.
- [Civici(1997c)] A. Civici. Evolution des politiques économiques et agricoles de 1945-1995. *Option Méditerranéennes, Sér. B* (15) : 15-50, 1997c.
- [Cungu and Swinnen (1999)] A. Cungu and F.J. Swinnen. Albanian's radical agrarian reform. *Economic development and cultural change*, 47(3) : 605-619, April 1999.
- [Zyra e Bankës Botërore Tiranë] Z. e Bankës Botërore në Tiranë. Statusi i Reformës së tokës dhe i tregut të pronave të paluajtshme në Shqipëri. Technical report, Banka Botërore, 2006.
- [Enyedi(1967)] G. Enyedi. The changing face of agriculture in Eastern Europe. *Geographical Review*. 57(3) : 358-372, July 1967.
- [Pashko (1993)]G. Pashko. Obstacles to economic reform in Albania. *Europe-Asia studies*, 45 (5) : 907-927, 1993.
- [Roucek (1933)] J. S. Roucek. Economic conditions of Albania. *Economic Geography*, 9(3) : 256-264, July 1933.
- [Sanders (1950)] I. T. Sanders. Changing status on the peasant in Eastern Europe. *Annals of the American Academy of the Political and Social Science*, 271:78 93, September 1950.
- [Schmitt (1993)] G. H. Schmit. Agrarian reform in Eastern Europe after the World War II. *American Journal of agricultural economics*, 75 (3) : 845-850, August 1993.
- [Tomasevich (1958)] J. Tomasevich. Agriculture in Eastern Europe. *Annals of the American Academy of the political and Social Science*, 317: 44-52, May 1958.
- [Wheeler-Sabates and Waite (2003)] R. Wheeler-Sabates and M. Waite. Albanian country brief: Property rights and land markets. July 2003.

Liria Ekonomike si faktor përcaktues i flukseve hyrëse të IHD – Rasti i Shqipërisë

Thoma L., Luga E.

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

ABSTRAKT. Në botën e sotme në kuadër të globalizimit, rritja ekonomike varet nga dy faktorë kryesorë: Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NMV). Kështu, ndërkohë që IHD janë burimi kryesor i financimeve të huaja, ato mund edhe të rrisin kapitalin fiks dhe të ndihmojnë në arritjen dhe ruajtjen e vlerave pozitive në bilancin e pagesave. IHD-të kanë gjithashtu potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të aftësisë prodhuese, aftësi transferuese dhe teknologji të re si dhe rritjen e eksporteve.

Gama e faktorëve që përcaktojnë flukset hyrëse të IHD-ve në një vend është tepër e gjerë. Disa prej tyre kanë të bëjnë me faktorë të brendshëm të kompanisë investuese (investitorit të huaj), ndërkohë që shumë prej tyre lidhen direkt me faktorë specifikë të vendit ku do të kryhet investimi (Teoria OLI e Dunning) (Dunning 1993). Liria Ekonomike e cila përkufizohet si “pavarësia materiale e individit mbi pronën dhe punën e saj/tij nga shteti dhe grupe të tjera të organizuara”, përmbledh një sërë treguesish kompleks të cilët lidhen direkt me faktorët specifik të vendit ku do të kryhet investimi, ose e thënë ndryshe, me mjedisin e biznesit në një vend të caktuar. Në rast të një klime të dobët investimesh për shkak të taksave, tarifave, gjobave, korrupsionit dhe nevojës për shërbime shtesë, rriten kostot e transaksionit investues dhe investuesit mund të drejtohen diku tjetër. E njëjta gjë mund të thuhet edhe në rastet kur kostot e krahut të punës, transportit, energjisë në atë vend nuk janë konkurruese.

1. Liria ekonomike dhe efektet hipotetike të saj në flukset hyrëse të IHD-ve

Në Indeksin e Lirisë Ekonomike të 2008-ës publikuar nga “Heritage Foundation” liria ekonomike përshkruhet si “pavarësia materiale e individit mbi pronën dhe punën e saj/tij nga shteti dhe grupe të tjera të organizuara”. Sipas këtij përkufizimi një individ i pavarur ekonomikisht mund të ketë kontroll të plotë mbi punën dhe pronën e vet.

Liria ekonomike ndahet në 10 kategori. Disa nga këto kategori matin se sa e hapur është një ekonomi kundrejt tregtisë dhe investimeve, ndërsa të tjerat e shohin lirinë ekonomike në një nivel individual, duke matur kështu lirinë e individit për të përdorur burimet e veta financiare dhe të punës.

Dhjetë kategoritë e lirisë ekonomike janë: *liria për të bërë biznes, liria për të bërë tregti, liria fiskale, madhësia e qeverisë, liria monetare, liria për të investuar, liria financiare, të drejtat mbi pronën, mungesa e korrupsionit dhe liria e punës*. Në vijim paraqitet një përshkrim i shkurtër i secilës prej tyre, së bashku me efektet hipotetike mbi flukset hyrëse të IHD-ve. Përkufizimet janë marrë direkt nga Indeksi i Lirisë Ekonomike 2008, (Beach & Kane, 2008)

- **“Liria e biznesit** është aftësia për të krijuar, menaxhuar dhe mbyllur një firmë lehtësisht dhe në mënyrë të shpejtë. Rregullat e shumta kufizuese janë një prej barrierat kryesore të lirisë për të bërë biznes. “Në mënyrë të natyrshme ky faktor është tepër i rëndësishëm për një firmë e cila kërkon të zgjerohet dhe në tregje të tjera të huaja. Në përgjithësi firmat janë më të gatshme të investojnë në ato vende ku është e lehtë për t’u futur dhe për të dalë nga tregu (Beheshtitabar & Irgalijev, 2008)
- **“Liria për të bërë tregti** është një matës kompleks i mungesës së barrierave tarifore dhe jo tarifore që ndikojnë në importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve.” Impakti i këtij treguesi mbi flukset hyrëse të IHD-së varet nga natyra e IHD-ve. Shkalla e hapjes së tregut mendohet të ketë efekt negativ mbi IHD-të e ashtuquajtura horizontale (IHD që kërkojnë treg) dhe efekt pozitiv mbi ato vertikale (IHD në kërkim të burimeve ose aseteve). Megjithatë, sipas Kumar (2002), në përgjithësi shkalla e hapjes së tregut ka efekt pozitiv mbi flukset hyrëse të IHD-ve.
- **“Madhësia e qeverisë** përfshin të gjitha shpenzimet e qeverisë, duke përfshirë këtu konsumin dhe transfertat. Në kushte ideale, shteti do të ofronte mallrat publike në një minimum shpenzimesh.” Shpenzimet e larta qeveritare mendohen se janë dekurajuese për investitorët e huaj. Meqë për këtë tregues vlerat e larta tregojnë nivele të ulëta të shpenzimeve qeveritare, atëherë një rritje në vlerat e këtij treguesi mendohet të ndikojë pozitivisht në flukset hyrëse të IHD.
- **“Liria për investim** ka të bëjë me një vlerësim për lëvizjen e lirë të kapitalit, dhe veçanërisht atij të huaj” Përgjithësisht investitorët hezitojnë të investojnë në një ekonomi ku ka kufizime për lëvizjen e kapitalit përmes kufijve. Kështu që me rritjen e lirisë për të investuar pritet të rriten flukset e IHD-ve në një vend.
- **“Të drejta mbi pronën** ka të bëjë me një vlerësim të aftësive të individëve për të marrë në zotërim prona private, çka sigurohet përmes ligjeve të qarta dhe zbatimit rigoroz të tyre.” Të drejtat mbi pronën përbëjnë themelin e një ekonomie tregu. Nëse qeveritë nuk mund të garantojnë këto të drejta bazë, atëherë kompanitë ndërkombëtare nuk do të kenë interes të investojnë. Kështu, ajo që pritet është që rritja e të drejtave mbi pronën të ndikojë pozitivisht në nivelin e IHD-ve në një vend.
- **“Mungesa e korrupsionit** bazohet në të dhëna sasiore që vlerësojnë perceptimin e korrupsionit në mjedisin e biznesit përfshirë këtu korrupsionin në nivel qeveritar, korrupsionin e gjyqësorit dhe administratës publike.” Korrupsioni shpie në ulje

të efikasitetit dhe dekurajon investitorët e huaj. Kështu, flukset hyrëse të IHD-ve supozohet se rriten me uljen e nivelit të korrupsionit në vend.

- **“Liria fiskale** nënkupton se sa e kufizuar shfaqet një qeveri nga pikëpamja e të ardhurave. Ajo përfshin kufizimet e saj në lidhje me nivelet e tatimeve (kryesisht tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin) dhe kontributin e të ardhurave nga taksat në PBB.” Në kushtet kur nivelet e tatimeve janë të ulëta, liria fiskale konsiderohet në nivele të larta dhe kjo mendohet se ka ndikim pozitiv në flukset hyrëse të IHD-ve.
- **“Liria financiare** nënkupton matjen e asaj se sa të sigurta janë bankat në vend dhe sa të pavarura janë ato nga shteti.” Këtu flitet për bankat por në fakt merren në konsideratë dhe institucione të tjera financiare si ato në lidhje me tregun e sigurimeve dhe të kapitaleve. Në kushtet kur këto institucione janë krejtësisht të pavarura fluksi i IHD-ve mendohet të jetë i lartë.
- **“Liria monetare** është një matës për stabilitetin e çmimeve dhe kontrollit mbi to. Inflacioni dhe kontrolli mbi çmimet dëmtojnë aktivitetin e tregut. Ky indeks merr vlera të larta për vende ku ka stabilitet çmimesh dhe ku Banka Qendrore paraqitet më e pavarur. Në kushte të tilla IHD-të mendohet se janë më të larta.
- **“Lira për punë** është një matës për atë se sa mund të bashkëveprojnë me njëri – tjetrin punonjësit dhe bizneset pa qenë të kufizuar nga shteti.” Këtu përfshihen katër variabla, 3 nga të cilat 3 të përbëra si paga minimale, kufizimet në lidhje me orët dhe orarin e punës, vështirësitë për të pushuar punonjësit nga puna dhe kostoja e pushimit nga puna.

2. Metodologjia

Në këtë artikull, janë përdorur të dhëna primare dhe të dhëna sekondare. Të dhënat sekondare, janë përdorur kryesisht për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme të investimeve të huaja në Shqipëri. Të dhënat primare janë përdorur me qëllim për të analizuar se sa e rëndësishme paraqitet Liria Ekonomike në thithjen e sa më shumë investimeve të huaja në vend dhe cili/at nga treguesit e saj është më dominues në përcaktimin e flukseve hyrëse të tyre. Databasa e indekseve të Lirisë Ekonomike është përdorur gjithashtu dhe për treguar se çfarë përparimesh ka bërë vendi ynë në drejtim të një mjedisi sa më të favorshëm për biznes dhe investime.

Për të parë rëndësinë që ka Liria Ekonomike në thithjen e IHD-ve në Shqipëri, është përdorur një model i thjeshtë, një funksion linear i tillë si më poshtë:

$$Y = a + \sum b_i x_i + e$$

Y – është variabëli i varur, niveli i IHD-ve

x_i – është vektori i variablave shpjegues (indekset e lirisë ekonomike)

e niveli i gabimit

Të dhënat mbi Indekset e Lirisë Ekonomike janë marrë nga Heritage Foundation, ku secila nga kategoritë e lirisë ekonomike është vlerësuar në një shkallë 0 - 100 ku, 100 nënkupton lirinë maksimale.

3. Rezultatet

3.1 Ecuria e investimeve të huaja direkte në Shqipëri

Megjithëse flukset e investimeve të huaja në Shqipëri kanë qenë në rritje të vazhdueshme, ato mbeten ende në nivele të ulëta nëse i krahasojmë me rajonin. Kjo si pasojë e një trashëgimie negative të dëmtimit të rëndë të klimës së biznesit, për shkak të pengesave të konsiderueshme administrative, korrupsionit të përhapur, dobësive rregullatore si dhe riskut të perceptuar ekonomik dhe politik të vendit.


Investimet e huaja direkte, gjatë viteve të fundit, siç mund të vihet re dhe nga grafiku kanë pësuar një rritje të konsiderueshme. Gjatë vitit 2004, për shkak edhe të privatizimit të Bankës së Kursimeve, fluksi i IHD-ve arriti vlerën prej 267 milion Euro. Për vitin 2005, investimet e huaja direkte për efekt edhe të mungesës së privatizimeve, zbritën në 209 milion Euro.

Fluksi i investimet të huaja direkte në fund të vitit 2006 pësoi një rrije prej 14 % kundrejt vitit 2005 duke arritur në shifrën 260 milion euro. Kjo shifër ishte rezultat i investimeve “greenfield” apo i projekteve koncesionare. Për vitin 2007, falë reformave të Qeverisë për përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit, si dhe rifillimit të procesit të privatizimit të disa ndërmarrjeve shtetërore si dhe aplikimit të iniciativës “Shqipëria 1 Euro”, fluksi i IHD-ve tejkaloi shifrën 400 milionë euro. Po në këtë vit, kontributi i IHD-ve në PBB kapi shifrën më të lartë për të gjithë periudhën duke u regjistruar në nivelin 6%.

Investitorët nga vendet e BE-së dominojnë investimet e huaja direkte në Shqipëri. në fund të vitit 2004, jo më pak se 82% e këtij stoku i korrespondonte vendeve të BE-së, me investitorë kryesorë Greqinë (48%) dhe Italinë (30%). Investitorë të tjerë domethënës jashtë këtij grupi (BE) janë Turqia dhe Libani.


Në fakt, Greqia dhe Italia kanë rritur ndjeshëm praninë e tyre në stokun e kapitalit të huaj në vend. Afërsia gjeografike e Shqipërisë me këto dy vende si dhe një bashkëpunim i fuqishëm ekonomik me BE-në, janë ndër arsyet kryesore për dominimin e investitorëve të huaj nga këto vende.

Grafik 1: Ecuria e Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri



Burimi: Raporti vjetor 2007, Banka e Shqipërisë

Grafik 2: Stoku i kapitalit të huaj sipas origjinës



Rritja e stokut të kapitalit të huaj në vite, vërehet të ketë qenë më e ndjeshme për sa i përket kapitalit grek. Ky i fundit, në fund të vitit 2004 vlerësohet në rreth 18 miliardë lekë nga 7 miliardë në fund të vitit 2001. Kapitali grek është i përqendruar kryesisht në sektorin e komunikacionit (68%) dhe tregtisë me shumicë (13%). Gjatë viteve të fundit është zbehur disi prania e tij në industrinë e veshjeve.

Për sa i përket kapitalit italian, në fund të vitit 2004, ky kapital u vlerësua me rreth 11 miliardë lekë nga rreth 4 miliardë në fund viti 2001. Pjesa më e madhe e këtij kapitali rezulton të jetë në industrinë përpunuese (65%) (Banka e Shqipërisë).

Industria përpunuese është sektori kryesor ku janë shfaqur investimet e huaja. Brenda kësaj kategorie, rreth 65% e kapitalit të huaj i drejtohen industrisë së tekstileve dhe veshjeve, përpunimit të ushqimeve dhe prodhimit të mobilie.

Përgjithësisht investimet e huaja në Shqipëri janë të përqendruara në zonat me të ardhura më të larta dhe infrastrukturë më të zhvilluar. Kështu duket se IHD-të në vendin janë të lokalizuara më shumë në Tiranë dhe në pjesën perëndimore të vendit ndërkohë që pjesa verilindore e vendit duket se është një nga zonat më pak të preferuara nga investitorët e huaj. Një përqindje e konsiderueshme të IHD-ve duket se kanë dhe zonat kufitare të tilla si Korça dhe Gjirokastra.


Në Shqipëri IHD-të janë të përqendruara në sektorë që kërkojnë përdorim intensiv të fuqisë punëtore. Kjo gjë përveç se vërtetohet nëpërmjet përqendrimit të investimeve sipas sektorëve, por edhe nga fakti se pavarësisht se vetëm 12 % e ndërmarrjeve me kapital të huaj janë ndërmarrje të mëdha (mbi 100 të punësuar) ato së bashku figurojnë të kenë punësuar rreth 61% të totalit të fuqisë punëtore.

Pavarësisht se në Shqipëri, legjislacioni vendas nuk vendos ndonjë kufi për kuotën e kapitalit të huaj nëpër ndërmarrje, sipas vërtetimit më të fundit të përbashkët të Bankës së Shqipërisë me INSTAT, rezulton se në pjesën më të madhe (66%) pjesëmarrja e kapitalit të huaj në ndërmarrje varion nga 75 deri në 100%.

3.2 Liria ekonomike si faktor përcaktues i IHD-ve


Të dhënat mbi Indeksin e Lirisë Ekonomike për periudhën 1995 – 2008 (Grafik 3), tregojnë se në Shqipëri, ky i fundit ka ardhur duke u rritur vit pas viti deri sa në 2008 u regjistrua në shifrën prej 60.3 %. Kjo shifër flet për një rritje me pothuaj 14 pikë që prej vitit 1995, vit në të cilën datojnë dhe të dhënat e para mbi Lirinë Ekonomike në Shqipëri. Kjo rritje, është një pasqyrë e qartë e reformave të njëpasnjëshme ekonomike të ndërmarra në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit dhe investimeve në vend.

Grafik 3: Ecuria e Lirisë Ekonomike – Rasti i Shqipërisë



Duke parë vlerat e indekseve për vitin 2008 (Grafik 4), duket se në vendin tonë mjedisi fiskal paraqitet si më i favorshëm (90,3% nga 100) për thithjen e investimeve të huaja. Kjo nënkupton se nivelet e dy tatimeve kryesore, tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi fitimin, janë ndër më të ulëta (Beach & Kane, 2007). Liria monetare është vlerësuar të jetë rreth 80 çka nënkupton se vendi ynë futet në grupin e vendeve ku ka stabilitet çmimesh dhe si rrjedhim nivele të ulëta të inflacionit.

Grafik 4: Indekset e Lirisë Ekonomike për vitin 2008



Sipas vlerave që marrin indekset për vitin 2008, problematike paraqiten niveli i korrupsionit dhe të drejtat mbi pronën (vlera të ulëta të indekseve përkatësisht 26%

dhe 30%). Pavarësisht masave të ndërmarra nga Qeveria, përsëri duket se shoqëria shqiptare nuk është e çliruar nga një fenomen i tillë pavarësisht nga përmirësimet që mund të jenë vënë re vit pas viti. Nivelet e ulëta të indeksit i cili lidhet me të drejtat e pronësisë tregojnë se në vendin tonë prona private mbrohet pak. Nga ana tjetër, sistemi gjyqësor është jo eficient në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë, ka korrupsion dhe gjyqësori është i varur dhe influencohet nga organizmat e tjera qeveritare. Për sa i përket treguesve të tjerë të Lirisë Ekonomike, situata paraqitet e mirë në lidhje me lirinë për të bërë tregti, lirinë për investime ndërkohë që liria për të bërë biznes dhe liria e punës paraqesin gjithsesi vlera mbi mesataren.

Duke analizuar të dhënat sipas funksionit linear të shpjeguar më sipër (3. Metodologjia) rezulton se Liria Ekonomike është një faktor përcaktues i flukseve hyrëse të investimeve të huaja. Variablat e përfshira në të, shpjegojnë në masën 75% modelin. Duke qenë se gama e faktorëve të cilat ndikojnë në nivelin e IHD-ve në një vend është tepër e gjerë dhe nuk kufizohet vetëm tek ata indikatorë që përmbledh Liria Ekonomike, për rastin e Shqipërisë një sërë variablash të tjera mund të ndikojnë në nivelin e investimeve. Të tilla variabla mund të përfshijnë kostot e transportit, madhësinë e tregut apo faktorë të brendshëm të kompanisë investuese.

Nga analiza e të dhënave rezulton se nga të gjitha indekset e marra në konsideratë, 3 prej tyre janë më të rëndësishmit për sa i përket rolit që ato kanë në flukset hyrëse të IHD-ve. Ato janë: liria për të bërë biznes, liria për të bërë tregti dhe mungesa e korrupsionit në vend.

“Liria për të bërë biznes” nënkupton aftësinë për të krijuar, menaxhuar dhe mbyllur një firmë lehtësisht dhe në mënyrë të shpejtë. Këtu përmbledhen 10 variabla të cilat kanë të bëjnë me procedurat dhe kostot (kohë dhe para) për të hapur dhe mbyllur një biznes si dhe për të siguruar një licencë. Vlera aktuale e këtij indeksi është regjistruar në 55.6%. Meqenëse ky është një ndër treguesit kryesor i cili ndikon në thithjen e investimeve të huaj, çdo lloj iniciative që çon në reduktimin e procedurave dhe kostove të hapjes dhe mbylljes së një biznesi dhe marrjes së një licence do të ndikojë direkt në nivelin e investimeve në vend. Në këtë këndvështrim mund të thuhet se krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ishte një hap i kyç dhe i domosdoshëm për nxitjen e investimeve të huaja dhe nëse diçka e tillë do të arrihej të bëhej dhe për licencat atëherë kjo patjetër që do të ndikonte direkt jo në vlerën e indeksit (do të kishim një rritje të ndjeshme të tij) por edhe në nivelin e IHD-ve.

“Liria për të bërë tregti” është një matës kompleks i mungesës së barrierave tarifore dhe jo tarifore që ndikojnë në importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Vlera e këtij indeksi për vitin 2008 sipas Heritage Foundation vlerësohet të jetë 70%, çka tregon për një mjedis të tillë ku barrierat tarifore dhe jo tarifore janë në nivele relativisht të ulëta. Në Shqipëri tregtia është e liberalizuar. Ky liberalizim ka filluar që prej vitit 1990 duke ndjekur udhëzimet përkatëse të BE-së në këtë drejtim. Si rezultati i liberalizimit dhe i procesit të vazhdueshëm të harmonizimit të rregullave doganore të vendosura nga shteti Shqiptar me ato të BE-së, për importin dhe eksportin e mallrave përgjithësisht nuk kërkohet ndonjë autorizim i veçantë me përjashtim të kuotave apo kërkesave për kontroll të vendosura përmes marrëveshjeve të ndryshme bilaterale dhe

multilaterale të firmosura nga shteti Shqiptar. Licencat janë të nevojshme vetëm për mallra të veçanta me qarkullim të kufizuar brenda vendit si produktet me rëndësi strategjike (ato të përdorura në ushtri, materialet radioaktive, drogat, barnat, etj.). Këto licenca lëshohen nga institucionet përkatëse si Ministria e Mbrojtjes për produkte ushtarake ose të rëndësishme strategjike, Ministria e Shëndetësisë për barnat, etj.

Eksportet nuk janë subjekt i asnjë lloji detyrimi apo takse. Importet gjithashtu nuk janë subjekt i asnjë takse importi përveç detyrimeve doganore. Këto të fundit janë subjekt i TVSH-së dhe disa produkte si: duhani, pijet alkoolike dhe nafta janë subjekt edhe i akcizave.

Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) në vitin 2000. Ajo aplikon rregullat e OBT-së për sa i përket licencave të importit për produkte strategjike të tilla si ato që ndikojnë në jetën dhe shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Për 7 vjet (Tetor, 1999 - Nëntor, 2006), për eksportet shqiptare drejt vendeve të BE-së zbatohej një regjim asimetrik tarifimi. Më 12 Qershor 2006, në Luksemburg Shqipëria firmosi Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit (MSA) me BE dhe si rezultat që prej 1 Dhjetorit 2006 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Ndërmjetme Shqipëri - BE e cila liberalizoi dhe më tej marrëdhëniet tregtare midis të dy palëve. Niveli i liberalizimit të produkteve Shqiptare që hyjnë në tregun e BE vlerësohet të jetë 98%. Marrëveshja e Ndërmjetme zëvendësoi Marrëveshjen për Bashkëpunim Ekonomik dhe Tregtar midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjithë vendet anëtare të BE-së të ratifikojnë Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit me vendin tonë.

Indeksi i “Mungesës së korrupsionit” bazohet në të dhëna sasiore që vlerësojnë perceptimin e korrupsionit në mjedisin e biznesit përfshirë këtu korrupsionin në nivel qeveritar, korrupsionin e gjyqësorit dhe administratës publike. Niveli i ulët i këtij indeksi tregon për nivele ende të larta të korrupsionit në të tre nivelet e sipërpërmendura pavarësisht masave të ndërmarra çka është pengesë serioze në thithjen e investimeve të huaja në vend.

4. Konkluzione

Deri më tani, niveli i IHD-ve në vendin tonë kanë qenë i lidhur direkt me privatizimet e realizuara në sektorët strategjikë të ekonomisë. Për këtë arsye, kapitali huaj në Shqipëri është paraqitur më së shumti në formën e shkrirjeve dhe të blerjeve. Tani që procesit të privatizimeve po i vjen fundi, është më se e domosdoshme që strategjitë e qeverisë dhe institucioneve të lidhura me të, të fokusohen tek investimet e ashtuquajtura “greenfield”.

Aktualisht, investitorët nga vendet e BE-së dominojnë investimet e huaja direkte në Shqipëri, ndër të cilët spikasin ata Grekë (telekomunikacion) dhe Italianë (industri përpunuese). Pas privatizimeve, industria përpunuese është sektori kryesor ku janë shfaqur investimet e huaja. Brenda kësaj kategorie, rreth 65% e kapitalit të huaj i drejtohen industrisë së tekstileve dhe veshjeve, përpunimit të ushqimeve dhe prodhimit të mobilie.

Promovimi i investimeve të huaja është thelbësor për vetë rolin që kanë investimet e huaja në rritjen ekonomike. Krijimi i një mjedisi sa më të favorshëm për investitorët e huaj është një faktorët kyç që shërben për t'i orientuar këta të fundit drejt një vendi të caktuar. Në rastin e Shqipërisë, Liria ekonomike si një tregues kompleks i mjedisit, është një faktor përcaktues i flukseve hyrëse të IHD-ve. Ndër 10 treguesit e Lirisë Ekonomike, liria për të bërë biznes, liria për të bërë tregti dhe mungesa e korrupsionit në vend janë më të rëndësishmit. Pavarësisht masave të ndërmarra deri më tani në lidhje me liberalizimin e tregtisë, reduktimin e nivelit të korrupsionit në vend dhe procedura e kostove për të hapur, mbyllur dhe licencuar një biznes, çdo lloj përpjekje e mëtejshme e organizmave qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në përmirësimin e çdo lloj indikatorit në lidhje këta tregues do të ketë efekt në nivelin e IHD-ve në Shqipëri.

Bibliografia

- Beach, W. & Kane, T., 2008 Index of Economic Freedom: *The link between economic opportunity and prosperity*, pp 39 – 55, Washington: The Heritage Foundation.
- Beheshtitabar, E., & Irgalijev, A. "The impact of Economic Freedom on FDI inflow in developing countries: the case of Middle East", Jonkoping International Business School, Spring 2008.
- Buletini Ekonomik, vëllimi 9, numër, pp. 95 – 105, Banka e Shqipërisë, Qershor 2006.
- Dunning J.H., *Multinational Enterprises and the Global Economy*, Harlow Essex, Addison – Wesley Publication Company, 1993.
- Kumar, N., *Globalization and the Quality of Foreign Direct Investments*, Oxford University Press, 2002.
- Raporti Vjetor 2007, Banka e Shqipërisë.
- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2007 – 2013, METE.
- <http://www.heritage.org/research/features/index/downloads/2008PastScores.xls>.

Pronësia kombëtare, faktor kyç për efektivitetin e ndihmës së huaj

Evis Gjebreja

ABSTRAKT. Në ditët e sotme “efektiviteti i ndihmës së huaj” është termi që hasim më shumë kur i referohemi ndihmës së huaj që vendet e zhvilluara (donatorët) japin për vendet në zhvillim (vendet përfituese) për t’i ndihmuar këto të fundit të arrijnë rritjen ekonomike. Kjo madje është bërë një çështje mjaft e rëndësishme po të kemi parasysh angazhimet globale të marra përsipër ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe ato në zhvillim për përgjysmimin e varfërisë deri në vitin 2015. Kjo është e rëndësishme pasi vendet në zhvillim kanë marrë përsipër angazhime që lidhen me përmbushjen e objektivave afatgjatë, ndërsa donatorët pritet që në këmbim të sigurojnë fonde të mëdha të ndihmës së huaj për të mbështetur arritjen e këtyre objektivave. Si rrjedhim, pyetja që shtrohet është si mund të arrihet efektiviteti i ndihmës së huaj? Ka disa mënyra dhe qëllimi i këtij punimi është të përcaktojë një prej faktorëve kyçë, siç është pronësia kombëtare (country ownership), e cila konsiderohet më sfiduesja dhe më e rëndësishmja. E përmenda jo pa qëllim rëndësinë e këtij faktori, pasi është një koncept i ri dhe përbën bazën për rritjen e qëndrueshme, si dhe influencon procesin e vendimmarrjes së donatorëve për të ofruar ndihmë të huaj. Duke qenë se procesi i pronësisë kombëtare përfshin disa aktorë, një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet partneritetit në nivele të ndryshme, cilësia e të cilëve është përcaktuese për pronësinë kombëtare.

Përgjatë gjithë këtij punimi, një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet mënyrave të ndërtimit të partneritetit kombëtar me qëllim arritjen e pronësisë kombëtare. Pjesa e parë shpjegon arsyet e zhvendosjes nga ndihma e kushtëzuar nga kushtet e vendosura prej donatorëve drejt pronësisë dhe partneritetit kombëtar. Pjesa e dytë shtjellon mënyrat e krijimit të pronësisë dhe partneritetit kombëtar. Pjesa e tretë jep një rast studimi të Ganës, si një vend me eksperiencë të mirë. Pjesa e katërt jep një rast studimi të Zambias si një vend me eksperiencë jo të mirë. Pjesa e fundit jep rekomandime dhe konkluzione.

1. Nga ndihma e kushtëzuar nga donatorët, drejt krijimit të pronësisë dhe partneritetit kombëtar

Kushtëzimi i ndihmës nga donatorët e ka zanafillën që në vitet 80’, kur Banka Botërore futi konceptin e Rregullimit Struktural për të mbështetur mangësitë e bilancit të pagesave. Një nga instrumentet kryesore të Bankës

Botërore për të mbështetur politikat dhe reformat institucionale është huadhënia rregulluese. Ky instrument është i nevojshëm për të inkurajuar rritjen e barabartë dhe të qëndrueshme, thelbësore për uljen e varfërisë, nëpërmjet disbursimit të menjëhershëm të ndihmave tek vendet me nevoja të financimit të huaj, kushtëzuar nga zbatimi i reformave të veçanta.

Shpesh në të kaluarën, ky proces ka qenë i drejtuar nga donatorët pa shumë konsultim me qeverinë e vendit përfitues dhe rezultatet kanë qenë të dëmshme si për donatorët ashtu edhe për përfituesin. Të metat e financimit të udhëhequr vetëm nga donatori janë paaftësia nga shumë donatorë për të siguruar efencë të huadhënies bazuar në arritjet e reformave, për të garantuar qëndrueshmërinë e reformave, për të përfshirë aktorë të ndryshëm në proces, për të vendosur kushte objektive që reflektojnë realitetet ekonomike, politike, sociale dhe mjedisore të vendit (Koeberle, Stefan, 2005, pp 59-60).

Për shembull ndihma e huaj dhënë Afrikës është vlerësuar si jo efektive sepse nuk i ndryshoi jetët e afrikanëve më të varfër. Përafërsisht, 1 trilion dollarë e ndihmës së huaj ka shkuar në Afrikë gjatë gjysmës së fundit të shekullit, por përsëri varfëria është rritur (Pomerantz, Phyllis R, pp1). Mosefektiviteti i ndihmës së huaj në Afrikë vjen si rrjedhim i dhënies së saj jo për qëllime zhvillimi pasi ka qenë e drejtuar nga donatorët me shumë pak input nga qeveria Afrikane dhe për shkak të kapacitetit të ulët nga institucionet afrikane për të zbatuar programet/projektet (Lancaster, Carol, 1999, p 221-224).

Ky mosefektivitet i ndihmës krijon tensione si për donatorët ashtu edhe për vendin përfitues, pasi huadhënia mund të përsëritet për të njëjtat fusha si përpara dhe rëndojnë vendin përfitues duke i vendosur kushte të tjera të panevojshme që çojnë gjithashtu edhe në rritjen e borxhit të jashtëm.

Për arsyt e përmendura më sipër, Banka Botërore e ka ndryshuar modelin e saj për kushtëzimin duke futur konceptin e ri të Kuadrit të Zhvillimit Gjithëpërfshirës, që bazohet jo në kushtëzim, por në një marrëdhënie partneriteti ndërmjet Bankës Botërore që luan rolin institucional të “Bankës me Njohuri” dhe qeverisë huamarrëse që ka pronësi të plotë mbi politikat që ka zgjedhur për të ndjekur (Pender, John, 2001, pp 1).

Në të njëjtën kohë, Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për përgjysmimin e varfërisë deri në vitin 2015, kërkon volume të mëdha ndihmash nga komuniteti i donatorëve. Me qëllim që këto ndihma të jenë efektive, vendet përfituese kanë përgjegjësinë për të drejtuar procesin dhe për të përcaktuar prioritetet në bashkëpunim me aktorët e përfshirë, si dhe të bashkëpunojnë me donatorët për të përputhur ndihmat e tyre me prioritetet e përcaktuara nga vetë vendet (Banka Botërore, 2005, pp 3).

Cili është përkufizimi për pronësinë kombëtare?

Pronësia kombëtare do të thotë që ekziston mbështetje e mjaftueshme politike dhe kapaciteti institucional për zbatimin e një strategjie kombëtare zhvillimi që përfshin projekte, programe dhe politika për të cilat partnerët e huaj japin ndihmat. Pronësia kombëtare kërkon që qeveria të ketë mbështetje të mjaftueshme për strategjinë

ndërmjet aktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë qeverisë¹.

Vendet në zhvillim kanë shumë sfida kundrejt realizimit të reformave të tyre si rrjedhim, pronësia kombëtare nuk eliminon kushtëzimin nga ana e donatorëve, por i drejton donatorët që të alokojnë burimet e tyre drejt vendeve që kanë hartuar vetë strategjitë e tyre.

2. Liderhipi dhe proceset konsultative, si mënyra për krijimin e partneritetit dhe pronësisë kombëtare

Pronësia kombëtare nuk ndodh menjëherë, por është rezultat i një procesi të vazhdueshëm dhe të gjithë aktorët e përfshirë duhet të bëjnë përpjekje për ta siguruar atë. Duke qenë se vendet kanë përgjegjësinë e hartimit dhe zbatimit të strategjisë së zhvillimit kombëtar, Pushteti Qendror është aktori kryesor, roli i të cilit është:

- drejtimi i procesit të hartimit të strategjisë së zhvillimit kombëtar e shoqëruar nga një pjesëmarrje aktive e ekzekutivit;
- të ketë kapacitete institucionale të mjaftueshme për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së zhvillimit kombëtar;
- ndërtimi i partneritetit me aktorët brenda dhe jashtë vendit në kuadër të hartimit dhe zbatimit të strategjisë së zhvillimit kombëtar.

Në mënyrë praktike Qeverisë i kërkohet të:

1. Përcaktojë vizionin afatgjatë dhe prioritetet në strategjinë e saj kombëtare të zhvillimit, e cila duhet të formulohet nëpërmjet një procesi pjesëmarrës.
2. Lidhë prioritetet me kuadrin afatmesëm të shpenzimeve dhe me buxhetet vjetore.

Cilët janë aktorët dhe përse është e rëndësishme përfshirja e tyre?

Aktorët brenda vendit janë shoqëria civile, sektori privat dhe Parlamenti. Shoqëria Civile është pjesë e kapitalit social, dhe si rrjedhim, përfshirja e saj sjell zërin e njerëzve dhe e bën procesin më transparent dhe të përgjegjshëm. Përfshirja e sektorit privat është e rëndësishme pasi shumë prej Letër Strategjive për Uljen e Varfërisë vënë theksin në zhvillimin e sektorit privat si motori i rritjes ekonomike.

Përfshirja e Parlamentit është e rëndësishme sepse krijon më shumë debate gjatë procesit të hartimit të Letër Strategjisë për Uljen e Varfërisë dhe ndihmon në krijimin e lidhjes ndërmjet strategjive kombëtare dhe alokimit të buxhetit, pasi në shumë vende roli i Parlamentit është të miratojë dhe mbikëqyrë buxhetin. Ndërsa literatura për “zhvillimin” shpesh e harron, parlamentet më shumë se thjesht “aktorë” – janë një nga institucionet thelbësore të përfaqësimit demokratik. Anashkalimi i parlamenteve, ashtu siç ndodh ndonjëherë në procese të tilla mund të dobësojë legjitimitetin demokratik.

1 <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/STRATEGIES/CDF/0,,contenMDK:20072933~menuPK:140843~pagePK:139301~piPK:139306~theSitePK:140576,00.html>

Për partnerët e jashtëm, zakonisht përfshirja në një partneritet efektiv për zhvillim varet në respektimin e principit të pronësisë kombëtare: partneriteti i drejtuar nga qeveria dhe nga aktorët e vendit ndihmon për të siguruar se ndihma e huaj drejtohet nga kërkesa. Përfshirja në mënyrë të efektshme në partneritetet përfshin tre procese plotësuese: harmonizimin, koordinimin dhe përshtatjen.

Qëllimi i këtij studimi nuk është për të shkuar në detaje për secilën nga këto procese plotësuese, si rrjedhim do të paraqesim vetëm përkufizimin e tyre. Përshtatshmëria do të thotë dhënia e ndihmës në përputhje me prioritetet e strategjisë së zhvillimit kombëtar. Harmonizimi do të thotë të adoptosh procese dhe sisteme më të thjeshta dhe të përbashkëta që ulin kostot e transaksioneve dhe që lidhen me asistencën e zhvillimit dhe përdorimi i strukturave, proceseve dhe sistemeve ekzistuese institucionale. Koordinim do të thotë ndarja e detyrave partnerëve të zhvillimit për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese dhe për të shmangur gjërat e panevojshme (**redundancies**)².

Të ndërtosh partneritetet nuk është një detyrë e lehtë sepse pjesëmarrësit janë të shumtë, mund të kenë qëllime dhe objektiva të ndryshme, mund t'ju mungojnë njohuritë dhe ndërkohë që sfida për vendin është të gjejë një mirëkuptim të përbashkët. Pjesa që ngelet për këtë seksion do t'i kushtojë vëmendje elementeve të ndërtimit të partneritetit.

Elementi bazë në ndërtimin e partneritetit është besimi. Besimi bazohet deri në njëfarë mase në qëllimin e përbashkët, angazhimin, besueshmërinë, familjaritetin, transparencën dhe ndershmërinë dhe komunikimin e hapur. (Pomerantz, Phyllis R, 2004, pp 12). *Francis Fukuyama argumenton se niveli i besimit në një shoqëri është kryesor për zhvillimin ekonomik, pasi kontribuon në ndërtimin e kapitalit social, dhe si rrjedhim, influencon pozitivisht aftësinë e një kombi apo komuniteti për të begatuar.* (Pomerantz, Phyllis R, 2004, pp 19).

Qëllimi i përbashkët do të thotë të kesh qëllime dhe objektiva të përbashkëta. Në një nivel formal donatorët dhe vendet në zhvillim kanë objektiva të përbashkëta për të ulur varfërinë dhe vuajtjen njerëzore. Në nivelin e vendit individual, objektivat mund të jenë të përbashkëta, por ka diferenca në hapat dhe kohën sesi të arrihet deri atje. Për shembull, realitetet politike dhe presionet e hasura nga qeveritë Afrikane shpesh diktojnë rrugë të tjera veprimi sesa ato të rekomanduara nga donatorët. Donatorët e interpretojnë si një problem të vullnetit politik, ndërsa zyrtarët Afrikanë kanë mendimin se donatorët nuk kuptojnë realitetet e vendit (Pomerantz, Phyllis R, 2004, pp 24-25).

Një tjetër element i rëndësishëm i besimit është angazhimi, i cili duhet të ekzistojë ndërmjet të dyja palëve që kanë qëllime dhe objektiva të përbashkëta. Një angazhim më i madh nga vendi përfitues është shumë i rëndësishëm sepse drejton procesin dhe influencon procesin e vendimmarrjes së donatorit. Kur gjykohet hartimi i strategjisë kombëtare të zhvillimit të vendit një mënyrë për donatorët për të matur angazhimin e vendit përfitues është sesa pjesëmarrës ishte procesi i

2 <http://web.worldbank.org/WSITE/EXTERNAL/PROJECTS/STRATEGIES/CDF/0,,contentMDK:20072936~menuPK:140851~pagePK:139301~piPK:261885~theSitePK:140576,00.html>

hartimit të tij. Një mënyrë për vendin përfitues për të matur angazhimin nga ana e donatorëve është mbështetja që ata japin gjatë procesit të hartimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit.

Besueshmëria ka të bëjë më shumë me historinë e marrëdhënieve që kanë ekzistuar ndërmjet donatorëve dhe vendeve përfituese. Për disa vende në zhvillim disa donatorë duken më të besueshëm se të tjerët, sepse këta donatorë i ruajtën premtimet dhe u përgjigjën në kohë ndaj nevojave të vendeve në zhvillim. Për shembull, qeveritë Afrikane kanë tendencën të shohin disa donatorë më të besueshëm se të tjerët, sepse ata siguruan menjëherë fondet në kohë emergjence. (Pomerantz, Phyllis R, 2004, pp 32). Për donatorin çelësi i besueshmërisë janë procedurat e brendshme nga vendet huamarrëse për ta bërë ndihmën sa më efektive, si dhe angazhimi për të zbatuar projekte/programe brenda afateve të përcaktuara.


Familjariteti është një koncept i gjerë pasi përfshin disa aspekte. Nga këndvështrimi i donatorit do të thotë masa deri në të cilën ata janë familjarë me mjedisin e brendshëm të vendit përfitues (ekonomik, social, kulturor etj), e cila do të influencojë më vonë marrëdhëniet ndërmjet vendit përfitues dhe donatorit, dhe alokimin e fondeve të tyre. Nga këndvështrimi i vendit përfitues, do të thotë masa deri në të cilën ata njohin procedurat e donatorit, mjedisin në të cilin ata veprojnë. Të jesh familiar me mjediset lokale të të dyja palëve kërkon kohë dhe përpjekje të mëtijshme për të rritur reputacionin.

Ashtu siç e përmendëm në pjesën hyrëse në të kaluarën asistencë nuk ka qenë efektive sepse ishte e drejtuar nga interesat e donatorëve, të cilët nuk ishin familjarë me mjediset vendase të vendeve përfituese dhe rezultati ishte hartimi i projekteve dhe programeve jo realiste. Familjariteti nga ana e donatorëve me mjediset e vendeve përfituese do t'i ndihmojë ata të gjykojnë objektivitetin e strategjisë së zhvillimit kombëtar dhe të drejtojnë asistencën e tyre.

Transparencë do të thotë ndarja (dhënia) e informacionit. Për donatorin është e rëndësishme që vendi përfitues të ndajë informacion për disa dokumente kyçe me partnerët lokale dhe publikun e gjerë. Kjo do të ndihmojë donatorët në marrjen e vendimeve për dhënie e asistencës. Për vendin përfitues është e rëndësishme që donatorët të ndajnë informacionin lidhur me strategjitë e vendeve dhe financimet e tyre afatgjata, në mënyrë të tillë që vendet përfituese të njihen me vendimet strategjike të donatorëve dhe të jenë në gjendje të parashikojnë asistencën.

Ndershmëria dhe komunikimi i hapur janë elemente shumë të rëndësishëm të transparencës. Komunikimi influencon marrëdhëniet ndërmjet dy palëve. Është e rëndësishme sepse përfshin gjuhë të ndryshme që mund të jenë pengesë për partneritetin dhe si rezultat për pronësinë kombëtare. Të dyja palët duhet të sillen në mënyrë diplomatike dhe të ndërtojnë një komunikim të thjeshtë.

Në mënyrë të përmblëdhur ndërtimi i Partneritetit mund të paraqitet sipas paraqitjes grafike të mëposhtme:



Megjithëse në një nivel formal vendet në zhvillim dhe donatorët kanë objektiva të përbashkëta për uljen e varfërisë dhe janë të angazhuar të ndërtojnë partneritet, ky proces është i lehtë po t'i referohemi disa donatorëve, ndërsa jo aq i lehtë nëse iu referohemi të tjerëve. Nëse i referohemi ndihmës Japoneze arrijmë në përfundimin se karakterizohet nga: mos familiariteti me nevojat vendase, ndikim jo shumë domethënës në çështjet e uljes së varfërisë, shumë burokraci që i komplikon procedurat e ndihmës dhe vështirësia për tu marrë me kultura të tjera. Ndërsa nuk është rasti për ndihmën Suedeze e cila karakterizohet nga asistenca për uljen e varfërisë dhe partneritet me përfituesit, donatorit dhe OJQ-ve ndërkombëtare dhe administrimit transparent dhe me pjesëmarrjen e publikut për të siguruar efektivitetin dhe eficientë. (Arase, David, 2005, pp 14-15).

Përse donatorët sillen në mënyrë kaq të ndryshme? Gjithçka lidhet me çështjet filozofike që drejojnë ndihmën. Ndihma japoneze përmban supozimin se zhvillim do të thotë rritja e prodhimit industrial dhe tregtisë në një proces të drejtuar nga shteti që mund të përparojë nëpërmjet projekteve që lidhen me ndërtimin dhe blerjen e teknologjive përkatëse. (Arase, David, 2005, pp 268). Ndërkohë që ndihma suedeze ka përcaktuar standardin ndërkombëtar drejt filozofisë së ndihmës humanitare (Arase, David, 2005, pp 15)

Mësimet e Nxjerra

Ndihma e diktuar nga donatorët pa konsultimin me vendin përfitues ka rezultuar të jetë e paefektshme pasi ka qenë e diktuar sipas interesave të donatorëve duke mos

i shërbyer nevojave të vendit përfitues dhe në shumë raste donatorët nuk kanë qenë familjarë me mjedisin ekonomik, kulturor dhe social të vendeve përfituese. Si rezultat prioritetet e vëna kanë dëmtuar qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik.

Në të kundërt, ndihma e diktuar nga prioritetet e vendosura nga vetë vendet përfituese ofrojnë shumë më tepër premtime për efektivitetin e ndihmës sepse vendi përfitues ka pronësi ndaj këtij procesi dhe ka shumë të ngjarë që prioritetet të jenë më realiste pasi vetë vendi njih mjedisin më mirë se kushdo tjetër, njeh kapacitetet që ka për t'i zbatuar dhe procesi është pjesëmarrës ndërmjet palëve.

Pronësia kombëtare nuk është një proces që ka një fillim dhe fund por është një proces i vazhdueshëm dhe përfshin disa ndërveprime ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë. Duke marrë në konsideratë se të gjithë aktorët kanë një qëllim në proces, në vend që të ndërtohet vetëm një marrëdhënie vendet përfituese duhet të ndërtojnë partneritete dhe të ndajnë së bashku përpjekjet me partnerët e tyre për qëllimin final të sigurimit të pronësisë kombëtare.

3. Shembujt më të mirë të Pronësisë Kombëtare dhe Partneriteti- një rast studimi i Ganës

Të dhëna mbi vendin

Gana është një vend me të ardhura të ulëta, por synon të arrijë nivelin e një vendi me të ardhura të mesme. Ekonomia e Ganës ka regjistruar një rritje të kënaqshme ekonomike që nga viti 2000. Rritja reale e PBB-së u rrit nga 3.7% në 5.9% ndërmjet viteve 2000 dhe 2005. Normat aktuale të rritjes e kanë vënë Ganën në rrugë të mirë për të arritur Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit « përgjysmimi i varfërisë deri në vitin 2015 ».

Në vitin 2005 indikator i zbutjes së varfërisë ekstreme ishte 33.4%, i cili është një indikator i mirë krahasuar me objektivin që vendi ka për të arritur deri në vitin 2015 prej 26%. Vlerësimet për vendin e vendosin Ganën në krye të listës së vendeve afrikane (Banka Botërore, 2007, pp6). Gana është e angazhuar të arrijë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe ka nënshkruar gjithashtu Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj.

Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së huaj ka përcaktuar disa indikatorë që vendet duhet të arrijnë me qëllim që ndihma e huaj të jetë efektive. Megjithatë indikator i pronësisë kombëtare kërkon që vendi të ketë hartuar Letër Strategjinë e Uljes së Varfërisë për të udhëhequr koordinimin e ndihmës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, në këtë rast do të hedhim një vështrim edhe mbi indikatorët e tjerë. Arsyeja është sepse mund të jetë e vështirë të arrihet një konkluzion mbi partneritetin dhe pronësinë kombëtare duke vlerësuar vlefshmërinë e strategjisë kombëtare dhe të përjashtohet përshtatja e ndihmës së donatorëve me prioritetet kombëtare ose harmonizimi i donatorëve në drejtim të përdorimit të sistemeve të vendit, besueshmërinë e sistemeve të vendit ose koordinimi i donatorëve.

Arritjet e pronësisë kombëtare

Sipas rezultateve të Anketimit të vitit 2006 mbi Monitorimin e Deklaratës së Parisit, pronësia kombëtare e Ganës në shkallën zbritëse nga A në E vlerësohet në kategorinë C. Objektivi që Gana ka deri në vitin 2010 është të jetë në kategorinë B ose A.

Kjo ecuri i atribuohet si më poshtë (OECD, 2007 (a), pp 1-12):

- Rolit drejtues të Qeverisë në hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar dhe koordinimi i asistencës së zhvillimit. Deri më sot Gana ka formuluar dy Letër Strategji të Uljes së Varfërisë.

Një tregues i ecurisë së deritanishme është kuadri i politikave të vendit të arritura nga projektimi i objektivave afat mesme dhe gjithashtu nga lidhja e strategjive me burimet e buxhetit. Megjithatë, një nga pikat e dobëta të vendit është mungesa e racionalitetit dhe veprimtarive.

- Procesit pjesëmarrës të Qeverisë me aktorët vendas në procesin e formulimit të Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar: - Shoqëria civile është aktive dhe një faktor kryesor për reformat e qeverisjes politike. Lëvizjet e fermerëve, Unionet Tregtare dhe Shoqatat Profesionale tradicionalisht kanë qenë të përfshira në procesin politik të vendit. Së fundi edhe organizata të tjera si: shoqata për zhvillimin e qyteteve, grupi i të drejtave të grave, klubet e mirëqenies, shoqata e mësuesve në familje, organizatat fetare janë pjesë e angazhimit të shoqërisë civile (Banka Botërore, 2007, pp 5).
- Procesit pjesëmarrës të Qeverisë me donatorët: - Të gjithë donatorët kanë nënshkruar strategjinë e partneritetit të rënë dakord në Nëntor 2005, e cila thekson lidhjen e fondeve. Lidhja e fondeve të donatorëve me prioritetet kombëtare raportohet nga indikatori i parashikimeve të buxhetit të Qeverisë mbi ndihmat e disbursuara nga donatorët që është 96% dhe është një indikator i mirë krahasuar me objektivin prej 98% që vendi duhet të arrijë deri në vitin 2010.
- Sistemeve të besueshme të vendit nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit financiar publik. Vlerësimi Institucional dhe i Politikave të Vëndit i kryer nga Banka Botërore i jep Ganës një vlerësim prej 3.5 për cilësinë e menaxhimit buxhetor dhe financiar publik, që është mbi mesataren për Vendet anëtare të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, pjesë e grupit të Bankës Botërore.
- Zhvillimit të kapaciteteve nëpërmjet mbështetjes së koordinuar të donatorëve. Ky indikator është 40% krahasuar me objektivin prej 50% që duhet të arrihet deri në vitin 2010.
- Përdorimit të sistemeve të vendit. Ky indikator është 62% krahasuar me objektivin prej 75% që duhet të arrihet deri në 2010. Ky rezultat i mirë i atribuohet përdorimit të mbështetjes buxhetore që aplikohet nga shumë donatorë.
- Një kuadri të përgjegjshmërisë reciproke i cili tashmë ekziston: - Qeverive iu kërkohet të përmirësojnë sistemet e përgjegjshmërisë së vendit, ndërkohë që donatorët duhet të jenë transparentë në lidhje me kontributet e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur arritjet e Pronësisë Kombëtare paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Indikatori	Arritjet e deritanishme	Objektivi për tu përmbushur deri në 2010
Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar	2 Letër Strategji të Uljes së Varfërisë	Strategji operacionale për të drejtuar koordinimin e ndihmës së huaj dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit
Pjesëmarrja e Qeverisë me aktorët vendas	√	
Lidhja e fondeve të donatorëve me prioritetet kombëtare (parashikimi i buxhetit / ndihmat e disbursuara)	96%	98%
Vlerësimi Institucional dhe i Politikave të Vëndit	3.5 (më e lartë se mesatarja prej 3.2 për vendet e IDA)	Përmbushur
Zhvillimi i Kapaciteteve	40%	50%
Përmirësimi i sistemeve të vëndit	62%	75%
Kuadri i Përgjegjshmërisë së Vëndit	√	

4. Pronësia kombëtare dhe partneriteti dhe hapat e mëtejshëm – (rasti i Zambias)

Zambia është një vend me të ardhura të ulëta. Sipas anketimit të fundit (Anketimi për Monitorimin e Kushteve të Jetesës për vitin 2004) 68% e njerëzve jetojnë nën linjën e varfërisë dhe 53% nga këto klasifikohen si shumë të varfër. Zambia mbështetet kryesisht në ndihmat e huaja, si rrjedhim efektiviteti i ndihmës është thelbësor [OECD, 2007 (b)].

Arritjet e pronësisë kombëtare [OECD, 2007 (b), pp 1-11].

Ashtu siç u përmend me sipër, sipas rezultateve të Monitorimit të Deklaratës së Parisit, pronësia kombëtare e Zambias në shkallën zbritëse nga A në E klasifikohet në kategorinë C. Objektivi që Zambia ka deri në vitin 2010 është që të jetë në kategorinë B ose A. Ndonëse në përgjithësi ky është një rezultat i mirë, po të analizojmë edhe indikatorë të tjerë arrijmë në përfundimin se pronësia kombëtare dhe partneriteti i Zambias është ende një sfidë.

Disa nga sfidat janë:

- Strategjia e zhvillimit kombëtar është duke u përgatitur dhe nuk ka përfunduar ende. Ekziston një kuadër afat mesëm i shpenzimeve, por lidhja ndërmjet prioritetëve dhe buxhetit është e dobët.
- Cilësia e menaxhimit buxhetor dhe atij financiar publik është vlerësuar me numrin 3 më ulët se mesatarja prej 3.2 për të gjitha vendet anëtare të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.
- Lidhja e fondeve të donatorëve me prioritetet kombëtare që reflektojnë vlerësimet buxhetore mbi disbursimet nga donatorët vlerësohet të jetë 52% krahasuar me objektivin prej 85% që duhet të arrihet deri në vitin 2010.
- Zhvillimi i kapaciteteve nëpërmjet ndihmës së koordinuar të donatorëve vlerësohet të jetë 32% krahasuar me 50% që është objektivi që duhet të arrihet deri në vitin 2010.
- Përdorimi i sistemeve të vendit. Ky indikator është 34% krahasuar me objektivin prej 75% që duhet të arrihet deri në vitin 2010.
- Nuk ekziston ende një kuadër i përgjegjshmërisë reciproke nëpërmjet së cilës qeverive t'ju kërkohet të përmirësojnë sistemet e përgjegjshmërisë së vendit, ndërkohë që donatorët duhet të jenë transparente për kontributet e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, arritjet e Pronësisë Kombëtare paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Indikatori	Arritjet e deritanishme	Objektivi për tu përmbushur deri në 2010
Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar	Në hartim e sipër	Strategji operacionale për të drejtuar koordinimin e ndihmës së huaj dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit
Lidhja e fondeve të donatorëve me prioritetet kombëtare (parashikimi i buxhetit /ndihmat e disbursuara)	52%	85%
Vlerësimi Institucional dhe i Politikave të Vëndit	3 (më e ulët se mesatarja prej 3.2 për vendet e IDA)	
Zhvillimi i Kapaciteteve	32%	50%
Përmirësimi i sistemeve të vendit	34%	75%
Kuadri i Përgjegjshmërisë së Vëndit lidhur me përmirësimin e sistemeve të përgjegjshmërisë së vendit	Ende jo	

Hapat e mëtejshme për Qeverinë dhe Donatorët në Zambia janë si më poshtë:

1. Qeveria duhet të përmirësojë sistemet e përgjegjshmërisë së vendit.
2. Qeveria duhet të përmirësojë kapacitetet për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Kombëtar.
3. Donatorët duhet të jenë transparentë për kontributet e tyre dhe të ndihmojnë vendin të rrisë kapacitetet e tij.

Ashtu siç teoria e shpjegoi, pronësia kombëtare nuk është një detyrë e lehtë dhe suksesi i tij ndryshon nga vendi në vend. Si rezultat, vendet që kanë arritje jo të mirë siç është rasti i Zambias duhet të vënë në përdorim praktikatat më të mira si p.sh. të Ganës sepse megjithëse rrethanat e vendit ndryshojnë, konceptet për ndërtimin e partneritetit të vendit dhe të pronësisë janë të njëjta.

Rekomandime

Ashtu siç e shpjegoi teoria, pronësia kombëtare kërkon që vetë vendi të hartojë strategjinë e tij të zhvillimit kombëtar nëpërmjet një procesi pjesëmarrës ndërmjet aktorëve si brenda dhe jashtë vendit dhe të kenë kapacitetet e ngritura për t'i zbatuar. Ky proces kontribuon për efektivitetin e ndihmës sepse vendi përfitues vendos vetë mbi prioritetet, të cilat në shumicën e rasteve janë objektive, pasi vendi përfitues është i familjarizuar me mjedisin e brendshëm, i njeh më mirë kapacitetet që ka për zbatimin dhe është një proces pjesëmarrës ku të gjithë aktorët duhet të kenë një pjesë dhe si rrjedhim të përmirësojnë procesin.

Por eksperiencia tregon se të matësh efektivitetin e ndihmës nëpërmjet indikatorit të pronësisë së vendit - e cila parashikon që vendi të ketë një strategji kombëtare operacionale - nuk është e lehtë dhe deri diku kontradiktore. Për shembull si Gana ashtu edhe Zambia u vlerësuan njësoj për sa i përket indikatorit të Pronësisë Kombëtare, megjithëse Gana ka përgatitur dy strategji të zhvillimit kombëtar, ndërkohë që Zambia është ende duke e përgatitur. Si rrjedhim, nuk është e qartë se çfarë konkluzioni mund të arrihet për sa i përket efektivitetit të ndihmës në rastin e Zambias nëpërmjet pronësisë kombëtare.

Meqenëse indikatorit i pronësisë kombëtare mat masën në të cilën një vend ka një strategji operacionale të zhvillimit kombëtar për të drejtuar koordinimin e ndihmës dhe të zhvillimit në përgjithësi të vendit, rekomandohet që vlerësimi i këtij indikatorit të bëhet mbi bazën e të gjithë indikatorëve të tjerë që plotësojnë pronësinë kombëtare dhe i cili mund të reflektojë në mënyrë më objektive operacionalizimin e strategjisë së vendit.

Konkluzion

Në ditët e sotme, arritja e efektivitetit të ndihmës është bërë tema e ditës si rezultat i angazhimeve të bëra ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim për të përgjysmuar varfërinë deri në vitin 2015, e cila parashikon arritjen e objektivave afatgjatë nga vendet në zhvillim dhe sigurimin e shumave të mëdha nga vendet e zhvilluara.

Pronësia kombëtare është kyç në efektivitetin e ndihmave sepse përbën bazën për rritje të qëndrueshme – pasi vendet vendosin vetë lidhur me prioritetet e tyre – dhe influencojnë procesin e vendimmarrjes së donatorëve – pasi ata japin asistencën bazuar në prioritetet e vendosura. Si rrjedhim, të arrish pronësinë kombëtare dhe ta matësh atë në mënyrë objektive është sfida si për vendet e zhvilluara, ashtu edhe për ato në zhvillim.

Rasti i Shqipërisë

Gjatë procesit të gjatë të tranzicionit, Shqipëria (dhe do të ishte e saktë të thuhej për të gjitha vendet e Ballkanit) është mbështetur në rrugën e saj drejt demokratizimit dhe ekonomisë së tregut të lirë nga donatorët bilateralë dhe multilateralë dhe Banka Botërore ka qenë dhe është një nga partnerët më të rëndësishëm të vendit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe Banka Botërore ka dhënë më shumë se 950 milionë dollarë për projektet e infrastrukturës (energji dhe transporti), investime në kapitalin njerëzor (arsimi dhe projektet e shëndetësisë), shërbime këshilluese dhe asistencë teknike. Trajnimi i vazhdueshëm dhe ndërtimi i kapaciteteve të sektorit publik të Shqipërisë kanë qenë një komponent konstant i të gjithë ndihmës, si një para-kërkesë për rritjen e eficiencës në shpërndarjen e shërbimeve publike.

Në fazat e para të kësaj ndihme, qeveritë duke qenë në një nevojë ekstreme të asistencës dhe mbështetjes financiare dhe sektori publik duke qenë mjaft i dobët dhe duke pasur mangësi për ekspertizë teknike, kanë qenë agjentë receptivë duke luajtur një rol të vogël në identifikimin e prioriteteve dhe të hartimit të projekteve. Më vonë, situata ka ndryshuar dhe si vendimmarrësit, ashtu edhe ekspertët në nivelin ministror janë bërë të vetëdijshëm për rolin që ata duhet të luajnë në ç'do projekt të vetëm, strategji, dokument që ka të bëjë me zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Kjo është bërë kryesisht e evidente pas vitit 2002, kur Shqipëria u ftua për të aplikuar për procesin e Stabilizim-Asocimit si hapi i parë drejt integritimit europian. Vendi iu kërkuar një angazhim më i madh dhe dedikim për përmbushjen e reformave gjyqësore, ekonomike dhe në fushën e zgjedhjeve. Mesazhi nuk është përcjellë vetëm nga qeveritë, por nga shoqëria civile, parlamenti dhe nga qarqet akademike. Një shembull mjaft i mirë i një ushtrimi të pronësisë ka qenë miratimi i strategjisë kombëtare dhe sektoriale.

Që prej vitit 2005 qeveria e re lançoi iniciativën e strategjive totalisht të reja sektoriale. Në këtë moment, nën drejtimin e ministrave përkatës dhe me inputin e ekspertëve më të mirë shqiptarë dhe pas një diskutimi të gjerë me grupet e interesit, të

gjitha këto strategji janë hartuar nga qeveria. Për më tepër ato i shërbejnë një strategjie më të gjerë dhe afat gjatë siç është Strategjia për Zhvillimin e Integritit. Qeveria Shqiptare po mban përgjegjësinë për zbatimin e strategjisë dhe arritjen e objektivave.

Bibliografia:

Arase David: *Japan's Foreign Aid: old continuities and new directions*, Routledge, USA and Canada, 2005

Dollar David, Pritchett Lant, *Assessing Aid: What works, what doesn't and why World Bank Policy Research Repor*, Oxford: Oxford University Press, 1998 http://www-wds.worldbank.org/external/default/main?pagePK=64193027&piPK=64187937&theSitePK=523679&menuPK=64187510&searchMenuPK=64187283&theSitePK=523679&entityID=000094946_99030406212262&searchMenuPK=64187283&theSitePK=523679.

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/STRATEGIES/CDF/0,,contentMDK:20072933~menuPK:140843~pagePK:139301~piPK:139306~theSitePK:140576,00.html>

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/STRATEGIES/CDF/0,,contentMDK:20072936~menuPK:140851~pagePK:139301~piPK:261885~theSitePK:140576,00.html>

Killick, Tony, *The Developmental Effectiveness of aid to Africa*, World Bank Policy Research Working Paper no. WPS 646, 1991,

http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/IW3P/IB/1991/04/01/000009265_3961001050858/Rendered/PDF/multi_page.pdf.

Koeberle Stefan. "Conditionality under what conditions?." Chapter 5- Conclusions, in Stefan Koeberle, Harold Bedoya, Peter Silarszky, Gero Verheyen, eds.

Conditionality Revisited: Concepts, Experiences and Lessons. Washington, DC: The World Bank, 2005:78-79

<http://siteresources.worldbank.org/PROJECTS/Resources/40940-1114615847489/Conditionalityrevisedpublication.pdf>

Lancaster, Carol.: *Aid to Africa: so much do do, so little done*, The Century Foundation, Chicago and London, 1999

OECD/DAC.High level Forum. "Paris Declaration on Aid Effectiveness: ownership, harmonization, alignment, results and mutual accountability." Paris, February 28-March 2, 2005:1-11. <http://www.oecd.org/dataoecd/11/41/34428351.pdf>

OECD, 2007 (a): "2006 Survey on Monitoring the Paris Declaration in Ghana"

<http://www.oecd.org/dataoecd/27/48/38901668.pdf>

OECD, 2007 (b): "2006 Survey on Monitoring the Paris Declaration in Zambia"

<http://www.oecd.org/dataoecd/44/33/38949615.pdf>

Pender, John, "From Structural Adjustment to Comprehensive Development Framework: conditionality transformed? Third World Quarterly, Vol. 22, No 3 (2001): 397-411

Pomerantz, Phyllis R.: *Aid effectiveness in Africa: developing trust between donors and governments*, Lexington Books, USA, 2004

Radelet, Steven "A primer on Foreign Aid" Working Paper, No 92. Washington D.C: Center for Global Development, July 2006, <http://www.cgdev.org/content/publications/detail/8846>

Sulka, Evis, Operations Officer-Public Sector, World Bank Office, Tirana, Albania

November 12, 2007, 9:00-9:30 am: "Country Ownership in Albania"

World Bank Independent Evaluation Group : "Executive Summary". Annual Review of Development Effectiveness 2006, Washington DC: The World Bank, 2006:xi-xvi.
[Siteresources.worldbank.org/EXT206ANNREVDEVEFF/Resources/arde_ex_summary.pdf](http://siteresources.worldbank.org/EXT206ANNREVDEVEFF/Resources/arde_ex_summary.pdf).

World Bank Operations Evaluation Department. 2004 Annual Report of Development Effectiveness – The Bank's Contributions to Poverty Reduction. Summary: vii-xii.
Chapter 3, "Development Effectiveness at the Country Level – Major Determinants of Satisfactory Outcomes:" 24-32.

Chapter 5, "Empowering Poor People to Participate in Development and Investing in Them:" 58-60.

www.worldbank.org

World Bank, "Ghana Joint Assistance Strategy, 2007

http://siteresources.worldbank.org/INTGHANA/Resources/GJAS_Final_270207.pdf

“Project finance”¹ në vendet në zhvillim – Vlerësimi i ndërtimit të TEC-it të Vlorës

— Ermela Kripa —

ABSTRAKT. E lindur si një teknikë që përdorej për financimet e projekteve të mëdha infrastrukturore, Project Finance ka pasur një rritje të ndjeshme këto vitet e fundit. Aktualisht, është një teknikë shumë e përdorur në vendet në zhvillim, në ato të industrializuara dhe më gjerë. Ky prezantim ka si qëllim të përmbledhë aspektet kryesore dhe institucionale që karakterizojnë këtë instrument. Një ndër aspektet më të rëndësishme për vlerësimin e këtij projekti ka të bëjë me marrëdhëniet tekniko-ekonomike që lidhin institucionet financiare, konsorciumet për dhënie të koncesioneve, furnizuesit, ndërtuesit e impiantit dhe entet publike, interesat e të cilëve gërshtohen vazhdimisht dhe janë të kushtëzuara nga rezultatet e parashikimeve të bëra për të garantuar realizimin me sukses të kësaj iniciative. Zhvillimi i këtij instrumenti në shumë sektorë ekonomikë të një vendi (gjithashtu dhe në vendin tonë), bën të mundur përballjen midis kompetencave teknike të vendit, nevojave të tregjeve financiare, dhe atij të sigurimeve, të cilat janë të lidhura me njëra tjetrën dhe kërkojnë shkëmbime informacioni dhe njohurish. Faza e ndërtimit përbën fazën më të rëndësishme të këtij projekti, ku së bashku me fazën operative, përbëjnë thelbin e vetë projektit. Në fund, për ta kuptuar më mirë se si funksionon një Project Finance, do të sjellim një analizë konkrete në sektorin energjetik në Shqipëri dhe përdorimit të këtij operacioni financiar, duke nxjerrë në pah avantazhet që sjell ndërtimi i TEC-it të Vlorës përmes kësaj mënyre.

1. Hyrje – Roli i Project Finance në vendet në zhvillim

Ky punim pasqyron në mënyrë kritike logjikën e përgjithshme që “fshihet” pas fenomenit të quajtur *Project Finance* dhe zhvillimit të tij në tregje të ndryshme. Ky fenomen, karakterizohet nga një shumëllojshmëri formash organizative që paraqesin objektiva të ndryshëm. Në ekonominë e zhvilluara dhe në

1 Termi *project finance* mund të përshtatet me shprehjen “vetëfinansim i një projekti”, dhe bëhet fjalë për një operacion financiar të një projekti ndërtimi, garancitë e të cilit bazohen më shumë në aftësinë e kapitaleve të promotorëve të projektit, në vlefshmërinë tekniko-ekonomike të tij, apo të parashikimeve të të ardhurave dhe të flukseve vetëfinansuese që mund të gjenerohen gjatë ushtrimit të projektit. Zhvillimi i projektit i besohet një shoqërie të krijuar “ad hoc”, qëllimi i të cilit është realizimi dhe administrimi i projektit. Kësaj shoqërie i përkasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me investimet.

ato emergjente, verifikohet një rritje e përdorimit të kësaj formule, si për investimet infrastrukturore, ashtu edhe për ato tradicionale. E parë nga një këndvështrim financiar, është shumë e rëndësishme të theksohet fakti që, bankat e investimeve karakterizohen nga një kompetencë dhe eksperiencë shumë e gjerë në fushën e konsulencës, duke marrë parasysh aftësinë e tyre për lëvizjen e kapitaleve në sasi të mëdha. Ky fenomen ka regjistruar kohët e fundit një ekspansion të fortë, duke u fokusuar në projektet me natyrë industriale dhe mbi investimet me natyrë infrastrukturore që tentojnë të përqendrohen në krahinat dhe në ekonomitë në zhvillim. Nga të dhënat e fundit të marra nga Banka Botërore shprehet në mënyrë të qartë pjesëmarrja e vazhdueshme dhe konstante e këtyre shteteve në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, duke u përballur me një rritje konstante të vëllimit të investimeve. Përdorimi i saj ofron mundësinë e realizimit të projekteve të mëdha, që në rrugë të tjera do të ishte e vështirë të arriheshin. Avantazhi i shfrytëzimit të fondeve private për financimet e projekteve që kanalizohen përmes instrumentit të *Project Financing*, jepet nga fakti që, procesi i vlerësimit dhe aprovimit ose jo të këtij projekti, është vendosur nga subjektet financiare private, duke u bazuar në një logjikë tregu dhe jo në procedura burokratike. Gjithashtu, ndërhyrja e subjekteve private paraqet një iniciativë të lirë dhe është në interesin e këtyre subjekteve të realizojnë dhe ta përfundojnë projektin brenda një kohe shumë të shkurtër. Arritja e efikasitetit nëpërmjet këtij projekti që vetëfinancohet duke iu referuar kapitaleve private, nxitet nga fakti që projekti është resursi kryesor i flukseve që prodhohen për pagimin e borxhit të kontraktuar. Subjekti që realizon projektin është i interesuar ta mbarojë sa më shpejt ndërtimin e impiantit, në mënyrë që të kalojë në fazën e administrimit, ku përmes mekanizmave tariforë, të gjenerohen të ardhurat dhe flukset vetëfinancuese. Për të arritur përmirësimin e flukseve vetëfinancuese është e rëndësishme ulja e kostove të projektit. Kjo nis nga momenti që plani i amortizimit të hua-së është i përcaktuar. Është evidente që, kush realizon projektin, nxjerr nga ulja e kostos së realizimit të tij një avantazh për sa i përket fitimit. Gjithashtu, një ndër karakteristikat e *Project Finance* është pjesëmarrja e shumë subjekteve vepruese që kanë një marrëdhënie të ngushtë midis tyre dhe që kanë interesa të shumëllojshme. Kjo garanton një kontroll tjetër, që ka për qëllim rritjen e korrektesës dhe transparencës së këtyre operacioneve. Procesi i vlerësimit të riskut është një tjetër element shumë i rëndësishëm në operacionet e *Project Financing*: ndarja, ose blindimi i rreziqeve, është një nga principet në të cilin bazohet suksesi i këtij projekti. Fal ndarjes së rreziqeve, subjektet nxiten të marrin pjesë në operacione të tilla, në mënyrë që, në rast verifikimi të një falimentimi total ose të pjesshëm të projektit, humbjet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë mes tyre. Gjithashtu, siç e kemi thënë dhe më sipër, një element tepër i rëndësishëm për mbështetjen e vendeve në zhvillim është pjesëmarrja e organizmave ndërkombëtarë. Mungesa e resurseve për financimin e infrastrukturave, karakteristike kjo e vendeve në zhvillim, bën që progresi ekonomik të varet nga një ndërhyrje e sektorit privat. Mund të themi që mënyra kryesore e përdorur prej Bankës Botërore për të bashkëpunuar me ente të tjera financiare është *bashkëfinancimi*. Ky sistem i referohet akordeve, në bazë të të cilëve, fondet ose garancitë e dhëna nga Banka janë të lidhura me fondet e vëna në dispozicion nga financues të tretë, qofshin këta publik apo privat, për të financuar një projekt apo një program.


2. Struktura e operacionit: Palët e përfshira

Project Finance paraqitet si një rrjet kontratash, në qendër të së cilës gjendet një shoqëri e krijuar ad-hoc. Secila nga palët nënshkruan një kontratë që i lejon shoqërisë të realizojë strukturën dhe ta administrojë atë në mënyrë që të përfitojë flukse vetëfinancuese, të cilat do të përdoren për pagimin e kostove të projektit, për shërbimin e borxhit dhe të dividendëve për sponsorët (nismëtarët e këtij projekti). Këto kontrata (kontrata e blerjes, e ndërtimit, e mirëmbajtjes, e administrimit e kështu me radhë) janë thelbësore në disa faza specifike të jetës së projektit. Suksesi i operacionit arrihet kur interesat e të gjithë pjesëmarrësve përmbushen njëkohësisht. Çdo kontratë mund të parashikojë disa nën kontrata me palë të treta dhe dhënien e garancive kolaterale. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve është i një rëndësie të veçantë. Zakonisht, kjo realizohet njëkohësisht nga këshilltarët ligjor të sponsorëve dhe të bankave këshilluese, të cilët paraqesin konsulentët e parë që marrin pjesë në këtë operacion. Më poshtë do të japim disa të dhëna për sa i përket subjekteve që marrin pjesë në këtë operacion financiar të cilët bashkëpunojnë me shoqërinë. Duhet të theksojmë faktin që, një subjekt mund të kryejë shumë role njëkohësisht. (shih. Skemën 1)

- **Nismëtarët e projektit**

Sponsorë mund të jenë ndërmarrjet ose administrata publike, të cilët i kanë dhënë jetë këtij operacioni duke ndërtuar shoqërinë ad-hoc, e duke derdhur në të kapitalin vetjak. Motivet e kryerjes së këtij operacioni financiar janë nga më të ndryshmet. Sponsorët privatë, në përgjithësi, dëshirojnë ose të realizojë një strukturë financiare që është ndihmëse për biznesin kryesor të tyre, ose të jenë ndërtuesi i kësaj strukture. Ndryshe nga kjo, sponsorët publikë përdorin këtë formulë që është më efciente se të tjerat, duke derdhur një shumë të vogël kapitalesh vetjake, për shërbimet publike.

Struktura tip e një operacioni project finance (skema 1)



- ***Shoqëria e posaçme***

Shoqëria e krijuar në mënyrë të posaçme është titullarja e të gjitha të drejtave të lidhura me këtë operacion financiar që nënshkruan me palët e tjera. Gjithashtu, prania e saj, nuk është as e nevojshme e as e domosdoshme për ta quajtur këtë operacion si *Project Finance*. Por, krijimi i saj preferohet, sepse gjenerohet një subjekt juridik i ndarë nga sponsorët

- ***Ndërtuesi i impiantit***

Ndërtuesi është ndërmarrja, të cilit i jepet e drejta për ndërtimin e impiantit. Ai paraqitet gjithmonë nga një grup ndërmarrjesh, në krye të së cilës është ndërtuesi kryesor, i cili bën një sërë nënkontratash ndërtimi me subjekte të tjera ndërtuese dhe u jep të realizojnë një pjesë të ndërtimeve

- ***Drejtuesi i impiantit***

Është pala e kundërt e shoqërisë, e cila merr përsipër impiantin nga ndërtuesi në fund të fazës së ndërtimit dhe merret me funksionimin, duke i siguruar asaj mirëmbajtjen për të cilën është kontraktuar me parë. Është detyrë e drejtuesit, kontrolli i dispozitave të sigurisë së impiantit dhe të mbajtjes së standardeve të fiksuara në kontratë.

- ***Blerësit***

Paraqesin palën e kundërt, të cilës shoqëria i shet produktin e realizuar, që mund të jetë komuniteti që nënkupton një treg “me pakicë”, ose të një palë tjetër që blen gjithë sasinë e prodhuar të shoqërisë - projekt. Në këtë rast, produkti ose shërbimi jepet “me shumicë”.

- ***Furnizuesit***

Janë subjektet që i japin SPV-së lëndën e parë për funksionimin e strukturës. Në shume raste, numri i furnizuesve është shumë i vogël. Situata më optimale arrihet kur një furnizues i vetëm është në gjendje të mbulojë gjithë nevojat për inputet.

- ***Administrata publike***

Roli i administratës publike në operacionet e *Project Finance* është i dyfishtë. Nga njëra anë, ajo mund të japë vetëm një lidhje për realizimin dhe drejtimin, subjekteve private, të cilëve u jepet projektimi, financimi, realizimi dhe drejtimi i projektit. Nga ana tjetër, administrata publike (p.sh. një bashki) mund të ndërhyjë edhe me dhënien e resurseve financiare në formën e kapitalit vetjak dhe më rrallë në formën e kapitalit të borxhit. Ajo mund të kushtëzojë iniciativat e *Project Finance* nëpërmjet dhënies së autorizimeve, licencave dhe lejeve.

- ***Bankat financuese***

Bëhet fjalë për një grup ndërmjetësish financiar të organizuar nga bankat kryesore (të cilat janë banka këshilluese dhe financuese njëkohësisht), të cilët kanë për detyrë të financojnë shoqërinë - projekt. Në krye të kësaj sindikate është banka lider, e

cila ndihmohet nga banka të tjera. Bankat organizuese janë ato që janë marrë me strukturën e sindikatës, duke negociuar *marrëveshjen e financimit* me ndihmën e këshilltarëve juridikë. Gjithashtu, ato impenjohen për nënshkrimin e financimit në favor të shoqërisë, për të vënë menjëherë në dispozicion fondet edhe në rast se tregu nuk do t'i përgjigjet në mënyrë të favorshme operacionit.

3. Identifikimi dhe shpërndarja e rreziqeve të projektit

Procesi i administrimit të rrezikut, së bashku me ndërtimin e një strukture financiare të përshtatshme, është baza e suksesit të këtij operacioni. *Project Finance* përveçse konsiderohet një perspektivë financimi, duhet të konsiderohet si një sistem i shpërndarjes së rreziqeve midis pjesëmarrësve që, më mirë se të tjerët janë në gjendje të administrojnë në mënyrë të suksesshme. Mund të themi që, në një operacion *Project Finance*, më shumë se garancitë reale, vlejnë garancitë kontraktuese. Arrijmë në përfundimin se dy karakteristikat kryesore të *Project Finance* janë: 1. Një shkallë e lartë e levës financiare; 2. Një skarsitet të mirash për t'i ofruar si garanci. Suksesi i këtij operacioni arrihet nëpërmjet “blindimit të rreziqeve”, që realizohet nga pala kontraktuese midis SPV dhe palëve të tjera pjesëmarrëse. Rreziqet që karakterizojnë këto projekte eliminohen nëpërmjet përdorimit të këtyre kontratave (p.sh., rreziku në fazën e ndërtimit eliminohet nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate: *çelësa në dorë* - ku fiksohet çmimi dhe data e fillimit të ndërtimit; rreziku në fazën operative eliminohet nëpërmjet kontratës *vendos ose paguaj*; rreziku për blerjen e produktit të prodhuar nga ky projekt eliminohet nëpërmjet kontratës: *merre ose paguaj*; rreziqet e tjera eliminohen me kontratën *sigurime mbi të gjitha rreziqet* etj.) të cilat përbëjnë thelbin e suksesit të këtij projekti.

4. Përcaktimi i strukturës financiare të operacionit. Treguesit ekonomik për financuesit

Të gjithë elementet e lartpërmendur paraqesin anën *industriale* të projektit. Banka këshilluese duhet të përpunojë gjithë elementet më sipër në të dhëna numerike, me anë të të cilave të japi një vlerësim për qëndrueshmërinë e projektit, duke pasur mundësinë t'ia propozojë një grupi bankash për ta financuar. Nëse në fund të kësaj analize konsulenti sigurohet se ky projekt është i paaftë të gjenerojë flukse vetëfinansimi të mjaftueshme, ai do të hedh poshtë këtë opsion dhe do t'i këshillojë sponsorëve të bëjë një financim tradicional. Duhet pasur parasysh se qëndrueshmëria e *Project Finance* varet edhe nga mënyra se si financohet kjo iniciativë, që do të thotë, sa borxhe dhe sa kapitale vetjake do të përdoren për të mbështetur realizimin dhe drejtimin e këtij operacioni. Principi kryesor është që banka këshilluese do të kërkojë gjithmonë e më shumë të propozojë një levë financiare shumë të lartë, duke pasur parasysh se një nga objektivat kryesore të sponsorëve është që të derdhin sa

më pak kapital vetjak dhe sa më vonë të jetë e mundur. Nga ana tjetër, banka këshilluese kujdeset në mënyrë prioritare për interesat e klientëve të saj (të sponsorëve) edhe pse secili nga pjesëmarrësit në këtë iniciativë e gjen shpërblimin në kapitalet e investuara vetëm ekskluzivisht nga flukset që gjenerohen nga vetë iniciativa. Vetëm kënaqshmëria e njëkohshme e të gjitha palëve do të bëjë të mundur realizimin e këtij operacioni. Të projektosh strukturën financiare për mbështetjen e kësaj iniciative, presupozon që banka këshilluese të përpunojë parashikimet për marzhet vetëfinancuese në të ardhmen, që lidhen me drejtimin industrial të projektit. Këto madhësi do t'i quajmë *flukse vetëfinancimi operative* ose *flukse vetëfinancimi para përbërësve financiar*. Hartimi i një *projekt-plani* nga ana e bankës këshilluese, bën të mundur nxjerrjen e njëkohshme të llogarisë ekonomike dhe të bilancit financiar të projektit. Për ta bërë më të qartë këtë koncept, po japim këtë figurë. Në të tregohet sjellja tipike e flukseve operative të prodhuara nga projekti.




Figura 1. dinamika e flukseve operative te kumuluar te nje projekti

5. Flukset e gjeneruara gjatë fazës së ndërtimit

Faza e parë e iniciativës, ajo nga 0 deri në j , i përket asaj së ndërtimit. Në këtë fazë, projekti paraqet një nevojë për financime, duke parë se pagesat e bëra për kostot nuk gjejnë balancim në të ardhurat e gjeneruara gjatë kësaj faze. Në këtë fazë nevoja për likuiditet mbulohet sipas 3 mënyrave:

1. Përdorimi i borxhit të marrë nga bankat financuese, dhe më pas përdorimi i kapitaleve vetjake të sponsorëve.
2. Përdorimi i kapitalet vetjake të sponsorëve dhe më pas kapitalin e marrë nga bankat
3. Me një klauzolë ku borxhi dhe kapitali përdoren në proporcion me shkallën e levës financiare.

6. *Flukset e gjeneruara gjatë fazës operative.*

Pas momentit j , projekti hyn në fazën operative, dhe pikërisht në këtë fazë fillon të prodhojë të ardhurat e destinuara për mbulimin e kostove të ndryshme të drejtimit: kurba e marzheve vetëfinancuese operative të akumuluar merr një andament rritës, sepse impianti fillon të funksionojë. Në korrespondencë me kohën k , flukset pozitive barazojnë tërësisht flukset negative. Duke iu afruar vitit n , që është viti i mbylljes së projektit, financimet do të jenë rimbursuar në mënyrë të plotë, dhe të ardhurat e gjeneruara do të përdoren për të mbuluar kostot operative dhe për financimet në rast rritjeje të kapitalit qarkullues. Fluksi operativ është variabël kyç në çdo vit të drejtimit operativ të projektit. Në fakt, ky fluks duhet të jetë në gjendje që të suportojë, si shërbimin për borxhin e marrë, ashtu edhe kapitalin e investuar nga sponsorët. Dividendët janë dytësorë në krahasim me impenjimet fikse dhe të pakthyeshme, si ato që kemi konsideruar, por këto flukse duhet të jenë në gjendje që të gjenerojnë një normë të brendshme interesi të përshtatshme, duke e krahasuar me shkallën e rrezikut të iniciativës së marrë.

7. *Si përcaktohet struktura financiare e projektit?*

Struktura financiare e projektit, e përzgjedhur për të mbështetur iniciativën, paraqet një ekuilibër midis interesave të kundërta të sponsorëve dhe bankave financuese. Siç e kemi thënë dhe më sipër, këshilluesit financiarë që punojnë për llogari të aksionerëve të shoqërisë së krijuar në mënyrë të posaçme, do të përpiqen të maksimizojnë normën e brendshme të interesit për këta të fundit, duke rritur sa më shumë të jetë e mundur borxhin dhe duke ulur sasinë e kapitalit vetjak. Rritja e borxhit shkakton rritjen e kostos financiare dhe të shërbimit për borxhin. Duke marrë si të dhënë flukset operative, rritja e raportit borxh/kapitale do të bëhet e mundur vetëm duke pranuar këtë kusht:

$$FCOt > DSt \quad (1)$$

Simbolet kanë këtë kuptim: $FCOt$ = fluksi hyrës operativ në vitin t ; DSt = shërbimi për borxhin e vitit t çfarëdo, gjatë gjithë jetës së projektit.

Banka këshilluese bën një analizë të fundit, atë të llogaritjes së koeficienteve të mbulimit. Këto raporte janë tregues që vlerësojnë se kush është hapësira e sigurisë për bankat në çdo vit të jetës operative të projektit, për të perceptuar flukset për shërbimin e borxhit të kontraktuar me shoqërinë e krijuar. Koeficientet kryesorë të mbulimit janë dy:

1. *Raporti i garancisë së shërbimit të borxhit të kontraktuar: (DSCR)*

$$DSCR = FCO_t / K_t + I_t + F_t$$

Ku simbolet kanë këtë kuptim: $FCOt$ = fluksi hyrës operativ në vitin t ; Kt = sasia e kapitalit për tu rimbursuar në vitin t ; It = sasia e interesit për të paguar, duke iu referuar vitit t ; Ft = komisione të ndryshme që mund të shfaqen në vitin t .

2. Raporti për garancinë e jetës së borxhit të kontraktuar (LLCR).

$$LLCR = \sum \frac{FCO_t}{(1+i)^t} + R_{O_t}$$

Ku simbolet kanë këtë kuptim: $FCOt$ = fluksi hyrës operativ në vitin t ; O_t = borxhi i mbetur; R = rezerva për borxhin; i = norma e interesit.

8. Sektori Energjetik Shqiptar.

Në fillimet e tranzicionit në Shqipëri, në fillim të viteve '90, vendi ka qenë 100 % i elektrifikuar, dhe ishte një eksportues neto i energjisë elektrike, me eksporte që arrinin rreth 20 % të prodhimit të brendshëm në 1991 dhe në 1992. Sistemi i transmetimit dhe shpërndarjes nuk funksiononte në mënyrë të rregullt, si pasojë e mosmirëmbajtjes, e makinerive të amortizuara dhe e mbingarkimit. Janë verifikuar raste të ndryshme të ndërprerjeve të ushqimit me energji për efekt të një mbingarkese të strukturave elektrike. Gjithashtu, sistemi energjetik shqiptar është i ndjeshëm edhe ndaj kushteve hidrologjike. Kërkesa për blerjen e energjisë bie në rreth 70 % të nivelit që nga 1989 deri në 1992. Kjo, për efekt të rënies së prodhimit industrial. Por më vonë u rrit me 10 % në vit, deri në 2000-shin. Kjo rritje e kërkesës për energji verifikohet nga rritja e konsumit nga ana e qytetarëve dhe nga strukturat e vogla tregtare. Që nga 1998, kur Shqipëria bëhet një eksportues neto i energjisë elektrike, deri në vitet 2000, verifikohet një mungesë në prodhimin e energjisë elektrike. Kjo për shkak të një rënie të prodhimit hidroelektrik shkaktuar nga ulja e nivelit të lumenjve. Kjo mungesë shkakton një ndërprerjeje të shpeshtë dhe të zgjatur të energjisë elektrike. Rasti më alarmant ka qenë ai i vitit 2002, kur prodhimi i energjisë elektrike ishte vetëm 50 % e sasisë së kërkuar. Vendi nuk ishte në gjendje të mbulonte këtë kërkesë, kjo si për shkak të mosfunksionimit të sistemit të transmetimit, ashtu edhe për mungesë fondesh financiare. Situata përmirësohet në vitet 2004, ku verifikohet një gjenerim i energjisë së prodhuar në vend, dhe njëkohësisht nga ulja e energjisë së importuar. Nevoja për të importuar energji elektrike do të vazhdojë edhe për disa vjet, për efekt të mungesës së burimeve për prodhimin e energjisë dhe për efekt të amortizimit të rrjetit, i cili shkakton humbjen e një pjese të energjisë gjatë procesit të transmetimit. Kërkesa për energji mendohet të rritet akoma deri në 2010. Është bërë një projekt për ndërtimin e një impianti me cikël të kombinuar gazi dhe naftë, i cili është financuar nga IDA, BERS, BEI dhe nga KESH-i. KESH-i nuk ishte në gjendje të paguante importacionet e nevojshme me burimet e veta, për shkak të vështirësive financiare, të cilat janë shkaktuar nga një përdorim ilegal i energjisë elektrike, nga mbledhjet

e pakta të faturave dhe çmimi i ulët i shitjes së energjisë. Duke konsideruar këto vështirësi, që nga vitet 2000, qeveria ka filluar të ofrojë një subvevencion për të mbuluar diferencën midis kostos së importacionit të energjisë elektrike dhe flukseve hyrëse nga shitja e saj. Qysh nga viti 2001, KESH ka ndërmarrë disa aksione për të reduktuar konsumin e paligjshëm të energjisë elektrike dhe të përmirësojë mbledhjet e faturave. Gjithashtu, është rritur edhe niveli mesatar i tarifave në mënyrë të rregullt. Si rezultat i këtyre masave, flukset monetare nga mbledhjet e faturave janë rritur nga viti 2000 në vitin 2004, edhe pse niveli i importeve do vazhdojë të jetë i lartë edhe për disa vite të tjerë. Përmirësimi i performancës financiare të KESH-it bën të mundur që shoqëria të jetë e aftë të paguajë vetë importet qysh nga 2005, pa marrë asnjë subvencion nga qeveria.

9. Karakteristikat e projektit për ndërtimin e TEC-it të Vlorës

Projekti konsiston në ndërtimin e një centrali termik me cikël të kombinuar, i cili do të ushqehet me gaz dhe naftë. Kapaciteti i impiantit është 131 më dhe energjia e gjeneruar është 920 kwh/në vit. Impianti do të projektohet në mënyrë të tillë që të bëjë konvertimin e gazit natyral dhe të naftës në energji elektrike. Gjithashtu, ky projekt, parashikon asistencë teknike për të ekzaminuar ofertën më të mirë të furnizimit me naftë, dhe nëse kjo ofertë rezulton optimale, të përgatisin dokumentet dhe të japë asistencë në ndërtimin e impiantit. Importi total i financimit është aktualisht i vlerësuar në 112,26 milionë \$ (ku Banka Botërore 26 milionë \$; BERZH 37,5 milionë \$; BEI 37,5 milionë \$ dhe KESH 12,66 \$). BERZH dhe BEI kanë shprehur vullnetin të rrisin huadhënien edhe për 40 milion \$ të tjera nëse do të nevojiten. Në qoftë se kërkohet një financim më i madh, kjo do të bëhet e mundur nga KESH – i. Kostot e këtij impianti përfshijnë edhe 3 milion dollarë për rinovimin e terminalit të naftës që ekziston atje, dhe 4,4 milion dollarë do të përdoren për financimin e një sistemi transmetimi në nënstacionin e Babiçës, që gjendet rreth 7 km larg qytetit. Kostot totale të projektit përfshijnë edhe 4,85 milion dollarë edhe për asistencën teknike dhe formimin e dhënë.

Motivet e ndërtimit të këtij centrali janë këto:

1. Përmirësimi i performancës të sistemit energjetik në Shqipëri dhe
2. mungesa e strukturës bazë në sistemin energjetik



Struktura financiare (pra kombinimi i kapitaleve vetjake dhe borxheve) e projektit karakterizohet:

Rreth 85% e financimit të këtij projekti bëhet nga organizmat e huaja, si Banka Botërore, BERZH (Banka Europiane e Rikonstruksionit dhe Zhvillimit) dhe BEI (Banka Europiane e Investimeve). Kurse KESH-i do të derdhë vetëm 15 % të kapitalit që nevojitet për realizimin e këtij projekti. Kjo është një strukturë tipike financimi (karakterizuar nga një levë financiare e lartë) që realizohet duke përdorur *project finance*.

Më poshtë po paraqesim një përmbledhje të analizës ekonomike dhe financiare të projektit. **Shih Aneks 1** (tabelat)

10. *Avantazhet e realizimit të këtij projekti*

Për të kuptuar më mirë avantazhet që rrjedhin nga ky projekt, përmendim disa tregues:

- a. Ulja e mbingarkesës;
- b. Ulja e humbjeve të energjisë gjatë transmetimit dhe shpërndarjes;
- c. Përmirësimi në mbledhjen e faturave elektrike;
- d. Ulja e faturave të papaguara;
- e. Ulja dhe eliminimi i subvencioneve nga ana e qeverisë, KESH-it;
- f. Përmirësimi i raporteve të vetëfinancimit të KESH – it;
- g. Përdorimi i një programi që ka të bëjë me reformat në sektorin energjetik.

Rritja e prodhimit të energjisë elektrike në vend lidhet me këtë central elektrik dhe njëkohësisht me uljen e sasisë së energjisë së importuar që do të verifikohet pasi projekti të ketë përfunduar. Megjithatë, kjo nuk mund të monitorohet gjatë përdorimit të projektit. Propozimet për investimin e këtij projekti dhe veprimtaritë që do të përdoren do të kenë një impakt pozitiv shumë të rëndësishëm mbi ekonominë, duke kontribuar në:

- a. Një funksionim të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje të ndërmarrjeve dhe fabrikave;
- b. Një ulje e rëndësishme e konsumit ilegal të energjisë;
- c. Një rritje me furnizim të energjisë elektrike;
- d. Ulja e subvencioneve nga ana e qeverisë për importimin e energjisë, dhe
- e. Një përmirësim të rendimentit financiar të sektorit energjetik, dhe si pasojë, ulja e një dizavanci fiskal (i cili parashikohet të jetë rreth 220 milion dollarë, ose rreth 5 % e GDP-së) të lidhura ngushtë me aktivitetin aktual të sektorit energjetik. Veprimet e ndërmarra bëjnë që të verifikohet një përmirësim i sistemit energjetik dhe ristrukturim i sektorit.

11. Përfundimet mbi projektin

Suksesi i këtij projekti varet nga përmirësimi i vazhdueshëm i:

1. Uljeve të humbjeve të energjisë elektrike
2. Mbledhjes së faturave
3. Një projektligj që vendos tarifat në nivelin e duhur
4. Përmirësimet e performancës së KESH-it, e cila bën të mundur që korporata ta ketë më të thjeshtë për të zvogëluar shpenzimet dhe të eliminojë situatat e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Duke bërë të mundur përmirësimin e rendimentit financiar për KESH-in, bëhet e mundur gjithashtu, që sektori energjetik të jetë më atraktiv për investorët e huaj, duke përmirësuar perspektivën për:

- a. Ristrukturimin e sektorit energjetik dhe
- b. Procesin e privatizimit të KESH-it.

12. Konkluzionet:

Rezultatet që mund të presim nga përdorimi i *Project Finance* janë:

1. Një rezultat i parë është që ky instrument të bëjë të mundur realizimin e projekteve që, për sa i përket rëndësisë së tyre ekonomike ose sociale, vazhdojnë të mos realizohen për shkak të limiteve të vendosura nga shpenzimet publike, ose nga mënyra e papërshtatshme e financimit tradicional.
2. Konsiderata e dytë ka të bëjë me rritjen dhe kulturën e tregjeve dhe pikëpamjes sipërmarrëse, e aplikuar edhe për projektet infrastrukturore. Dy janë avantazhet: në planin specifik, do të ishte një kontribut i rëndësishëm të vështrosh alokimin e resurseve si një proces që duhet të jetë transparent, që bazohet në *trade – off* dhe e udhëhequr nga parametra ekonomikë (jo domosdoshmërisht fitimi), në planin më të përgjithshëm do të ishte si një guidë për të riorientuar proceset vendimtare që, sidomos në sede publike, janë të papërcaktuara dhe diskrete.
3. Një avantazh tjetër ka të bëjë me zhvillimin e sistemit financiar që bëhet e mundur nga zhvillimi i *project finance*. Në qoftë se është e vërtetë që shërbimet financiare, të cilat vërtiten rreth *Project Finance*, janë shumë të specializuara, gjithashtu është e vërtetë që, të vepros në këtë fushë sjell një akumulim kompetencash dhe eksperiencash jashtëzakonisht prodhuese, edhe për sa i përket impaktit të saj kulturor dhe të rritjes profesionale dhe teknike, në krahasim me fushat e tjera te aktivitetit.

Bibliografia

- Albiseti R. (1996), *Il finanziamento dei progetti privati nei paesi emergenti*, World Bank, Washington.
- Albiseti R. (2000), *Finanza Strutturata*, Etas, Milano.
- Amato R., Chiappi R. (1993), *Pianificazione e Controllo dei progetti*, Franco Angeli, Milano.
- Benoitte P. (1996), *Project Finance at World Bank: An Overview of Policies and Instruments*, World Bank Technical Paper nr.312
- Brealey R.A., Cooper I. A, Habib M.A. (1996), "Using Project Finance To Fund Investment Investments", in *Journal of Applied Corporate Finance*, vol.9, n.3.
- Brealey R.A, Myers S.C. (1990), *Principi di Finanza Aziendale*, McGraw Hill Italia, Milano.
- Boeri T., Cohen R. (1998), *Analisi dei Progetti di Investimento. Teoria e Applicazioni per il Project Financing*, Egea, Milano.
- Brugger G. (1990), "Le Decisioni Finanziarie", in Pivato G. (a cura di), *Trattato di Finanza Aziendale*, Franco Angeli, Milano.
- Bull P. (1995), "Capital Leasing in Project Finance", in Shaughnessy H. (editor), *Project Finance in Europe*, John Wiley & Sons, New York.
- Buckley A. (1996), *Project Finance, in International Capital Budgeting*, Prentice Hall, London.
- Cappellini G., Gatti S. (1997), "Il settore del Project Finance in Italia. Situazione Attuale e Prospettive Future", in *Economia e Management*, n.6
- Carapella B. (2001), *Il Project Financing*, Angeli, Milano.
- Carretta A. (1998), *Gli intermediari Finanziari non Bancari*, Egea, Milano.
- Carriere P. (1999), *Project Financing, profili di compatibilità con l'ordinamento giuridico*, Cedam, Padova.
- Censis (1997), *Leasing verso il Duemila: attualità e prospettive di uno strumento finanziario per l'impresa moderna*, Angeli, Milano.
- Chen A.H., Kensinger J.È. (1992), "Uncommon Equity", in *Journal of Applied Corporate Finance*, n.1.
- Cima C.B. (1996), "Le responsabilità delle banche nel dover disinquinare terreni e proprietà inquinate", in *Economia e Banca*, n.2.
- Clarke P.S. (1996), *Asset - Based lending. The complete guide to originating, evaluating and managing asset - based loans, leasing and factoring*, Irwin, Chicago.
- Cnel (1995), *Il project financing nella realizzazione dei grandi progetti infrastrutturali*.
- Dailami M. (1997), *Infrastructure project finance and capital flows*, World Bank, Washington.
- Dallochio M. (2004), *Finanza d'azienda*, Egea, Milano.
- De Laurentis G. (1998), *Caratteri evolutivi del project financing*, in *Lettera Newfin*, n.1, gennaio/marzo
- De Sury P., Miscali M. (1995), *Il Project finance: principi guida per la realizzazione delle pubbliche*, Egea, Milano.
- Dossena G. (2000), *La gestione per progetti*, Egea, Milano
- Dossena G. (1995), *Project Financing e asset securitization: opportunità per le imprese industriali*, Egea, Milano
- Draetta U, Vacca C. (2002), *Il project financing. Soggetti - Disciplina - Contratti*, Egea, Milano.
- Esty Benjamin C. (2003), *Modern Project Finance*, International, New York
- Forestieri G. (2000), *Il corporate e investment banking*, Egea, Milano
- Frignani A. (1996), *Factoring, leasing, franchising, venture capital, leveraged buy-out, hardship clause, countertrade*, Giappichelli, Torino
- Gallardo J. S. (1997), *Leasing to support small businesses and micro enterprises*, World Bank, Washington
- Gao S. S. (2000), *International Leasing. Strategy and Decision*, Ashgate
- Gatti S. (1999), *Manuale del Project Finance*, Bancaria Editrice, Roma
- GHIA L. (1997), *I contratti di finanziamento dell'impresa: leasing e factoring*, Giuffrè, Milano

- Hoffman S. L. (1998), The law and business of international project finance, Kluwer Law International, The Hague
- Imperatori G. (1995), Il Project Financing: una tecnica, una cultura, una politica, Il sole 24 ore libri, Milano
- Miscali M. (1995), Aspetti fiscali del project finance, ed. Libero Istituto Universitario Carlo Cattaneo, Castellana
- Nevitt P. K., Fabozzi F.J. (2000), Project Financing. Seventh Edition, Euromoney Books, London
- Pogliotti G. (2001), Capitali private per le grandi opere, in *IlSole24Ore* del 25 giugno 2001
- Ternau W. (1996), Project financing, Angeli, Milano
- Yescombe R. (2002), Principles of project finance, Academic Press, Amsterdam

Faqe interneti të konsultuara:

- Institute of International Finance (2004), "Capital flows to emerging market economies", http://www.iif.com/verify/data/report_docs/cf_1004.pdf, [26/10/2004].
- International Finance Corporation (2004), "Annual Report 2004. Vol.1", link http://www.1.ifc.org/ar2004/pdf/IFC_04AR_V1.pdf [11/11/2004].
- International Finance Corporation (2004), "Annual Report 2004. Vol.2", link http://www.1.ifc.org/ar2004/pdf/IFC_04AR_V2.pdf [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004), link <http://www.ifc.org/about>, "Basic Fact About IFC", [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004), "What we do", link <http://www.ifc.org/ifcext/about.nsf/Content/WhatWeDo> [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004), "Equity financing", link <http://www.2.ifc.org/proserv/products/equity/equity.html> [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004), "Loan Structure", link <http://www.ifc.org/ifcext/treasury.nsf/Content/LoanStructure> [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004), "Risk Management Product sand Services", link <http://www.2.ifc.org/proserv/products/risk/risk.html> [11/11/2004]
- International Finance Corporation (2004) "2004 Annual Review: Small Business Activities" link [http://www.ifc.org/ifcext/sme.nsf/AttachmentsByTitle/SME+ARreport2004Full.pdf/\\$FILE/SME+ARreport2004Full.pdf](http://www.ifc.org/ifcext/sme.nsf/AttachmentsByTitle/SME+ARreport2004Full.pdf/$FILE/SME+ARreport2004Full.pdf) [25/11/2004]
- International Monetary Fund (2004), "Annual Report of the Executive Board for the Financial Year Ended April 30, 2004", link <http://www.imf.org/external/pubs/ft/ar/2004/eng/index.htm>, [26/10/2004].
- Project Finance Portal (2004), "Emerging Markets Data" link <http://www.people.hbs.edu/besty/projfinportal/emdata.htm> [26/10/2004]
- WORLD BANK (2004), "About Us" link <http://www.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/EXTABOUTUS> [26/10/2004]
- WORLD BANK (2004), "Annual Report 2004" link <http://www.worldbank.org/annualreport/2004> [26/10/2004]
- WORLD BANK (2004), "Global Development Finance 2004", link http://siteresources.worldbank.org/GDFINT2004/Home/20177154/GDF_2004.pdf [26/10/2004]
- www.kesh.al.org <http://www.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/0>, content MDK, Project – Statements of loans and Credits.2007.
- <http://worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/0>, content MDK, Projects - Albania: World Bank Supports 2007.
- <http://worldbank.org/external/projects/main?Projectid=P074905&type=Implement>, Projects - Albania: Power Sector Rehabilitation & Restructuring project.

Pronësia intelektuale, një koncept i hershëm dhe modern

____ Dr. Kreshnik Bello _____

ABSTRAKT. Historia e njerëzimit është bazuar mbi aplikime të imagjinatës, novacioneve dhe krijimtarisë, d.m.th. në njohuritë ekzistuese, dhe kjo është bërë për të zgjidhur probleme të ndryshme. Janë të panumërt shembujt se si imagjinata e individëve në botë ka bërë të mundur progresin e sotëm teknologjik, përgjatë zhvillimit të historisë së njerëzimit. Sikurse për shkencën, imagjinata është burim i progresit edhe në art. Muzika, piktura, skulptura, arkitektura dhe punët e tjera artistike, janë krijuar nga individë të cilët nuk kënaqen me të vjetrën, por i shohin dhe i shprehin gjërat me mënyra të reja dhe rinovuese. Pronësia intelektuale (PI) është termi që përshkruan idetë, shpikjet, teknologjitë, punimet artistike, muzikën dhe letërsinë, të cilat janë fillimisht të pakuptueshme kur krijohen, por që bëhen me vlerë, kur formohen si produkte. **Pronësia intelektuale është aplikimi komercial i mendimeve imagjinare, për të zgjidhur një sfidë artistike ose teknike, ajo nuk është produkt në vetvete, por një ide specifike prapa tij, mënyra se si ajo shprehet, emërtohet, përshkruhet.** Pronësia intelektuale rrjedh nga bazat e risive në njohuritë ekzistuese. Ajo është rezultat i përmirësimit krijues mbi atë çfarë ka funksionuar mirë në të kaluarën, ose i shprehjeve të reja krijuese të ideve dhe koncepteve të vjetra. Në vendin tonë, pronësia intelektuale, në kuptimin e plotë të saj është një koncept i ri. Vetëm pas viteve '90, shteti ka filluar të merret me çështje të pronësisë intelektuale dhe për elementë të ndryshëm të saj, kanë dalë edhe ligje, që përgjithësisht janë të përditësuara me legjislacionin perëndimor. Sidoqoftë, për një pjesë të elementeve të pronësisë intelektuale, ende në vendin tonë nuk ka njohuri, dhe në përgjithësi pronësia intelektuale ende nuk ka fituar statusin që meriton.

1. Një historik i shkurtër i pronësisë intelektuale

Shumë pak njerëz nuk do të jenë dakord që shkenca, teknologjia dhe artet kreative të sotme përcaktojnë jetën tonë të përditshme. Zbulimet e hershme teknologjike e nxorën njerëzimin prej sistemit feudal, dhe në 100 vitet e fundit lidheshi teknologjik është bërë një faktor përcaktues në krijimin e pasurive dhe ka nxitur rritjen e kombeve.

Që prej rritjeve më të hershme, që nga fillimet e muzikës dhe vallëzimit, rriteve mortore, pikturimit të shpellave, fjalës së shkruar, përfaqësimit teatral, deri në

përdorimin e teknologjive moderne të tilla si, filmi në celuloid, transmetimet jo kabllore, software-t, regjistrimi dixhital etj, njeriu ka identifikuar dhe përcaktuar veten e tij nëpërmjet krijimtarisë dhe shprehjes së veprimtarisë kulturore, në formën e veprave dhe performancës artistike. Shumë prej këtyre veprimtarive kanë mbijetuar deri më sot, dhe janë mishëruar në folklor ose në forma të tjera të njohurive tradicionale, sidoqoftë, vlera e tyre e veçantë është që trashëgimia e përpjekjeve humane jeton në shprehjen e tyre.

Pronësia intelektuale është një koncept i vjetër. Ligji Venecian i vitit 1474, shpesh është referenca, për sa i përket përjasjes sistematike fillestare në mbrojtjen e shpikjeve prej një lloj forme patentë, ndërkohë që përcakton një të drejtë ekskluzive të një individi, duke limituar për herë të parë, interesin publik.

Para 1800-ës, megjithëse shembuj të përqendrimit industrial mund të identifikohen në disa vende Europiane, rritja e prodhimit ishte më shumë një çështje e prodhimit artizanal në shkallë të vogël, se sa e metodave dhe organizimeve të reja radikale. Sidoqoftë, midis vitit 1750 dhe 1870, Europa pësoi ndryshime të thella, ku midis të tjerave mund të përmendim: rritjen e qyteteve, ndërtimin e hekurudhave, investimin e kapitalit dhe rritjen e ekonomisë transoceanike. Sidoqoftë, në Europë elementet kryesore të pronësisë intelektuale ende ishin në fillimet e tyre. Ndërkohë që kolonitë Amerikane, kishin ligje që jepnin patenta shumë kohë përpara shpërthimit të revolucionit Amerikan në vitin 1775, dhe shumë shpejt pas revolucionit, 12 prej 13 kolonive origjinale adoptuan ligje mbi të drejtën e autorit.

Duke iu drejtuar fundit të shekullit XIX, shumë faktorë çuan në një industrializim në shkallë të madhe, të mbështetur prej idealeve të reja të industrializimit, lindjes së qeverive të centralizuara, dhe nacionalizmit të fortë. Këto zhvillime udhëhoqën shumë vende në krijimin e ligjeve të para moderne për patentat dhe të drejtat e autorit. Sidoqoftë, zhvillimi i konceptit modern të pronësisë intelektuale (PI), nuk ka qenë gjithmonë i drejtpërdrejtë. Në shekullin XIX, lëvizjet e tregtisë së lirë, të cilat grishnin për lënien mënjatë të sistemeve të patentave, gjetën mjaft mbështetje. Por vala e fuqishme e nacionalizmit që karakterizoi periudhën, duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e njohjes dhe ruajtjes së ligjeve moderne të pronësisë industriale.

Përdorimi më i hershëm i termit pronësi intelektuale, duket se ka qenë në Tetor të vitit 1845, në një çështje gjyqësore në Massachusetts, në rastin e patentës *Davoll et al. v. Brown*, në të cilën gjykatësi Charles L. Woodbury shkroi që “*vetëm në këtë mënyrë ne mund të mbrojmë pronësinë intelektuale, punën e mendjes, prodhimtarinë dhe interesat që një njeri zotëron ... sikurse gruri që ai kultivon, sikurse tufa që ai rrit*”. Në Europë, autori francez A. Nion përmendi “*propriété intellectuelle*” në publikimin e tij të vitit 1846, *Droits civils des auteurs, artistes et inventeurs*. Ndërsa popullariteti modern i termit, është një fenomen i kohëve të fundit. Ai hasej rrallë deri në vitin 1967, kur u themelua Organizata Botërore e pronësisë intelektuale (WIPO), e cila në mënyrë aktive u përpoq të promovonte termin.

2. Traktatet e para ndërkombëtare të pronësisë intelektuale: i Parisit dhe i Bernës

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, të mirat dhe punëtorët që kalonin kufijtë nacionalë, sollën një valë globalizimi për fuqitë industriale. Megjithëse ishin nxjerrë ligje për patentën, në disa vende filloi të ndihej kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare të shpikjeve. Në fakt, ekzibicionistët e huaj, refuzuan të ndiqnin ekspozitën ndërkombëtare të shpikësve në Vjenë, në vitin 1873, sepse ata ishin të frikësuar që idetë e tyre do të vidheshin dhe do të shfrytëzoheshin komercialisht në vendet e tjera. Ky incident rezultoi në lindjen e Konventës së Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industriale, në vitin 1883 - traktati i parë kryesor ndërkombëtar, i krijuar për të ndihmuar individët e një vendi të siguronin mbrojtjen në vende të tjera për krijimet e tyre intelektuale. Një mbrojtje e tillë mori formën e të drejtave të Pronësisë Industriale, në formën e patentave, markave dhe dizenjove industriale.

Në mes të shekullit të XIX-të, autorë të mirënjohur po shikonin që veprat e tyre po prodhoheshin dhe shiteshin ilegalisht në vende të tjera, dhe për to, ata nuk merrnin ndonjë të ardhur. Me qëllim që të eliminonin këtë praktikë, autori i famshëm francez i *Les Miserables* dhe i *The Hunchback of Notre Dame*, Victor Hugo, organizoi një grup autorësh në *Lidhjen Ndërkombëtare të Letërsisë*, për të vendosur një formë të thjeshtë të mbrojtjes ndërkombëtare të punëve të tyre. Më 1886, për të siguruar bazën për njohje të ndërsjellë të së drejtës së autorit midis vendeve të ndryshme, një tjetër traktat ndërkombëtar i pronësisë intelektuale ishte krijuar, Konventa e Bernë-s, për mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike.

Thelbi i të dy konventave ishte parimi i trajtimit kombëtar, d.m.th. “mbrojtje e njëjtë midis vendasve dhe të huajve”. Ky parim përcaktohet më së miri në tekstin e Konventës së Parisit.

3. Disa elemente të pronësisë intelektuale

Pronësia intelektuale përbëhet prej një morie elementesh dhe konceptesh, të cilat, të marra së bashku përbëjnë pronësinë intelektuale. Elementët e saj, mbulojnë aspekte të fushave të ndryshme të jetës, shkencës, teknologjisë etj, duke përfaqësuar një tufë të drejtash për t'i krijuar ekskluzivitet mbajtësit të tyre. Disa prej elementëve të pronësisë intelektuale janë: *e drejta e autorit, të drejtat morale, treguesit gjeografikë, të drejtat e dizenjove industriale, patentat, veshjet tregtare, markat.*

A. E drejta e autorit

E drejta e autorit mbron punët origjinale të autorësisë, të fiksuara në një medium të prekshëm të shprehjes, si dhe shumë punë të tjera. *E drejta e autorit i siguron zotëruesit të saj, të drejtën ekskluzive për të riprodhuar dhe shpërndarë materialin ose për ta përdorur ose shfaqur atë publikisht, megjithëse një numër i kufizuar riprodhimesh të punës së mbrojtur mund të lejohet të bëhet prej të tjerëve për qëllime të ndershme.*

Punët me të drejtë autori, mund të regjistrohen në zyrën e të drejtës së autorit. Shumë vende ofrojnë mbrojtje të së drejtës së autorit pa regjistrim, ndërsa të tjera vende ofrojnë pak ose aspak mbrojtje, sidomos për punët e shtetasve të huaj. Në pjesën më të madhe të vendeve të botës, kohëzgjatja e pranueshme për shumë punë e së drejtës së autorit, është gjithë jeta e autorit plus 50 ose 70 vjet. E drejta e autorit përgjithësisht mbaron në fund të vitit të fundit, se sa në datën ekzakte të vdekjes së autorit.

B. Të drejtat morale

Nocioni i të drejtave morale është një nocion që ka lindur në vendet që aplikojnë të drejtën civile ose *civil law*. Vendet ndryshojnë nga njëri-tjetri për sa i përket mënyrës se si ato i përkufizojnë dhe i mbrojnë të drejtat morale. Franca mund të quhet vendi që i njeh në mënyrën më bujare këto të drejta. Ndërsa në vendet që aplikojnë *common law*, në përgjithësi ka pasur një ngurrim për njohjen e të drejtave morale.

Të drejtat morale të autorit njihen edhe nga legjislacioni shqiptar. Sipas Ligjit tonë për të Drejtën e Autorit, autori ka këto të drejta morale:

- *E drejta për t'u njohur si autor i veprës.*
- *E drejta për të mbetur anonim ose për të përdorur pseudonim.*
- *E drejta për të kundërshtuar çdo lloj shtrembërimi, heqje a ndryshim dhe çdo veprim tjetër përçmues ndaj veprës që do të cënonte nderin dhe emrin e autorit.*
- *E drejta për të kundërshtuar bashkautorësinë e vendosur në mënyrë arbitrare nga të tjerët.*

C. Treguesit gjeografikë

Një tregues gjeografik, shpesh me shkurtimin GI, është një emër ose shenjë e përdorur mbi disa produkte, e cila korrespondon me një vendndodhje gjeografike specifike ose origjinë, si për shembull një qytet, një rajon ose një vend. Përdorimi i një GI-je, mund të veprojë si një certifikatë, që tregon se produkti zotëron disa cilësi të caktuara ose gëzon një reputacion të caktuar në sajë të origjinës së tij gjeografike.

Më shpesh, një tregues gjeografik përbëhet prej emrit të vendit të origjinës së të mirave. Produktet bujqësore, në mënyrë tipike, kanë cilësi që rrjedhin prej vendeve të tyre të prodhimit dhe që janë ndikuar prej faktorëve lokal specifik, të tilla si klima dhe toka. Treguesit gjeografik mund të përdoren për një varietet të gjerë të produkteve bujqësore, të tilla si për shembull “*Tuscany*” për vajin e ullirit të prodhuar në një zonë specifike të Italisë ose “*Roquefort*” për djathin e prodhuar në Francë. Sidoqoftë, përdorimi i treguesve gjeografik nuk është i limituar thjesht tek produktet bujqësore.

D. Të drejtat e dizenjove industriale

Të drejtat e dizenjove industriale janë të drejta të pronësisë intelektuale, që mbrojnë dizenjon vizuale të objekteve. Një dizeno industriale përbëhet prej krijimit të një forme, konfiguracioni ose kompozimi të modeleve ose ngjyrave, ose kombinim i modeleve dhe ngjyrave në forma tredimensionale që përmbajnë vlera estetike. Një dizeno industriale

mund të jetë një model dy ose tre dimensional, i përdorur për të prodhuar një produkt, një të mirë industriale ose artizanale. Dizenjot industriale aplikohen mbi një varietet të gjerë produktesh industriale dhe artizanale: që nga instrumentet teknike, deri tek orët, arturinat dhe artikuj të tjerë luksi. Që të mbrohet nën shumë ligje kombëtare, një dizenjo industriale duhet të “tërheq syrin”. Kjo do të thotë që një dizenjo industriale ka fillimisht një natyrë estetike, dhe nuk mbron ndonjë veçori teknike të produktit mbi të cilin ajo është aplikuar.

E. Patenta

Një patentë është një set i të drejtave ekskluzive, i dhënë prej një shteti një të patentuari, për një periudhë kohë të fiksuar, në shkëmbim të bërjes publike në mënyrë të rregulluar të disa detajeve të një pajisjeje, metode, procesi ose përbërjeje të një substance, e cila është e re, e dobishme dhe që sjell risi, ose e aplikueshme në industri.

Një patentë e dhënë i ofron mbajtësit një status mbi teknologjinë e patentuar dhe procesin e patentuar, për një periudhë kohë nga 15 deri 20 vjet, në varësi të shtetit ku mbrohet. Ligjet e dhënies së patentave në Amerikë dhe Japoni, japin një shembull të ndryshimeve ligjore në këto shtete si edhe implikimet e tyre për kompanitë. Ndryshimi më thelbësor ndërmjet dy shteteve, është në parimet “*first-to-file*” dhe “*first-to-invent*”. Ndërsa shumica e shteteve ndjekin parimin e “*first-to-file*”, vetëm Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe Filipinet ndjekin parimin e “*first-to-invent*”.

F. Veshjet tregtare

Veshjet tregtare u referohen karakteristikave të paraqitjes vizuale të një produkti ose paketimit të tij (ose madje fasada e një ndërtese, si për shembull një restorant), e cila mund të jetë regjistruar dhe mbrojtur, përballë të qenit e përdorur prej konkurrentëve, në të njëjtën mënyrë si marka. Këto karakteristika përfshijnë, formën tredimensionale, dizenjon grafike, kolorin, ose madje aromën e një produkti dhe/ose paketimin e tij.

Ekzistojnë dy kërkesa të thjeshta që duhet të plotësohen për mbrojtjen e veshjeve tregtare. *E para* është, që ato veçori duhet të jenë të afta të funksionojnë si një tregues burimi – duke identifikuar një produkt të veçantë dhe prodhuesin e tij tek konsumatorët. *Së dyti* veshjet tregtare, duhet të jenë jo funksionale që të mbrohen ligjërisht; përndryshe ajo është një çështje subjekt i ligjit të patentave. Çfarë është funksionale, varet fuqimisht prej produktit të veçantë. Për të qënë jo funksionale, ajo nuk mund të ndikojë mbi kostot, cilësinë e produktit ose aftësinë e një prodhuesi për të konkurruar efektivisht.

G. Markat

Një markë, është një shenjë dalluese e ndonjë lloji të caktuar, e cila është përdorur prej ndonjë organizate për të identifikuar në mënyrë unike veten, produktet dhe shërbimet e saj tek konsumatorët, dhe për të dalluar organizatën dhe produktet dhe shërbimet e saj, prej atyre të organizatave të tjera. Një markë është një lloj i pronësisë industriale, e cila është e dallueshme

prej formave të tjera të pronësisë intelektuale. Tradicionalisht një markë përfshin një emër, fjalë, shprehje, logo, simbol, dizenjo, imazh, ose një kombinim të këtyre elementeve.

Simboli TM, mund të përdoret kur të drejtat e markës pretendohet, por që marka nuk është regjistruar në zyrën e markave të një vendi ose juridiksioni të veçantë, ndërsa shenja [®] përdoret kur marka është regjistruar. Nuk është i detyrueshëm përdorimi i të dy simboleve, megjithëse forca e traditës është e tillë që, simbolet përdoren gjerësisht nëpër botë. Sidoqoftë, në juridiksionet e ndryshme është e jashtëligjshme përdorimi i simbolit [®] në lidhje me një markë, kur ajo markë nuk është regjistruar.

4. Pronësia intelektuale në Shqipëri

Për sa i përket vendit tonë, tashmë pronësia intelektuale është një koncept i cili po fiton qytetarinë. Kështu, gjithnjë e më shumë, të gjithë elementët që e përbëjnë atë po bëhen të dëgjuar, dhe jo vetëm në ambientet teknike, por ato po shoqërohen prej legjislacionit mbështetës, organeve përkatëse të cilat i administrojnë ato, traktateve dhe marrëveshjeve ku vendi ynë është palë, etj. Gjithnjë e më shumë kuadri ligjor i vendit tonë po plotësohet ku mund të përmendim ligjet për patentat, markat tregtare, dizenjot industriale, emërtimet e origjinës, treguesit gjeografikë, treguesit e burimeve, të drejtat e autorit, ndërkohë që nuk ka ligje për të mbrojtur disa elemente të tjerë të pronësisë intelektuale si: të drejtat morale; të drejtat e personalitetit; mbrojtje e varieteteve bimore; veshjet tregtare; sekretet tregtare.

Vendi ynë është anëtar i OBT-së si edhe nënshkrues i marrëveshjes TRIPS (Aspekte Tregtare të të Drejtave të pronësisë Intelektuale), që prej Shtatorit të vitit 2000. Po ashtu vendi ynë është anëtar i EPO (Zyrës Europiane të Patentave), që prej Shkurtit të 1996. Gjithashtu vendi ynë aderohet në shumë traktate dhe konventa, dhe është palë e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, duke ndjekur zhvillimet ndërkombëtare në këtë fushë, lidhur me standardizimin e legjislacionit. Vendi ynë aderohet në marrëveshjet ndërkombëtare, me të rëndësishme në fushën e PI-ve si Konventa e Bernës; Traktati i Budapestit; Marrëveshja e Madridit; Protokollin e Madridit; Konventa e Parisit; Konventa e Fonogrameve; Konventa e Romës. Shqipëria aderohet në një sërë traktatesh të WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale).

Në vendin tonë ekzistojnë organizma në lidhje me pronësinë intelektuale si dhe specialistë të fushës, që ndihmojnë që këto organizma të luajnë rol qendror në formimin e sistemeve rregullatorë dhe administrative, të cilat mund të nxisin ose pengojë gjenerimin, komercializimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Disa prej këtyre institucioneve që interesohen apo janë përgjegjës për çështjet e pronësisë intelektuale janë: Drejtoria e Patentave dhe Markave, Autoriteti i Konkurrencës; Drejtoria e Krimit Ekonomik të Policisë; Doganat; Gjykata e Tiranës; QIP (NGO). Sidoqoftë, filozofia dhe praktika e këtyre institucioneve, ende është larg standardeve të BE dhe WIPO.

Gjithashtu shumë institucione të tjera kanë lidhje me pronësinë intelektuale. Ato krijojnë, gjykojnë, njohin dhe promovojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. Institucione të tilla përfshijnë universitetet, gjyqësorin, si edhe dikastere, dogana dhe institucione të tjera në nivel lokal. Këto janë çelës për mbrojtjen, njohjen dhe promovimin e sistemit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Edhe në vendin tonë, ndërmarrjet e biznesit, kryesisht bizneset e mëdha janë entet shndërruese më të mëdha, të të drejtave të pronësisë intelektuale, në produkte dhe shërbime të prekshme. Përveç drejtimit të pavarur të kërkim-zhvillimit, nëpërmjet njësive të brendshme të tyre të kërkim – zhvillimit, apo mënyrave të tjera të sigurimit të pronësisë intelektuale, ato janë aplikuesit kryesorë të gjithë sistemit rregullator, dhe praktikisht aty një element i pronësisë intelektuale gjen vlerën e tij të vërtetë dhe përfitimin që ai i siguron kompanisë, prej mbajtjes apo komercializimit të tij.

Në vendin tonë ka probleme, për sa i përket dhunimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, të cilat kanë qenë në forma të tilla si: dhunim i copyright; falsifikimi i markës; shkelje/dhunim i dizenjot etj. Në rastet kur janë hasur probleme të kësaj natyre, shpesh janë ndërmarrë veprime të tilla si: padi civile në gjykatë. Gjithashtu, për forcimin (shtrëngimin) e të drejtave të pronësisë intelektuale, në vendin tonë, janë ndërmarrë veprime prej strukturave të tilla si: DPMSH (Drejtoria e Patentave dhe e Markave); GTZ; USAID; Shkolla e Magjistraturës etj.

Sidoqoftë, në raste të shkeljeve apo dhunimeve të elementeve të ndryshëm të pronësisë intelektuale, kur ato konstatohen prej palëve të interesuara, ato mund t'i drejtohen për zgjidhje ligjore Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës si dhe Gjykatës së Apelit të Tiranës. Ndërkohë që në Tiranë gjenden edhe avokatë të specializuar në çështje të pronësisë intelektuale. Për sa i përket ndikimit të ligjeve që mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, ato e lehtësojnë ecurinë normale të biznesit. Gjithashtu, për sa i përket praktikave të përdorimit të elementeve të ndryshëm të pronësisë intelektuale si: noterizimi i dokumentacionit; legalizimi i dokumentacionit; përkthimi i dokumentacionit, etj, në vendin tonë, ato janë të ngjashme me praktikat në vendet e BE.

Megjithëse vendi ynë është duke ecur në drejtimin e duhur për të arritur standardet e nevojshme, për sa i përket çështjeve të pronësisë intelektuale, me qëllim Integrimin në BE, përsëri ecuria ende nuk është e kënaqshme dhe ende përpara shtrihet rrugë e gjatë.

Konkluzione

Muzika, filmat, librat, arti shpikjet e ndryshme, si edhe format e tjera të krijimtarisë dhe të shprehjes janë tregues të progresit social dhe cilësisë së jetës. Si pronësi private të krijuesve të tyre origjinal, ato janë vlerësuar dhe mbrojtur nga shoqëria për rolin e tyre ekonomik, politik dhe kulturor – si shprehje e trashëgimisë dhe përpjekjeve njerëzore.

Tërësia e tyre e shprehur në termin Pronësi Intelektuale, është bërë objekt mbrojtjeje që herët, me Ligjin Venecian të vitit 1474, si përfaqëse fillestare sistematike në mbrojtjen e shpikjeve prej një lloji forme patente; duke vazhduar me Konventën e Parisit, të vitit 1883, si traktati i parë kryesor ndërkombëtar, për të ndihmuar individët e një vendi të siguronin mbrojtjen në vende të tjera për krijimet e tyre intelektuale; si edhe pak vjet më pas më 1886, Konventa e Bernë-s, një tjetër traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e punëve letrare dhe artistike, për njohje të ndërsjellë të së drejtës së autorit midis vendeve të ndryshme.

Pronësia intelektuale përfaqëson një tufë të drejtash për ti krijuar ekskluzivitet mbajtësit të tyre. Disa nga elementët e pronësisë intelektuale janë: e drejta e autorit, të drejtat morale, treguesit gjeografik, të drejtat e dizenjove industriale, patentat, veshjet tregtare, markat.

Ligjet e pronësisë intelektuale për krijimin, identifikimin, sigurimin, regjistrimin dhe forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale ndryshojnë mjaft nga një vend në tjetrin. Por integrimi ekonomik ndërkombëtar dhe prirjet e globalizimit e të ndërvlerësimit ekonomike botërore, diktojnë harmonizimin e tyre nëpërmjet traktateve apo organizmave qeverisëse të PI-ve, ndërkombëtare rajonale dhe globale, (WIPO, EPO, TRIPS) ku Shqipëria ka aderuar me kohë.

Në vendin tonë ekzistojnë institucione (ose strukturë NGO apo GO) të cilat interesohen (janë përgjegjëse) për çështjet e pronësisë intelektuale, por ende duken larg standardeve të BE dhe WIPO, për nga filozofia dhe praktika e këtyre institucioneve në lidhje me pronësinë intelektuale, të drejtat e saj dhe mbrojtjen e tyre.

Ndërsa vendi ynë ka një paketë ligjore e rregullatore, kënaqshëm të plotësuar, që lehtësojnë ecurinë normale të biznesit për një pjesë të elementëve të PI-ve, ende nuk ka fare ligje si dhe nuk ekzistojnë ueb-site zyrtare, në të cilat mund të kryhet kërkim për elementët e ndryshëm të pronësisë intelektuale, apo të jenë pjesë e networkut ndërkombëtar përkatës.

Ndërsa procedurat e fitimit të së drejtës për përdorim të elementëve të ndryshëm të pronësisë intelektuale në vendin tonë, janë të ngjashme me praktikën në vendet e BE-së, janë hasur probleme, për sa i përket dhunimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Me qëllim forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, janë ndërmarrë veprime prej strukturave të ndryshme, por ende nuk ka politika dhe programe qeveritare të mirë-menduara e koordinuara, për sa i përket luftës kundër piraterisë dhe produkteve të falsifikuara. Niveli i piraterisë në vendin tonë, është në një shkallë mesatare, dhe gjendja e legjislacionit dhe mos zbatimi i ligjit (nga ana e individëve të ndryshëm) kanë qenë disa prej shkaqeve për këtë.

Referencat

Alexander I. Poltorak, Paul J. Lerner, "Essentials of intellectual property", USA, 2002.
Andy Gibbs, Bob De Matteis, "Essentials of patents", USA, 2003.

Claas Junghans, Adam Levy, *"Intellectual property management"*, Germany, 2006.
 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së publikimeve Zyrtare, Nr.42, Qershor 2005.
<http://www.wikipedia.org>, the free encyclopedia
<http://www.wipo.org>, "World Intellectual Property Organization", Botime ne Internet.
<http://www.wto.org>, "World Trade Organization", Botime në Internet.
 John J. Wild, Kenneth L. Wild, Jerry C.Y. Han, *"International Business"*, botimi II, USA, 2004.
 Koci Elina, *"Pronësia Intelektuale, E Drejta e Autorit dhe Markat"*, Tiranë, 2003.
 Ligji Nr. 7564, datë 19.5.1992 "Për të Drejtën e Autorit"
 Ligji Nr. 7819, datë 27.04.1994 "Për Pronësinë Industriale"
 Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"
 Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"
 Ligji Nr. 8116, date 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë"
 Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë"
 Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të"
 Masaaki Kotabe, Kristiaan Helsen, *"Global Marketing Management"*, botimi III, USA 2003.
 Microsoft ® Encarta ® Reference Library 2004.
www.alpto.gov.al

The End of Oil and Petropolitics in the 21st Century

Fatos Tarifa

Romeo Gurakuqi

Irena Nikaj

Joshua Ludy

- Gregory, A. (2000): *Planning and Managing Public Relations Campaigns*. London. IPR.
- Gruing, J. (1989) *Symmetrical Presuppositions as a Framework for Public Relations Theory*, in: *Public Relations Theory*, /ed./ Bolton, C. i Hazleton, V. Mahwah. LEA Pub.
- Heath, R., Coombs, T. (2006) *Today's Public Relations-An Introduction*. Thousand Oaks. Sage pub.
- Gruing, J, Hunt, T. (1984): *Managing Public relations*. Thomson-Wadsworth.

- Jefkins, F. (2003) *Oglašavanje*. Beograd. Clio.
- Kinebrock, W. (2000): *Multimedijski marketing*. Beograd. Clio.
- Kotler, P. (1994): *Upravljanje marketingom*, Informator, Zagreb.
- Potter, L. (2007): *Komunikacijski plan-srž strateških komunikacija*, HUOJ, Zagreb.
- Šiber, I. (2003) *Politički marketing*. Zagreb. Politička kultura.
- Wilcox, D., Ault, P., Agee, W. i Cameron, G. (2001) *Esentials of Public Relations*. New York. Longman.
- <http://www.mvpei.hr>
- <http://www.vlada.hr>
- <http://www.poslovni.hr>

Një nobelist “anti-krizë”

Adrian Civici

Në kulmin e krizës të frikshme financiare që po kalon gjithë globi, krizë që po hedh shumë re të zeza mbi të ardhmen e ekonomisë botërore, ishte më se e natyrshme që të pritej me shumë interes emri i atij që do nominohej me çmimin prestigjioz “Nobel në ekonomi”. Dhe me sa duket, mesazhi dhe vlerësimi i Akademisë Mbretërore Suedeze ishte në drejtimin që pritej. Çmimi Nobel 2008 kurorëzoi ekonomistin amerikan Paul Krugman, një nga kritikët më të mëdhenj të politikës ekonomike e financiare amerikane të Presidencës Bush, një ekonomist i njohur dhe identifikuar gjerësisht si “neo-keynes-ian dhe përkrahës i teorisë së nevojës së ndërhyrjes së Shtetit për të rregulluar devijimet dhe çrregullimet e tregut”. Profesori i shquar i universitetit të Princeton-it, MIT Boston dhe editorialist i spikatur i New York Times, u laureua veçanërisht për punimet e tij në lidhje me tregjet dhe tregtinë ndërkombëtare.

E veçanta e Paul Krugman-it nuk qëndron thjesht te vlerat si ekonomist me përmasa ndërkombëtare apo si autor i studimeve e librave që sot janë pika referimi për ekonomistët dhe lexuesit e mbarë botës. Vlera e veçantë e tij qëndron në faktin se Krugman bën pjesë në një grup shumë të vogël studiuesish që e kanë “parashikuar” rrezikun e krizës financiare aktuale duke evidentuar dhe faktorët që e shkaktojnë atë. Për të gjithë lexuesit, politikanët dhe analistët tashmë vlerësohet si profetik libri i Krugman-it i botuar në 2001 me titullin tundues “*Rikthimi i ekonomisë së depresionit. A po shkojmë drejt një krize të re si ajo e 1929?*”. Fatkeqësisht Krugmani nuk u dëgjua. Kritikët e tij i kujtonin shpesh jo pa ironi një shprehje se “ekonomistët kanë meritën e veçantë që të parashikojnë 10 kriza nga 5 të mundshme që vërtet mund të ndodhin”. Por Krugman vërtetoi se kishte qenë totalisht i saktë që para shtatë vitesh kur analizat dhe këndvështrimet e tij e çuan në përfundimin se “*një situatë e ngjashme me krizën më të madhe që ka njohur deri tani sistemi kapitalist, atë të viteve 1929-1933, ne mund të na prekë përsëri*”. Fatkeqësisht u provua se ai kishte të drejtë.

Paul Krugman është sot një nga ekonomistët më të lexuar të botës. Në radhë të parë sepse “*ai ndryshoi mënyrën se si ekonomistët mendonin dhe vlerësonin globalizimin*”. Mbas publikimit të librave të tij, studimi i ekonomisë ndërkombëtare nuk është më si më parë. Krugmani argumentoi se globalizimi nuk duhet parë as si “*një fenomen që sjell vetëm mrekulli, dhe as si një demon që sanksionon disa vende e popuj në favor të disa të tjerëve*”. Përkundrazi, ajo që rezulton si thelbësore është fakti se “globalizimi duhet parë në tërë

kompleksitetin e tij...se bota e globalizuar është më e ekspozuar ndaj krizave....se, si të mirat, ashtu dhe goditjet nga globalizimi duhen parë të personalizuar” në kontekstin dhe përmasat e aktorëve ekonomikë, qofshin këto edhe shtete apo rajone të veçanta. Teoricien i globalizimit dhe tregtisë ndërkombëtare, por jo mbështetës i politikave të barrierave doganore, Krugman është gjendur shpesh nën shënjestrën e sulmeve të ekonomistëve liberalë e ultra-liberalë. Debatin e tij kryesor, ai e ka bërë në mbrojtje të tezës “*së konkurrencës në tregjet globale*”, duke goditur veçanërisht pikëpamjen se në këto tregje gjithçka zhvillohet në kushtet e një konkurrence perfekte. Krugman dëshmoi në analizat e tij se shumë shpesh “në treg dominojnë oligopolet”, të cilat ndjehen të mbrojtura nga politika dhe bëjnë gjithçka për të mos u perceptuar qartë nga konsumatorët të cilët paguajnë fitimet e tyre kolosale. Këtu fillon dhe vëmendja apo roli i veçantë që Krugman i atribuon Shtetit dhe mënyrave të ndërhyrjes së tij në ekonomi në favor të eliminimit të çrregullimeve strukturore dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

Popse Krugman-i? dhe pse pikërisht tani, në kulmin e krizës globale? Mos vallë ngaqë ai konsiderohet si një nga ekonomistët më aktivë “anti-Bush”? Shumë personalitete që e njohin nga afër mënyrën se si vepron dhe vendos Akademia Mbretërore Suedeze kur atribuon çmimin Nobel, shprehen të bindur se një paralelizëm i tillë as që duhet menduar. Përkundrazi, ata mendojnë se shkaku kryesor i kurorezimit të Krugman-it, është se sot, më shumë se kurrë, kriza e thellë financiare ka rihapur disa debate e dilema “të konsideruara të vjetra” apo “jashtë modës”. Krugmani studioi në detaje “se si mund të lindin në mënyrë të papritur krizat edhe atje ku për një kohë të gjatë gjithçka duket e stabilizuar”....se si “situata apo sinjale ekonomiko-financiare që konsiderohen të tolerueshme dhe të padëmshme, mund të bëhen dramatike”. Dhe, në këto raste, “recetat” e tij kanë qenë mjaft “ortodokse” : ndërhyrja e qeverisë dhe Shtetit është e domosdoshme, por ajo duhet të jetë njëkohësisht dhe shumë e besueshme”. Sipas Krugman-it, “Piani Paulson në SHBA dhe në mënyrë të veçantë, ndërhyrja e qeverive evropiane janë zgjidhja më e mirë për përballimin pa shumë dhimbje të krizës aktuale që ka përfshirë tregjet financiare dhe financat globale”.

Në gjuhën e politikanëve, në masmedia, revista të specializuara, bile dhe në debatet e përditshme të shumë njerëzve po përdoren terma e koncepte që dukej sikur i takonin historisë apo ishin thjesht diskutime teorike. “Rikthimi triumfal i Keynes-it”, “Kapitalizmi shtetëror në revansh”, “Monetarizmi drejt muzeut historik”, “Liberalizmi i paralizuar”, “Kapitalizmi anglo-sakson në pikëpyetje”, “Ëndrra amerikane apo zgjimi i trazuar amerikan?”, “Reegan-dhe Thatcher : gabimet e mëdha”, “Fundi i kapitalizmit”, etj., janë disa prej tyre. Ç’po ndodh që gjithçka e servitur dhe mbrojtur si premisa dhe faktori i suksesit në fushën e zhvillimit ekonomiko-financiar po vihet në dyshim? Kriza financiare dhe frika e përhapjes së saj në ekonominë reale është tmerrësisht e madhe. Po në ato përmasa po kërkohet dhe fajtori apo kurban i saj. Dhe për momentin duket sikur është gjetur. Fajtori quhet KAPITALIZËM. Faji kryesor : zakone dhe sjellje tejet liberale. Dënimi : kontroll i rreptë dhe ndërhyrje Shtetërore për disiplinimin e tij.

Fundi i kapitalizmit? Aspak, krejt e kundërta! Falimentimi i bankave apo kompanive të mëdha financiare është në fund të fundit “një sanksion i tregut”. Nëse një biznes bën gabime ai është i destinuar të falimentojë dhe të zëvendësohet nga biznese të tjerë

më efektive. Në gjuhën ekonomike kjo quhet “shkatërrimi krijues” dhe është burimi i dinamizmit dhe eficiencës së ekonomisë së tregut. Kriza e Wall Street-it sinjalizon triumfin e kapitalizmit dhe rigjenerimin e sistemit bankar. Bankat e reja që priten të lindin kanë tashmë një mësim më shumë për ta pasur në konsideratë : të mos bëjnë gabimet e tanishme të homologeve të tyre. Fundi i “laissez-faire” apo liberalizmit dhe rikthim i regulacionizmit apo planifikimit të centralizuar? Gjithshka duket shumë larg kësaj ideje. Funksionimi i bankave dhe profesioni i bankierit është nga më të rregulluarat e kontrolluarat, por kriza aktuale dëshmoi se ky rregullim u zbatua keq ose nuk u zbatua fare. Marrëveshja ndërkombëtare mbi rregullat e supervizionit bankar e quajtur “Bazel 2” nuk është zbatuar si duhet ose është zbatuar pjesërisht, pa përjashtuar këtu konkluzionin e mjaft ekspertëve se “ajo ishte e paplotë dhe kushtet e reja kërkojnë një Bazel 3” me shtrirje dhe efekte më globale. Një financier i shquar, Charles Wyplosz shprehet se në *“këtë rast, paaftësia jonë është më fajtores se sistemi që po anatemojmë”*. Një rregullim dhe kontroll cilësor i bankave kushton shtrenjtë. Por në fund të fundit ky është një çmim që tregu kërkon që të paguhet për të pasur “produkt” cilësor. Ch.Wyplosz thotë se “ne ju shmangëm kësaj pagese ose nuk e bëjmë atë të plotë....dhe pasoja erdhi....edhe këtë radhë tregu na ndëshkoi”.

Pikërisht në këtë situatë të komplikuar qëndron dhe merita e Krugman. Ai është përkrahës i tregut të lirë po aq sa është dhe partizan i realizimit nga ana e Shtetit të disa ndërhyrjeve e funksioneve bazë në ekonomi. Nuk ka nevojë të presim që tregu të na ndëshkojë, bile rëndë si tani. Krizat duhen pranuar se mund të ndodhin, por njëkohësisht qeveritë duhet të jenë prezente e rigorozë jo vetëm në supervizionin konstant të tregut, jo vetëm në garantimin e transparencës dhe ndershmërisë së tij, por mbi të gjitha në ndërhyrjen e tyre aktive e masive në pikat dhe situatat delikate të prodhuara prej tij në momente. “Paketa anti-krizë Paulson” në SHBA, vendimet e G 7 dhe G 20 si dhe plani i qeverive evropiane për eliminimin e krizës duket se janë prova më e mirë për këtë. Ky është “mësimi” për të cilin duket se u laureua me çmimin Nobel Paul Krugman-i.

Henry Paulson, ose “Hammer”-i i përballimit të krizës financiare

Adrian Civici

“Çelësi” i zgjidhjes së krizës financiare amerikane ka tashmë edhe një emër të përveçëm. Ai quhet Henry Paulson, që prej vitit 2006 në postin e sekretarit amerikan të thesarit, pozicion i ngjashëm me Ministrin e financave. Me anën e planit të tij special anti-krizë të quajtur thjesht “plani Paulson”, ish drejtuesi i njëres nga bankat më të mëdha në SHBA dhe botë, asaj Goldman Sachs, fatkeqësisht dhe ajo e prekur mjaft rëndë nga kjo krizë, për disa javë u bë personi më i rëndësishëm i Amerikës. Paulson u bë kryefjala e të gjithëve, në Amerikë dhe jashtë saj. Duke filluar nga Presidenti Bush, vazhduar me dy kandidatët për president Barack Obama dhe John McCain, me Nancy Pelosi Kryetaren demokrate të dhomës së përfaqësuesve, presidenti i FED Ben Bernake, pa përmendur këtu udhëheqësit e botës mbarë, të gjithë i drejtuan sytë dhe veshët në propozimet e tij “shpëtimtare”. Xhorxh Bush foli 14 herë publikisht për këtë plan gjatë 15 ditëve të fundit, gjë që nuk kishte ndodhur asnjëherë me presidentët amerikanë. Dhe më në fund, pas shumë debatesh, shpresash e dyshimesh, në 3 tetor 2008, në kuadrin e një “ligji të stabilizimit ekonomik me urgjencë për 2008”, dhoma e përfaqësuesve, me 263 vota pro dhe 171 kundër votoi “planin Paulson” të përmirësuar. Versioni përfundimtar i shtonte edhe 150 miliard dollarë të tjera shumë fillestare prej 700 miliard dollarësh. Wall Street, bursa e Nju-Jorkut dhe bursat kryesore të botës morën përkohësisht frymë të lehtësuara, por megjithatë askush nuk pranon “të vëri bast” se për sa kohë do vlejë kjo qetësi. Ankthi në ekonominë, financat, bankat dhe shqetësimet e depozituesve në mbarë botën vazhdon. Skena politike e niveleve më të larta të botës është mbërthyer në takime, bisedime, marrëveshje e vendime që kanë në fokus vetëm krizën financiare amerikane dhe shkallën e infektimit prej saj të financave dhe ekonomisë botërore. Por, në fund të fundit, epilogu i gjithë kësaj lëvizje frenetike mbetet pikëpyetja “çfarë efektesh dhe rezultatesh do të japë zbatimi i planit Paulson?”. A do të arrijë të fiksohet në histori Henry Paulson si “çelësi i përballimit të njëres nga krizat financiare më të mëdha të kapitalizmit?”.

Sekretari amerikan i thesarit ka mbajtur gjithnjë mbi vete epitetin “the Hammer” (Çekiçi), meqenëse në rininë e tij ai ishte një lojtar i shquar në futbollin amerikan. Paulson nuk ka fare “aftësi” për të qenë shumë i komunikueshëm me të tjerët. Shpesh,

Ai vlerësohet se kalon dhe limitin e mirësjelljes duke shfaqur shenja gjaknxehtësie të paparashikueshme. Kongresmenët dhe senatorët amerikanë përmendin shpesh se “edhe vetë plani i tij i shpëtimit të financave amerikane ka tiparet e një tentative dhe imponimi force”. Por Henry Paulson është mbi të gjitha një njeri pragmatik. Ai e rishikoi dhe korrigjoi pa u mërzhitur planin e tij deri sa e bëri atë të votueshëm për kongresmenët. Ai pranoi tu bënte shumë koncesione politikanëve të cilët e akuzonin se po detyronte taksapaguesit e thjeshtë amerikanë që të paguanin për çmenduritë e Wall Street-it. Paulson duhet të bindte të vetët por dhe “kundërshtarët” demokratë që të votonin pro planit të tij të shpëtimit. “Unë nuk ju dija kaq katolik zoti Paulson” i thoshte me humor kryetarja e demokratëve dhe dhomës së përfaqësueseve, Nansy Pelosi, duke e ditur se interlokutori i saj ishte një i krishterë shientolog, dhe për më tepër, që ishin republikanët ata që po i vinin stërkëmbësin planit të ministrit të tyre. Në mënyrë paradoksale, ish padroni i bankës Goldman Sachs, i njohur si një nga përkrahësit më të zjarrrtë të liberalizmit, po akuzohej nga familja e tij politike “se po tentonte të impononte në mënyrë autoritare një zgjidhje të pastër sipas traditave marksiste”. Paulson po bëhej kështu viktimë e të kaluarës dhe reputacionit të tij në Wall Street. Kundërshtarët e tij kishin në dorë dy argumente të forta në lidhje me karakterin e Paulson-it. Mënyrën “e ashpër” me të cilën në vitin 1999 ai eklipsoi Jon Corzine, partnerin e tij në Goldman Sachs dhe faktin më të hershëm të adoleshencës së tij, kur Paulson ishte një nga lojtarët më të “pa mëshirshëm” të ekipit të futbollit amerikan të universitetit të Dartmouth-it në New Hampshire, ashpërsi që i dha dhe epitetin “the Hammer”.

Karakterin “i ashpër” e ka shoqëruar gjithnjë Paulsonin. Ata që e njohin nga afër e dinë se shpesh ai nuk nguron të përplasë grushtin në tavolinë kur gjërat nuk “shkojnë ashtu siç duhet”. Por realiteti është më kompleks se kaq. Duke kombinuar shientologjinë me skautizmin, i biri i një argjendari, i lindur në vitin 1946, Paulson ka ruajtur vazhdimisht sensin e disiplinës, një lloj asketizmi si dhe dëshirën për veprime të mira. Ai nuk pi pije alkoolike dhe nuk luan golf, veti këto mjaft të vlerësuara për një bankier. Në Nju Jork ai i shmangej shpesh jetës mondane dhe kthehej vazhdimisht para orës 21.00 në shtëpi “për të mos ngrënë nga orët e gjumit apo për të ndenjur më shumë me gruan në shtëpi”. Në moshën 62 vjeçare, ky burrë i madh por elegant, me portret imponues ka ruajtur gjithnjë një fizik sportiv. Në Washington ai ishte i spikatur për turet e gjata me biçikletë në parkun e Rock Creek-it. Ai është shumë i lidhur edhe me natyrën dhe i pëlqen ta përsërisë shpesh, se në rininë e tij ka pasur ëndërruar të bëhej rojtar pyjesh, ëndërr që e prishi mbasi realizoi një Master në financë në universitetin e famshëm të Harvard-it. Por megjithatë, përpara se të bëhej Sekretar i thesarit, ai ishte President i “Nature Conservancy” dhe anëtar aktiv i një komiteti ndërkombëtar për ruajtjen e luginës së tre grykave në Kinë. Ky konservator natyral u prononcua menjëherë në favor të objektivave të Marrëveshjes së Kyoto-s (Japoni) për lëshimin në atmosferë të gazrave që shkaktonin efektin serrë, një protokoll që qeveria Bush e hodhi poshtë. Por financieri që fitoi miliona dollarë në krye të Goldman Sachs, rezulton të jetë dhe një filantrop i shquar. Ai i dhuroi së fundi 100 milionë dollarë në aksione tek banka e tij, për një fondacion që luftonte për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, Paulson ka

bërë të ditur se mbas vdekjes së tij, ai ja dhuronte pasurinë e tij prej 500 milionë dollarësh fondacioneve dhe organizatave që merren me kujdesin për fëmijët në nevojë. Ai i konfirmoi një gazetareje se “i donte shumë fëmijët e tij dhe për këtë arsye nuk e shikonte te udhës që ti linte një shumë kaq të madhe parash”.

A ishte vetëm sensi i tij civil që e shtyu Henry Paulson që të braktiste milionat e Wall Street-it ku ai mbretëronte me kompetencën e tij, me postin e sekretarit të thesarit në qeverinë Bush në 2006? Ai hezitoi gjatë përpara se ti përgjigjej pozitivisht ftesës së Bush-it për tu bërë pjesë e ekipit të tij. Këshillat kryesore i morri nga ish sekretari i shtetit të Bill Clinton-it, Robert Rubin, paraardhësi i tij tek Goldman Sachs. Megjithatë, duke pasur parasysh se Xhorxh W. Bush-i besonte shumë pak tek “jakat e bardha” të Wall Street-it duke preferuar të kishte në ekipin e tij sa më shumë nga të cilësuarit si “besnikë”, zgjedhja e Henry Paulson-it si sekretar shteti shkaktoi jo pak habi e polemika në gjirin e republikanëve. Por sot, janë të shumtë ata që vlerësojnë se Bush bëri një zgjedhje të shkëlqyer me Paulsonin. Sfida e madhe qëndron në faktin se “numri një i financave amerikane, përfaqësues nga më të lartët në administratën republikane dhe për më tepër, i cilësuar si financieri superliberal është sot më popullor te demokratët se sa në partinë dhe mbështetësit e tij republikanë. Natyrisht, Paulson nuk shquhet si ideolog. Megjithëse ai ka qenë gjithmonë anëtar i Partisë republikane, Paulson-i evidentohet më shumë si pjesëtar i grupit të moderuar të të ashtuquajturve “*Republikanët Rokfeleristë*”. Bashkëshort i një gruaje të shquar si demokrate, Paulson ka ditur gjithmonë që të dialogojë me opozitën dhe të gjejë zgjidhje të përbashkëta me të. Partia e Nancy Pelosi-t nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të aprovonte në fillim të 2008 planin e tij të mbështetjes ekonomike prej 168 miliard dollarësh. Ai arriti me shumë mjeshtëri të bindte Xhorxh Bushin për rreziqet që paraqiste gropa e madhe dhe e rrezikshme që ishte krijuar në SHBA ndërmjet super të pasurve dhe pjesës tjetër të Amerikës. Paulson arriti përsëri, në kuadrin e kërkimeve frenetike të një recete për ta shpëtuar ekonominë dhe financat amerikane nga kjo krizë e tmerrshme e javëve të fundit, të bindte demokratët e republikanët se “plani Paulson” ishte zgjidhja më e mirë. Dhe e gjitha kjo, në kurriz të humbjes së reputacionit të tij si ultraliberal dhe “damkës” së një neo-keney-s-iani apo akoma më keq, të një neo-marksisti. Vetëm Henry Paulson arriti të tregojë i aftë të navigonte në ujërat e turbullta të krizës aktuale, etheve të fushatës presidenciale, reagimit të dhjetëra milionë amerikanëve të thjeshtë që protestoni çdo ditë kundër favoreve për Wall Street-in, shqetësimit të bankierëve dhe liderëve të botës mbarë.....dhe të impononte planin e tij, që me gjithë rezervat apo kritikata duket se ishte i vetmi për të dalë nga kjo krizë financiare me përmasa të frikshme globale.

Concept and rebus of development policies

Prof.ass.Dr. Adrian Civici

Abstract. How much developed or undeveloped are we? Do we or don't we have coherent development policies? Are we or aren't we developing? Is economic growth helping us sufficiently on our way towards development? And finally, are we or aren't we clear about the concept and dimensions of development itself? ... concerning the relationship between growth and development? Following attentively and progressively the vision of Albanian political spectrum regarding these questions, the vision of main academic institutions and civil society as well, it is concluded that the questions raised as well as the lack of coherence are still significant.

This unclear situation and this kind of debate are certainly typical of Albania as well as of all countries in the world, but in particular of developing countries, which in the effective conditions of globalisation, present financial-economic crises that is affecting many countries are deeply reflecting over their strategies and policies towards socio and economic development. In the core of debates stands the "concept of development", the way the fundamental theories of development or rich western countries' experiences are absorbed by different countries and nations. The question of defining the "development model" still remains a big question mark to many countries and international institutions while it is normal for Albania the debates and suggestions to reflect confusion and insufficiency in response to this paramount issue.

A neoclassical analysis of the Albanian Growth Patterns

Prof. Asoc. Dr. Luljeta Minxhozi

Abstract. The years of transition has created a Growth pattern for Albania. After a sharp decline of the output during the first years of the transition the, following the extend of the private sector the GDP growth showed a good performance in the coming years. The policy makers in Albania are focused to develop strategies that can

sustain the positive rate of growth experienced in the last decade. An analysis of the sources of economic growth could help us to understand better the factor that can create sustainability in growth patterns. The aim of the paper presented is to identify the factors that had contribute in the high rate of GDP growth in Albania in a neoclassical approach. By decomposing the sources of growth we can understand that the most significant determinant of growth are physical and human capital accumulation. The key finding of the paper is that the case of Albania the engine of growth has been the high rate of growth of TPF (Total Factor Productivity). The evidence from Albania suggests that growth during the past decade has been driven primarily by reallocation of the resources that occurs in the aftermath of transition. This has been made possible by the fact that Albania was swift in achieving macroeconomic stabilization and moved to liberalize prices and external trade, to privatize agriculture and SME after transition. To further boost the growth is needed to maintain macroeconomic stability, to improve the investment climate, to remove the obstacles to competitiveness and to mobilize resources of essential public investments.

Economic development in retrospective and perspective

Dr. Selami Xhepa _____

Abstract. Economy researchers, who try to explain the unexplainable “puzzle” of human society economic development, face questions and fight with unsolvable dilemmas. Why some countries are developed and some others are not? Which are the fundamental factors of growth, and are they the same with all countries and all times? What are the limits of economic growth and are there any? Such questions of the discipline of economic development have drawn the attention of researchers throughout centuries, with the hope of understanding the processes within this “black box” as well as to orientate policy-making with the aim of accelerating country’s economic development and increasing citizen’s living standards.

In this context, nevertheless, a parenthesis needs to be made, bringing to mind Schumpeter’s remark in 1952 that “economics is not a list of political prescriptions, but a unity of analytic instruments”. Thus, economics provides the methodology in studying and understanding a phenomenon, while it cannot be blamed or pretend merits of success or failure of the economic development of the society. Development is not simply economics; it covers the history, politics, sociology, and anthropology – being this way a multidisciplinary field. This is the reason why looking back in history is very helpful since through the echoes of an old world we could draw valuable lessons, which would prevent our society from falling into a second medieval darkness. To the economists, who cannot exploit the experiment as a method, history is the laboratory

to draw lessons from successes, but more importunately from errors, on the way of economic development. Throughout the history of economics, its theoretic paradigms have pended between “Smith’s laissez-faire”, Keynes’s interventions, and socialisation Marxist theories, to return at the end of the past century to the paradigms of the magnificent market forces. But presently, as Greenspan says, we have entered the epoch of turbulence, which is why we are simultaneously both Keynesians and Friedmanists, or simply eclectics. In order to better understand the present day realities let us have a quick observation of the development economic theories, which is presented in the form of early research collections carried out by the most reputable authors, masterfully collected into the Meier and Stiglits publication (2001).

Sustainable growth and environmental challenges

Dr. Juliana Latifi

Abstract. “The new millennium offers everybody a possibility to reflect over the achievements and failures of mankind during the past millennia and the challenges we will have to face during a new and more interdependent era in the history of mankind. A lot of our present-day concerns might seem insignificant in a long-term perspective, but the aim for sustainable, equal and healthy development, under the environmental perspective, is even more important since it concerns the survival of life on earth”.

These days, a number of serious environmental problems lay ahead of humankind.

Depletion of the ozone layer; irresponsible exploitation of underground waters; decrease of earth productivity; destruction of tropical rainforests as well as dry forests; irreversible loss of species, impact of uncontrolled population growth, etc; considerably influence the environment, making the environmental equilibrium in the viewpoint of sustainable development be fragile and frequently not sustainable.

The challenge towards preservation of growth

Gjergj Filipi

Abstract. Compared to other countries in the region, Albania has been distinguished for impressive rhythms of economic growth during the transition period. Nevertheless, the country still remains the poorest in the region. Transition growth was clearly stimulated by the new incentives to appear after the collapse of centralised economy and the onset of the long journey towards market economy. These incentives were

transformed into a more efficient allocation of resources, vigorously increasing the Productivity of the Entirety of Factors that contributed during 1993-2003, with nearly 98% to the real economic growth, while labour and capital, which could be considered as the “raw materials” of national growth, have given a rather modest contribution. Emigrants’ remittances as well as the recent increased crediting have provided the internal demand, in function of economic growth. In context of global economy shrinkage, the risks to the growth of the Albanian economy increase, especially bearing in mind the fact that the present columns of economic growth will naturally move towards consumption, and they are not expected to ensure the long-term sustainability of growth. Policymakers remain responsible for orienting policies towards augmenting the other production factors, the workforce and capital. In order to achieve this, it is needed a present investment in the education of the future labour force , in the country’s trade growth and integration as well as in the improvement of the quality and efficiency of public institutions at all levels.

Human development paradigm and post-communist transition in Albania

Eno Ngjela

Abstract. Human development is not a recent invention. It is attributed to the early political and economic thinkers. Aristotle used to say that “wellbeing is obvious that it is not the good we search for, but it is simply useful for the sake of something else.” Emanuel Kant went on the tradition of treating human beings as the true aim of all activities, when stressing out the treatment of man in its form and never as a means. When Adam Smith, the defender of private free initiative, expressed his concern that the economic development must allow a person to freely mix with the others “without feeling ashamed to present himself in public”, he expressed a concept of poverty that went beyond the assessment of income concerning a concept that integrated the poor into the majority of community. The same line was reflected in the writings of the other founders of economic thought, including, Robert Malthus, Karl Marx and John Stuart Mill . This paper aims to present the alternative theory of human development, against the traditional theory of economic development, while applying it in the post-communist transition situation in Albania.

The ultimate goal of development is to broaden people’s choices. In principle, these solutions could be endless and may change with time. People usually asses achievements which never appear, or do not instantly appear, in the indicators of income development: better access to knowledge, better food and health services, safer neighbourhoods, safety against crime and physical violence, pleasant free time, political and cultural freedom and a participatory sense to community activities. In

brief, the objective of development is to create an environment that makes possible a long, healthy and creative life to the people.

Human capital and development – the Albanian case

Blerta Picari

Abstract. This article aims to analyse the changes and impact of human capital on the economic, political and social development of the country during the transition period. It analyses different aspects of human capital, focusing on the primary and secondary influential factors. It covers the educational system and the relevant governmental policies including the budget, trainings at work place and its adaptation to market requirements, as well as the secondary factors, like external and internal migration, social protection policies, health system, etc. This article gets forward the argument that based on present-day findings, the level and quality of human capital in Albania cannot serve as bases for achieving a sustainable economic development, and as a result, a political and social one in the future. The present quality of education, registration in elementary and high schools, as well as the impact of other elements do not provide firm foundations to improve the present situation of the human capital which is indispensable for giving an end to the ongoing transition the country is in.

Development policies of rural and disfavoured areas – the need for contemporary concepts

Doktorant Shkelzen Marku

Dr Tomi Treska

Abstract. Albania has a population of 3.13 million inhabitants, 54% of which lives in rural areas. The development of Albanian economy has had a relatively good progress the recent years with a growth of 5-7% annually. Among the main factors that brought and preserved this relatively high level of growth are the reforms in privatisation, liberalisation of trade, a high fiscal discipline, a relatively educated work force that is

capable of utilising market opportunities as well as the rapid growth of a sustainable financial sector. Rural areas cover 2/3 of the territory, while the disfavoured areas (even though there is not an official definition yet), are estimated to cover about 65% of the territory of the country. In these areas live about 1/3 of the population with almost 50% of farmland (compared to 56% of the total farmland in EU countries).

Based on the outcomes of policies implemented so far, a new development approach is necessary for these areas, which will offer more efficient solutions with quicker balancing and integrating effects. The challenges these areas face require more “holistic” and integrated methods for a sustainable and socio-economically balanced development, based on the experience of approaches adopted by many developed EU countries, based on the contemporary concept of territorial development.

Is extreme equality an objective to boast? The case of agrarian reforms in Albania

Fatmir Guri

Adrian Civici

Anne- Marie Jouve

Abstract. Historically, land administration in Albania has been directly related, like in a good number of countries, to the political system of the time. The study of organisation and structures that administered land remains a privileged research topic to urban economists, bearing in mind the radical changes that associated these structures along the last century. This article presents a general view of evolution of land structures during the last century. The main objective of our analysis is the comparison of the characteristics of agrarian reforms applied in Albania during 1930 – 1990 and the analysis of their effects on the structures of country’s farm land. The article is made up of five sections. The first section analyses land administration from the time Albania proclaimed its independence up to WW II with the reforms carried out by King Zog I. The second section explains the evolution of land structures in the aftermath of WW II with the 1946 reform. The third section focuses on de-collectivisation process in 1991 and the dissolution of all forms of collective ownership in agriculture. The fourth section makes a comparative analysis of the three agrarian reforms applied in the Albanian agriculture during the last century, the inspiring ideological support, as well as a comparison of results. Finally, there is a listing of results on the development of agrarian structures in the country. The main objective of this article is to demonstrate

that the agrarian reforms recently applied in Albania instead of fulfilling their goal of improving the situation of rural population as well as ensuring social peace, they have caused the counter effects. They have increased the land-related conflicts at village level, increasing as consequence land-related insecurity, reducing this way the efficiency of using this resource.

Economic Freedom as a determining factor for DFI influxes – Albanian case

L. Thoma

E. Luga

Abstract. In the present framework of globalisation, the economic growth depends on two main factors: Direct Foreign Investments (DFI) and the development of small and medium companies (SMC). While DFI are the main source of foreign financing, they could also increase the fix capital and help in achieving and preserving positive values in the payment balance. DFI have the potential for generating employment, increase of productive capacity, transferring capacity and new technology as well as increase of exports. The range of factors to determine DFI influxes into a country is very broad. Some are related to the internal factors of the investing company (foreign investor); while a lot of others are directly related to special factors of the country, where the investment will take place. (OLI and Dunning Theory) (Dunning 1993). The Economic Freedom, which is defined as “material independence of the individual over his/her property and work from the state and other organised groups”, consists of a number of complex factors which are directly related to the specific factors of the country where the investment will be made, or in other words, to the business environment in a certain country. In case of a weak investment climate due to taxes, tariffs, fines, corruption and need for extra services, the investing transaction costs get increased with investments directed elsewhere. The same thing could be said about the cases when costs of working force, transport and energy are not competitive in that country.

Country Ownership, Key Factor for Foreign Aid Efficiency

Evis Gjebreja

Abstract. Nowadays “foreign aid efficiency” is the term we usually encounter while referring to the foreign aid that the developed countries (donors) give to the developing countries “beneficiaries” in order to assist the latter ones in having economic growth. This has become a question of great importance considering the global commitments made by developed and developing countries to reduce poverty by fifty percent by 2015. This is important since the developing countries have taken commitments concerning the meeting of long-term objectives, while in return donors are expected to provide great funds of foreign aid to support the meeting of these objectives.

Consequently, the question to make is how to achieve foreign aid efficiency? There are a number of ways while the scope of this study is to determine one of the key factors, such as the country ownership, which is considered as the most challenging and important one. I purposefully mentioned the importance of this factor since it is a new concept and is a foundation for steady growth as well as influences donor’s decision-taking process in providing foreign aid. Since the country ownership process covers a number of actors, special attention needs to be given to partnership at different levels, whose quality is determining to country ownership.

Throughout this study, special attention will be given to the different ways of building country partnership with the aim of achieving country ownership. The first part explains the reasons of moving from aid under the conditions imposed by the donors towards the country ownership and partnership. The second part describes the ways of creating country ownership and partnership. The third part provides a case study from Ghana as a country of good experience. The fourth part provides a case study from Zambia as a country of not a very good experience. The last part presents recommendations and conclusions.

Project finance in developing countries – assessment on the construction of Vlora Thermoelectric Plant TEP

Ermela Kripa

Abstract. Being born as a technique used for financing major infrastructural projects, Project Finance has had a significant growth in recent years. Presently, it is a highly used technique in developing countries, industrialized ones and broader. This presentation aims to summaries the essential and institutional aspects this instrument is characterized of. One of the major aspects for assessing this project concerns the technical-economic relations between financial institutions, consortiums for giving concessions, providers, site builders and public entities, whose interests are continuously interwoven and are subject to the outcomes of prognoses made with the scope of guaranteeing the successful implementation of this initiative. The development of this instrument in different economic sectors of a country (including our country), makes possible the juxtaposition between country's technical competences, needs of financial markets, as well as assurance market needs, which are interconnected with one another and require exchange of information and knowledge. Construction phase constitutes the most important phase of the entire project, which together with the operative phase make up the core of the project itself. Finally, in order to better understand the way a Finance Project operates, we will provide a concrete example from the Albanian energetic sector and the use of this financial operation, bringing to light the advantages of constructing the Vlora TEP through this method.

Intellectual ownership, an old new concept

Dr. Kreshnik Bello

Abstract. History of humanity is based on the application of imagination, innovations and creativity, in other words, on existing knowledge, and this in order to solve different problems. There are countless examples to show that the imagination of people in the world made possible the present technological progress throughout the history of humanity. Alike in science, imagination is the source of progress in art as well. Music, painting, sculpture, architecture and other works of art are created by individuals who are not pleased with the old but see and express things through new and innovative ways. Intellectual ownership (IO) is the term to describe the ideas, inventions, technologies, music and literature, which are initially meaningless

when created, but acquire value when formed as products. Intellectual ownership is the commercial application of imaginary thoughts, to solve an artistic or technical challenge, it is not a product in itself, but a specific idea beyond that, the way it is expressed, named, described. Intellectual ownership derives from the bases of existing knowledge. It is result of the creative improvement of what worked well in the past, or the new creative expressions of old ideas and concepts. In our country, intellectual ownership, is a totally new concept. It was only after the '90-s that the state started dealing with issues concerning intellectual ownership and different elements of it. New laws, usually updated with the western legislation, have been promulgated. Nevertheless, concerning a number of intellectual ownership elements, there is still incomplete knowledge in our country, while intellectual ownership has not won its deserved status yet.

Comparative analysis of communication strategies for accession to the EU – lessons for Kosovo

Zoran Tomić

Dario Malnar

Muhamet Sadiku

Abstract. On grounds of applying the European Union membership, in its two sessions, the government of the Republic of Croatia adopted the Communication Strategies to inform the Croatian public about the EU and membership preparations. The implementation of this strategy remains among the priorities of the coalition government formed after the elections held on 25 November 2007. Taking into consideration the great expectations of the Government and public, the authors analyze the strategy of the Government of the Republic of Croatia, and its specific entirety and compare it to the strategies of Slovenia, Bulgaria, Slovakia, Latvia and Serbia. By comparing the specified strategies through objectives, target public, techniques and canals of communication, the authors indicate specific shortcomings and recommend possible steps to make the Strategy more applicable and more efficient, and thus accomplish the proclaimed objectives. Theoretical observations defined in that way are given as an empirical model to describe the communication strategy for Kosovo.

The End of Oil and Petropolitics in the 21st Century

Fatos Tarifa

Romeo Gurakuqi

Irena Nikaj

Joshua Ludy

Abstract. Is there an energy crisis looming on the horizon? If so, how dire is the forecast and what does it mean for America's global standing as the world's hegemon? Maybe a more skeptical—yet logical line of questions—would involve the United States itself acknowledging its position as the world's dominant nation, its desire to retain the status of the sole superpower and the lengths it may go to in ensuring the maintenance of U.S. hegemony. If the world is dependent on oil, and the world is slowly waking up to the fact that oil is running out and will not continue to be available in the relatively cheap—and seemingly endless—supplies the world has come to know over the last hundred years, will this alter the behavior and attitudes of the United States and, perhaps, those of other states? Does the U.S. opine that the best way to ensure her hegemonic status would be to make sure, first and foremost, that it was never wanton for energy; and secondly, to make sure that potential competitors were?

Economy of knowledge – USA and Europe at different velocities

Evis Sulko

Abstract. The recent European Commission Report on Technology and Science Indicators, tolls the bells of alarm over the European situation with regard to economy of knowledge. While Europe had foreseen the investment of 3% of its GDP on R&D until the end of 2010, presently it is still too far from its objective with only 1.8% of its GDP spent on R&D. While Japanese and South-Korean private sectors contribute with 75% to total R&D, the European private business contributes with only 55% while in decline since 2000. Europe produces only 34 patents (Triadic) per 1 million inhabitants, while America produces 68, and Japan produces 106. Employees in science-technology sectors (with a degree in the respective field) consist 15.4% of

European work force. This figure is over 20% in USA, over 22% in Japan, while in some countries this indicator is up to 25%. The European strategy for overcoming this situation, drafted in 2000, did not bring the expected outcome. Presently, European policymakers seem to be more confused than ever not only with regard to the reasons this strategy failed, but also more impertinently with regard to the way to go. While the dilemma is not solved yet, it seems that the “old” continent will need much more time to “renovate” itself.